



RAPORT

(Auditim financiar dhe përputhshmërie)

BASHKIA PATOS

Tiranë 2024

PËRMBAJTJA

I. Përmbledhje ekzekutive	4-7
1.1 Konkluzioni dhe Opinioni i auditimit	7-14
<i>II. Hyrja.....</i>	
<i>a. Objektivat e auditimit.....</i>	
<i>b. Qëllimi i auditimit.....</i>	
<i>c. Identifikimi i çështjes.....</i>	
<i>d. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.....</i>	
<i>e. Përgjegjësitë e audituesve.....</i>	
<i>f. Kriteret e vlerësimit</i>	
<i>g. Standardet e auditimit.....</i>	
<i>h. Metodologjia e auditimit.....</i>	
<i>l. Dokumentimi i auditimit</i>	
III. REZULTATET E AUDITIMIT.....	14-144
3.1. Mbi menaxhimin financiar, kontrollin dhe auditin e brendshëm	14-34
3.2 Mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit.....	34-40
3.2.6. Vlerësimi dhe mbledhjes së të ardhurave.....	40-49
3.3 Mbi vlerësimin e raportimit financiar, për pasqyrat financiare 2023	49-59
3.4 Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik,.....	59-100
3.4.1 Auditim mbi zbatimin e kontratave të punimeve në investimet publike.	100-140
3.5 Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e planifikimit dhe zhvillimit të territorit.....	140-143
3.6 Mbi organizimin dhe funksionimin e IMT –së, të Njësisë Vendore.	143-144
3.7 Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme	144-182
IV. GJETJE DHE REKOMANDIME	182-199

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin

Zona gjeografike: Bashkia e re e Patosit kufizohet në veri dhe perëndim me bashkinë Fier, në jug me bashkinë Mallakastër dhe në lindje me bashkinë Roskovec. Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Patosit.

Popullsia: Sipas Censurit të vitit 2011 Bashkia e re Patos ka një popullsi prej 22.959 banorësh, ndërsa në regjistrin civil rezultojnë banues 42.738 banorë. Territori i bashkisë së re është vetëm 82.5 km². Në bazë të të dhënave të regjistrit civil densiteti i popullsisë është 518 banorë për km² ndërsa në bazë të censurit densiteti i popullsisë është 278.3 banorë për km².



Të dhëna të tjera: Qyteza e Patosit nisi të ndërtohej rreth vitit 1949 për të strehuar punëtorët dhe inxhinierët e naftës. Baseni naftëmbajtës i njohur si “Patos-Marinza” është historikisht zona më e pasur me naftë në Shqipëri dhe sot vijon të prodhojë shumicën dërrmuese të naftës bruto në vendin tonë. Por pavarësisht kësaj, numri i të punësuarve në industrinë e naftës nga kjo zonë është sot shumë herë më i ulët se sa ka qenë dikur.

Për shumë vite burimi kryesor ekonomik ka qenë sektori naftënxjerrës, por pasi kanë nisur operimin në tregun e naftës kompanitë e huaja niveli i të punësuarve në këtë sektor ka ndryshuar, duke sjellë një përqendrim gjithnjë e më të madh tek sektori i bujqësisë dhe agrikulturë. Sipas të dhënave tashmë, përveç ish komunës Zharrës, zonat e tjera si Patosi dhe Ruzhdia kanë si burim kryesor ekonomik kultivimin e ullirit dhe tregtimin e nënprodukteve të tij, të cilat favorizohen dhe nga vetë relievi kodrinor i kësaj zone.

Më tej është sektori privat i shërbimeve ai që siguron të ardhurat për zonën urbane dhe vitet e fundit kanë nisur aktivitetin në këtë njësi vendore edhe bizneset fashione. Për shkak të relievit malor, në këtë bashki ka zona të largëta me qendrën e bashkisë, popullsia e tyre është reduktuar ndjeshëm për shkak të zhvendosjes drejt qendrave urbane të vendit ose drejt vendeve fqinje.

Kuadri ligjor: Bashkia Patos e ushtron aktivitetin e saj mbështetur në dispozitat ligjore/nënligjore për se cilën fushë të aktivitetit të saj, të cilat janë të specifikuar në programin e auditimit dhe në aneksin bashkëlidhur. Bashkia Patos në veprimtarinë e tij drejtohet nga Kryetari i Bashkisë dhe Këshilli Bashkiak përbëhet nga 21 anëtarë.

a. Përshkrim i shkurtër i institucionit dhe një informacion mbi buxhetin:

Bashkia Patos, si të gjitha njësitë e tjera të vetëqeverisjes vendore ka kuadrin legjislativ dhe operues, bazë e të cilave janë ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe ligji nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, krahas akteve të tjera ligjore, nënligjore dhe rregullatorë.

Rëndësia e auditimit financiar dhe të përputhshmërisë të Bashkisë Patos për periudhën e aktivitetit të viti 2023, krahas detyrimit kushtetues dhe ligjor që konsiston në kontrollin e përdorimit dhe mbrojtjes së fondeve shtetërore nga organet e pushtetit vendor, pra njësitë e vetëqeverisjes vendore janë subjekt i kontrollit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, sipas legjislacionit në fuqi, qëndron në të bërit sa më transparente të veprimtarisë menaxhuese dhe administruese, për të rritur përgjegjshmërinë dhe llogaridhënien e të zgjedhurve dhe administratës publike, në funksion të rritjes së mirëqenies së qytetarëve.

b. Rëndësia e institucionit dhe e auditimit të tij

Rëndësia e auditimit financiar dhe të përputhshmërisë të Bashkisë Patos për periudhën e aktivitetit 2023, krahas detyrimit kushtetues dhe ligjor që konsiston në kontrollin e përdorimit dhe mbrojtjes së fondeve shtetërore nga organet e pushtetit vendor, pra njësitë e vetëqeverisjes vendore janë subjekt i kontrollit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, sipas legjislacionit në fuqi, qëndron në të bërit sa më transparente të veprimtarisë menaxhuese dhe administruese, për të rritur përgjegjshmërinë dhe llogaridhënien e të zgjedhurve dhe administratës publike, në funksion të rritjes së mirëqenies së qytetarëve.

c. Qëllimi i auditimit ku përcaktohet dhe periudha nën auditim, paraqitja e objektivave të cilat janë të njëjta me drejtimit e auditimit të tij:

Për auditimin financiar, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve është paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe atë të shpenzimeve. Qëllimi i auditimit të pasqyrave financiare është që ti bëhet e njohur nivelit drejtues të bashkisë, si dhe rritja e shkallës së besimit të përdoruesve të pasqyrave financiare, nëpërmjet shprehjes së një opinionit nga ana jonë nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar, si një mekanizëm kontrolli për të siguruar përgjegjshmërinë në menaxhimin financiar.

Në përmbushje të qëllimit të auditimit, janë shqyrtuar çështjet e mëposhtme:

- Funksionimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit.
- Organizimi dhe vlerësimi i veprimtarisë së Njesisë së Auditit të Brendshëm.
- Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit.
- Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitin 2022.
- Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, si dhe zbatimin e kontratave të punimeve.
- Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e planifikimit dhe zhvillimit të territorit.
- Mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Mbrojtjes së Territorit të Njesisë Vendore (IMTV).

d. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave.

Është përdorur metoda me auditim të njëpasnjëshëm dhe me zgjedhje periudhash. Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në subjektin që auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me efikasitet dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku. Nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur, bëhet përzgjedhja e kandidateve për ekzaminim në zërat e shpenzimeve.

Vlerësimi bazuar në riskun dhe materialitetit. Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesit e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar. Në dhënien e opinionit kemi marrë parasysh nivelin e materialitetit prej 21,141 mijë lekë, i cili është llogaritur mbi zërin e shpenzimeve.

Për arritjen e konkluzionit vlerësues, janë përdorur teknikat e auditimi si: Kontrolli aritmetik, Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese, Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese, Kontrolli i vlerësimit, Konfirmim nga të tretët. Kontrolli sipas një treguesi, Verifikimi i

transaksioneve Intervistimi, Raporte dhe informacione, Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm.

e. Nga shqyrtimi i evidencave rezultoi se institucioni për periudhën nénauditim paraqet të meta dhe mangësi në disa prej drejtimeve veprimtarisë. Grupi i auditimit ka konstatuar 38 gjetje dhe ka dhënë 32 rekomandime, nga ku masa organizative me 21 gjetje dhe 24 rekomandime, 5 gjetje-rekomandime shpërblim dëmi në fushën e zbatimit të kontratave të punimeve në vlerën **11,772 mijë lekë**, dhe 3 gjetje-rekomandime në vlerën **207,517 mijë lekë** në fushën e të ardhurave.

f. Paraqitja e gjetjeve kryesore. Disa nga problematikat e konstatuara lidhen me:

▪ ***Procedurat e zbatimit të kontratave të punimeve të ndërtimit***

- Në **5 raste** janë konstatuar punime të pakryera me një **dëm ekonomik në vlerën 11,772 mijë lekë** projektet e investimit me objekt:

- Në **3 raste** KVO ka s'kualifikuar OE me oferta më ulëta ose më të favorshme për devijime të

- Në **5 raste** u konstatuan mangësi që lidhen me hartimin e kriterëve për kualifikim, të cilat nuk janë në përputhje me natyrën dhe objektin e prokurimit dhe nuk i përshtaten procedurës së zhvilluar.

- Në **1 rast** u konstatua se nga AK Bashkia Patos në procedurën me objekt "Rikonstruksion i Çerdhes Patos me hapësirat përreth" për pajisjet dhe grup pajisjet nuk janë vendosur specifikimet teknike, "Treguesit kryesor teknik sipas pasaportës teknike", duke krijuar mundësin e spekulimit të OE pjesëmarrës në garë për të vendosur instaluar pajisje me tregues teknik me të ulët, ***Procedurat e miratimit të lejeve të ndërtimit.***

- Në **1 rast** nuk janë respektuar kondicionet urbane të parashikuara në ligj, siç janë respektimi i distancave që objektet bujqësore duhet të ruajnë nga banesa më e afërt, e veçuar nga qendra urbane.

- Në **3 raste** mangësi në projektin ndërtimor, dokumentacionin shoqërues të tij, si dhe dokumentacionin e kërkuar në ligj për pajisjen me leje ndërtimi ose certifikatë përdorimi. Më konkretisht, këto anomali kanë të bëjnë me: projekti konstruktiv është nënshkruar elektronikisht nga drejtori i Drejtorisë së Hartimit të Projekteve, Shërbimeve dhe Emergjencave Civile, gjithashtu, ka kryer dhe aplikimin online për lejen e ndërtimit gjatë orarit të punës; rifreskimin e kartelave të pasurisë gjatë tre muajve të fundit; aktet e kontrollit sipas fazave të ndërtimit nuk janë përpiluar dhe dorëzuar elektronikisht; mungon akti përkatës i lëshuar nga institucionet kompetente për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin; mungon projekti as-built; mungojnë fotografitë e objektit në të gjitha drejtimet.

- Në **2 raste** DPKZHT dhe Bashkia Patos nuk kanë kërkuar dhe respektuar mendimin e autoriteteve publike që duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit. Më konkretisht, këto anomali kanë të bëjnë me: Mos-marrjen mendimi nga Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrë (ASHK) dhe Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST).

-Në **1 rast** ka mangësi në lidhje me inspektimin e objekteve me leje ndërtimi të miratuar. Më konkretisht, këto anomali kanë të bëjnë me mos-evidentimin e shmangieve midis projektit të miratuar dhe objektit të ndërtuar (aksesi për në objekt nuk është realizuar sipas projektit të miratuar).

▪ ***Procedurat e planifikimit dhe realizimit të të ardhurave.***

- Të ardhura të munguara në vlerën **160,265 mijë lekë** nga mos arkëtimi i taksave dhe tarifave vendore nga debitorë e biznesit, institucioneve dhe familjare.

- Të ardhura të munguara në vlerën **39,904 mijë lekë** nga mos arkëtimi i taksës së ndikimit në infrastrukturë nga 1,158 persona debitorë.

- Të ardhura të munguara në vlerën **5,350 mijë lekë** nga mos arkëtimi i tarifës së autorizimit për ushtrim aktiviteti tregtimi hidrokarbure dhe derivatet e tyre nga 5 subjekte të palicencuara.

▪ ***Procedurat e ndjekura për inventarizimin dhe regjistrimin e aseteve.***

Nga auditimi rezultoi se, janë 1324 të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, të transferuara në pronësi ose në përdorim Bashkisë Patos (Qendër) me VKM. Referuar Ligjit 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë” është bërë një inventarizim i plotë i të gjitha pronave që i janë transferuar organeve të pushtetit vendor duke saktësuar të dhënat mbi këto prona, ku sipas inventarizimit faktik rezultuan 2,803 prona.

h. Paraqitja e rekomandimeve kryesore: Me qëllim zgjidhjen e problematikave, janë dhënë disa rekomandime si vijon:

- Bashkia Patos në lidhje me **zbatimin e kontratave të punimeve të ndërtimit** të kërkojë në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjyqimit, nga sipërmarrësit e punimeve arkëtimin e vlerës prej **11,771 mijë lekë** të faturuara dhe të paguara nga AK, të konstatuar dëm ekonomik nga mos kryerja e punimeve. Të merren masa që për të gjitha punët publike, të kryhet Oponenca Teknike para fillimit të procedurës së prokurimit. Nga Kryetari i Bashkisë Patos të merren masa për ngritjen e grupit për kolaudimin e objektit objekt “Rikonstruksion i çerdhes Patos me hapësirat përreth”, me qëllim marrjen në dorëzim të punimeve. Bashkia Patos të merren masa që për të gjitha punët publike të parashikuara për tu realizuar të kryhet Oponenca Teknike para fillimit të procedurës së prokurimit.

- Bashkia Patos **në lidhje me të ardhurat**, të marrë masa dhe të ndjekë të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore në vlerën **160,265 mijë lekë** nga taksapaguesit të biznesit, institucione shtetërore, familjarë, fermerë, individë etj.

- Nga Drejtoria e Planifikimit Urban, Lejeve dhe Monitorimit të Investimeve **në lidhje me lejet ndërtimit**, të merren të gjitha masat për të respektuar kondicionet urbane, ku në çdo rast të ruhen distancat nga kufiri i pronës sipas përllogaritjes së parashikuar në rregullore. Të kërkojë çdo subjekti që aplikohen për pajisje me leje ndërtimi ose çertifikatë përdorimi, të gjithë dokumentacionin e nevojshëm dhe të detyrueshëm, të projektit ndërtimor dhe dokumentacionit shoqëruar të tij, sipas kuadrit rregullator dhe ligjor në fuqi dhe të ngarkuar në sistemin elektronik. Në çdo rast që aplikohet për leje ndërtimi, të merret mendimi i autoriteteve, të cilat duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit. Të marrë të gjitha masat për të përllogaritur në mënyrë të saktë sipërfaqen ndërtimore me funksion banim e pjesë takuese të sipërfaqeve të përbashkëta për çdo aplikim për pajisje me leje ndërtimi.

I.1. Konkluzioni dhe Opinioni i auditimit

a. Opinioni mbi pasqyrat financiare

Në kemi audituar pasqyrat financiare të Bashkisë Patos për vitin ushtrimor nga 01.01.2023 – 31.12.2023, të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar, pasqyrën e performancës financiare, pasqyrën e ndryshimeve të aktiveve, pasqyrat e fluksit të mjeteve monetare dhe shënimet shpjeguese që shoqërojnë këto pasqyra. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumatat në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Opinioni:

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare vjetore paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozitën financiare të subjektit Bashkia Patos më 31 dhjetor 2022, referuar kuadrit rregullator; Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik; Standardet Kombëtare të Kontabilitetit; Udhëzimi i MFE nr. 8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar mbi të cilat subjekti i audituar është mbështetur për përgatitjen e pasqyrave financiare.

Baza për opinionin e pamodifikuar/pakualifikuar për auditimin financiar:

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e audituesit për pasqyrat financiare. Ne jemi të pavarur nga Subjekti Bashkia Patos, në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Opinionin e pamodifikuar/pakualifikuar e mbështesim në faktin se; pasqyra e pozicionit financiar, pasqyra e performancës financiare, pasqyra e ndryshimeve në kapital, pasqyra e flukseve e mjeteve monetare, si dhe shpjegimet mbi to, janë përfshirë në deklaratat financiare, si dhe nuk përmbajnë gabime materiale.

Në dhënien e opinionit kemi marrë parasysh nivelin e materialitetit prej 21,141 mijë lekë, i cili është llogaritur mbi zërin e shpenzimeve.

Theksojmë nevojën e marrjes së masave nga ana e drejtimit e më pas në linjë hierarkike nga gjithë personeli i subjektit Bashkia Patos, sa i takon llogarive të mëposhtme:

- Llogaria 466 “Kreditore për mjete nën ruajtje”, është mbivlerësuar për vlerën **35,120 mijë lekë**, në fund të vitit 2023;

- Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm”, është nënvlerësuar për vlerën **207,517 mijë lekë**, në fund të vitit 2023.

b. Opinion i auditimit të përputhshmërinë.

Ne audituam përputhshmërinë e veprimtarisë së subjektit Bashkia Patos për periudhën 01.01.2023 deri më 31.12.2023, sa i takon shkallës së zbatueshmërisë nga subjekti të ligjeve, vendimeve rregullave dhe rregulloreve, udhëzimeve politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord, nëpërmjet: a) auditimit të sistemeve financiare dhe transaksioneve, duke përfshirë edhe vlerësimin e përputhshmërisë me ligjet dhe rregulloret; b) auditimit të sistemit të kontrollit të brendshëm financiar publik; c) auditimit të integritetit dhe përputhshmërisë së vendimeve administrative të marra nga subjekti i audituar, d) raportimin e të gjitha çështjeve të tjera që dalin nga apo që lidhen me auditimin, të cilat Kontrolli i Lartë i Shtetit i konsideron të rëndësishme për t'u bërë publike.

Opinionin:

Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe dokumentacionin e kërkuar dhe të vënë në dispozicion kemi konstatuar se në veprimtarinë e subjektit Bashkia Patos janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, që nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një opinionin të modifikuar/kualifikuar”, e shprehur kjo në bazën për opinion.

Baza për opinionin e modifikuar/kualifikuar të përputhshmërisë:

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Auditimi ynë përfshin kryerjen e procedurave me qëllim marrjen e evidencave të auditimit, mbi ligjshmërinë dhe rregullshmërinë e veprimtarisë të ushtruar nga subjekti i audituar. Procedurat janë përzgjedhur mbështetur mbi gjykimin profesional të audituesit, duke marrë në konsideratë vlerësimin e riskut dhe materialitetit për subjektin e audituar. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për dhënien e opinionit të modifikuar/kualifikuar të përputhshmërisë. Nga evidencat e marra për veprimtarinë e Bashkisë Patos rezultuan:

-Bashkia Patos nuk ka ngritur një sistem efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke mos hartuar një kuadër të plotë rregullash të shkruara për këtë qëllim.

-Nuk janë marrë masa të plota për arkëtimin e detyrimeve të prapambetura nga debitorët në mënyrë

progresive më datën 31.12.2023, në vlerën **207,517 mijë lekë**.

Në **6 raste** nga auditimi i procedurave të prokurimit të zhvilluara përgjatë periudhës 01.01.2023-31.12.2023, u konstatua se në dokumentet standarde të tenderit nuk është argumentuar plotësisht vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimeve teknike.

Në **3 raste** nga auditimi i procedurave të prokurimit të zhvilluara përgjatë periudhës 01.01.2023-31.12.2023, u konstatua se OE janë shpallur fitues në kushtet e mos përmbushjes së kriterëve të veçanta të kualifikimit të përcaktuara në DT.

Në **3 raste**, janë konstatuar mangësi në projektin ndërtimor, dokumentacionin shoqërues të tij, si dhe dokumentacionin e kërkuar në ligj për pajisjen me leje ndërtimi ose çertifikatë përdorimi.

Në **4 raste**, janë konstatuar punime të porealizuara sipas kushteve të preventivit në zbatimin e kontratave të punëve publike me vlerë 11,772 mijë lekë, dëm ekonomik.

II. HYRJA

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” dhe në zbatim të Programit të Auditimit nr. 30/1 Prot, datë 10.01.2024, ndryshuar me shkresën nr. 30/2 Prot., datë 12.02.2024, miratuar nga Kryetari i KLSH-së, nga data 15.01.2024 deri në datën 01.03.2024, në subjektin Bashkia Patos u krye “Auditimi Financiar dhe i Përputhshmërisë për periudhën 01.01.2023 - 31.12.2023. Grupi i auditimit përbëhej nga audituesit:

- 1.H.I – Përgjegjës Grupi
- 2.R.L – Anëtar
- 3.S.J – Anëtar
- 4.B.B – Anëtar
- 5.S.M – Anëtar

OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA.

Objekti dhe qëllimi i auditimit: Objekti i auditimit financiar është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, nëse për vitin 2023, transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, në referencë të kuadrit ligjor të raportimit financiar në fuqi.

Në auditimin e përputhshmërisë synohet dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve të aktivitetit të subjektit për periudhën e aktivitetit të audituar.

Për auditimin financiar, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve është paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe atë të shpenzimeve.

Qëllimi i auditimit të pasqyrave financiare është që ti bëhet e njohur nivelit drejtues të bashkisë, si dhe rritja e shkallës së besimit të përdoruesve të pasqyrave financiare, nëpërmjet shprehjes së një opinionit nga ana jonë nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar, si një mekanizëm kontrolli për të siguruar përgjegjshmërinë në menaxhimin financiar.

Në përfundim të auditimit, hartohet Raporti Përfundimtar i auditimit, i cili përfshin dhënien e opinionit mbi bazën e vlerësimeve dhe të gjetjeve, si dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësimin e veprimtarisë së Bashkisë Patos.

Identifikimi i çështjes: Të përcaktojë nivelin e duhur të materialitetit, duke i mundësuar kryerjen e saktë të auditimit (ISSAI 13), nëpërmjet një pune audituese sistematike me zgjedhje, duke saktësuar përputhshmërinë ligjore të akteve normative me qëllim që auditimi t'i shërbej subjektit në marrjen e masave në përmirësimin e punës në të ardhmen dhe për të bërë të mundur evidentimin në kohë të mangësive dhe shkeljeve për përmirësimin e gjendjes.

Sipas përcaktimit të ISSAI 100 *“Auditimi i përputhshmërisë, përcakton se deri në çmasë subjekti i audituar ndjek rregullat, legjislacionin dhe aktet normative, politikat, kodet e miratuara apo kushtet e përcaktuara si, kushtet e kontratës apo klauzolat e një marrëveshjeje financimi”*, duke ofruar raporte të besueshme për fondet nëse janë administruar dhe të drejtat e qytetarëve për një proces të rregullt, nëse janë respektuar siç kërkohet nga kuadri ligjor, rregullator në fuqi.

Raporti i auditimit, synon të identifikojë përmbushjen e rolit të njësisë vendore dhe përgjegjësi të saj, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve dhe shërbimeve në dobi të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e Bashkisë Patos, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave dhe nevojave të tyre.

Saktësia, rregullshmëria, ndodhja e transaksioneve kontabël dhe regjistrimi i tyre me korrektësi dhe në përputhje me kuadrin e raportimit financiar në fuqi.

Në bazë të kriterëve të vlerësimit e gjykimit profesional, audituesit kanë bërë vlerësimin e rezultateve të testeve të kontrollit, analizimin dhe klasifikimin e gabimeve të zbuluara, si dhe është bërë vlerësimi i evidencave të grumbulluara përsa i përket mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë për qëllimet e auditimit. Procedurat e kryera, varen nga gjykimi profesional i audituesit, përfshirë vlerësimin e rrezikut material, për shkak të mashtrimit apo gabimit që do përdoren për procedura auditimi që janë me të përshtatshme për rrethanat.

Nisur nga procedurat e ndjekura për auditim besojmë se evidencat e mbledhura janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të dhënë opinionin tonë mbi veprimtarinë ekonomiko-financiare të Bashkisë Patos.

Përgjegjësitë e strukturave drejtuese. Kryetari i Bashkisë Patos (Administratori i Përgjithshëm), në cilësinë edhe të Nëpunësit Autorizues (NA) dhe Drejtori i Financës, në cilësinë e Nëpunësit Zbatues (NZ), janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin normativ të zbatueshëm të raportimit financiar në sektorin publik dhe për mirëfunksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, i cili garanton përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare. Gjithashtu, në cilësinë edhe të NA si dhe NZ, janë përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Bashkisë Patos, bazuar në ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 *“Për vetëqeverisjen vendore”*, konkretisht neni 34/6, neni 65/1 dhe neni 91, pika 1.3.

NA i njësisë së vetëqeverisjes vendore, në cilësinë e titullarit të kësaj njësie është përgjegjës për menaxhimin financiar aktivitetin e bashkisë.

Titullarët e njësive publike përgjigjen për vendosjen e përmbushjen e qëllimeve dhe të objektivave të njësive publike, nëpërmjet krijimit të një sistemi të përshtatshëm dhe efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe përdorimit të fondeve publike, në mënyrë të ligjshme, me ekonomi, efektivitet dhe efikasitet.

Këshilli i njësisë së qeverisjes vendore, me vendim të veçantë, miraton të ardhurat dhe fondet buxhetore vjetore për njësitë e qeverisjes vendore dhe fondet speciale të tyre, me qëllim kryerjen e shpenzimeve për ushtrimin e funksioneve që kanë, si dhe huamarrjen, për financimin e projekteve të investimeve.

Strukturat drejtuese të subjekteve të audituara kanë përgjegjësi që t'i dorëzojnë dokumentet zyrtare, shkresore apo elektronike, si dhe informacionin e kërkuar, në kushtet, afatet dhe strukturën e vendosur prej grupit të auditimit të KLSH-së.

Përgjegjësitë e audituesve. Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion në lidhje me pasqyrat financiare Bashkisë Patos dhe një opinion në lidhje me përputhshmërinë e aktivitetit të subjektit të audituar je me aktet ligjore dhe nënligjore për buxhetin, prokurimin dhe menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI sipas INOTSAI-t, të cilat kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike dhe të planifikojë dhe kryejë auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, sipas evidencës së kërkuar dhe të vënë në dispozicion të auditimit.

Audituesit kanë zbatuar parimet e auditimit financiar: Etika dhe pavarësia, Kontrolli i cilësisë, Menaxhimi i grupit të auditimit dhe aftësive të tyre, si dhe Parimet lidhur me konceptet bazë të auditimit.

Gjithashtu, janë zbatuar pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim, si përkatësia, plotësia, saktësia, vlerësimi, periudha, klasifikimi, kushtetueshmëria, ligjshmëria rregullsisë, ekzistenca, plotësia, alokimi, transaksionet, të drejtat dhe detyrimet.

Në cilësinë e audituesit të jashtëm publik, kemi përgjegjësinë për garantimin e sigurisë së arsyeshme, nëse veprimtaria e Bashkisë Patos është zhvilluar në përputhje me kriteret e paracaktuara, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesit e KLSH-së kanë aplikuar gjykimin dhe skepticizmin profesional gjatë veprimtarisë audituese.

Audituesit kanë përgjegjësi në identifikimin e çështjeve më të rëndësishme lidhur me auditimin e veprimtarisë së subjektit, në raport me kriteret e paracaktuara të auditimit, të nxjerra nga aktet ligjore, nënligjore, si dhe ato rregullative mbi të cilat subjekti i audituar mbështetet në ushtrimin e veprimtarisë së tij, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

Audituesit kanë përgjegjësi që të zbatojnë parimet që lidhen me procesin e auditimit, të sanksionuara në ISSAI/IFPP-100 “*Parimet themelore të auditimit të sektorit publik*”, paragrafi 44-51.

Kriteret e vlerësimit. Auditimi është bazuar në ligjin nr. 154/14, datë 27.11.14 “*Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, Manualin e Auditimit Financiar, Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë, në kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, si dhe në referenca të tjera ligjore sa më poshtë:

- *Në fushën e Menaxhimit financiar dhe kontrollit:* Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar; Ligji nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “*Për auditimin e brendshëm publik*”; Ligji nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “*Për vetëqeverisjen vendore*”, i ndryshuar; Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “*Për financat e vetëqeverisjes Vendore*”; VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “*Për miratimin e kriterëve të krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik*”; Udhëzimi i Ministrisë Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*” i ndryshuar; Udhëzimi i Ministrisë Financave nr. 21, datë 25.10.2016, “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin, Njësia Zbatues*”; Urdhri i MF nr. 54, datë 15.07.2010 “*Për miratimin e manualit të MFK*”; Urdhri i ministrit Financave nr. 100, dt. 16.10.2017 “*Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik*”.

- *Në fushën e buxhetit dhe administrimit financiar:* Ligji nr. 25/2018, datë 10.05.2018 “*Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare*”; Ligji nr. 137/2020 “*Për buxhetin e vitit 2021*” dhe Ligji nr. 115/2021 “*Për buxhetin e vitit 2022*”, si dhe aktet normative që ndryshojnë këto ligje; Ligji nr. 9869, datë 04.02.2008 “*Për huamarrjen e qeverisjes vendore*”; Ligji nr. 48/2014, datë 24.04.2014

“Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare” i ndryshuar; VKM 783 datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël”; Udhëzimi i MF nr. 8, datë 29.03.2012 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”; UMFE nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” etj.; Udhëzimit i MF nr. 2, datë 02.06.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar; Udhëzimi MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme” i ndryshuar; Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 5, datë 27.02.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura” i ndryshuar; Udhëzimi i MF nr. 10/1, datë 28.02.2017 “Për përgatitjen e buxhetit vendor”; Udhëzimin plotësues të Ministrisë Financave nr. 4, datë 25.01.2021 “Për zbatimin e buxhetit e vitit 2021”, pikat 88-125; Udhëzimin plotësues të Ministrisë Financave nr. 1, datë 10.01.2022 “Për zbatimin e buxhetit e vitit 2022”, pikat 95-122; Udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të vetëqeverisjes vendore”.

- Në fushën e mbajtjes Kontabilitetit dhe Hartimit të Pasqyrave Financiare: Ligji nr. 25/2018, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”; VKM nr. 248, datë 10.4.1998 “Për miratimin e planit kontabël publik, për organet e pushtetit lokal, institucionet shtetërore, qendrore dhe lokale, si dhe të njësive që varen prej tyre” i ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001; VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimi i standardeve dhe të rregullave kontabël”; VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiviteteve dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial”; Udhëzimi i MF nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme” i ndryshuar; Udhëzimi përbashkët i Ministrisë të Çështjeve Vendore dhe Ministrisë Financave nr. 3237 datë 16.07.2015 “Për procedurat afatet kohore standartet dhe kriteret e plotësimit të dokumentacionit të nevojshëm për riorganizimin administrativo-territorial”, udhëzimi i MFE nr. 26, datë 27.9.2019 “Procedura për menaxhimin e vështirësive financiare për njësitë e vetëqeverisjes vendore” .

- Në fushën e prokurimeve publike: Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar; Ligji nr. 162/202, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar; VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe akteve të tjera nënligjore të prokurimit publik”, i ndryshuar; VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe akteve të tjera nënligjore të prokurimit publik”, i ndryshuar; Udhëzim i Agjencisë Prokurimit Publik nr. 1, datë 01.2.2013 “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla”, i ndryshuar; Urdhri i MF nr. 33, datë 11.07.2013 “Për gjurmët standarde të auditimit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë”.

- Në fushën e administrimit të taksave dhe tarifave vendore: Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar”; Ligji nr. 9632, datë 30/10/2006 “Për sistemin e taksave lokale”, i ndryshuar; Ligji nr. 9975, datë 28.7.2008, “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar; VKM nr. 170, datë 25.4.2002 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre”, me ndryshime; VKM nr. 1064, datë 22.12.2010, “Për disa ndryshime në VKM nr. 391, datë 21.06.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”; Udhëzim i MF nr. 24, datë 02.9.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

- Në fushën e ndërtimeve, zbatimit të punimeve dhe kontrollit të territorit: Ligji nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”; Ligji nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”; Ligji nr. 10448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”; Ligji Nr. 107-2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”; Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; VKM nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e

manualeve të ndërtimit”; VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit, e përditësuar*”; VKM nr. 894, datë 4.11.2015 “*Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore*”; Udhëzimi i KM nr. 1, datë 18.7.2012 “*Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara*” dhe si dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore që kanë si objekt tokën bujqësore.

Në fushën e marrëdhënieve të punësimit dhe pagave: Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 “*Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë*”, i ndryshuar; Ligji nr. 152-2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar; Ligji nr. 10405, datë 24.3.2011, “*Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve*”, i ndryshuar; VKM nr. 187, datë 08.03.2017, “*Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë*”, i ndryshuar; VKM nr. 165, datë 02.03.2016, “*Për pagat e vetëqeverisjes Vendore*”, i ndryshuar.

Standardet e auditimit. ISSAI 100 “*Parimet themelore të auditimit të sektorit publik*”, i cili përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi; ISSAI 2000-2899 “*Udhëzues të Auditimit Financiar*”; ISSAI 2300 “*Planifikimi i auditimit të pasqyrave financiare*”; INTOSAI GOV 9100 “*Udhëzues mbi Standardet e Kontrollit të Brendshëm për Sektorin Publik*” si dhe INTOSAI GOV 9110 “*Udhëzues mbi raportimin e efektivitetit të kontrolleve të brendshëm*”; ISSAI 400 “*Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë*”, i cili përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë; ISSAI 4000 “*Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë*”; si dhe ISSAI 4200 “*Udhëzime për auditimin e përputhshmërisë*”; INTOSAI “*Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë*” etj.; Standardet Kombëtare të Kontabilitetit; Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilistëve IFAC; Manuali i Auditimit Financiar dhe i Përputhshmërisë të KLSH-së; Manuali i Auditimit të Brendshëm etj. Standardet Ndërkombëtare të Auditimit mbi Raportimin e Audituesit të Pavarur, (IFAC); Praktika të mira të fushës, si manualët e Gjykatës Evropiane të Audituesve, Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t etj.; Kodit Etik dhe Rregullorja e Procedurave të Auditimit të KLSH-së.

Metodat e auditimit. Është përdorur metoda me auditim të njëpasnjëshëm dhe me zgjedhje periudhash. Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në subjektin që auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me efikasitet dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku. Nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur, bëhet përzgjedhja e kampioneve për ekzaminim në zërat e shpenzimeve.

*Vlerësimi bazuar në riskun dhe materialitetin*¹. Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesit e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t’u audituar.

Për arritjen e konkluzionit vlerësues, janë përdorur teknikat e auditimit:

- **Kontrolli aritmetik.** Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve

¹ *ISSAI 1320 (ISA 320) trajtojnë përgjegjësinë e audituesit për të zbatuar konceptin e materialitetit në planifikimin dhe kryerjen e një auditimi të pasqyrave financiare, në funksion të zbulimit dhe korrëgjimit të anomalive. Një trajtim i tillë i ngjashëm mund të përdoret edhe në rastet e auditimit të përputhshmërisë, ku natyrisht një rol të rëndësishëm ka gjykimi profesional i audituesit.*

në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim. (Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve)

- *Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese.* Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë asnjë gabim aritmetik, ai mund të jetë i gabuar, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje i pjesëve justifikuese (Urdhër shpenzimeve) konstatoi nëse shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar. UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “*Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”.

- *Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese.* Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminon përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, duke u siguruar edhe për ekzistencën reale të aktiveve në subjekt.

- *Kontrolli i vlerësimit.* Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

- *Konfirmim nga të tretët.* Nëse subjekti që auditohet ka të konfirmuara (Rakorduar) me të tretët informacionet që vërtetojnë ekzistencën e operacioneve, detyrimeve, të tepëricave ose të çdo regjistrimi tjetër.

- *Kontrolli sipas një treguesi.* Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna “*jashtë normales*”, që përbëjnë tregues të parregullsive kontabël. Mund të përmendim: mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, të emrave, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave etj.

- *Verifikimi i transaksioneve* - është marrë informacioni për një rrethanë ose transaksion nga dy burime duke kryer krahasueshmërinë e tyre.

- *Intervistimi* - është përdorur gjatë marrjes verbale të informacionit nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit që auditohet.

- *Raporte dhe informacione* - janë shfrytëzuar raporte, analiza dhe informacione të cilat lidhen me objektivat e auditimit dhe çështjet për trajtim.

- *Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm* – grupi i auditimit ka përdorur pyetësorin e vetëvlerësimit të subjektit duke verifikuar çdo raportim të tij në lidhje me 5 komponentët e funksionimit të sistemit së kontrollit të brendshëm të subjektit.

Dokumentimi i auditimit. Është mbështetur në kërkesat e Manualeve të Auditimit Financiar dhe atij të përputhshmërisë, si edhe në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit: ISSAI 1230 “*Dokumentimi i Auditimit*”, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore.

Nga audituesit është përgatitur dokumentacioni i auditimit, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat ligjore dhe rregullatorë të zbatueshme. Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra gjatë auditimit, si dhe çështje të tjera të rëndësishme që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre sipas gjykimit dhe skepticizmit profesional që audituesit kanë shfrytëzuar në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e Audituesve dhe ka shërbyer si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

Në përfundim të auditimit në terren (Akt-Konstatimeve), të mbajtura mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, si dhe pas reflektimit të observacioneve të subjektit nën auditim të akt-konstatimeve, u përgatit Projektraporti i Auditimi i cili u dërgua në subjekt me shkresën nr. 30/6, datë 08.04.2024. Nga ana e Bashkisë Patos me shkresën nr. 67/43prot, datë 10.5.2024 (*prot KLSH nr, 30/8, dt. 14.5.2024*) janë dërguar konfirmimi i marrjes së projektraportit dhe observacionet përkatëse. Në përfundim nga audituesit u përgatit Raporti i Auditimit.

III. PËRSHKRIMI AUDITIMIT.

3.1. Mbi menaxhimin financiar, kontrollin dhe auditin e brendshëm.

Bazuar në *Misionin* e Vetëqeverisjes Vendore “për të siguruar qeverisjen e efektshme, efikase dhe në një nivel sa më afër qytetarëve” nëpërmjet: zgjedhjes së llojeve të ndryshme të shërbimeve dhe lehtësive të tjera publike vendore në dobi të bashkësisë; ushtrimit efektiv të funksioneve, kompetencave dhe realizimit të detyrave nga organet e vetëqeverisjes vendore; realizimit të shërbimeve në forma të përshtatshme, bazuar në nevojat e anëtarëve të bashkësisë; nxitjes efektive të pjesëmarrjes gjithëpërfshirëse të bashkësisë në qeverisjen vendore; realizimit të shërbimeve, në përputhje me standardet e kërkuara me ligj ose akte të tjera normative; për të rritur cilësinë e jetës si dhe shtuar aktivitetet për t’i shërbyer popullsisë së bashkisë Patos”²; referuar dhe Ligjit nr. 10296 dt. 08.07.2010, kreu III “Komponentët e menaxhimit financiar dhe kontrollit”, neni 19, në të cilin citohet: “*Titullarët e njësive të sektorit publik, zbatojnë menaxhimin financiar dhe kontrollin nëpërmjet komponentëve të ndërlidhur me njëri-tjetri: Mjedisi i kontrollit, Menaxhimi i riskut, Veprimtaritë e kontrollit, Informacioni dhe komunikimi, Monitorimi*”, Bashkia Patos, për çdo vit ka përgatitur “Deklaratën dhe Pyetësin e Vetëvlerësimit” dhe i ka dërguar në MFE/ Drejtoria e Përgjithshme e Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar/ Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar, Kontrollit dhe Kontabilitetit. Më poshtë po i analizojmë në mënyrë të detajuar, duke përcaktuar mangësitë e konstatuara në plotësimin e kërkesave që kërkojnë komponentët në drejtim të funksionimit me përgjegjshmëri menaxheriale, realizimit të objektivave të institucionit dhe përdorimit me efektivitet të fondeve të tij.

1. Mjedisi i kontrollit.

Mjedisi i kontrollit është një element i menaxhimit financiar dhe kontrollit, duke siguruar vendosjen e objektivave në përmbushjen e misionit të institucionit, Integritetin personal dhe etikën profesionale të nivelit menaxherial dhe punonjësve të tjerë të njësisë publike; Politikat menaxheriale dhe stilin e punës; Strukturën organizative, garantimin e ndarjes së detyrave, hierarkinë dhe rregulla të qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit; Politikat dhe praktikatat e menaxhimit të burimeve njerëzore dhe aftësitë profesionale të punonjësve.

Nga auditimi u konstatua se, bazuar në ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, Kreu II, neni 8, pika 8 “*Përgjegjshmëria menaxheriale e Titullarit*”; neni 9 pika 4/a “*Përgjegjshmëria menaxheriale e Nëpunësit Autorizues*”, në Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Kreu IV “*Zbatimi i MFK*”, pika, 4,2,10/a “*Roli i nëpunësit autorizues të njësisë*”, rezulton se janë hartuar/miratuara: “Plan i Përgjithshëm Vendor” - [PPV] me Fokus Strategjia e Zhvillimit Vendor, Analiza & Vlerësimi Territorit, Parashikimet e Planit, Vlerësimi Strategjik Mjedisor, Materiali hartografik si dhe “Rregullore e Planit Vendor”, të cilët hartohen si bashkëpunim i Bashkisë me KKT dhe miratuar me VKB Patos nr.48 datë 04.12.2020, me Vendim të KKT nr. 02 datë 28.12.2020; Bashkia Patos nuk ka hartuar dhe miratuar Strategjinë e Zhvillimit Vendor - [SZHV], ku paraqiten

² *Misioni dhe Vizioni përbëjnë dhe hapin 2 të ciklit të MFK sipas Manualit të MFK miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 8980/2010 dhe përditësuar me atë nr. 108/2016.*

synimet kryesore për një periudhë 5 vjeçare për çdo fushë përgjegjësie dhe identifikohen veprimet që njësia duhet të ndërmarrë për realizimin e tyre, duke parashikuar edhe kostot përkatëse.,

BASHKIA PATOS	Njësitë Administrative
	Patos
	NJA Zharrëz
	NJA Ruzhdie

Punoi: Grupi i Auditimit

1.1. Integriteti personal dhe etika profesionale e nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të kësaj njësie publike.

a. Bashkia Patos ushtron funksionet e veta me Rregulloren e Brendshme “Mbi organizimin, funksionimin, detyrat dhe procedurat për zbatimin e kompetencave vendore në administratën dhe njësitë administrative e të varësisë të Bashkisë Patos”, hartimi dhe miratimi i të cilës është mbështetur në zbatimin e Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” neni 9 pika 1/1 germa ‘b’, Ligjit nr. 7961 datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Vendimet e Këshillit Bashkiak [VKB] të çdo viti respektiv “Mbi miratimin e numrit të përgjithshëm të punonjësve të bashkisë, institucioneve në varësi dhe njësive administrative si dhe nivelit të pagave” për vitin 2023 është VKB nr. 92 datë 22.12.2022 si dhe Vendimit të Kryetarit nr. 01 datë 04.01.2023 “Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Patos”. Kjo Rregullore është miratuar me Vendim të Kryetarit të Bashkisë nr. 21 datë 27.01.2023 e cila i përket Strukturës Organizative miratuar nga Kryetari i Bashkisë nr. 01 dt. 04.01.2023 i ndryshuar. Vendimet e Këshillit Bashkiak janë konfirmuar edhe nga Prefekti i Qarkut Fier. Këto ndryshime nuk janë pasqyruar në Rregulloren e brendshme të njësisë.

b. Bashkia Patos ka hartuar dhe miratuar me Urdhër të Kryetarit nr. 52 datë 07.01.2020 “Kodin e Etikës së Bashkisë Patos”, konformë Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” neni 9, pika 1/1 germa ‘b’, VKM nr. 306 datë 13.06.2000 “Për disiplinën në shërbimin civil;

c. Bashkia Patos ka hartuar dhe miratuar “Rregulloren e Posaçme për Parandalimin e konfliktit të Interesit në ushtrimin e funksioneve publike” me nr. 3480 prot., datë 24.12.2019, konformë Ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funksioneve Publike” i ndryshuar, Ligji nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” neni 9, pika 1/1 germa ‘b’, neni 46; Ligjit nr. 9049 datë 10.04.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë” i ndryshuar.

“Kodi i Etikës” dhe “Rregullore për Parandalimin e Konfliktit të Interesit” përcaktojnë rregullat e sjelljes së nëpunësve të administratës publike, sipas standardeve të kërkuara, i ndihmon ata për arritjen e këtyre standardeve si dhe vë në dijeni publikun për sjelljen që duhet të ketë nëpunësi i administratës publike. Kjo ndikon në mbarëvajtjen e funksionimit të institucionit, duke mos lejuar cenimin e aktivitetit të tij në çdo aspekt.

1.2 Politikat menaxheriale dhe stili i punës.

a. Punësimi në Bashkinë Patos bëhet në zbatim të Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe Ligjit nr. 7961 /1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, VKM nr. 243/2015 i ndryshuar me VKM nr. 746/2018 Kreu I pika 1,2.

Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Ligjore [DBNJL] është përgjegjëse për zbatimin e hapave të procedurës së punësimit sipas nenit 10 pika 1 e Ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe VKM nr. 243/2015 i ndryshuar Kreu II;

Komiteti i Përhershëm i Pranimi [KPP] në zbatim të përcaktimeve në Kreun III të VKM nr. 243/2015 i ndryshuar;

Kryetari i Bashkisë në zbatim të nenit 64 pika (e,ë,f,g) të Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”.

Nga titullari i Bashkisë është ngritur Komiteti i Përhershëm i Pranimit (KPP), në zbatim të përcaktimeve në Kreun III të VKM nr. 243/2015 i ndryshuar;

b. Struktura përgjegjëse e çdo bashkie harton në fillim të çdo viti “Planin vjetor të pranimit në shërbimin civil” në zbatim të Ligjit nr. 152/2015 “Për nëpunësin civil” neni 18 dhe 69, VKM nr. 108/2014 “Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil”, si edhe të atyre me Kontratë Pune konformë Ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i punës i Republikës të Shqipërisë” i ndryshuar, VKB “Mbi miratimin e numrit maksimal të punonjësve dhe nivelit të pagave të tyre” si dhe Vendimeve të Kryetarit “Për miratimin e strukturave organizative të Bashkisë Patos”.

Nga verifikimi i dokumentacionit vënë në dispozicion grupit të auditimit, rezultoi se për vitin 2023 struktura organizative është miratuar me Vendim të Kryetarit të bashkisë nr. 01 dt. 04.01.2023 “Mbi miratimin e strukturës, organikën, kategoritë, nivelin e pagave, klasën e pagave për çdo pozicion të administratës së bashkisë dhe njësive shpenzuese në varësi të bashkisë Patos për vitin 2023” i ndryshuar me Vendimin nr. 102 datë 10.07.2023. Mbi këto akte të miratuara është hartuar Plani vjetor i pranimit në shërbimin civil, i cili bazohet mbi nevojat e institucionit për vitin e ri ushtrimor, duke detajuar emërtimin e pozicionit dhe të njësisë përbërëse në strukturë. Ky informacion duhet të përcillet nga çdo njësi dhe përmban: pozicionin, përshkrimin e punës së çdo pozicioni, numrin e nevojshëm për punonjësve, kriteret e veçanta që duhet të plotësojë punonjësi sipas secilit pozicion etj., mbi të cilat klasifikohet edhe afati dhe koha e punës në kontratë.

Rezultoi se në fund të vitit 2022 nuk ka komunikim të dokumentuar mes Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Njësive të tjera të strukturës së bashkisë, mbi informimin për nevojat e tyre për rekrutim për vitin pasardhës (2023), kjo pasi në strukturën organizative të miratuar, nuk është pasqyruar dhe numri i punonjësve që do të punësohen përkohësisht me afat 3 mujor. Kjo rezulton nga mungesa e informacionit të përgjithshëm mbi: numrin, kategorinë (specialistë apo punëtorë), baza ligjore mbi të cilën klasifikohet dhe grupi i pagës, drejtorinë/sektorin që iu nevojiten, përshkrimin e punës dhe arsyen e punësimit të tyre sezonal. Lista emërore e të punësuarve me kontratë 3 mujore.

Konstatim: Plani vjetor i punësimit rezulton të jetë hartuar dhe miratuar pa një studim të mirëfilltë nga secila strukturë e bashkisë mbi nevojat dhe kriteret e tyre, në moszbatim të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 3, neni 9 pika 1.1/c.

Konstatim: Bashkia Patos ka hartuar “Planin Vjetor të Pranimit në Shërbimin Civil për vitin 2023” pa përfshirë edhe nevojat e njësisë për ato pozicione marrëdhëniet e punës të të cilave me punonjësit rregullohen me Kodin e Punës, ka hartuar dhe miratuar strukturën organizative pa shoqëruar me një relacion të detajuar, mbi nevojat për punonjësit provizorë në kundërshtim kjo me Ligjin nr. 152/2015 “Për nëpunësin civil” neni 18; VKM nr. 108/2014 pika 11,13; si dhe udhëzimeve të DAP.

Konstatim: Bashkia Patos deri në 31.12.2023 ka publikuar vendet vakante në faqen zyrtare të saj si dhe në Portalin Kombëtar të Punësimit të AKPA, duke anashkaluar stendat e bashkisë, në moszbatim të VKM nr. 108/2014 “Për Planin vjetor të Pranimit në Shërbimin Civil” pika 13; VKM nr. 243/2015 “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive” i ndryshuar Kreu II pika 6, 10/b.

c. Përshkrimin e punës të çdo pozicioni si dhe kriteret (e përgjithshme dhe të veçanta) që duhet të plotësohen nga kandidatët, duhet të jenë të përshkruara në Formularin e Përshkrimit të Pozicionit të Punës. Ato janë pjesë e rëndësishme e politikave dhe praktikave që lidhen me burimet njerëzore. Si të tilla *Politikat e burimeve njerëzore duhet të garantojnë kriteret dhe kërkesat të përshtatshme*

në drejtim të kualifikimit dhe përvojës profesionale në procesin e rekrutimit dhe të emërimit të stafit.


Bashkia Patos funksionon me Rregullore të Brendshme të miratuara me Vendim të Kryetarit të Bashkisë nr. 21 datë 27.01.2023 e cila i përket Strukturës Organizative miratuar nga Kryetari i Bashkisë nr. 01 dt. 04.01.2023; Struktura organizative ka pësuar ndryshime të miratuara me Vendimin e Kryetarit nr.102 datë 10.07.2023, ndryshime të cilat nuk janë pasqyruar në Rregulloren e brendshme tek rubrika “përshkrimet e punës”: kompetencat, funksionet dhe të drejtat e çdo njësie e pozicioni të strukturës organizative, kriteret e veçanta për çdo pozicion etj., duke iu referuar strukturës së re.

Konstatim: Nga auditimi rezultoi se Formularët e Përshkrimit të Pozicioneve të Punës nuk ishin pjesë e dosjes së personelit, apo shtojcë e Kontratës së punës për ata punonjës që marrëdhëniet e punës me bashkinë iu rregullohen me Ligjin nr. 7961 datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, në kundërshtim kjo me VKM nr. 142 datë 12.03.2014 “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar.

Konstatim: Nga auditimi rezultoi se Bashkia Patos kriteret e punësimit nuk i ka përfshirë në rregulloren e brendshme, si për pozicionet me statusin e nëpunësit civil edhe për ato ku marrëdhëniet e punës rregullohen me Ligjin nr. 7961 datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.

1.3 Struktura organizative, garantimi i ndarjes së detyrave, rregullat e qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit.

Nga auditimi konstatohet se Bashkia Patos funksionon me një Strukturë që bazohet në Ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen vendore”. Nga auditimi rezulton se Strukturat Organizative shoqërohen edhe me Organigramën përkatëse për tu miratuar nga kryetari i Bashkisë.



Skemë e thjeshtuar e strukturës së NJVQV

A. Organi Përfaqësues i Bashkisë - Këshilli Bashkiak.

B. Organi Ekzekutiv i Bashkisë - Kryetari i Bashkisë.

Gjatë periudhës 1 vjeçare – vitit 2023 që ne auditojmë, struktura organizative e Bashkisë Patos ka pësuar ndryshime nga ajo e mëparshme, të cilat miratohen me Vendim të Kryetarit të Bashkisë, ndërkohë që numri i përgjithshëm i punonjësve për vitin ushtrimor, miratohet nga Këshilli Bashkiak në fund të vitit paraardhës me miratimin e PBA-së dhe Planit Buxhetor Vjetor. Një pasqyrim të thjeshtuar të kompozimit të Strukturës organizative të Bashkisë Patos paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Viti	VKB / Vendim Kryetari	Njësi	Drejtori	Sektor	Punonjës sipas strukturës
2023	Nr. 1, datë 04.01.2023	2	10	25	371
	Nr. 102, datë 10.07.2023	2	11	27	377

Një pasqyrim i kompozimit të Strukturës organizative të Bashkisë Patos me njësitë e varësisë për vitin 2023, për çdo njësi bazë të miratuara nga Kryetari i Bashkisë është në tabelën më poshtë:

Nr.	Emërtimi i njësisë në Strukturën organizative Bashkia Patos	Nr. i punonjësve	
		V.I	V. II
1	Kabineti i Kryetarit	5	7
2	Sekretar i Përgjithshëm	1	1
3	NJAB	3	3
4	Drejtorja e Financës	6	11
5	Drejtorja e Shërbimit Social	6	
6	Drejtorja e të Ardhurave Vendore	5	5
7	Drejtorja e Hartimit të projekteve, shërbimeve dhe emergjencave civile	12	21
8	Drejtorja e Planifikimit urban, kadastrës, dhe kontrollit të zhvillimit urban	11	
9	IVMT		
10	Drejtorja e zhvillimit Bujqësor, rural, pyjor, mjedisit dhe kontrollit ushqimor	18	17
11	Drejtorja e Burimeve njerëzore, legjislacionit dhe informimit publik	14	21
12	Drejtorja e Arsimit, Kulturës, Sportit	23	28
13	Drejtorja e integritit evropian, koordinimit të fondeve të huaja dhe informimit publik	9	
14	Personeli edukativ, ndihmës parashkollor dhe para universitar	79	80
15	Policia Bashkiake	6	6
16	NJAB	3	3
17	NJ Prokurimeve Publike	3	3
18	NJA Ruzhdie	4	4
19	NJA Zharrëz	5	5
20	MZSH	14	14
		227	232
21	Gjendja Civile		
22	QKB		
23	ASHP	144	145
Totali		371	377

Burimi: Bashkia Patos/DJMBNJ

Konstatim: Në strukturën organizative për vitin 2023 nuk janë përfshirë funksionet e deleguara: Gjendja civile dhe QKB.

Struktura organizative është korniza me anë të cilës planifikohen, zbatohen, kontrollohen dhe raportohen aktivitetet e njësisë, në pajtim me funksionet e ngarkuara sipas kuadrit ligjor. Rregullore e Brendshme “Për organizimin, funksionimin, detyrat dhe përgjegjësitë e Administratës së Bashkisë Patos dhe Njësi Administrative” është miratuar me Vendimin e kryetarit të bashkisë me nr. 21 datë 27.01.2023 dhe me nr. 265 prot., datë dhe i përket strukturës organizative të miratuar me Vendim nr. 01 datë 04.01.2023 për vitin 2023. *Strukturat organizative janë rikompozuar në përmbajtje, formë dhe numër, ndryshime të cilat nuk janë shoqëruar me pasqyrim të tyre në Rregulloren e Brendshme të Bashkisë.*

Konstatim: Referuar informacionit dokumentar të vënë në dispozicion dhe të dhënave të pasqyruara në tabelë, rezultoi se ndryshimet e bëra në strukturën organizative nuk janë shoqëruar me përditësimin e Rregullores së Brendshme, duke mos bërë ndarjen e qartë të detyrave dhe përkrahjet e punës për ato drejtori të rikompozuar me sektorë dhe stafin përbërës të tyre, në moszbatim të kërkesave të ligjit 10296/2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar, Manualin MFK, miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 8980/2010 dhe përditësuar me atë nr. 108/2016, Kapitulli III, Pika 3.1 paragrafi 5.

Nga auditimi i njësi të strukturës organizative, organizimi dhe veprimtaria e të cilave rregullohet me ligj të veçantë, rezultoi si në tabelën më poshtë:

Emërtimi i strukturës	Baza ligjore/nënligjore	Numri i personelit sipas bazës Ligjore	Numri personelit në vitin 2023	
MZSH	Ligji nr. 152/2015	14	14	√
IVMT	Ligji nr. 107/2014	= ose < 6	3	↘
Policia Bashkiake	Ligji Nr. 8224, datë 15.5.1997	6	6	√

Konstatim: Nga informacioni i pasqyruar edhe në tabelë, rezulton se Struktura e IVMT nuk është krijuar konform ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” neni 14.

Shpërndarja e pozicioneve në strukturën organizative për vitin 2023 sipas ligjit që rregullon marrëdhëniet e punës, pasqyrohet si më poshtë:

Niveli pozicionit	Aparati i Bashkisë Patos		Me njësitë e varësisë	
	Status i Nëpunësit Civil	Kodi i Punës	Status i Nëpunësit Civil	Kodi i Punës
Kategori e lartë	1	2	1	2
E mesme drejtuese	6	5	8	10
E ulët drejtuese	12	8	15	11
Ekzekutive	47	48	49	91
Totali	66	66	73	114
	132		377	

Burimi: Bashkia Patos/DJMBNJ

Nga informacioni shkresor i vënë në dispozicion, rezultoi se numri i largimeve të punonjësve për arsye të ndryshme gjatë vitit 2023 në Bashkinë Patos ka qenë i konsiderueshëm, prej 52 punonjësish, ku të “larguarit me dëshirë” është me 23 punonjës ose 44% të totalit të punonjësve të larguar.

Numri i përgjithshëm i punonjësve në Bashkinë Patos, referuar strukturave organizative në planifikim për vitin 2023 është Vendimin I me 368 punonjës dhe Vendimin II me 377 punonjës. Për rritjen e përgjegjshmërisë në punë nga ana e punonjësve dhe forcimin e kërkesave të kodit të etikës, në Bashkinë Patos janë ngritur 2 komisione disiplinore.

Nga punonjësit e larguar nga puna me shkarkim/me masë disiplinore apo largim nga detyra, për vitin 2022 nuk ka asnjë ankesë/padi dorëzuar në Komisionerin e Nëpunësit Civil apo në Gjykatën e Shkallës së Parë; gjithashtu nuk ka procese gjyqësore për largime nga puna të kryera para vitit 2023.

Nga auditimi referuar planit vjetor të punësimeve rezultoi se në Bashkinë Patos gjatë vitit 2023: janë punësuar 34 punonjës me kontratë të përkohshme 3 mujore (punonjës provizorë); nuk ka punonjës me kohë të pjesshme; nuk ka punonjës të punësuar nga kategori sociale “grup i veçantë”; nuk ka punonjës me statusin “ekselent”.

Konstatim: Bashkia Patos nuk ka planifikuar në strukturën organizative dhe nuk ka punësuar punonjës në pozicione të ndryshme nga “grupi i veçantë”, në të cilin përfshihen 15 kategori punëkërkesish të disavantazhuar në tregun e punës: persona me aftësi të kufizuara, jetimë, kryefamiljare, të komuniteteve të ndryshme (romë, egjiptianë etj.) si personel administrativ dhe jo vetëm, në mosbatim të Ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil” i ndryshuar neni 5; Ligjit nr. 93/2014 “Për Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuara”; Ligjit nr. 15/2019 dt. 13.03.2019 “Për Nxitjen e Punësimit”;

Nga Bashkia Patos nuk janë planifikuar në strukturë pozicione për statusin “ekselent”, në mosbatim të VKM nr. 586 datë 30.08.2019 “Për punësimin e përkohshëm të studentëve të ekxelencës në institucionet e administratës shtetërore”.

▪ Në Vendimet e Kryetarit të Bashkisë Patos është miratuar Strukturat Organizative në zbatim të Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” neni 9 pika 1.1/c. Strukturat organizative janë shoqëruar me Organigramën përkatëse.

Përsa më lart është në zbatim të “Manualit MFK” të miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave, nr. 8980, dt. 15.07.2010 dhe atë nr. 108/2016; Ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”; Ligjit nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore” neni 21 pika 1,2.

- Nga verifikimet e dokumentacionit dhe analiza e informacionit të pasqyruar, rezultoi se për funksionin “Mbrojtja e Mjedisit” neni 26, në strukturën e Bashkisë Patos, ky funksion nuk mbulohet nga një njësi e veçantë, por në DZHBRPMKU³/Sektori i Pyjeve dhe mjedisit [SPM] është një specialist i mjedisit, që mbulon problemet mjedisore të territorit të bashkisë; Nga auditimi rezultoi se përgjegjësja e sektorit të pyjeve dhe mjedisit dhe specialistja për mjedisin kanë hartuar planet e aktiviteteve për vitin 2023 sipas ditëve mjedisore të përzgjedhura. Në mënyrë të detajuar paraqitet në aneksin nr. 2 pika 1 bashkëlidhur raportit të auditimit.

Referuar kalendarit mjedisor të publikuar nga MMT dhe AKM janë 24 ngjarje/ditë të caktuara për mbrojtjen e mjedisit. Për vitin 2023 rezulton se nga Bashkia Patos janë hartuar plane e programet përkatëse për 10 evente mjedisore, duke lënë të papërfshira shumë data mjedisore të rëndësishme veçanërisht për territorin e kësaj bashkie, të tilla si: “Dita e inxhinierit pyjor”, “Dita ndërkombëtare e jetës së egër”, “Java evropiane e pyjeve“ dhe “Dita ndërkombëtare e pyjeve”, “Dita ndërkombëtare e mjedisit”, “Dita ndërkombëtare e luftës kundër shkretëtirëzimit dhe thatësirës”, “Dita e defiçitit ekologjik”, “Dita ndërkombëtare e maleve” etj. Referuar shtrirjes gjeografike dhe relievit që përfshin Bashkia Patos, rezulton se kjo zonë përmban një kapital natyror relativisht të pasur të ndarë në 3 kategori: Monumente kulturore e natyrore, Monumente Kulturi, Burime minerare. Mungesa e përfshirjes dhe planifikimit të aktiviteteve sensibilizuese dhe ndërgjegjësuere referuar kalendarit mjedisor, ka ardhur si rezultat i mungesës së një studimi dhe analize të mirëfilltë të faktorëve klimaterikë, mjedisorë dhe gjeografikë që ndikojnë në cilësinë e jetës së komunitetit të kësaj bashkie. Kjo për shkak të numrit të kufizuar të specialistëve të mjedisit dhe mungesës së një njësi të veçantë në strukturën organizative të saj. Lidhur me efektivitetin e veprimtarisë së Bashkisë Patos mbi mbrojtjen e mjedisit, për vitin 2023 nuk ka një Plan vjetor të përgjithshëm të miratuar në fillim viti, por vetëm plane të veçanta për çdo ditë të përzgjedhur. Për vitin 2024 është hartuar dhe miratuar plani vjetor me nr. prot. 210 datë 24.01.2024;. Deri në 31.12.2023 nga ana e Bashkisë Patos nuk është marrë asnjë angazhim për evidentimin e kapitalit natyror, duke e parë si burim të ardhurash dhe si pjesë e PPV. Me Urdhër të titullarit nr. 11 datë 17.01.2024 dhe nr. 137 prot., datë 17.01.2024 është ngritur një grup pune prej 11 anëtarësh, për evidentimin e kapitalit natyror [KN], vlerësimin e tij si potencial turistik, konsultim me grupet e interesit.

Kapitali Natyror - Bashkia Patos		
Monumente Kulturore e Natyrore	Monumente Kulturi	Burimet minerare
I	II	III
Kalaja e Margëlliçit	Kisha e Shën Mëhillit	Zona naftëmbajtëse Patos-Marinëz
Ura e Ofiçinës	Manastiri i Shën Trifonit	Vendburimi i rërës bituminoze Kasnicë
Liqeni i Zharrëz	Mekami i Drenies	Shfrytëzim Konglomerate në Kuqar
Rezervuari i Ruzhdies	Varri i Baba Mustafait	////////////////////////////////////
Ujëvarat në Kanionin e Siqecës	Kisha e Shën Mërisë	
Rrapë i Zhugrit	Kisha e Shën Sotirit	

³ Drejtoria e Zhvillimit bujqësor, Rural, Pyjor, Mjedisit dhe Kontrollit të ushqimit

Konstatim: Deri në 31.12.2023 nga Bashkia Patos, nuk është marrë asnjë angazhim për shtimin e dimensionit turistik si pjesë integrale e planin të përgjithshëm të zhvillimit vendor (I dhe II), duke i lënë të papërfshirë si në programet buxhetore ashtu edhe në strukturën organizative, si një shërbim i munguar ndaj komunitetit dhe më gjerë, duke mospërmbushur detyrat që i atribuon ligji (nenet 25,26,27,28 ligji 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”);

Nga Bashkia Patos dhe Sektori i pyjeve dhe mjedisit është bërë monitorimi i cilësisë së ajrit, ujit dhe tokës në zonën naftëmbajtëse Patos – Marinëz në datën 21.06.2023. Nga auditimi rezulton se mbrojtja e mjedisit përfshihet në veprimtarinë e këtyre strukturave: Sektori i Pyjeve dhe Mjedisit, Agjencia e Shërbimeve Publike/Sektori i Pastrimit & Sektori i gjelbërimit. Nga sa më sipër për mbrojtjen e mjedisit Bashkia Patos deri tani ka funksionuar vetëm me një *specialist mjedisi*, duke mos hartuar politika dhe plane efektive nga njëra anë dhe monitorimin e zbatimit të tyre nëpërmjet një strukture të veçantë që i mbulon të gjitha funksionet/nënfunksionet për të ofruar shërbimet komunitetit dhe nivel të cilësisë së mjedisit brenda standardeve, duke ushtruar kompetencat që i atribuon Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” Kreu VII në nenet 23-30; Ligji nr. 10431/2010 “Për mbrojtjen e mjedisit” i ndryshuar; Ligji nr. 9587/2006 “Për mbrojtjen e biodiversitetit”; Ligji nr. 10463/2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” i ndryshuar; Ligji nr. 162/2014 “Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis”; VKM nr. 123/2011 “Për miratimin e planit kombëtar të veprimit të zhurmave në mjedis” etj.

1.5 *Aftësitë profesionale të punonjësve.*

Për të audituar dosjet e personelit, përzgjedhëm dosjet e të punësuarve për vitet 2023 në aparatit e bashkisë dhe në ndërmarrjet e varësisë për kategoritë: ngritje në detyrë, pranim në shërbimin civil, me Kod pune; si dhe dosjet e punonjësve të larguar nga Bashkia Patos. Emërimet/largimet i janë nënshtruar, Ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” dhe Ligjit nr. 7961/1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”.

Konstatim: Nga testimi me zgjedhje të dosjeve të personelit (kampioni që përzgjedhëm), emëruar/larguar në 2023 rezultoi se DBNJL i kishte plotësuar dosjet e personelit me dokumentacionin përkatës, por u konstatuan edhe këto mangësi:

- Në *dosjet e personelit* mungonin: praktika e plotë e punësimit nga shpallja e pozicionit deri në emërimin e tij për punonjësit me Kod Pune; formulari i vetdeklarimit, Kontrata e punës nuk kishte të bashkëngjitur Formularin e përshkrimeve të punës, vërtetimet e Prokurorisë dhe Gjykatës, vlerësimi 6 dhe 12 mujor ishte miratuar por administrohej në dosje të veçantë; nuk kishte praktika të ndara dokumentare të përditësuara për ata punonjës të cilët kanë patur lëvizje të pozicionit të punës brenda të njëjtës drejtori apo jashtë saj, por brenda bashkisë;

- Në *disa dosje të pozicioneve të veçanta (specifike)*: dosja e përgjegjësit të Sport klub “Älbpetroli” ishte e paplotësuar me dokumentet bazë;

- *Dosjet e punonjësve të larguar* në praktikën e ndërprerjes së marrëdhënieve të punës nga njoftimi deri në vendimin për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, duke përfshirë në dosje edhe procesverbalin e dorëzimit të bazës materiale që ka patur punonjësi në ngarkim;

Për të gjitha këto konstatime, nuk janë zbatuar: Ligji nr. 152/2013 i ndryshuar “Për nëpunësin civil” neni 17 pika 1,4; Ligji nr. 10325, datë 23.9.2010 “Për bazën e të dhënave shtetërore”; VKM nr. 117, datë 5.3.2014 Lidhja 1 e 2; VKM nr. 243/2015 “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive” i ndryshuar; Ligji nr. 7961 /1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë” Kreu VII, XIV;

- Nga verifikimi i pozicioneve me kod pune i punonjësve të cilët janë të punësuar si “shofer” dhe që kanë në ngarkim për të përdorur një mjet transporti. . Në mënyrë të detajuar paraqitet në aneksin nr. 3 pika 1 bashkëlidhur raportit të auditimit.

- Nga informacioni që grupit të auditimit iu vu në dispozicion dhe verifikimi i dosjeve për punonjësit në pozicionin “shofer”, “elektracist”, “hidraulik”, “mekanik” dhe punonjës që kanë mjete në ngarkim, rezultuan mangësi të dokumentacionit: dokumenti i arsimimit, dëshmi penaliteti, leje drejtimit dhe dëshmi e aftësisë profesionale të parinovuara apo jashtë afatit të përdorimit, Kontrata e punës pa nënshkrimin e të punësuarit, procesverbali i marrjes në dorëzim të mjetit etj.⁴ Me komunikimin e mangësive të konstatuara, nga Bashkia Patos na u vu në dispozicion Urdhri i Kryetarit nr. 110 datë 06.07.2023 dhe me nr.1647 prot., datë 06.07.2023 nëpërmjet të cilit është ngritur grup pune për verifikimin e lejeve të drejtimit të drejtuesve të mjeteve të bashkisë dhe njësive vartëse të saj, brenda afatit kohor datës 14.07.2023.

Në Bashkinë Patos gjatë periudhës tetor-nëntor është ushtruar auditim nga Komisioneri i Shërbimit Civil me objekt “Mbi zbatimin e ligjshmërisë gjatë zhvillimit të procedurave të plotësimit të pozicioneve të lira në shërbimin civil, nëpërmjet pranimit në shërbimin civil, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë në institucionin Bashkia Patos” për periudhën 3 vjeçare 2021-2023. Me shkresën nr. 1054/4 prot., datë 15.12.2023 është dërguar nga KSHC Projekt Raporti me konstatimet dhe rekomandimet e përcjella nëpërmjet tij për Titullarin dhe Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, Ligjislacionit dhe Informimit publik [DBNJLIP]. Nga ana e saj DBNJLIP me shkresën nr. 2894/2 prot., datë 10.01.2024 ka përcjellë në KSHC observacionet mbi konstatimet dhe rekomandimet e lëna në PRA të KSHC. Meqënëse afati i auditimit të grupit të KLSH përkoi me fazën e Projekt Raportit, Rekomandimet e lëna në PRA mbeten për tu vlerësuar nga grupi i auditimit të KSHC dhe merren të mirëqena.

- b Mbi trajnimin e punonjësve në Bashkinë Patos.

Nga auditimi rezultoi se nga Bashkia Patos, struktura përgjegjëse e saj [DBNJLIP]⁵ ka hartuar Planin vjetor të trajnimeve për punonjësit e saj dhe miratuar nga Kryetare e bashkisë me nr. 245 prot., datë 25.01.2023, ka mundësuar përfshirjen e stafit administrativ në nivel drejtorish apo sektorësh në trajnimet e programeve të ofruar nga ASPA⁶, me qëllim njohja nga ana e tyre me Ligjin nr. 10296/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar dhe Manualin për MFK.

Plani i trajnimeve nr. 245 datë 25.01.2023	Nr.Trajnime të planifikuara	Numri i Strukturave/ punonjësve	Nr. Trajnime të realizuara	Numri i Strukturave/ punonjësve
	35	13 / 81	31	53

Burimi: Bashkia Patos

Trajnimet e zhvilluara nga ASPA janë ndjekur rregullisht vetëm nga punonjësit në periudhë prove për përfitim të “statusit të nëpunësit civil”; Nuk ka patur një frekuentim të rregullt nga pjesa tjetër e stafit. Trajnimi i punonjësve është i nevojshëm për të garantuar minimizimin e akteve të parregullta, gabimeve dhe shpërdorimeve, si dhe për të kuptuar se direktivat e dhëna prej menaxherëve të njësisë kuptohen dhe arrihen nga punonjësit. Në mënyrë të detajuar paraqitet në aneksin nr. 4 pika 1 bashkëlidhur raportit të auditimit.

⁴ Informacion i detajuar në tabelën bashkëngjitur Akt Konstatimit (aneks)

⁵ Drejtoria e Burimeve njerëzore, Legjislacionit dhe Informimit Publik

⁶ Shkolla Shqiptare e Administratës Publike

Nga auditimi rezultoi se në planin vjetor nuk janë përfshirë: trajnim për specialistin IT lidhur me njohjen nga ana e tij me programet, metodat e avancuara kryesisht për mbrojtjen kibernetike, trajnim për njohjen e thelluar të komponentëve të MFK nga i gjithë niveli menaxherial, trajnim i specialistëve të arkiv protokollit etj. Nuk është planifikuar program trajnimi zhvilluar nga vet menaxherët e njësisve kryesore, për njohjen nga ana e stafit vartës me legjislacionin bazë të proceseve të punës, konkretisht: nga Drejtoria e Burimeve njerëzore mbi zbatimin e kodit të etikës, ndërgjegjësimi për rritjen profesionale të stafit, ngritjen e nivelit të komunikimit të brendshëm dhe me komunitetin sipas standardeve profesionale dhe etike; trajnim nga specialisti IT për përdoruesit e sistemeve të institucionit etj. me qëllim përmbushjen me sa më me efektivitet të objektivave institucionale.

Konstatim: Nëpunësi Autorizues dhe struktura përgjegjëse e bashkisë Patos [DBNJL], nuk kanë hartuar dhe miratuar plane dhe programe vjetore *efektive* për trajnimin e detyrueshëm të të gjithë punonjësve mbi zgjerimin e njohurive të tyre për proceset e punës dhe të aftësive për t'i kryer me efikasitet ato, dhe kryesisht për njohjen nga stafi dhe menaxherët e njësisë mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin, në moszbatim të Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” neni 64 pika h, Ligjit nr. 10296 /2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar dhe “Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” Kapitulli III pika 3.1

2. Menaxhimi i Riskut

2.1 Regjistri i Riskut Grupi i auditimit lidhur me menaxhimin e riskut, kërkoi t'i vihet në dispozicion Regjistri i riskut, i cili pasqyron identifikimin e risqeve të çdo njësie të strukturës dhe masat që duhen marrë për parandalimin apo minimizimin e pasojave. Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, rezultoi se Bashkia Patos për vitin 2023 ka hartuar Regjistrin e riskut dhe miratuar me nr. 2997 prot., datë 05.12.2022.

Konstatim: Bashkia Patos ka hartuar dhe miratuar Regjistrin e Riskut të unifikuar, por nuk kanë identifikuar risqet që vijnë nga burime të brendshme dhe atyre që vijnë nga burime të jashtme, në moszbatim të Ligjit 10296 dt. 08.07.2010, Kreu III, neni 10 ndryshuar me Ligjin nr. 110/2015 si dhe Udhëzimit nr. 16 dt. 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të MFK dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”.

Regjistri i Riskut është i bazuar në analizën e riskut të çdo drejtorie dhe ka si *Synim* “Planifikimin dhe Përdorimin me efencë, efikasitet dhe transparencë të fondeve buxhetore në përputhje me misionin e Bashkisë, për arritjen e objektivave”. Ky regjistër përmban përshkrimin e risqeve për çdo drejtori/sector, nivelin e risqeve, kontrollet ekzistuese, veprimet e ndërmarra për të adresuar risqet, zotëruesi i riskut si dhe situatën e riskut pas detyrës së fundit, si dhe mënyrën apo rrugëzgjdhjen e situatës në rastin e ndodhjes apo konstatimit të dukurisë. Në regjistrin e riskut nuk ka përshkruar marrjen e një pakete masash që të përfshijë jo vetëm njësitë e strukturës së Bashkisë, por edhe Njësitë Administrative dhe ASHP.

Bashkia Patos ka ngritur *Grupin e Menaxhimit Strategjik* [GMS] me Urdhrin nr. 23 datë 23.01.2023 dhe me nr. 217 prot., datë 23.01.2023 të përbërë nga 23 anëtarë me koordinatorin e MFK; Me ndryshimin e titullarit të bashkisë, u miratua ngritja e GMS të ri me Urdhrin nr. 102 datë 29.06.2023 dhe me nr. 1571 prot., datë 29.06.2023, Urdhrin nr. 188 datë 04.10.2023 me nr. 2606 prot., datë 04.10.2023; Urdhri me nr. 210 datë 15.11.2023 dhe me nr. 3028 prot., datë 15.11.2023 është si më poshtë. Në mënyrë të detajuar paraqitet në aneksin nr. 5 pika 1 bashkëlidhur raportit të auditimit.

Nga auditimi i dokumentacionit mbi aktivitetin dhe takimet e zhvilluara nga GMS gjatë vitit 2023, rezultoi se nga GMS janë zhvilluar 27 takime, të dokumentuara në proces verbale konform akteve

ligjore. Për vitin 2023 janë bërë 2 herë rikompozime të strukturës organizative të bashkisë, dhe lëvizje të personelit të cilat janë shoqëruar edhe me ndryshimin e menaxherëve të njësive kryesore/drejtorive. Ky fakt është shoqëruar me përditësimin e GMS me Urdhra të miratuara nga titullari i bashkisë dhe Udhëzimet për GMS nr. 1, datë 10.04.2023 dhe nr.9 datë 07.08.2023, në zbatim të Ligjit nr. 10296/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” Kreu II neni 8, pika 8/b; neni 27 pika 1,2;

2.2 Strategjia e riskut, përcakton mënyrën se si sillet institucioni ndaj risqeve dhe vendos kuadrin e përgjithshëm të procesit të menaxhimit të riskut. Strategjia e riskut e një njësie duhet të miratohet nga titullari i njësisë, e cila përgatitet nga NA dhe duhet t’u vihet në dispozicion punonjësve dhe të njihet prej tyre.

Nga auditimi rezulton se Bashkia Patos për vitin 2023 ka hartuar Strategjinë e riskut dhe e ka miratuar nga Kryetari i bashkisë me nr. 2997/1 prot., datë 05.12.2022, konform kjo Ligjit nr. 10296/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, Kreu II neni 8, pika 8/a; neni 21, pika 2,3; dhe “Manualin e Menaxhimit financiar dhe kontrollin” miratuar nga Ministri MFE me nr. 8980 /2010 dhe ai i ri me nr. 108/2016 Kapitulli II pika 2.2.5; 2.2.7.

2.3 Gjurmët e Auditimit, janë një instrument mbështetës për menaxhimin e njësisë.

Nga auditimi rezulton se deri në 31.12.2023 gjurmët e auditimit i kanë hartuar vetëm 3 struktura: Sektori i Prokurimeve Publike me nr. 1635 prot., datë 28.06.2022; Drejtoria e Shërbimeve sociale me nr. 2673 prot., datë 25.10.2022; NJAB me nr.3366 prot dhe nr. 3367 prot., datë 14.12.2023. Në përfundim të auditimit tematik “Këshillim mbi Kontrollin e brendshëm dhe Gjurmët e auditimit” me nr. 2751 prot. datë 17.10.2023 të Programit, ka dalë Urdhri i Kryetarit nr. 215 datë 01.12.2023 me nr. 3142 prot., datë 01.12.2023 me objekt “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e Gjurmëve të auditimit” prej 10 (dhjetë) anëtarësh dhe me një afat të përcaktuar deri në 15.12.2023. Deri tani nga ana e Bashkisë Patos, nuk janë hartuar Gjurmët e Auditimit për pasojë nuk janë miratuar nga Titullari i Bashkisë në cilësinë e NA-së.

Konstatim: Nga auditimi rezulton se, Bashkia Patos deri në 31.12.2023, nuk ka hartuar Gjurmët standarde të auditimit, si një dokument *i unifikuar* për të gjitha proceset që ushtrohen në bashki, në kundërshtim kjo me ligjin nr. 10296/2010 i ndryshuar, neni 16 pika 2; Manualin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit” kapitulli V; Udhëzimit nr. 30 dt. 27.12.2011 i ndryshuar, neni 121 e 122.

» Lidhur me *Menaxhimin dhe Mirëmbajtjen e Sistemeve IT*, grupi i auditimit referuar informacionit të dhënë nga specialisti IT si dhe verifikimeve në “Deklaratën, Raportin dhe Formularin e Vetëvlerësimit” që dërgohen çdo fillim viti në MFE/Drejtorinë e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, për vitin ushtrimor 2022, rezultoi se Bashkia Patos për të gjitha shërbimet që u ofron qytetarëve, si edhe të gjitha Bashkitë e tjera, operojnë në sisteme kombëtare online dhe që administrohen në zbatim të VKM nr. 673/2017 nga AKSHI;

Nga specialisti IT çdo vit paraqiten në Drejtorinë e Financës kërkesat buxhetore mbi nevojat institucionale për mirëmbajtjen e infrastrukturës dhe pajisjet IT.

Kështu për vitin 2023, kërkesat buxhetore janë si më poshtë:

Shpenzime Operative	Plan	Fakt	
Internet	320,000	206,400	
Mirëmbajtje, shërbime, pajisje informatike	355,000	355,000	
Sistemi Regjistrir elektronik i kërkesave dhe përgjigjeve	100,000	99,000	
Mirëmbajtje për Programin e Financave Vendore Tais-Fais	700,000	-	
Nëntotali	1,475,000	660,400	44.8%
Shpenzime për Investime			

Shpenzime Operative	Plan	Fakt	
Pajisje Informatike	600,000	323,520	
Nëntotali	600,000	323,520	54%
Totali	2,075,000	983,920	47.4%

Nga auditimi **rezulton** se nuk tregohet vëmendja e duhur për mirëmbajtjen e mirëfunksionimin e Programit të financave vendoren Tais -Fais, si aset i rëndësishëm i bashkisë që ndikon në rritjen e performancës së aktivitetit të bashkisë në përgjithësi dhe Drejtorisë së të ardhurave vendore në veçanti.

Në godinën e Bashkisë janë instaluar kamera, investim ky i bërë nga fondet e Bashkisë, të cilat menaxhohen nga specialisti IT; Ka dhomë serverësh, e cila rezultoi sipas parametrave të “Rregullores për ndërtimin e dhomës së serverave” hartuar nga AKSHI/2008;

Nga verifikimi i dokumentacionit dhe komunikimi mbi implementimin, menaxhimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve dhe programeve IT **u konstatua:** **1.** Nuk ka rregullore për përdoruesit e tjerë të këtyre sistemeve, ku të përcaktohet dhe ndarja e detyrave, siguria në komunikim. **2.** Nuk kryhet Backup i databazës dhe konfigurimeve të pajisjeve IT; mungesë dokumentacioni mbi procedurat e veprimeve në sistem, regjistër për dokumentimin e problematikave të tyre etj. ku mundësohet gjurma e auditimit të aktivitetit dhe efienca e tyre. **3.** Sistemet mbështeten nga 1 (një) specialist IT i vetëm, i pozicionuar në DBNJL⁷/ SBNJ. **4.** Nga ana e Burimeve njerëzore për vitin 2022 mungon analiza mbi nevojat vjetore për trajnim, nuk është hartuar plan vjetor për trajnim të specialistit IT në veçanti dhe nuk janë hartuar plane/programe për të gjithë përdoruesit e sistemeve, gjë që cenon sigurinë e informacionit. Për sa më lart, në moszbatim të VKM nr. 710/2013 “Për Krijimin dhe Funksionimin e Sistemeve të Ruajtjes së Informacionit, Vazhdueshmërisë së Punës dhe Marrëveshjeve të Nivelit të Shërbimit”. Udhëzimit nr.115 dt.17.03.2014 “Për Hartimin e Marrëveshjes së Nivelit të Shërbimit; Ligjit nr. 10296/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 9 pika 4/dh; “Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” Kapitulli III pika 3.1.

b. Lista (Harta) e Proceseve/Manuali i Procedurave të punës. Nga auditimi rezulton se proceset e punës janë hartuar nga sektorë të veçantë dhe për disa nga proceset e punës, konkretisht: nga njësia e prokurimit me vlerë të vogël dhe miratuar nga titullari i bashkisë me nr. 2244 prot., datë 16.09.2022; “rregullore mbi procedurën e ndjekjes së zhvillimit të projekteve /punimeve të investimeve publike” miratuar me nr. 941 prot., datë 11.04.2022; “Procedura standarde e veprimit për matjen e volumit të punës dhe normën e harxhimit të karburantit të ekskavatorit në Bashkinë Patos” miratuar me nr. 3352 prot., datë 31.12.2021; “Procedura standarde e veprimit për furnizimin me karburant të mjeteve të ASHP” miratuar me nr. 1575 prot., datë 22.06.2022; “Procedura standarde e veprimit mbi furnizimin me karburant të ekskavatorit të Bordit të kullimit dhe skrepit” miratuar me nr. 1577 prot., datë 22.06.2022”.

Konstatim: Bashkia Patos deri më sot nuk ka hartuar listën (hartën)/manualin e proceseve të punës të unifikuar, në moszbatim të Ligjit nr. 10296 /2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe “Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit” miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 8980 datë 15.07.2010 dhe Manualin e ri me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 108/2016 Kapitulli III pika 3.3 dhe sipas Aneksit 2, Aneksit 3.

3. Veprimtaritë e kontrollit. Për të qenë efektive, aktivitetet e kontrollit duhet të jenë: Të përshtatshme; Efektive nga pikëpamja e kostos; Të gjithanshme; Të dokumentuara qartë etj. Për këtë, çdo Njësi Publike dhe NJVQV duhet të hartojë dhe miratojë Planin e Kontrollit të Brendshëm

⁷ Drejtorja e burimeve njerëzore dhe Legjislacionit

(periodik apo vjetor), si një instrument për përshkrimin dhe organizimin e aktiviteteve të kontrollit (kush, kur dhe si të kontrollosh) me qëllim menaxhimin e risqeve kryesore dhe dhënien e sigurisë së arsyeshme se objektivat dhe qëllimet do të arrihen; gjithashtu ndihmon në monitorimin e detyrave që menaxherët e njësisë i ngarkojnë stafit, mbi cilësinë dhe afatet e përbushjes së tyre.

Konstatim: Nga Bashkia Patos, nga të gjitha njësitë e strukturës *nuk është hartuar/miraturar një Plan i Kontrollit të Brendshëm* i unifikuar, periodik apo vjetor, kjo në moszbatim të nenit 22, pika 1 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, “Manualit për Menaxhimin financiar dhe kontrollin” Kapitulli III pika 3.3.

▪ Lloji i Kontrollit që zbatohet në Bashkinë e Patosit është ai parandalues, ndërsa kontrollet pas faktit realizohen nga NJAB të Bashkisë etj., pra jo nga personat përgjegjës apo personat që marrin pjesë në kontrollet para faktit:

a. Kontrole në shqyrtimin e dokumentacionit që nënshkruhet, praktika e saj dhe verifikohet saktësia e materialit

b. Ekzekutimi dhe regjistrimi i transaksioneve financiare nuk bëhen nga i njëjti person (NA-NZ)

c. Të gjitha angazhimet financiare miratohen në të njëjtën kohë nga NA&NZ (sistemi i 2 firmave)

d. Çdo dalje e Aktiveve afatgjata autorizohet dhe monitorohet nga NA; kontroll i dokumenteve të inventarëve, regjistrave financiarë, librat e kontabilitetit etj.

e. Ka rregullore për Sistemet IT të cilat *nuk iu janë vënë* në dispozicion çdo përdoruesi;

f. Parashikuar procedura te qarta mbi komunikimin e shkresave brenda dhe jashtë Bashkisë: hyrja, trajtimi, mbajtja e dokumentacionit lidhur me depozitimin e protokollimin, komunikimin shkresor e elektronik

g. komunikimi dhe trajtimi urdhrave të brendshëm dhe udhëzimeve përshtatur sipas përgjegjësiive individuale të çdo pozicioni.

h. Institucioni ka parashikuar politika të ruajtjes së dokumenteve, ka një plan masash për trajtimin e gabimeve dhe incidenteve që mund të ndodhin gjatë punës të përshkruara në “Rregulloren e funksionimit e sekretari – arkivit” miraturar me Vendim të Kryetares nr.635 datë 05.03.2019.

i. Bashkia Patos ka hartuar dhe ka miratur nga Titullari në cilësinë edhe të NA, Rregullore “Për menaxhimin, vlerësimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të Bashkisë Patos” me nr. 885/2 prot., datë 26.09.2013, e nënshkruar nga grupi i punës prej 5 (pesë) anëtarësh.

j.1 Bashkia Patos me Vendimin e Kryetarit nr. 162 datë 14.01.2022, ka ngritur Njësinë e Sinjalizuesit, ka hartuar Rregullore “Për hetimin administrativ të sinjalizuesit dhe mbrojtjen e sinjalizuesve nga njësia e sinjalizimit” me nr.251/3 prot. Datë 04.03.2019, në zbatim të ligjit nr. 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, neni 13 pika 10.

2. Ka hartuar Rregullore “Për hetimin administrativ të kërkesës së sinjalizuesit për mbrojtjen nga hakmarrja nga njësia e sinjalizimit” shoqëruar me regjistrin, formulari tip I dhe tip II, me nr. 251/2 prot. Datë 04.03.2019 në zbatim të ligjit nr. 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve” neni 19 pika 8.

Për periudhën nën auditimi grupit të auditimit iu vu në dispozicion raporti vjetor i dërguar në ILDKPKI⁸ me nr. 81 prot., datë 10.01.2024 për vitin 2023 i cili rezulton pa raste sinjalizimi të brendshëm, për pasojë dhe asnjë rast për mbrojtje të sinjalizuesit; Deri më 31.12.2023 në bashkinë Patos nuk ka patur raste informacioni nga njësia e sinjalizimit.

4. Informacioni dhe komunikimi. Drejtuesit e institucionit (NA & NZ të të gjitha niveleve) kanë informacion për qëllimet dhe rëndësinë e menaxhimit financiar dhe të kontrollit; si dhe kanë kryer trajnime të pjesshme mbi Ligjin “Për menaxhimin financiar dhe kontrollit” të organizuar nga

⁸ Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave,

ASPA. Kjo ka bërë që në mënyrë të vazhdueshme të ruhet komunikimi ndërmjet njësive brenda strukturës së Bashkisë si dhe Bashkisë me ndërmarrjet në varësi të saj. Informacioni shkëmbehet në nivel horizontal dhe vertikal. Bashkia e Patosit disponon një Rregullore të Brendshme ku rezultoi se nuk janë përshkruar edhe ndryshimet e bëra në Strukturë dhe Organikë gjatë vitit 2023 sipas VKB-ve përkatëse. Në Bashkinë e Patosit është emëruar *Koordinatori për Informim* dhe *Koordinatori i Transparencës* konform Ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 15, 16. Çdo informacion dhe njoftim publikohen në WEB-in e Bashkisë. Mos përditësimi i Rregullores së Brendshme me ndryshimet e strukturës organizative të miratuara, mos hartimi dhe mos miratimi i Manualit të Procedurave dhe i Gjurmëve të Auditimit (të unifikuara), riskon të pasurit e një komunikimi jo shumë efektiv e harmonik, si dhe paqartësi në ndarjen e detyrave dhe monitorimin e zbatimit të tyre brenda njësië publike (bashkisë) dhe bashkisë me njësitë e varësisë.

a. Buxheti diskutohet në të gjitha nivelet e Institucionit (edhe ato të varësisë).

b. Zhvillohen analiza vjetore të arritjeve të objektivave të Bashkisë Patos.

c. Drejtoria e Burimeve Njerëzore, është përgjegjëse për komunikimin me Subjektet kryesore të jashtme (ka korrespondencë shkresore zyrtare dhe elektronike sipas rastit) si dhe e çdo dokumenti administrativ (operacional e financiar) në Institucion; ajo përzgjedh formën e komunikimit (shkresor të protokolluar apo elektronik) sipas rastit. Duhet të aplikohet rregullisht komunikimi elektronik ose shkresor (komunikim i brendshëm), duke evituar komunikimin verbal me qëllim forcimin e gjurmës së auditimit.

d. Çdo muaj bëhet akt rakodimi me Degën e Thesarit dhe raportimi i bëhet Titullarit të Bashkisë (NA).

e. Punonjësit komunikojnë drejtpërdrejtë me eprorët sipas shkallës hierarkike për çdo problem apo paqartësi, në rrugë verbale, shkresore të protokolluar dhe më rrallë elektronike.

5. Monitorimi. Sekretari i Përgjithshëm në cilësinë edhe të Koordinatorit të MFK dhe Koordinatorit të riskut, merr raporte katër mujore nga drejtuesit e programeve buxhetore për ecurinë dhe realizimin e produkteve, masën e realizimit të shpenzimeve, si dhe identifikimin e fushave të cilat nuk janë realizuar në masën e pritshme, duke analizuar dhe shkaqet përkatëse. Ky raportim bëhet nga personeli përgjegjës i çdo drejtorie tek eprori dhe eprorët ia përcjellin titullarit, në cilësinë e NA dhe Kryetarit të GMS. Raportimi mbi aktivitetin e strukturave që ata drejtojnë, përmban informacione dhe evidenca të ndryshme, ku bazohet dhe Raporti 4 mujor dhe vjetor i monitorimit, i cili i dërgohet Ministrisë së Financave si dhe prezantohet edhe në Këshillin Bashkiak.

Ky Raportim bëhet në zbatim të nenit 48 të ligjit nr. 68 /2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, neni 65 të ligjit nr. 9936/2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor ne Republikën e Shqipërisë” e të Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 22/2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”. Raportet e monitorimit janë dërguar në MFE: *për 4 mujorin I* me nr. 1187/10 prot., datë 30.05.2023; *për 8 mujorin* me nr. 2423/2 prot., datë 29.09.2023. Është duke u hartuar Raporti vjetor i monitorimit *për 12 mujorin 2023*. Këto Raporte Monitorimi përmbajnë: Pyetësin e Vetëvlerësimit, Deklaratën për Cilësinë e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm dhe Regjistrin e Menaxhimit të Riskut, Raporti për Funkionimin e Cilësisë së Kontrollit të Brendshëm, Plani i Veprimt për MFK që për vitin 2023 janë dërguar në MFE me shkresën nr. 3311/1 prot., datë 05.02.2024, me shkresën nr. 3311/2 prot., datë 05.02.2024 dhe me shkresën nr. 3311/3 prot., datë 05.02.2024. Gjithashtu nga ana e Bashkisë Patos , “Drejtoria e zhvillimit bujqësor, blegtoral, pyjor, mjedisit dhe kontrollit të ushqimit” ku përfshihet edhe sektori që mbulon mbrojtjen e mjedisit dhe ASHP, raportojnë çdo vit te Agjencia Kombëtare e Mjedisit (Ministria e Turizmit dhe Mjedisin) dhe te Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, në zbatim të Ligjit nr. 10431/2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit” i ndryshuar, ligjit

nr.10463/2011 “Për Menaxhimin e integruar të mbetjeve” i ndryshuar si dhe VKM nr. 687/2015 “Për miratimin e rregullave për mbajtjen, përditësimin dhe publikimin e statistikave të mbetjeve”.

3.1.2.Vlerësimi dhe aktiviteti i Auditit të brendshëm në sektorin publik.

1.2 .Organizimi i njësisë së auditimit të brendshëm sipas përcaktimeve në VKM nr. 83,datë 03.02.2016 ”Për Miratimin e kriterëve të krijimit të Njësisë të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”.

a. Njësia e auditimit të brendshëm - [NJAB] në Bashkinë Patos, është e organizuar në nivel *sektori*, në përbërjen e të cilës janë pozicionuar 3 auditues të brendshëm në strukturën e Bashkisë Patos (1 përgjegjës + 2 auditues), konform kërkesave të ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” dhe pikat 3 dhe 6 të VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të Njësisë të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik”, rëndësia e të cilës konsiston në faktin se “Njësia e Auditimit të Brendshëm” ka funksion kryesor mbështetjen e menaxhimit të lartë në zbatimin e objektivave, për Bashkinë Patos, në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, neni 10, germa “c” si dhe neni 64, germa “a” të Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”.

b. Nga NJAB Bashkia Patos janë dërguar në Ministrinë e Financave/Njësia Qendrore e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm: Plani Strategjik i Auditimit të Brendshëm 2021-2023 me nr. 2389/1 prot., datë 15.10.2020; Plani Strategjik i Auditimit të Brendshëm 2022-2024 me nr. 2327 prot., datë 19.10.2021; Plani Strategjik i Auditimit të Brendshëm 2023-2025 me nr. 2340/1 datë 14.10.2022.

Plani Vjetor i Auditimit të Brendshëm me nr. 2327/3 prot., datë.19.10.2021 dhe ai i ndryshuar; Raporti vjetor për vitin 2023 si dhe pasqyrat përkatëse të miratuara me shkresën nr. 384/1 prot., datë 13.02.2024.

Plani strategjik i auditimit në njësitë e sektorit publik/ NJVQV, mbështetet në programet dhe objektivat e NJQV-së (bashkisë dhe ndërmarrjeve të varësisë) ku ushtron veprimtarinë audituese, si dhe në *identifikimin dhe vlerësimin e risqeve* që ndikojnë në (mos)realizimin e objektivave të këtyre njësive. NJAB mbi bazën e njohjes dhe të studimit të objektivave strategjike dhe të risqeve të njësisë publike, evidenton jo vetëm subjektet dhe fushat e auditimit që do të realizohen në programin strategjik afatmesëm (PSA), por edhe frekuencën e realizimit të këtyre auditimeve. Planifikimi i auditimit bëhet duke patur parasysh anën funksionale e organizative të subjekteve që janë objekt auditimi, raportet vjetore të institucionit, raportet e mëparshme të auditimit të brendshëm, rekomandimet e auditimit të jashtëm (KLSH), regjistrat e riskut dhe këshillat/opinionet e drejtuesve të njësive respektive në strukturë.

Nga NJAB janë hartuar raportet vjetore të aktivitetit të saj ose dokumentet e sigurimit të cilësisë dhe regjistri i riskut *për vitin 2023* miratuar nga kryetari i bashkisë me 2033 prot., datë 28.07.2023, të cilat janë dorëzuar në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik në MFE/Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm *brenda afatit* të përcaktuar në “Manualin e auditimit të brendshëm në sektorin publik” miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100/2016, datë 25.10.2016 .

Baza rregullatore mbi të cilën mbështetet aktiviteti i NJAB Bashkia Patos:

- ✓ “Kodi i Etikës së Audituesit të Brendshëm” hartuar nga Përgjegjësi i NJAB-së dhe miratuar nga Kryetari i Bashkisë Patos me nr. 1597/1 prot., datë 10.07.2023;
- ✓ “Kartën e Auditimit të Brendshëm” hartuar nga Përgjegjësi i NJAB dhe miratuar nga Kryetari i Bashkisë Patos me nr. 1597 prot., datë 03.07.2023;

✓ Gjurma e Auditimit të Brendshëm miratuar nga Kryetari i Bashkisë Patos nr. 3366 prot., datë 14.12.2023 për procesin e një auditimi të brendshëm dhe me nr. 3367 prot., datë 14.12.2023 për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve;

✓ Rregullorja e funksionimit të NJAB të Bashkisë Patos e përfshirë në Rrgulloren e Brendshme të Bashkisë Patos miratuar me Vendim të Kryetarit (nëse ka).

c. Përbërja e strukturës së NJAB në Bashkinë Patos nga data 01.01.2023 deri më 31.12.2023 miratuar me VKB nr. 92 prot datë 19.12.2022 paraqitet në tabelën e mëposhtme:

NJAB	Përgjegjës	Specialist Auditues	Kualifikimi profesional	Emëruar	Numri i punonjesve Plan / Fakt
Viti 2023	1	4		Me /pa certifikatë	3 / 3
H.M	deri më 01.06.2023		Financë	Po / 2005	x
E.H	nga 31.08.2022		Financë	Po / 2023	x
R.B		x	Ekonomiks	Jo / 2013	x
XH.GJ		x	Ekonomi & politika agrare	Jo / 2023	x

Burimi: Bashkia Patos/ NJAB

Referuar ligjit nr.114/2015 “Për Auditimin e Brendshëm”, i ndryshuar dhe VKM nr. 83 datë 03.02.2016 “Mbi Miratimin e Kriteve të Krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”, me VKB nr. 92 datë 22.12.2022 “Mbi miratimin e numrit maksimal të punonjësve të Bashkisë Patos dhe institucioneve vartëse të saj si dhe miratimin e nivelit të pagave për vitin 2023” dhe Vendimit të Kryetarit të Bashkisë nr. 01 datë 04.01.2023 “Për miratimin e Strukturës/Organikën/Kategoritë e Nivelin e pagave/Klasën e pagave për çdo pozicion të administratës së Bashkisë dhe Njësive shpenzuese në varësi të Bashkisë Patos për vitin 2023”, i ndryshuar.

Nga verifikimi i Strukturave organizative dhe tabela përmbledhëse rezulton se NJAB e Bashkisë Patos është krijuar dhe miratuar me VKB në rang sektori me 3 auditues (1+2) dhe vazhdon të funksionojë me po këtë strukturë, konform ligjit nr.114/2015 “Për Auditimin e Brendshëm në sektorin publik” i ndryshuar dhe VKM nr. 83 datë 03.02.2016 “Mbi Miratimin e Kriteve të Krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik” pika 3; përgjegjësi i NJAB H.M. (deri në 01.06.2023) rezulton i pajisur me certifikatën e audituesit të brendshëm prej 18 vitesh; audituese E.H (nga 01.08.2023 si përgjegjëse e NJAB) është pajisur me certifikatën e audituesit të brendshëm në korrik të vitit 2023; si dhe 2 specialistët e auditimit R.B dhe XH.GJ rezultojnë të pa certifikuar si “Auditues të brendshëm” për periudhën 01.01.2023-31.12.2023. Gjatë periudhës në auditim, NJAB ka funksionuar me këtë personel:

Nr	Emër Mbiemër	Pozicioni	Vjetërsia në NJAB	Miratuar/Emëruar	Larguar/Liruar	Gjendja në 31.12.2022
1	H.M.	Përgjegjës	23 vite	Akt nr. 540 datë 10.07.2006	Akt nr. 1345 datë 01.06.2023	
2	E.H.	Auditues/ përgjegjës	2 vite & 6 muaj	Akt nr.1300/13 datë 04.08.2023	-	√
3	R.B.	-/-	5 muaj	Akt nr. 1525/11 datë 02.08.2023	-	√
4	XH.GJ.	-/-	2 muaj	Akt nr. 2128/9 datë 01.11.2023	-	√
Numri total i personelit të NJAB sipas strukturës						3

Burimi: Bashkia Patos/ NJAB

d. Trajnimet e [NJAB] dhe certifikimet.

Referuar ligjit nr.10296/2010, Manualit të MFK-së, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave Nr. 8980, dt. 15.07.2010, Manuali i Ri me Urdhrin e Ministrit të FE nr.108/2016 të MFK, Ligjit nr.114/2015 “Mbi Auditimin e Brendshëm në sektorin publik” dhe “Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”, nga Bashkia Patos është hartuar një plan vjetor trajnimesh për audituesit e NJAB-së, referuar planit vjetor të Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik me Urdhrin nr. 248 datë 31.12.2021;

Trajnimi i audituesve [të NJAB-së] duhet të përmbushi planin vjetor prej 40 orëve në vit për çdo auditues të certifikuar, përcaktuar dhe programuar nga Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm. Kjo për mirëfunksionimin e auditimit të brendshëm në njësinë publike, për të cilën gjatë procedurës audituese, duhet të mbështetet në zbatimin me korrektësi të 7 (shtatë) parimeve të përgjithshme.

Nga sa më lart përshkruam rezulton se: audituesi i pacertifikuar E.H. ka zhvilluar orët e trajnimit të programit për certifikim procedure e cila është përmbysur me pajisjen e saj me certifikatën e audituesit të brendshëm; 2 auditueset R.B. dhe Xh.Gj. nga momenti i emërimit deri në 31.12.2023 nuk kanë realizuar asnjë orë trajnimi të zhvilluar nga Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm në MFE. Nga informacioni i vënë në dispozicion nga përgjegjësi i NJAB janë zhvilluar orë trajnimi me 2 specialistet audituese të sapo emëruara. Nga DHAB gjatë vitit 2023 rezulton të mos jenë hapur aplikimet për procesin e certifikimit.

II Hartimi dhe zbatimi i planeve të Auditimit të Brendshëm;

2.a [NJAB] e Bashkisë Patos ka hartuar dhe miratuar nga Kryetar i Bashkisë Planet Strategjike dhe ato Vjetore respektive, konform përcaktimeve ligjore, i ka dërguar në Drejtorinë e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit në MFE/Drejtorinë e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm, brenda afatit kohor (20 Tetor): Plani Strategjik dhe vjetor që janë dërguar në DHAB (2021-2023 me nr. 2389/2 prot., datë 15.10.2020; 2022-2024 me nr. 2327/2 prot., datë 19.10.2021; 2023-2025 me nr. 2340/2 prot., datë 14.10.2022), përmban këto 5 (pesë) pasqyra:

Pasqyra Nr.1 - Plani Strategjik i subjekteve të synuara për t’u audituar për vitet 2020-2022, 2022-2024, 2023-2025;

Pasqyra Nr.2 - Plani i Angazhimeve të NJAB për vitet 2021, 2022 dhe 2023;

Pasqyra Nr.3 - Planifikimi vjetor i nevojave për trajnim të NJAB për vitet 2021, 2022 dhe 2023;

Pasqyra Nr.4 - Planifikimi vjetor i buxhetit dhe shpërndarja e burimeve të NJAB për vitet 2021, 2022 dhe 2023;

Pasqyra Nr.5 - Vlerësimi i nivelit të riskut për subjektet që auditohen për vitet 2021, 2022 dhe 2023.

Konstatim: - Nga sa mësipër rezulton se për vitin 2023 janë vlerësuar me koeficientin e riskut “i lartë” – 7 njësi, “i mesëm” – 1 njësi, “i ulët” – 1 njësi dhe 10 njësi të strukturës nuk janë vlerësuar [NA]; për vitin 2022 janë vlerësuar me koeficientin e riskut “i lartë” – 9 njësi, “i mesëm” – 1 njësi; “i ulët” – 6 njësi dhe 3 njësi të strukturës nuk janë vlerësuar [NA]; për vitin 2023 janë vlerësuar me koeficientin e riskut “i lartë” – 8 njësi, “i mesëm” – 1 njësi, “i ulët” – 6 njësi dhe 3 njësi të strukturës nuk janë vlerësuar [NA]; për njësitë e strukturës organizative /fushat/ sistemet e Bashkisë Patos, plotësia dhe saktësia e të cilave orienton NJAB për të hartuar një plan strategjik dhe plan vjetor sa më real, gjithëpërfshirës dhe në shërbim të institucionit, për përmbushjen e detyrave funksionale që i atribuon ligji.

- Për vitin 2023 Plani vjetor i punës të NJAB është miratuar nga Kryetari i Bashkisë Patos me nr. 2340/1 prot., datë 14.10.2022 i ndryshuar me atë nr.1068 prot., datë 26.04.2023 dhe përmban **12 misione** audituese të planifikuara dhe të miratuara. Ky ndryshim konsiston në këto 4 drejtime:

1. Mosfillimin e auditimit për drejtorinë e Financave dhe Drejtorinë e të ardhurave dhe tarifave vendore me arsyetimin e fillimit të auditimit nga KLSH - e pashprehur në planin vjetor të ndryshuar;
2. Mosfillimin e auditimit për Ujësjellës Kanalizime - sh.a. pas nënshkrimit të marrëveshjes së riorganizimit të tyre – e shprehur në planin vjetor të ndryshuar;
3. Zhvillimin e një Auditimi Këshillimi me gjithë strukturat e Bashkisë dhe njësitë vartëse të saj – e pa shprehur në planin vjetor të ndryshuar;
4. Programim për mision auditimi në Sektorin Juridik - e shprehur në planin vjetor të ndryshuar;

“Auditim këshillimi” është realizuar jashtë planit vjetor 2023 të miratuar (përfshirë edhe atë të ndryshuar), inicuar me Urdhrin nr. 201 datë 17.10.2023 të Kryetarit të ri të Bashkisë Patos me nr.2751 prot., datë 17.10.2023 me temë “Për kontrollin e brendshëm dhe komponentët e tij si dhe hartimi i gjurmës së auditimit”. Ky auditim është zhvilluar me një afat 3 ditor me të gjitha strukturat e Bashkisë Patos dhe njësitë vartëse të saj. Në total në vitin 2023 janë realizuar 10 misione audituese nga 12 misione të planifikuara. Për ndryshimin në programin dhe realizimin e planit vjetor 2023, NJAB ka vënë në dijeni zyrtarisht Drejtorinë e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm [DHAB] në MFE me shkresën nr. 1068 prot., datë 26.04.2023 vetëm për mosfillimin e auditimit në Ujësjellës Kanalizime-sha.

▪ Planifikimi dhe grafiku i shpërndarjes së misioneve audituese është bërë mbi bazë risku dhe paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Viti	2021			2022			2023		
Numri i auditimeve plan	9			14			12(+2)		
Numri i auditimeve fakt	9			11			11		
Niveli i riskut	lartë	mesëm	ulët	lartë	mesëm	ulët	lartë	mesëm	ulët
Numri për çdo nivel fakt	7	1	1	6	0	5	6	1+(1)	3
Shprehur në % (ndaj planit)	78	22		43	36		43	36	

Punoi: Grupi i Auditimit

Nga auditimi rezultoi se për vitin 2021 nga 9 misione audituese të planifikuara/miratuara janë realizuar 9; për vitin 2022 janë realizuar 11 misione audituese nga 14 të planifikuara/miratuara dhe për vitin 2023 janë realizuar 9 misione audituese nga 12 të planifikuara/miratuara në Planin vjetor të vitit 2023, ndërsa në total janë realizuar 11 misione audituese duke përfshirë edhe 2 auditimet jashtë planit vjetor.

Nga auditimi i vlerësimit të njësive të strukturës organizative objekt auditimi me koeficient risku dhe planifikimit/realizimit të misioneve audituese mbi bazën e vlerësimit të riskut, rezultoi se për vitin 2021 raporti mes fushave/sistemeve me koeficient risku të lartë ndaj atyre me koeficient risku të mesëm/të ulët është [7:2] ose në tejkallim të raportit [60%:40%]; për vitin 2022 është [6:5] ose në respektim të raportit [60%/40%]; për vitin 2023 është [6:5] ose në respektim të raportit [60%/40%]. Planifikimi i misioneve audituese vjetore në respektim të këtij raporti, është konform ligjit nr. 114/2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik” dhe “Manualin e Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik” Kapitulli III paragrafi 3 pika 3.1.2.

2.2 Auditimet e planifikuara dhe realizuar nga [NJAB] e Bashkisë Patos, të klasifikuara sipas llojit, paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Nr	PERIUDHA	TË DHËNA SIPAS RAPORTIMIT		
		Auditime		Nga të realizuarat, sipas llojit

		të planifikuara	Auditime të realizuara	Përputh	Financiar	Kombinuar	Performa	Tjera
1	Viti 2022	14	11	7	-	6	-	-
2	Viti 2023	12 (+2)	11	6	-	4	-	1

Burimi: NJAB/Bashkia Patos

Nga auditimi i raportimeve vjetore hartuar nga [NJAB] mbi aktivitetin e saj për çdo vit ushtrimor, të dhënat mbi gjetjet/rekomandimet dhe statusin e zbatimit të tyre, paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Nr	PERIUDHA	TË DHËNA SIPAS RAPORTIMIT							
		Rekomandime të shprehura në numër				Rekomandime të shprehura në vlerë (shpërblim dëmi)			
		Gjithsej në numër	Zbatuar	Në proces	Pazbatuar	Gjithsej në vlerë	Zbatuar	Në proces	Pazbatuar
1	Viti 2022	23	23	-	-	-	-	-	-
2	Viti 2022	27	17	9	1	-	-	-	-
	Trendi	↗	↘	↗	↗	-	-	-	-
	Totali	50	40	9	1	-	-	-	-

Burimi: NJAB/Bashkia Patos

Nga auditimi mbi rekomandimet e lëna nga NJAB në misionet audituese të realizuara në 2 vitet e fundit, rezulton se numri i tyre vjen në rritje; i atyre me status “zbatuar” për vitin 2022 janë 23 ose 100% e totalit të rekomandimeve të lëna; për vitin 2023 janë 17 ose 63% e totalit të rekomandimeve; me statusin “në proces” janë vetëm për vitin 2023 me 9 rekomandime ose 33.3% e totalit të rekomandimeve dhe me status “pa zbatuar” është vetëm 1 rekomandim ose 3.7% e totalit të rekomandimeve të lëna; rekomandime të shprehura në vlerë nuk janë lënë për 2 vitet e fundit.

▪ Realizimi i auditimeve nga [NJAB] të Bashkisë Patos për periudhën nën auditim 2023, pasqyrohen në tabelën më poshtë:

Nr	Subjekte të Planifikuara dhe të Audituar/Fusha	Realizimi i Auditimeve
		2023
1	Program Auditimi “Njësia Administrative Zharrëz”, nr. 91/1 prot., dt. 12.01.2023	√
2	Program Auditimi “Njësia Administrative Ruzhdie”, nr. 319/1 prot., dt. 02.02.2023	√
3	Program Auditimi “Drejtorja e të ardhurave, taksa e tarifave vendore”, nr. 444/1 prot., dt. 16.02.2023	pezulluar
4	Program Auditimi “Drejtorja e Financës” nr. 2581 prot., dt. 05.04.2022	pezulluar
5	Program Auditimi “Njësia e Prokurimeve Publike” nr. 991 prot., dt. 18.04.2023	√
6	Program Auditimi “Drejtorja e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve”, nr. 1226/1 prot., dt. 19.05.2023	√
7	Program Auditimi “MZSH” nr. 1440/1 prot., dt. 21.06.2023	√
8	Program Auditimi “Sektori i Planifikimit Urban”, nr. 1670/1 prot., dt. 14.07.2023	√
9	Program Auditimi “IVMT” nr. 1844 prot., dt. 28.07.2023	√
10	Program Auditimi “Drejtorja e Burimeve njerëzore, Legjislacionit, Informimit Publik” nr. 2314/1 prot., dt. 13.09.2023	√
11	Program Auditimi “Agjencia e Shërbimeve Publike”, nr. 3818 prot., dt. 11.10.2023	√
12	Program Auditimi Këshillim “Mbi Kontrollin e Brendshëm dhe Gjurmët e Auditimit” nr. 2751 prot., dt. 17.10.2023	√
13	Program Auditimi “Sektori Juridik” nr. 3132/1 dt. 04.12.2023	√
14	Plan Auditimi “U -sha”, planifikuar nga dt. 20.05.2023 deri 20.06.2023	-
	Totali i Auditimeve vjetore të realizuara	11

Punoi: Grupi i auditimit

Nga auditimi *rezultoi se* [NJAB] nuk ka realizuar numrin e angazhimeve audituese të miratuara në “Planin vjetor dhe Strategjik” për vitin 2023.

Referuar Shkresës nr. 22772 prot., datë 27.02.2018 të Ministrisë të Fiancave dhe Ekonomisë me objekt “Dërgohet programi format dhe gjurma standarde e auditimit për detyrimet e prapambetura”, nga auditimi i planeve strategjike [2021-2023], [2022-2024] dhe [2023-2025] dhe atij vjetor [2023], *rezultoi se* nuk janë pjesë e tyre *mision auditues mbi “detyrimet e prapambetura”*, pasi Bashkia Patos nuk ka të tilla. (edhe në periudha të mëparshme).

2.3 Nga auditimi i 14 dosjeve të Subjekteve të planifikuara për t’u audituar dhe realizuar në vitin 2023, rezultuan si më poshtë:

1. Fletë inventari FI të dosjes	- FI me nënshkrimin e përgjegjësit të grupit/NJAB;
2. Autorizimi për fillim auditimi	- është në dosje
3. Takimi fillestar me subjektin	- realizuar /në dosje;
4. Deklarata e Interesit	- në dosje / në 1 rast mungon (DAKS)
5. Formulari tip i vlerësimit të risqeve	- në dosje / në 1 rast i panënshkruar
6. Evidencat/dokumentacioni	- në dosje / të panumerizuara
7. Projekt Raporti	- në dosje
8. Takim përmbyllës	- në dosje
9. Observacione	- sipas rastit;
10. Raporti Përfundimtar	- në dosje;
11. Memo Kryetarit	- në dosje;
12. Plani i veprimit nga subjekti i audituar	- mungon në 13 raste/ është vetëm në 1 rast dhe i pa regjistruar në protokoll (SPP);
13. Raportim nga subjekti i audituar mbi statusin e rekomandimeve të lëna	- nuk ka /mungon.

- Nga auditimi i dosjeve të auditimit *rezultoi se*: për auditimin e “Sektori i Prokurimit publik” Plani i veprimit nuk është regjistruar në regjistrin e protokollit të Bashkisë Patos;

- Për auditimin e “Drejtoria e Arsimit, kulturës dhe sportit” mungon Deklarata e pavarësisë së përgjegjësit të NJAB njëherësh anëtar i grupit të auditimit H.M.;

- Për auditimin e “NJA Ruzhdie” Formulari tip i vlerësimit të risqeve për sistemet/fushat nuk ka nënshkrimin e vlerësuesit të risqeve dhe datën kur është plotësuar;

- Për “Auditimin e këshillimit” mungon fleta e inventarit të dosjes;

- Nga 14 subjekte të planifikuara, janë realizuar misione auditimi në 12 subjekte (një është tematik), për të cilët rezultoi se 10 prej tyre nuk kanë hartuar planet e veprimit brenda afatit 30 ditor nga marrja në dorëzim e Raportit Përfundimtar të Auditimit, me anë të të cilit vihet në dijeni NJAB mbi pranimin ose jo të rekomandimeve të lëna dhe personat përgjegjës të ngarkuar për zbatimin e tyre;

- Për auditimet e “Drejtoria e financës” dhe “Drejtoria e të ardhurave” të cilat nuk janë realizuar sipas planit vjetor 2023, nuk janë pasqyruar në planin e ndryshuar;

- Gjithashtu rezultoi edhe mungesë e monitorimit të NJAB për zbatimin e rekomandimeve nga ana e subjekteve të audituara brenda afateve të përcaktuara, sipas përcaktimeve në kreun 4.1.13.1 dhe 2 “Procedurat e ndjekjes së rekomandimeve të auditimit” paragrafi 3 dhe “Raportimi i ndjekjes së rekomandimeve” paragrafi 4. Kjo si pasojë e mungesës së raportimit nga ana e subjekteve të audituara, në moszbatim këto të kreut 4.1.13.3 “Përgjegjësitë e njësisë për të zbatuar rekomandimet e AB”.

III. Sigurimi i cilësisë në auditimet e kryera dhe kontrolli i zbatimit të detyrave të lëna; Raportimi në DHAB/MFE.

3.a Në njësinë e auditimit të brendshëm, Sigurimi i Cilësisë në të gjitha angazhimet e Auditimit të Brendshëm të kryera gjatë periudhës objekt auditimi është kryer nga grupi i punës që ka realizuar angazhimin e auditimit, pra nga NJAB të Bashkisë Patos. Sigurimi i cilësisë është pjesë e procesit që bën të mundur zbatimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016 “Për Miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik” me emërtesën “Njësia e Auditimit të Brendshëm”.

Për periudhën 2022-2023 nga Njësia e Auditimit të Brendshëm të Bashkisë së Patos janë lënë **50 [23/27]** rekomandime, nga të cilat janë pranuar dhe “zbatuar” plotësisht **40 [23/17]** rekomandime, “në proces zbatimi” janë **9 [0/9]** rekomandime dhe “pa zbatuar” është vetëm **1 [0/1]** rekomandim; Ndërsa vetëm në vitin 2023 janë lënë dhe pranuar **27** rekomandime nga të cilat **17** janë “zbatuar”, **9** janë “në proces zbatimi” dhe **1** është “pazbatuar”.

3.b Bashkia Patos ka raportuar në DHAB/MFE me shkresën nr. 384/1 prot., 13.02.2024 me subjekt: “Mbi dërgimin e Raportit vjetor të veprimtarisë së Njësies së Auditimit të Brendshëm në Bashkinë Patos për vitin 2023” konform kërkesave të akteve ligjore në fuqi.

Nga sa më lart grupi i auditimit thekson se lëvizjet dhe rekrutimi i personelit të strukturës së NJAB gjatë vitit 2023 përbën pengese për mirëfunksionimin dhe në performancën e [NJAB] së bashkisë Patos. Kjo rezulton në përzgjedhjen e sektorëve/fushave në planifikim në mungesë të një vlerësimi real dhe për çdo fushë/sistem; mosrealizimin e numrit vjetor të misioneve audituese të planifikuara; numrit në rritje të rekomandimeve nga viti 2021 në vitin 2023 dhe atij në rënie të rekomandimeve me statusin “i zbatuar”; në mos planifikimin/realizimin e misionit auditues “zbatimi i rekomandimeve” si dhe në mospërbushjen dhe mosrealizimin e plotë të Skemës së Procesit të Auditimit → Hapi 4 [Ndjekja e Rekomandimeve], veprime këto në kundërshtim me ligjin 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” dhe “Manualine Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”.

3.2. Mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit.

2.1. Programimi PBA dhe programimi i buxhetit vjetor 2023.

2.2. Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas akteve normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fonde të çelura.

2.3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetorë dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit.

2.4. Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikujduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve; (Faturat e palikujuara të shoqërohen me listë analitike, të detajuara me numër fature dhe datë krijimi etj, sipas raportimit në MFE, ku të evidentohen detyrimet nga mungesa e burimeve të veta dhe detyrimet nga mungesa e alokimit të granteve si FZHR, Ministrinë e linjës etj.).

2.5. Çelja dhe ekzekutimi i fondeve të përfituara përmes FZHR-së, saktësia e raportimit buxhetor të tyre.

2.1. Programimi PBA dhe programimi i buxhetit vjetor për vitin 2023;

Nga auditimi i procedurave për përgatitjen PBA 2023-2025, u konstatua se janë realizuar fazat e përgatitjes, është bërë ngritja e grupit të punës, është bërë marrja e kërkesave për nevojat për punë,

mallë e shërbime, llogaritja e planifikimit për të ardhurat e veta, përcaktimi i tavaneve të shpenzimeve sipas programeve etj.

Për hartimin e programeve buxhetore afatmesme dhe projektbuxhetet vjetore janë kryer konsultime me komunitetin dhe grupet e interesit në njësinë e vetëqeverisjes vendore. Buxhetet janë hartuar mbi bazën e kërkesave shkresore nga njësitë administrative, drejtoritë e shkollave, sektorët e bashkisë etj, gjë që vërteton se prej tyre janë marrë kërkesat për nevojat reale e mbi bazën e tyre dhe të buxhetit faktit të mundshëm janë përzgjedhur ato më prioritare.

Për vitin 2023 buxheti bazë fillestar vjetor (në bazë të vlerësimit të të ardhurave dhe të transfertave të pakushtëzuara, të përcaktuara në ligjin e buxhetit vjetor), është miratuar me VKB nr. 93 .datë 19.12.2022, konfirmuar nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Fier me shkresën nr 1316/1 datë 30.12.2022. Buxheti vjetor është miratuar brenda afateve që përcakton pika e nenit 41 të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” (brenda datës 25 dhjetor).

Në këtë VKB të ardhurat nga burimet e veta të planifikuara për vitin 2023 kanë vlerën 287,999,000 lekë, transfertat e pakushtëzuar ka vlerën 154,219, 000 lekë, transfertat specifike ka vlerën 101,519,000 lekë. Të ardhura të trashëguara nga viti i mëparshëm 0,000 lekë.

Në total të ardhurat kanë vlerën 543,737,000 lekë, po ashtu edhe shpenzimet kanë vlerën 543,737,000 lekë.

Të dhënat për PBA dhe projekt buxhetet për vitin 2023 në 000/lekë, sipas tabelave në vijim:

	Emërtimi	Faza I- PBA 2023	Faza II- PBA 2023	Projekt Buxhet 2023
600	Paga	208,084	208,084	212,343
601	Sigurime Shoqërore	35,454	35,454	36,554
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	130,704	130,704	134,439
604	Transferta Korente të Huaja	12,860	12,860	9,000
606	Trans për Buxh. Fam. & Individ	4,343	4,343	4,804
I	Shpenzime Korrente	391,445	391,445	397,140
230	Kapitale të Patrupëzuara			
231	Kapitale të Trupëzuara	125,951	125,951	146,597
	Shp. Kapitale me financim te brendshëm	125,951	125,951	146,597
230	Kapitale të Patrupëzuara			-
231	Kapitale të Trupëzuara			
	Shpenzime Kapitale me financim te huaj	-	-	-
II	Shpenzime Kapitale	125,951	125,951	146,597
III	Shpenzime nga Të ardhurat jashtë limiti			
I+II +III	Totali i Shpenzimeve	517,396	517,396	543,737

Gjatë vitit 2023, janë marrë gjithashtu edhe disa vendime të tjera të këshillit bashkiak të cilat kanë bërë që të ndryshojnë vlerat e buxhetit bazë (miratuar në dhjetor 2023). Këto ndryshime paraqiten si vijon:

- Me VKB nr.10 , datë 21.02.2023 është marrë vendim për alokimin e fondeve të trashëguara nga viti 2022, duke planifikuar të ardhura dhe shpenzime shtesë në vlerën 246,193,269 lekë.

- Me VKB nr.37 , datë 30.06.2023 është marrë vendim për miratimin e shtesave te buxhetit dhe ndryshimeve te pagave për vitin 2023, të ardhura vendore shtese, transfertat e pakushtëzuar nga Ministria e Financave për kompesimin e rritjes së pagës minimale, duke planifikuar të ardhura dhe shpenzime shtesë në vlerën 16,039,000 lekë.

- Me VKB nr. 47, datë 27.07.2023 është marrë vendim për miratimin e shtesës së buxhetit për miratimin projektit “Shërbim në familje për të moshuarit dhe nxitje e të bashkëveprimit ndërbreznor, të ardhura vendore vendore shtese nga Ministria e Financave, duke planifikuar të ardhura dhe shpenzime shtesë në vlerën 1,520,000 lekë.

Planifikimi i shpenzimeve për investime për vitin 2023 ka vlerën 380,557,000 lekë në mënyrë të detajuar.

2.2. Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas akteve normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fonde të çelura.

-Krahasimi planeve buxhetore me PBA respektive:

PBA 2023-2025 me planin buxhetor 2023, paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Në 000/lekë

Nr.	Emërtimi	Plan përfundimtar 2023	Sipas PBA 2023-2025	Ndryshimi
1	Shpenzime për pagat (600+601)	248,897	243,538	-5,359
2	Shpenzime (602.604.609)	148,243	149,907	1,664
3	Investime Bashkia	146,597	125,951	-20,646
4	Investime nga FZSHH	0	0	0
	Total i planit fillestar	543,737	519,396	-24,341
	Shtesat nga Pushteti Qendror	0	0	0
5	Investime			0
6	Shpenzime për pagat			0
7	Shpenzime operative			0
	Gjithsej	543,737	519,396	-24,341

Burimi: Bashkia Patos

Plani përfundimtar i buxhetit ka diferenca prej 24,341 mijë lekë nga plani në PBA për shkak se në planin përfundimtar janë pasqyruar rritja e grantit të pakushtëzuar në vlerën 14,089 mijë, transferata specifike në vlerën 3,914 mijë lekë dhe të ardhurat e veta në vlerën 8,338 mijë lekë.

Në programet buxhetore është bërë shpërndarja e fondeve të vënë në dispozicion nga Pushteti Qendror të grandeve nëpërmjet transfertës së pakushtëzuar, transfertës së kushtëzuar dhe fondeve të krijuar nga burimet e veta, për kryerjen e funksioneve të veta, ato të deleguara dhe të përbashkëta si dhe shpërndarjen e fondeve të grandeve.

Ndarja e plan buxhetit dhe detajimi i tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli është kryer në respektim të disiplinës buxhetore sipas strukturës dhe burimeve të financimit. Gjatë vitit si rezultat i çeljeve të reja në llogarinë e njësisë vendore në thesar, vlerat përkatëse të buxhetit vjetor kanë pësuar ndryshime në kuptimin e vlerës totale, pasi janë çelur fondet për funksionet e deleguara, grandeve qeveritare, ndihma ekonomike, gjendja civile, shpërblime lindje etj., të cilat nuk kanë qenë të pasqyruara në çeljen fillestare të vitit.

Gjatë vitit janë kryer ndryshime në buxhet (shitesa/paksime). Këto lëvizje në rastet e lëvizjeve brenda të njëjtit artikull dhe brenda programit janë kryer me urdhër të Titullarit e përcaktuar kjo me VKB, ndërsa lëvizjet nga programi në program dhe nga një artikull në tjetrin janë kryer me Vendim të KB-së.

- Planifikimi dhe detajimi i buxhetit në nivel artikulli dhe nënartikulli, është bërë sipas nevojave të paraqitura dhe kërkesave për fonde buxhetore, duke u bazuar në kërkesat e udhëzimeve përkatëse “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”.

-Buxheti fillestar miratuar me VKB nr. 93, datë 19.12.2022 në vlerën 543,737 mijë lekë.

-Buxheti shtesë për fondet e trashëguara miratuar me VKB nr. datë nr.10 datë 21.02.2023 në vlerën 246,193 mijë lekë.

-Buxhet shtesë për Pagat miratuar me VKB nr. 37, datë 30.06.2023 në vlerën 16,039 mijë lekë.

-Buxhet shtesë për “Projektin e të moshuarëve” miratuar me VKB nr. 47, datë 27.07.2023 në vlerën 1,520 mijë lekë.

- Akordimi fillestar i buxhetit dhe ndryshimet që kanë pësuar zërat e tij gjatë vitit, janë të rakorduar me Degën e Thesarit dhe janë të raportuara periodikisht pranë degës së Thesarit dhe në MFE.

Situacionet e shpenzimeve janë të plotësuara sipas klasifikimit buxhetor për të gjithë periudhën e audituar. Fondet e akorduara në planet buxhetore dhe ndryshimet e bëra në periudha të ndryshme, janë evidentuar dhe janë ndjekur në dinamikë, në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nënartikulli sipas shërbimeve dhe më vete për çdo njësi vartëse e sipas periudhave të planifikuara.

Ndryshimet brenda shpenzimeve buxhetore për artikuj dhe nënartikuj është bërë me VKB nr. 13 datë 21.02.2023 “Për miratimin e dhënies së ndihmës financiare z. A.D ”.

VKB nr. 22 datë 27.04.2023 “Për miratimin e dhënies së ndihmës financiare z. S.K ”.

VKB nr. 05 datë 27.05.2023 “Për miratimin e ndihmës financiare”.

VKB nr. 57 datë 05.10.2023 “Për miratimin e përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për vitin 2023 për Mbrojtjen Civile , për blerjen e një autoboti uji”.

V. Kryetari nr.249 dt. 02.08.2023 “Për shtesë fondi për blerje mjete furoistradë për Mzsh”.

V. Kryetari nr.114 dt. 17.07.2023 “Për shtesë fondi për blerje elektropmpë për vaditje ”.

- Analiza e shpenzimeve buxhetore për artikuj dhe nënartikuj është bërë periodikisht mbi bazën e situacioneve mujore të konfirmuara nga Dega e Thesarit. Raportimi i realizimit të buxhetit është i shoqëruar me relacionin e realizimit të buxhetit duke argumentuar edhe shtesat e buxhetit gjatë periudhës ushtrimore për zërat e buxhetit të planifikuara dhe që nuk janë alokuar fonde që në fillim të çeljes së buxhetit.

Janë kryer ndryshime të vazhdueshme në buxhetin vjetor, veprime që tregojnë se planifikimi i buxhetit duhet të bëhet më i argumentuar, në mënyrë që gjatë vitit ndryshimet të jenë sa më të vogla. Në mënyrë të detajuar ndryshimet e buxhetit për vitin 2023 paraqiten në aneksin nr. 2 pika 2 bashkëlidhur raportit të auditimit.

2.3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetorë dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit.

Për zbatimet e buxheteve është rakorduar çdo muaj me Degën e Thesarit, si për shpenzimet e kryera ashtu edhe për të ardhurat, duke mbajtur akt-rakordimet përkatëse. Janë ruajtur kufijtë e miratuar të shpenzimeve në total dhe për çdo artikull e nënartikulli sipas klasifikimit ekonomik. Pasqyra e realizimit të treguesve të buxhetit viti 2023, referuar akt-rakordimet me thesarin paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Planidhe fakti i buxhetit te Bashkisë viti 2023 000/lekë

Art.	Emertimi	Plan	Fakti	dif
600	Paga	257,164	240,496	16,668
601	Sigurime Shoqërore	28,192	24,423	3,769
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	131,207	90,738	40,469
604	Transferta Korente të Brendshme	8,460	3,000	5,460
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	209,634	201,919	7,715
609	Fondi Rezervë	5,371	5,371	-
230	Kapitale të Patrupëzuara	7,044	-	7,044
231	Kapitale të Trupëzuara	624,970	446,120	178,850
	TOTAL	1,272,042	1,012,067	259,975

Konstatohet se plani i buxhetit, i gjeneruar nga thesari ka vlerën **1,272,042** lekë nuk përputhet me vlerën e planit të buxhetit fillestar të miratuar me VKB që ka vlerën **543,737** lekë, pasi në këtë buxhet përfundimtar sipas akt-rakordimit përfundimtar nuk janë përfshirë të gjitha shtesat dhe ndryshimet përfshirë këtu edhe fondet e pushtetit qendror, që nuk janë objekt i miratimit me VKB. Në mënyrë të detajuar buxheti përfundimtar plan-fakt për vitin 2023 paraqiten në aneksin nr. 3 pika 2 bashkëlidhur Raportit të Auditimit.

Për vitin 2023, planifikimi i buxhetit për zërin e shpenzimeve (të ardhurat e veta vendore, transferta e pa kushtëzuar, si dhe granti, transferta e kushtëzuar) ka vlerën **1,272,042** mijë lekë, ndërsa

realizimi **1,012,067** mijë lekë, ose në masën 79%. Zëri shpenzime page është planifikuar në vlerën 257,164 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 240,496 mijë lekë, ose në masën 94 %, ndërsa zëri sigurime shoqërore është realizuar në masën 87%.

-Zëri shpenzime operative 602 është planifikuar në vlerën 131,207 lekë dhe është realizuar në vlerën 90,738 lekë, ose në masën 70 %.

-Zëri shpenzime kapitale (artikulli 230 dhe 231) është planifikuar në vlerën 632,014 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 446,120 mijë lekë, ose në masën 71 %.

- Nga auditimi i shpenzimeve të kryera nga kjo llogari konstatohet se është kaluar edhe kontributi për shoqëritë tregtare për shoqatën sportive “A” në vlerën 7,105,900 mijë lekë për gjithë vitin 2023. Konstatohet se edhe në buxhetin e vitit 2023 është planifikuar të kryhet kontributi nga llogaria ekonomike 602 për shoqatën sportive “A”. Rezulton se Bashkia Patos nuk ka filluar procedurat për shitjen e aksioneve ndaj shoqatës sportive “A” në përputhje me ligjin nr. 105/2020, datë 29.07.2020 “Për Sportin”, neni 8⁹. Nga mos zbatimi i këtij ligji Bashkia Patos është vijuar me planifikimin dhe kryerjen e pagesave si kontribut në vlerë totale 7,105 mijë lekë ndaj “A”, që përbën shpenzim pa ekonomikitet i fondeve të buxhetit të shtetit.

-Nga auditimi u konstatohet se realizimi i shpenzimeve buxhetore për vitin 2023 me të ardhurat e veta (pa transfertën e pakushtëzuar) të Bashkisë Patos ka diferenca të dukshme me vlerën e planifikuar.

-Niveli i realizimit të investimeve të planifikuara, i cili është zëri më kryesor i buxhetit në lidhje me ndikimin që ka në ofrimin e të mirave publike ndaj komunitetit, është akoma më i ulët se mesatarja e realizimit të buxhetit. Ky zë është planifikuar në vlerën 632,014 mijë lekë, realizuar 446,120 lekë, ose në masën 71,16 %. Në menyrë të detajuar investimet e parashikuara e të përcaktuara në buxhetin e vitit 2023 paraqiten në aneksin nr. 4 pika 2 bashkëlidhur raportit të auditimit.

Ky mos realizim vjen si rezultat i mosrealizimit të të ardhurave, që do të thotë se nga Bashkia Patos në fillim të vitit buxhetor planifikohen angazhime buxhetore, duke mos u mbështetur në planifikime realiste të të ardhurave të veta nga taksat dhe tarifatat vendore dhe ky planifikim nuk korrigjohet gjatë vitit, duke mos përshtatur shpenzimet buxhetore të miratuara me të ardhurat reale të realizuara. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërm janë në kundërshtim me pikën (a) të nenit 5, si dhe nenin 46 të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” dhe ngarkojnë me përgjegjësi ish/kryetaren e bashkisë Patos znj, R.B dhe znj. M.SH me detyrë Drejtor e Financës. Gjithashtu edhe gjatë vitit 2023 nuk është bërë analiza e zbatimit të buxhetit brenda muajit qershor dhe nuk është dalë në konkluzion nëse duhej rishikuar ose jo buxheti vjetor 2023.

- *Fondi rezervë.*

Bazuar në pikën 6 neni 40 i nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe nenit 6 të ligjit nr. 9936, datë 26. 06. 2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, për të përballuar shpenzime të paparashikuara në buxhetin e njësisë të qeverisjes vendore, është planifikuar fond rezervë deri në 3% të totalit të shpenzimeve të planifikuara (duke përjashtuar transfertat e kushtëzuara).

Përdorimi i fondit rezervë gjatë vitit 2023 është bërë me vendimet e këshillit si më poshtë:

1. VKB nr. 5 datë 27.01.2023 dhe VKB nr. 49 datë 01.08.2023 “Për dhënie ndihmë financiare për sëmundje të rëndë terminale”, me vlerë 1,000,000 lekë ndaj qytetarit K.G.

⁹ ku citohet “Institucionet publike qendrore dhe vendore, që kanë në zotërim aksione të shoqërive tregtare sportive, brenda një viti nga hyrja në fuqi e këtij ligji i nxjerrin ato në shitje në përputhje me rregullat dhe procedurat e përcaktuara në legjislacionin në fuqi..”

2. VKB nr. 13 datë 21.02.2023 “Për dhënie ndihmë financiare për rehabilitim dëmi në banesë” me vlerë 700,000 lekë ndaj qytetarit A.D.
3. VKB nr. 22 datë 27.04.2023 “Për dhënie ndihmë financiare për sëmundje të rëndë”, me vlerë 100,000 lekë ndaj qytetarit S.K.
4. VKB nr. 67 datë 30.10.2023 “Për dhënie ndihmë financiare për sëmundje të rëndë”, me vlerë 150,000 lekë ndaj qytetarit M.B.
5. VKB nr. 48 datë 01.08.2023 “Për dhënie ndihmë financiare për rehabilitim dëmi në banesë”, me vlerë 45,000 lekë ndaj qytetarit F.S.

Në vitin 2023 Bashkia Patos nuk ka marrë subvencione. Sipas raportimit nga Drejtoria e Financës, Bashkia Patos nuk ka dhënë subvencione për vitin 2023.

2.4.Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikujduara, vendimeve gjyqësore, vendimeve të shpronësimit dhe niveli i realizmit të të ardhurave (faturat e pa likujduara të shoqërohen me listë analitike të detajuar me nr. fature, datë krijimi etj., sipas raportimit në MFE).

- Detyrimet e prapambetura viti 2023.

Bashkia Patos në datën 01.01.2023 ka pasur si çelje të vitit ushtrimor detyrime të prapambetura progresive vlerën 0 lekë, e cila ka si burim financimi të ardhurat e veta. Pra, në datën 31.12.2023 vlera e detyrimeve të prapambetura me burim financimi të ardhurat e veta, krahasuar me këtë vlerë në fillim të vitit ushtrimor (01.01.2023) nuk ka ndryshime.

- Efektet financiare në buxhet, si rezultat i zbatimit të vendimeve gjyqësore.

Bashkia Patos për zbatimin e vendimeve gjyqësore për vitin 2023 ka shpenzuar vlerën totale 12,653,945 lekë, nga e cila vlera 12,532,509 lekë i përket vendimeve gjyqësore me objekt “Shpenzime për zbatimin e vendimit nr.265 dt. 12.02.2020 të Vendimit Gjyqësor të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë për B”. Lidhur me zbatimin e vendimit të gjykatës, Këshilli Bashkiak, me VKB nr.63 datë 30.10.2023, ka miratuar në këtë vendim, marrëveshjen për mënyrën e pagesës me dy këste, ndërmjet subjektit “B” dhe Bashkia Patos, ku vlera prej 12,532,509 lekë të shlyhet brenda vitit 2023 dhe kësti i dytë brenda vitit 2024. Po ashtu ka kryer dhe pagesa për dëmshpërblimi shpronësimi sipas VKM nr. 600 dhe për detyrimet që kanë rrjedhur nga vendimi nr.318 datë 09.03.2018 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, lënë në fuqi me vendim nr. 420, datë 24.02.2020 nga Gjykata Administrative e Apelit Tiranë dhe vendimit nr.148 datë 09.04.2021, dhënë nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë për L. dhe F.R , për vlerën shtesë të mbetur në shumën vlerën 121,236 lekë.

Për vitin 2023 nuk rezultojnë vendime të reja gjyqësore të cilat do krijonin detyrime të reja shtesë.

2.5 Çelja dhe ekzekutimi i fondeve të përfituara përmes FZSHS, saktësia e raportimit buxhetor të tyre.

Në lidhje me Investime të kryera nga FZHR, Bashkia Patos nuk është pjesëmarrëse apo përfituese në financim. Rezulton se për periudhën e audituar nuk ka patur asnjë financim të tillë sipas të dhënave të vëna në dispozicion.

Për vitin 2023 janë financuar me fonde të buxhetit të shtetit (Qeverisja Qendrore) Ministrinë e linjës, 5 investime publike, për 2 prej të cilave kontrata është lidhur në vitin 2020, për 2 investime kontrata është lidhur në vitin 2022, dhe për 1 kontratë është lidhur 2023, dhe një investim është financuar nga donatorë, sipas të dhënave paraqitur në aneksin nr 5 pika 2 bashkëlidhur raportit të auditimit.

Sa më sipër subjekti i audituar nuk ka paraqitur observacione mbi konstatimet e grupit të auditimit.

3.2.6. “Niveli i realizimit të të ardhurave dhe mënyra e përdorimit të tyre. Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përrputhje me dispozitat ligjore dhe borxhi tatimor.”, u shqyrtua dokumentacioni i mëposhtëm:

- Vendimet e Këshillit Bashkiak Patos për miratimin e paketave fiskale të vitit 2023, me ndryshime;
- Dokumentacioni i sektorit të taksave dhe tarifave vendore në lidhje me mënyrën e mbajtjes së regjistrave të tatim-paguesve, shkarkime nga Programi Excel i mbajtjes së sistemit të taksave, dosje fizike të mbajtura për subjektet tatimpagues;
- Kontrata, aktmarrëveshje, procesverbale dhe relacione në lidhje me të ardhurat;
- Evidencat e debitorëve për bizneset dhe familjarët, për taksat dhe tarifave vendore;
- Miratimet e buxheteve në lidhje me planifikimin e të ardhurave për vitin 2023;
- Akt-rakordimet me degën e Thesarit dhe raportimet mbi realizimin faktik të të ardhurave, monitorimi dhe analiza mbi performancën e realizimit të të ardhurave të planifikuara;
- Dokumentacioni në lidhje me agjentët tatimorë, rakordimet me ta, me thesarin etj.;
- Dokumentacion tjetër i vënë në dispozicion nga Drejtoria e zhvillimit ekonomik dhe zyra e tatim-taksave.

- Strukturat për administrimin dhe mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore

Për vitin 2023 numri i përgjithshëm i punonjësve është miratuar me VKB nr. 93 datë 19.12.2022 “Për miratimin e numrit të përgjithshëm punonjësve të administratës të Bashkisë dhe strukturave të tjera”, ku përfshihet edhe struktura e Drejtorisë së të Ardhurave, e cila përbëhet nga 5 Punonjës me përbërje Drejtor, 4 specialistë .

Struktura e Drejtorisë të Ardhurave për vitin 2023 është paraqitur më poshtë:

Nr.	Emër Mbiemër	Pozicioni	Date fillimi
1	A.M.	Drejtor	27/05/2015
2	S.M.	Specialiste e të ardhurave	12/11/2007
3	E.A.	Inspektor i taksave	02/07/2020
4	M.H.	Specialiste e të ardhurave	11/05/2022
5	E.Q.	Inspektor i taksave	01/01/2022

Konstatohet se struktura e DTV Bashkia Patos ka probleme dhe nuk është në funksion të realizimit të të ardhurave, pasi nuk ka një Sektor të Borxhit i cili do ishte si një nga sektorët më të rëndësishëm në DTV Bashkia Patos, pasi evidentohet se një numër i lartë i detyrimeve të paarkëtuara (debitor) familjarë në vlerën **86,425 mijë lekë**, subjekte fizik/juridik dhe institucioni shtetërorë në vlerë **8,479 mijë lekë** për **80** subjekte, veprime që bien në kundërshtim me pikën (ç) të nenit 5 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar dhe në Kreun XI- “Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar”, nenet 88 – 104, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH” me ndryshime. Veprimet dhe mosveprimet ngarkojnë me përgjegjësi nëpunsin Autorizues si dhe Drejtorin e Tatim Taksave.

- Parashikimi dhe realizimi i taksave dhe tarifave vendore sipas llojeve

Për vitin 2023, Paketa Fiskale e taksave dhe tarifave vendore është miratuar me VKB nr. 82 datë 25.11.2022, e konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Fier. Nga të dhënat e **pasqyrës aneks nr. 2** më poshtë, shihet se për vitin 2023 planifikimi i të ardhurave është në vlerën 287,999 mijë lekë të planifikuara, janë realizuar 240,198 mijë lekë ose 84 %, mos realizim në vlerën 47,801 mijë lekë, kryesisht në taksat e popullatës, si p.sh. taksa e tokës bujqësore, taksa e ndërtesës dhe tarifa e pastrim-gjelbërimit. Konstatohet se:

-Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin, është planifikuar duke mos patur një databazë të saktë për numrin e subjekteve të cilët gjatë vitit mbyllen dhe regjistrohen, nuk ka bazë të dhënash për subjektet të cilët në bazë të xhiros do paguajnë tatimin e fitimit. Drejtoria e të Ardhurave, duke mospatur një bazë të dhënash nuk ka bërë rakordime me Drejtorinë Rajonale Tatimore Fier (DRT).

Parashikimi dhe realizimi i të ardhurave, për vitin 2023”

Tabela nr.1

Nr.	Emërtimi	2023		
		Plan	Fakt	%
1	Taksa mbi Ndërtesat	21,424,000	11,218,142	52
2	Taksa mbi Tokën bujqësore	21,420,000	9,082,163	42
3	Taksa e Ndikimit në Infrastrukturë	6,399,000	1,145,309	18
4	Taksa e kalimit të drejtës së pronësisë.	400,000	27,137	7
5	Taksa e rregjistrimit të automjeteve	15,691,000	18,099,653	115
6	Tatimi mbi të ardhurat personale (TAP)	3,512,000	9,939,824	283
7	Taksa e tabelës	630,000	634,693	101
8	Taksa e Rentës minerale	75,434,000	55,638,472	74
9	Taksa mbi Truallin	38,082,000	37,009,632	97
10	Taksë tregu	1,290,000	400,200	31
11	Tatim i thjeshtuar biznesi i vogël	0	253,030	
TOTALI I		184,282,000	143,448,255	78
1	Tarifa për Pastrimin	42,031,000	25,251,594	60
2	Tarifa për Shërbimin Komunitar	5,026,000	1,142,525	23
3	Tarifë për hapësirat publike	250,000	30,000	12
4	Tarifë Ndrëçimi	1,609,000	1,504,802	93
5	Tarifë Gjelbërimi	1,609,000	1,392,718	87
6	Tarifë reklame	507,000	0	
7	Tarifë parkimi	921,000	601,602	65
8	Tarifë për shërbime të tjera administrative	1,149,000	613,450	53
9	Tarifë për dhënie leje, licënsa dhe autorizime	3,179,000	1,283,747	40
10	Tarifë Ndotje/Përmirësim mjedisi	40,956,000	46,968,400	115
11	Tarifë mirëmbajtje vaditje-kullim	880,000	648,460	74
12	Qera toke	1,300,000	1,622,541	125
13	Qera ndërtesë	1,000,000	1,886,547	189
14	Të ardhura nga gjobat	500,000	204,700	41
15	Të ardhura nga pagesat kopësht+çerdhe	2,800,000	1,925,240	69
16	Të tjera jotatimore	0	157,967	
17	Sponsorizime	0	11,515,519	
TOTALI II:		103,717,000	96,749,812	93
TOTALI I + II :		287,999,000	240,198,067	84

- Agjentët tatimorë dhe rakordimet mujore me ta:

Në rregulloren e brendshme të institucionit nuk është përcaktuar personi i cili duhet të ketë për detyrë ndjekjen e arkëtimeve nga agjentët tatimorë dhe mbajtjen e aktrakordimeve me ta.

Të ardhurat nga agjentët tatimorë (*Drejtoria Rajonale Tatimore, në lidhje me TFTH; Drejtoria e Përgjithshme të Buxhetit, Drejtoria e Menaxhimit të Buxhetit, pranë Ministrisë së Financave, në lidhje me rentën minerare; AKSH-ja, në lidhje me taksën e ndikimit në infrastrukturë dhe DRSHTRR Patos, në lidhje me taksën vjetore të mjeteve të përdorura*) derdhen automatikisht në fund të çdo muaji, për llogari të bashkisë Patos dhe konfirmohen nga Dega e thesarit.

Konstatohet se sipas DTT Bashkia Patos, mos arkëtimet nga ana e Drejtoria Rajonale Vendore ASHK Fier, janë për shkak të anashkalimit të arkëtimit të këtyre detyrimeve për taksën e infrastrukturës, për të cilat nga Bashkia Patos është kërkuar vazhdimisht në rrugë zyrtare që të mos i kryejnë veprimet e regjistrimit të pronës nga këto lloj subjektsh, pa paraqitur dokumentin e pagesës së kësaj takse. Për sa më sipër, Bashkia Patos duhet të fillojë procedurat për të gjobitur Agjentin Tatimor ASHK në zbatim të dispozitës së mësipërme.

Gjithashtu, Bashkia Patos, duhet të marrë masa për evidentimin e diferencave të pa mbledhura sipas llojit të taksës/tarifës, të cilat përbëjnë mungesë të ardhurash për buxhetin e saj dhe të fillojë procedurat për gjobitjen e këtyre agjentëve tatimorë me 50% të shumës së plotë të taksave/tarifave

të pa arkëtuar apo të shmangura sipas Nënës 117 të ligjit nr. 9920, dt. 19.5.2008, “Për Procedurat Tatimore”, ku parashikohet se “Dënimet për agjentët e mbajtjes së tatimit në burim, agjentët e taksave dhe agjentët e tarifave”.

- Detyrimet e familjarëve:

Mënyra e parashikimit të detyrimeve të familjarëve.

- Tarifa e pastrimit parashikohet në bazë të numrit të familjeve rezidente aktive të bashkisë.

Taksa e ndërtesës parashikohet në bazë të regjistrit të taksës që kanë njësitë, të përditësuar me numër njësi pronësie të reja, saktësim dhe shtim sipërfaqesh.

Nga auditimi u konstatua se bashkia Patos nuk ka lidhur kontratë me Ndërmarrjen e Ujësjellës Kanalizimeve Patos për vjeljen e detyrimeve të familjarëve mbi bazën e kontratave të ujit të pijshëm që abonentët familjarë kanë, evidentimit dhe regjistrimit të abonentëve të rinj duke plotësuar regjistrin e taksapaguesve familjarë, gjë e cila ka shkaktuar edhe mangësitë e mëdha dhe një numër të lartë debitorësh në lidhje me këto detyrime.

- Njoftimet e bëra për familjarët, masat e mara dhe masat shtrënguese

Shërbimi për familjet ofrohet në Zyrën me një ndalesë për qytetin dhe në Njësitë Administrative nga specialisti i ngarkuar për taksat dhe tarifave vendore.

Paketa Fiskale e bashkisë publikohet në faqen zyrtare të saj, ku të gjithë personat e interesuar mund të marrin informacion të gjerë në lidhje me taksat dhe tarifave vendore, nivelin e tyre, afatet e pagesave, përjashtimet përkatëse etj.

Shpërndarja e faturave dhe njoftimi i familjeve për detyrimet vendore, kryesisht është bërë nga specialistët e taksave si në mënyrë verbale ashtu dhe shkresore.

Për shërbimet që qytetarët kërkojnë të kryejnë në bashki, zakonisht kërkohet dokumentimi i shlyerjes së detyrimeve, nëpërmjet librezës së taksave vendore, me synim ndërgjegjësimin e tyre për pagesën e taksave dhe tarifave vendore në mënyrë vullnetare. Sa më sipër është e vetmja masë shtrënguese e aplikuar për vjeljen e detyrimeve të papaguara nga popullata.

Nga auditimi i të dhënave, rezultoi se më datën 31.12.2023 për mos pagesën e detyrimeve janë debitorë për abonentët familjarë në vlerën progresive **86,425,784 lekë, ndërsa detyrime të krijuara të vitit 2023 janë në vlerën 23,686,491 lekë** sipas rakordimit me Drejtorinë e Financës. Vlerë e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e bashkisë Patos, nga mos arkëtimi i taksës dhe tarifave nga debitorët familjarë deri në datën 31.12.2023. Veprime dhe mosveprime janë në kundërshtim me ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Kreut XI- “Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara”, të neneve 88 deri 104, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore”, të ndryshuar.

Në pasqyrën më poshtë janë paraqitur të përmbledhura detyrimet e familjarëve për taksat dhe tarifave vendore të vitit ushtrimor 2023 si vijon:

Tabela nr.2

Nr	Njësi Administrative	Progresive deri në 31.12.2022		Familje Debitorë krijuar brenda vitit 2023		Progresive deri në vitin 2023	
		Nr	Vlerë/lekë	Nr	Vlerë/lekë	Nr	Vlerë/lekë
1	Njësi.Adm.Patos	4,064	40,471,772	4,101	14,021,665	4,101	54,493,437
2	Njësia.Adm.Zharrëz	635	17,008,621	654	7,685,226	654	24,693,847
3	Njësia.Adm.Ruzhdië	658	5,258,900	659	1,979,600	659	7,238,500
	TOTAL	5,357	62,739,293	5,414	23,686,491	5,414	86,425,784

Burimi: Bashkia Patos

Më poshtë paraqiten detyrimet sipas njësive administrative: **Kategoria Familje**

Tabela nr.3

Nr	Njësi Administrative	Familje të taksuara
		2023
1	Njësi.Adm.Patos	5,449
2	Njësia.Adm.Zharëz	1,407
3	Njësia.Adm.Ruzhdie	673
	TOTAL	7,529

Maturimi dhe arkëtimi **Njësia. Adm. Patos** (pa përfshirë taksën e tokës bujqësore)

Tabela nr.4

Nr.	Loji i Taksës dhe Tarifës	Maturimi	Arkëtimet
		2023	2023
1	Taksë Ndërtesë	6,356,000	3,821,541
2	Tarifë Pastrimi	16,175,000	7,316,269
3	Tarifë Shër.Kom	3,327,000	698,525
	Totali	25,858,000	11,836,335

Maturimi dhe arkëtimi **Njësia. Adm. Zharrëz**

Tabela nr.5

Nr.	Loji i Taksës dhe Tarifës	Maturimi	Arkëtimet
		2023	2023
1	Taksë Ndërtesë	3,328,000	1,415,314
2	Tarifë Pastrimi	7,298,000	2,856,900
3	Tarifë Shër.Kom	1,543,000	443,100
4	Tarifë Mi.Va.Ku	880,000	648,460
	Totali	13,049,000	5,363,774

Maturimi dhe arkëtimi **Njësia. Adm. Ruzhdie**

Tabela nr.6

Nr.	Loji i Taksës dhe Tarifës	Maturimi	Arkëtimet
		2023	2023
1	Taksë Ndërtesë	1,474,000	11,400
2	Tarifë Pastrimi	364,000	2,100
3	Tarifë Shër.Kom	156,000	900
	Totali	1,994,000	14,400

- Taksa e tokës:

Nga auditimi i dokumentacionit mbi planifikimin e taksës së tokës bujqësore për vitin 2023, u konstatua se kishte rezerva në planifikim, pasi, sipas të dhënave të marra nga Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe trajtimit të AMTP-së, mbi ndarjen e tokës bujqësore për familje dhe boniteti, evidentohet mosplanifikim në vlerën 17,835 mijë lekë, konkretisht sipas aneksit si vijon.

Pritshmëria e taksës së tokës bujqësore për vitin 2023.

Tabela nr.7

Kategoria e tokës	Sip/HA Nj.A.Pat	Sip/HA Nj.A. Zh	Sip/HA Nj.A.Ru	Vlera/Ha	Plani/Lekë
Kategoria I	12	4	0	5,600	89,600
Kategoria II	143	490	0	4,900	3,101,700
Kategoria III	188	1,179	0	4,200	5,741,400
Kategoria IV	500	388	0	3,600	3,196,800
Kategoria V	168	29	0	3,000	591,000
Kategoria VI	172	0	892	2,400	2,553,600
Kategoria VII	223	0	1,200	1,800	2,561,400
Totali sip. ha sipas planifikimit	1,406	2,090	2,092		17,835,500

Burimi: Bashkia Patos

Debitorët progresive dhe të krijuar gjatë vitit 2023 për taksën e tokës bujqësore.

Tabela nr.8

NJA	Debitorë krijuar në vitin 2023 (Lekë)						TOTAL DEBIA PROGRESIVE 2023
	Debitor të trashëguar deri në 31.12.2022	Familje me tokë bujqësore	Sip ha	Maturimi	Likujdimi	Debia	
Patos	15,566,297	1,962	1,406	6,167,000	2,360,562	3,806,438	19,372,735
Zharrëz	19,301,421	1,407	2,090	10,970,000	6,265,900	4,704,100	24,005,521
Ruzhdie	18,155,848	673	2,092	4,283,000	455,701	3,827,299	21,983,147
Totali	53,023,566	4,042	5,588	21,420,000	9,082,163	12,337,837	65,361,403

-Për vitin 2023, të ardhurat nga taksat e tarifave vendore gjithsej, nga **287,999 mijë lekë** të parashikuara, janë realizuar në vlerën **240,198 mijë lekë** ose 84 %, me një mosrealizim në vlerën **47,801 mijë lekë**.

Sa më sipër konstatohet se në planin e të ardhurave për vitin 2023, taksa e tokës është planifikuar për vlerën **21,420 mijë lekë dhe është realizuar 42 %**, me mosrealizim në vlerën **12,338 mijë lekë**.

Gjithashtu, me mosrealizim të dukshëm dhe që ka ndikuar në mosrealizimin e të ardhurave për periudhën objekt auditimi, janë taksat dhe tarifave e familjeve, për vitin 2023, të ardhurat nga Taksa e tokës, Taksa ndërtesë dhe Tarifa pastrimi gjelbërimi e ndriçimi, tarifa për shërbimin komunitar, janë planifikuar gjithsej në vlerën **93,119 mijë lekë ose 32%** e planit vjetor. Janë realizuar **74,852 mijë lekë ose 53 %** të planit. Taksa e ndërtesës rezulton se në vitin 2022, nga 21,424 mijë lekë e planifikuar është realizuar 11,218 mijë lekë ose 52 %, me një mosrealizim në vlerën 10,206 mijë lekë. Tarifa vendore (pastrimi, ndriçimi, gjelbërimi dhe shërbimi komunitar) rezulton se në vitin 2023, nga 50,275 mijë lekë e planifikuar janë realizuar 29,289 mijë lekë ose 58 %, me një mosrealizim në vlerën 20,986 mijë lekë. Nga mosrealizimi i planit të të ardhurave si më sipër ka sjellë mungesë të ardhurash në buxhetin e bashkisë vetëm për taksat dhe tarifave vendore familjare në vitin 2023 në vlerën gjithsej **31,192 mijë lekë**.

Sa më sipër veprimet apo mosveprimet janë në kundërshtim me Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, Ligjin nr. 9975, datë 28.07.2008, “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar, Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 22 dhe neni 23, VKB nr. 93, datë 24.12.2021 “Për miratimin e Paketës Fiskale 2023” .

- Bizneset, regjistrimi dhe mbajtja e të dhënave:

Administrimi i taksave vendore bëhet me program por nuk janë të pasqyruar familjarët në këtë sistem, sipas aktiviteteve, njoftim detyrimet dhe pagesat, kjo behet për subjektet fizik/juridik, ndërsa për abonentët familjarë bëhet me afishime në stendat e njësive administrative. Nga të dhënat që kërkohen për auditim, konstatohet se informacionet që kërkohen të dhënat nuk dalin të analizuar për çdo zë tatimor që DTT, Bashkia Patos aplikon.

Referuar të dhënave të marra nga DTT Bashkia Patos, situata e lëvizjes së subjekteve paraqitet si më poshtë:

Tabela nr.9

Nr	Lloji Biznesit	Viti	Gjendja Në fillim	Regjistrime Reja	Mbyllur Aktiviteti	Gjendja në fund të periudhës 2023
	Biznes i vogël	2023	446	60	67	439
	Biznes i madh	2023	88	12	7	93
	Institucione	2023	12	0	0	12
	TOTAL		546	72	74	544

Burimi: Bashkia Patos

- *Menaxhimi i borxhit nga taksat e tarifave vendore*

Nga auditimi i të dhënave, rezulton se në çelje të vitit 2023 kanë qenë për mos pagesën e detyrimeve tatimore janë 80 debitorë, nga të cilët subjekte biznesit të vogël dhe biznesit të madh në vlerën progresive **8,479,416 lekë, vlerë e cila konsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Patos**. Për vitin 2023 vlera e debisë së shtuar paraqitet në shumën **2,069,546 lekë** ose në 12 debitorë më shumë se viti 2022. Në tabelën e mëposhteme paraqiten llojet e biznesit dhe numri i tyre sipas njësive administrative. Tabela Analitike paraqitet në *aneksin nr.2.6.3* bashkëlidhur PRA.

Nga ana e Drejtorisë së të Ardhurave janë marrë masa shtrënguese, por jo të plota, në kundërshtim me ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Kreut XI-“*Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara*”, të neneve 88 deri 104, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore”, të ndryshuar.

Stoku i Borxhit në total paraqitet në total në vlerën progresive **160,265 mijë lekë** deri me datë 31.12.2023. Për vitin 2023 ky borxh është shtuar në vlerën **38,092 mijë lekë** ose **18.3%** e totalit, ku zërin kryesor në rritje e kanë debitorët familjarë për mos pagesën e taksave dhe tarifave vendore, në vlerën **23,686 mijë lekë** ose **11,4%** e totalit të stokut të borxhit të akumuluar.

Tabela nr.11 Debitorë Biznes

	Detyrime deri në 31/12/2022	Viti 2023	Detyrime deri në 31/12/2023
Patos	30	33	38
Zharrëz	33	36	37
Ruzhdie	5	5	5
Totali	68	74	80
Patos	3,247,270	1,034,676	4,281,946
Zharrëz	2,827,188	957,054	3,784,242
Ruzhdie	335,412	77,816	413,228
Totali	6,409,870	2,069,546	8,479,416
Biznes i Madh5	1,108,750	370,887	1,479,637
Biznes i vogël 75	5,301,120	1,698,659	6,999,779
Totali 80	6,409,870	2,069,546	8,479,416

Sa më sipër, vetëm për periudhën e vitit 2023 objekt auditimi, përfshihen debitorët e biznesit të vogël **për 75 subjekte në vlerën 1,698,659 lekë** dhe debitorët e biznesit të madh **për 5 subjekte në vlerën 308,455 lekë**.

Drejtoria e të Ardhurave, në zbatim të ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, për subjektet debitorë, vijon me procedurat e arkëtimit të detyrimeve në zbatim të kreut XI-“*Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara*”, të neneve 88 deri 104, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore”, me ndryshime. Sipas të dhënave, edhe pse vazhdojnë procedurat mbledhjes me forcë të detyrimeve, rezultojnë se nga 80 subjekte debitorë në vlerën 4,241,736 lekë, janë aktiv 80 subjekte të cilët nuk kanë paguar taksa dhe tarifa vendore. Ndaj këtyre subjekteve për asnjë rast nuk është zbatuar pika 2 e nenit 89, e ligjit nr. 9920, datë 19/5/2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe për rastet kur subjektet nuk pranojnë të paguajnë detyrimet në vite, nga ana e Drejtorisë së të Ardhurave, nuk është kërkuar kallëzim penal ndaj subjekteve problematike debitorë në vite dhe me vlera të konsiderueshme, mbështetur në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, me ndryshimet e mëvonshme, neni 181 -*Mospagimi i taksave dhe tatimeve*.

- Të ardhurat dhe vlerat debitoare nga taksa e ndikimit në infrastrukturë:

Nga auditimi i dokumentacionit që disponon Drejtoria e të Ardhurave, Bashkia Patos në lidhje me legalizimet e ndërtimeve pa leje dhe listave që disponon për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, konstatohet se nga Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Fier janë dërguar zyrtarisht me shkresë lista e qytetarëve shoqëruar me leje legalizimi dhe destinuara për regjistrim në ZVRPP (ASHK) Fier.

Konkretisht për periudhën nga 01.01.2016 deri më 31.12.2023, sipas listave të vëna në dispozicion me leje legalizimi dhe kryqëzimi i tyre me personat që kanë bërë të mundur likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturës, rezulton se detyrimi për këtë taksë është në vlerën **39,904,291 lekë** për 1,158 persona, ku vetëm për vitin 2023 janë debitorë 46 persona në vlerën 1,715,276. Vlera progresive **39,904,291** lekë është e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Patos. (sipas listës të administruar) dhe të paraqitur **në aneks nr.26.2** bashkëlidhur PRA.

Tabela përmbledhëse - Taksa e Ndikimit në Infrastrukturë (TNI) për legalizimin e objekteve informale.

Tabela nr.10

Debitor TNI deri në 31.12.2023	Subjekte	
	Nr	Vlera
Gjithësej progresive		
Nga të cilat deri në 31.12.2022	1,112	38,189,015
Nga të cilat krijuar në vitin 2023	46	1,715,276
Totali	1,158	39,904,291

Nga auditimi i ushtruar dhe dokumentacioni i paraqitur, konstatohet se: Bashkia Patos për periudhën ushtrimore nuk janë njoftuar subjektet debitorë si dhe nuk u evidentuan raste që Bashkia Patos të jetë drejtuar ASHK Dega Fier, për bllokimin e pasurisë dhe mos kryerjen veprimeve hipotekore ose bllokimin e marrjes së lejes së legalizimit dhe certifikatës pa bërë më parë pagesën taksës së ndikimit në infrastrukturë. Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me nenin 27 pika (d), të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”; VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim” i ndryshuar, pika 5 dhe ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave vendore”, i ndryshuar, neni 27- Taksa e ndikimit në infrastrukturë, pika 2/1 dhe ngarkohen me përgjegjësi Drejtorinë e PZHT-së dhe DTT Bashkia Patos.

- Debitorë nga kontratat e qerave të tokës bujqësore Njësia Administrative Ruzhdie. Debitorët për periudhën nga 31/12/2018 deri 31/12/2023.

Sipas të dhënave konstatohet se nga janë 67 debitorë të cilët kanë kontrata qeraje për tokë bujqësore, 52 prej tyre kanë detyrime të papaguara në vlerë totale 1,998,248 lekë, ku vetëm për vitin 2023 janë krijuar 381,099lekë. E ardhur e munguar për buxhetin e bashkisë Patos. Në mënyrë analitike lista e debitorëve paraqitet në **aneksin nr. 2.6.1** bashkëlidhur PRA.

- Pajisja me autorizime e subjekteve që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre:

Sipas dokumentacionit të venë në dispozicion nga Drejtoria e Shërbimeve dhe e licencave, në lidhje me subjektet e tregtimit të karburanteve që ushtrojnë aktivitet në territorin e Bashkisë Patos dhe në Njësitë Administrative, ushtronin aktivitetin 11 subjekte që rezultojnë aktiv dhe një subjekt i pezulluar, që tregtojnë me pakicë hidrokarbure dhe nënprodukte të tyre, si vijon:

Tabela nr.13

Nr.	Subjekti	Adresa	Nipti	Pajisur me License	Afati licensës		Pagesa e kryer	Detyrimi i papaguar
					Po	Fillon		
1	A SHPK	Patos	K...D	Po/Pezulluar	05/09/2018	04/09/2023	400,000	600,000
2	H SHPK	Patos	K...B	Po	17/07/2020	16/07/2025	150,000	850,000
4	E SHPK	Patos	L...H	Po	05/02/2015	04/02/2020	0	1,000,000
8	E SHPK	Zharrëz	L...K	Jo			0	1,000,000
10	G SHPK	Zharrëz	L...A	Po	22/09/2015	21/09/2020	100,000	1,900,000
	TOTALI							5,350,000

Burimi: *Bashkia Patos*

Nga auditimi i dokumentacionit mbi pasjen me Liçensë tregtimi për subjektet që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre, u konstatua se ka mangësi në plotësimin e të dhënave të këtyre subjekteve në përgjithësi dhe debitorëve në veçanti, si mos aplikimin e tarifës së licencës dhe lejimin e subjekteve të ushtrojnë aktivitet pa paguar këtë taksë dhe mos ndjekjen e detyrimeve për subjektet të cilat janë pajisur dhe nuk e kanë paguar tarifën.

Sipas dokumentacionit të venë në dispozicion nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave, rezulton se në territorin e Bashkisë Patos dhe në Njësitë Administrative në vartësi, ushtrojnë aktivitetin 12 subjekte të cilat tregtojnë me pakicë hidrokarbure dhe nënprodukte të tyre.

Nga 12 subjekte janë pajisur me autorizim 11 subjekte, të cilat janë përpara periudhës objekt auditimi dhe janë licensuar me leje tregtim karburanti, gjithsej janë evidentuar **5 subjekte** të cilët ushtrojnë aktivitet dhe papaguar detyrimin në **vlerën totale 5,350,000 lekë**, e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Patos. Veprimet apo mosveprimet janë në kundërshtim me ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar, neni 35, VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar kapitulli II, pika 1; germa “b”, dhe pika 9, i ndryshuar me VKM nr. 344, datë 19.04.2017, kapitulli II, pika 1; germa “b” dhe pika 9, si dhe pika 15.1, 15.2 të këtij akti normativ.

- Ligjshmëria e lidhjes së kontratave dhe arkëtimi i detyrimeve.

Kontratat me qiradhënës Bashkinë Patos për vitin 2023 të lidhura në përputhje me VKM nr. 54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfitozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”;

1. Vlera vjetore e miratuar me vendim nr. 18, datë 20.01.2023 të Kryetarit të Bashkisë është 100 lekë/m².

2. Me urdhërin nr. 94, datë 19.06.2023 është krijuar njësia e monitorimit të kontratave të qirasë.

Tabela nr.14

EMRI I QIRAMARRËSIT	Sipërfaqja	Nr. k, datë, vit	Fatura dhe vlera vjetore + tarifë planvendosjeje
V.G.	44.6 m ²	Nr. 176/1 prot, datë 25.01.2023	Faturë datë 25.01.2023 Vlera vjetore 55,520 lekë
P. Patos	23 m ²	Nr. 1485/2 prot, datë 19.07.2023	Faturë datë 12.07.2023 Vlera vjetore 29,600 leke
P. Zharrëz	22.2 m ²	Nr. 1485/3 prot, datë 19.07.2023	Faturë datë 12.07.2023 Vlera vjetore 28,640 leke
P. Ruzhdie	7 m ²	Nr. 1485/4 prot, datë 19.07.2023	Faturë datë 12.07.2023 Vlera vjetore 10,400 leke
E.M.	45.6 m ²	Nr. 1397/1 prot, datë 13.06.2023	Faturë datë 09.06.2023 Vlera vjetore 56,720 leke
K.M.	24.75 m ²	Nr. 1786/1 prot, datë 18.08.2023	Faturë datë 16.08.2023 Vlera vjetore lekë 31,700
A.P.	23.3 m ²	Nr. 2401/1 prot, datë 27.09.2023	Faturë datë 21.09.2023

EMRI I QIRAMARRËSIT	Sipërfaqja	Nr. k, datë, vit	Fatura dhe vlera vjetore + tarifë planvendosjeje
			Vlera vjetore 30,550 leke
SH.J.	48.6 m ²	Nr. 3434/1 prot, datë 28.12.2023	Faturë datë 26.12.2023 Vlera vjetore 60,910 lekë
E.S.	150 m ²	Nr. 2451/1 prot, datë 04.10.2023 deri më 05.11.2023	Faturë datë 02.10.2023 Vlera vjetore 33,453 lekë

Të gjitha kontratat përmbajnë dokumentacionin si më poshtë:

- kërkesën e subjektit për marrje me qira të pasurisë shtetërore;
- planbiznesin e hollësishëm për vënien në funksionim të objektit, ku të përshkruhen qartë: plani i punësimit, plani i investimeve, si dhe treguesit që do të realizohen;
- ofertën për vlerën e detyrimit mujor të qirasë;
- ç) certifikatën e regjistrimit dhe certifikatën historike të regjistrimit të subjektit në QKR;
- d) NUIS-in dhe vërtetimin nga dega e tatimeve se subjekti ka shlyer detyrimet tatimore dhe sigurimet shoqërore;
- dh) vërtetime nga institucionet përkatëse që nuk është në ndjekje penale, si dhe nuk ka procese gjyqësore në lidhje me aktivitetin.

Kontratat me qiramarrës Bashkinë Patos për vitin 2023

EMRI I QIRADHËNËSIT	Sipërfaqja	Nr. k, datë, vit	Vlera/lekë
L.LL.	56.6 m ²	Nr. 2197/7 prot, datë 30.08.2023	14,200 lekë në muaj.

Konstatohet se: Bashkia Patos ka lidhur 10 kontrata me persona kryesisht fizik dhe një subjekt juridik. Kryesisht konsistojnë në ambiente (hapsire dhe objekte). Gjatë auditimit të këtyre kontratave nuk kemi evidentuar mangësi si në ligjshmëri apo dhe në vjeljen e detyrimeve.

Konkluzion:

Nga auditimi i vjeljes së të ardhurave, rezultuan të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Patos në vlerën totale **207,517 mijë lekë** në progresiv.

- Të ardhura të munguara nga mospagimi i taksave dhe tarifave nga familjarët në vlerën **86,425 mijë lekë**. Krijuar gjatë vitit 2023 në vlerën 23,686 mijë lekë.
 - Të ardhura të munguara nga mospagimi i taksave dhe tarifave vendore nga subjektet e biznesit në vlerën **8,479 mijë lekë nga të cilat krijuar gjatë vitit 2023 në vlerën 2,069 mijë lekë**.
 - Të ardhura të munguara nga mospagimi i taksës së ndikimit në infrastrukturë për objektet (legalizim) në vlerën **39,904 mijë lekë**. Krijuar gjatë vitit 2023 në vlerën **1,715 lekë**.
 - Të ardhura të munguara nga mospagimi i detyrimit për pajisje me licencë tregtimi për shitjen me pakicë të hidrokarbureve dhe nënprodukteve të tyre në vlerën **5,350 lekë mijë lekë**.
 - Të ardhura të munguara nga mospagimi i detyrimit të taksës së tokës bujqësore në vlerë **65,361 mijë lekë** total. Krijuar gjatë vitit 2023 në vlerë **12,337 mijë lekë**.
 - Të ardhura të munguara nga mospagimi dhe arkëtimi i detyrimit të kontratave me qera të tokave bujqësore, në vlerë totale **1,998 mijë lekë**. Krijuar gjatë vitit 2023 në vlerë **381 mijë lekë**.
- Për veprimet dhe mosveprimet në përputhje me kriteret e përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjor mbahet ky akt konstatimi dhe ngarkon me përgjegjësi z.A.M. drejtor i Drejtorisë së të Ardhurave për periudhën 01.01.2023 deri më 31.12.2023, Përgjegjësi për vjeljen në kohë dhe administrimin e të ardhurave ka edhe kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore, sipas kërkesave të ligjit nr. 68/2017, datë 27.4.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 42 “Administrimi i mjeteve monetare”, pika 2.

Për sa më sipër mban përgjegjësi zj. R.B, ish/Kryetare e Bashkisë Patos për periudhën Janar-Qershor 2023.

3.3. Mbi vlerësimin e raportimit financiar, plotësia dhe saktësia në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike - Asetet

Nënpika 2.1. Plotësia dhe saktësia në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike.

Në lidhje me auditimin mbi plotësinë dhe saktësinë e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike të ndodhura gjatë periudhën 01.01.2023 deri 31.12.2023, në Bashkinë Patos konstatohet se:

Pasqyra e pozicionit financiar, Njësia Publike Bashkia Patos, për vitin 2023, Formati nr.1, janë depozituar në Degën e Thesarit Fier sipas shkresës nr. 146 prot, datë 23.02.2024 sipas udhëzimit nr. 5 datë 21.02.2022 dhe në mënyrë elektronike në datën 23.02.2024.

Janë plotësuar bilancet për vitin 2023 dhe pasqyrat anekse të tyre, e konkretisht me përbërjen si vijon:

- Formati 1 - Pasqyra e pozicionit financiar (bilanci);
- Formati 2 - Pasqyra e performancës financiare ose pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve;
- Formati 3 - Pasqyra e flukseve monetare;
- Formati 4 - Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto;
- Formati 5 - Shënimet shpjeguese për hartimin dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore;
- Formati 6 - Pasqyra statistikore e investimeve dhe burimeve të financimit të tyre;
- Formati 7 - Pasqyra statistikore mbi gjendjen dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata me koston historike dhe me vlerën neto; (formati 7/a, gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike), formati 7/b, gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto).
- Formati 8 - Pasqyra statistikore e numrit të punonjësve dhe fondi i pagave.

Gjendja e llogarive të bilancit në fund të vitit 2023, paraqitet në pasqyrat e mëposhtme:

Pasqyra e pozicionit financiar, Njësia publike Bashkia Patos.

Totali i Aktivit për vitin 2023 është **1,885,928,594 lekë** dhe për vitin 2022 është **1,639,169,643 lekë**, i paraqitur në formatin 1 dhe i zbërthyer në llogari, sipas **Aneksit nr. 1 pika 3** bashkëlidhur Raportit të Auditimit.

Në lidhje me verifikimin e vlerave të pasqyruara në llogaritë e pasqyrave të pozicionit financiar të vitit ushtrimor 2023, të saktësisë dhe besueshmërisë së tyre, u audituan referencat e llogarive të aktivitetit dhe të pasivit, si në vijim.

A.Aktivitet.

Rakordimi i llogarive me Degën e Thesarit llogaria 520, 466 dhe llogaritë e të Ardhurave.

Llogaritë kryesore të rakordueshme me degën e Thesarit; **llogaria 520 “Disponibilitete në Thesar”**, në pasqyrat financiare është në vlerën **277,567,766 lekë për** vitin 2023. Referuar aktit të rakordimit me Degën e Thesarit Fier, kjo llogari është e analizuar sipas tabelës vijuese.

Kjo vlerë sipas aktit të rakordimit me Degën e Thesarit, është e analizuar si vijon:

Nr.	Llogaria	2023
1	Llogaria 520 “Disponibilitete në thesar” (taksë pulle e kopështi)	277,567,766
2	Llogaria 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”	53,133,380
3	Llogaria 85 “Rezultati i veprimtarisë së ushtrimit”	224,434,385

- Llogaria 520 “Disponibilitete në Thesar” për vitin 2023 është e rakorduar **me të dhënat** e Degës së Thesarit, në pasqyrat financiare, duke pasqyruar saktë vlerën e saj në fund të vitit ushtrimor prej **277,567,766 lekë, në përputhje me kërkesat e UMF-së nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar, Kap. III, pikat 29, 30, 39, 50.**

2.Nënrubrika, gjendje e inventarit qarkullues, gjendja e llogarisë 31 “Materiale”, në pasqyrat e pozicionit financiar të vitit 2023 paraqitet në vlerën 2,626,410 lekë. Vlerat e kësaj llogarie janë të barabarta me vlerën e dokumentuar në aktin e rakordimit në fund të çdo viti të mbajtur midis magazinierit, përgjegjësit të financës dhe drejtorit të financës.

-Gjendja e llogarisë 32 “**Inventar i imët**” në pasqyrat e pozicionit financiar të vitit 2023 paraqitet në vlerën 24,787,852 lekë. Vlerat e kësaj llogarie janë të barabarta me vlerën e dokumentuar në aktin e rakordimit në fund të çdo viti të mbajtur midis magazinierit, përgjegjësit të financës dhe drejtorit të financës.

3.Nënrubrika, llogari të arkëtueshme, -Gjendja e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” në pasqyrat e pozicionit financiar të vitit 2023 paraqitet në vlerën 14,039,680 lekë, të cilat janë detyrimet e subjekteve të ndryshme ndaj bashkisë për taksa, tarifa vendore dhe detyrime të lëna nga aktet e kontrolleve të ndryshme të papaguara deri në 31.12.2023.

Nga analiza e llogaria 468 “**Debitorë të ndryshëm**” për vitin 2023 rezultoi se nuk është kontabilizuar vlera **207,517 mijë lekë**, si gjendje debitorë të subjekteve taksapagues privat dhe familjar, vlerë e cila është pasqyruar eksrta kontabel sipas llojit të taksapaguese e cila është trajtuar më hollësishtë në pikën 2.6 të programit të auditimit. Gjithashtu rezulton se Drejtoria e të ardhurave nuk ka komunikuar zyrtarisht me Drejtorin e Financës për pasqyrimin në kontabilitet të debitorëve gjendje 31.12.2023, në kundërshtim me dispozitat ligjore të poshtëpërmendura. Sa më sipër veprimet apo mosveprimet janë në kundërshtim me ligjin 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Urdhëri nr.64 datë 22.07.2014 “ Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuar” dhe Standartit Kombëtar të Kontabilitetit nr.8 “Të ardhurat”, pika 8 e standartit ku përcaktohet njohja fillestare e të ardhurës UMF nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njëjësive të Qeverisjes së Përgjithshme”, kapitulli II, pika 6.

Përsa më sipër ngarkohen me përgjegjësi:

1. Z. A.M, me pozicion ish përgjegjës sektori, aktualisht drejtor i Drejtorisë së të Ardhurave, në Bashkinë Patos, të dërgojë me shkresë përcjellëse listat e detajuara te debitorve te sipër cituar në Drejtorinë e Financës.

II. Rubrika, aktivet afatgjata.

1.Nënrubrika, aktive afatgjata jo materiale, gjendja e llogarisë 202 “Studime dhe kërkime”, më 31.12.2023 paraqitet në vlerën neto 641,801 lekë, (1,290,545 – 648,744) = 641,801 me diferencë në ulje në vlerën 48,412 lekë e cila përfaqëson vlerën e amortizimit të llogaritur për vitin 2023. Kjo llogari është e analizuar sipas aneksit nr. 3 pika 3 bashkëlidhur Raportit të Auditimit.

2.Nënrubrika, aktive afatgjata materiale,

-Gjendja e llogarisë 210 “**Toka, Troje, Terrene**” në datën 31.12.2023 paraqitet në vlerën neto 4,220,846 lekë. Në këtë llogari pasqyrohen vlerat e investimeve të kryera ndër vite. Për këtë llogari nuk është llogaritur amortizimi në zbatim të udhëzimit nr 8 datë 09.03.2018 ndryshuar me udhëzimin numër 5 datë 21.02.2022. Kjo llogari është e analizuar në mënyrë kontabël sipas të dhënave paraqitur në aneksin nr. 4 pika 3 bashkëlidhur Raportit të Auditimit.

-Gjendja në llogarinë 212 “**Ndërtime e konstruksione**” më 31.12.2023 gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën neto 583,529,013 lekë e cilat përfaqëson vlerën e investimeve të kryera ndër vite për ndërtime e rikonstruksione dhe shtesat gjatë periudhës, paksimet janë për transferimet dhe për vlerën e amortizimit. Gjendja e kësaj llogari në mënyrë të përmbledhur është analizuar sipas aneksit nr. 5 pika 3 bashkëlidhur Raportit të Auditimit.

-Gjendja në llogarinë **213 “Rrugë, rrjete vepra ujore”** më 31.12.2023, paraqitet në vlerën neto 103,356,220 lekë (108,796,019 – 5,439,801), e cila përfaqëson vlerën e investimeve të kryera ndër vite për rrugë, rrjete dhe vepra ujore si dhe shtesat gjatë periudhës, paksimet për transferimet dhe vlerën e amortizimit. Kjo llogari është e analizuar në mënyrë kontabël sipas të dhënave paraqitur në aneksin nr. 6 pika 3 bashkëlidhur Raportit të Auditimit.

-Gjendja e llogarisë **214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune”** më 31.12.2023 paraqitet në vlerën neto 8,726,593 lekë, e cila paraqet vlerën e objekteve të investimeve të kryera ndër vite, shtesat gjatë periudhës dhe paksimet nga amortizimi. Gjendja e kësaj llogari në mënyrë të përmbledhur është analizuar sipas inventarit fizik.

-Gjendja e llogarisë **215 “Mjete transporti”** më 31.12.2021 paraqitet në vlerën neto 17,982,751 lekë. Gjendja e kësaj llogari në mënyrë të përmbledhur është analizuar sipas aneksit nr. 8 pika 3 bashkëlidhur Raportit të Auditimit.

-Gjendja e llogarisë **218 “Inventar ekonomik”**, më 31.12.2023 paraqitet në vlerën neto 35,141,857 lekë, e cila paraqet vlerën e objekteve të investimeve të kryera ndër vite dhe paksime gjatë vitit 2023, sipas listës analitike të sektorit të financës.

Për vitin 2023 gjendja e llogarisë **219 “Amortizimi i Aktiveve të Qëndrueshme të Trupëzuara”**, amortizimi i AQT-ve nuk pasqyrohet në pasqyrën e pozicionit financiar në bilanc, pasi AQT-të paraqiten me vlerën neto të tyre, por vlerat historike dhe vlerat neto paraqiten në formatin 7/a dhe 7/b (gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata me vlerë historike dhe vlerë neto). Llogaritja e amortizimit është bazuar në ligjin nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatim mbi të ardhurat”, i ndryshuar; si dhe UMFE nr. 08, datë 09.03.2019” Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësisive të Qeverisjes së Përgjithshme” i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pasqyrën aneks nr. 4 llogaritja e amortizimit)*

3.Nënrubrika, aktive afatgjata financiare, ku bëjnë pjesë referencat e llogarive 25 “Huadhënie e nën huadhënie” paraqitet në vlerën 0 lekë.

Llogaria 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vetë”, më 31.12.2023 paraqitet në vlerën 14,530,000 lekë, në llogarinë 26 “Aktive afatgjata financiare” si aksionare me 100% të aksioneve të U SH.A. me NUIS “J...B”

4.Nënrubrika, investime.

-Gjendja e llogarisë **231 “Për aktive afatgjata materiale”** më 31.12.2023 paraqitet në vlerën 782,365,081 lekë, e cila përfaqëson, vlerën e investimeve në proces të cilat nuk kanë përfunduar brenda vitit ushtrimor dhe do të kenë financime të tjera deri në përfundimin e tyre kur ato të bëhen aktive dhe të kalojnë te llogaritë e klasës 2 “Aktive afat gjata materiale”. Gjendja e kësaj llogarie është e analizuar sipas Aneksi nr. 9 pika 3, bashkëlidhur raportit të auditimit.

II. Rubrika, pasivet afatshkurtra.

1.Nënrubrika, llogari të pagueshme, gjendja e llogarive të 401-408 “Furnitorë dhe llogari të lidhura me to”, të 42 “Personeli e llogari të lidhura me to”, -të 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim-taksa”, të 435 “Detyrime ndaj shtetit për sigurime shoqërore”, të 436 “Detyrime ndaj shtetit për sigurime shoqërore”, janë të barabarta me gjendjen e llogarisë 4342 “Operacione me shtetin” në vlerën 16,037,012 lekë për vitin 2023 të analizuar me vlerat e llogarive si vijon:

NR.	EMERTIMI	Gjendje 31.12.2023
1	Paga Personeli llogaria 42	9,916,560
2	Tatim page tatim ne burim llogaria 431	681,017
3	Sigurimet Shoqërore llogaria 435	3,193,482
4	Sigurime Shëndetësore llogaria 436	434,356
5	Furnitorëllogaria.401-408	1,190,709
6	Kreditore të ndryshëm	620,888
	TOTALI	16,037,012

Nuk rezulton diferencë midis vlerës pasqyruar në llogarinë 4342 **“Operacione me shtetin, të drejta” dhe vlerës së pasqyruar në 6 (gjashtë) llogaritë pasive**, pra, në vitin 2022 dhe 2023, është e njëjtë me vlerën e pasqyruar në aktivin e pasqyrave të pozicionit financiar.

-Gjendja e llogarisë 401-408 **“Furnitorë e llogari të lidhura me to”**, në 31.12.2023 paraqitet në vlerën 1,190,709 lekë për 9 subjekte e cila përfaqëson detyrimet e Bashkisë ndaj të tretëve brenda afatit 60 ditor të likuidimit të detyrimeve në përputhje me UMF nr. 8, datë 9.03.2018 *“Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”*, ndryshuar me udhëzimin nr 5 datë 21.05.2022, kapitulli II, pika 6; 11, aneksi 1, pika 2 Klasa 2, nënpika 2.1, paragrafi, -Trajtimi kontabël dhe funksionimi i grupit 20.

Aneksi, nr. 10, pika 3, pasqyra e detyrimeve gjendje më 31.12.2023, për 9 subjekte të cilat janë brenda afatit 60 ditor të likuidimit të detyrimeve bashkëlidhur raportit të auditimve.

Gjendja e llogarisë 466 **“Kreditorë për mjete në ruajtje”**, më 31.12.2023 paraqitet në vlerën 53,133,380 lekë, për 27 subjekte për 48 objekte të cilat përfaqësojnë detyrime të Bashkisë ndaj subjekteve të ndryshme për garanci punimesh në objekte të ndryshme, dhe garanci për taks pulle, kopshte çerdhe dhe qera banesat sociale për vlerën 638,743 lekë. Gjatë vitit 2023 shesta janë në vlerën 19,424,682 lekë dhe likuidimet e kryera në vlerën 2,014,236 lekë për 4 subjekte. Nga analiza e kësaj llogarie, konstatohet se:

a) Për 48 objekte të përfunduara dhe në proces, në vlerën 53,133,380 lekë, sipas aneksit nr.11, pika 3, nuk është bërë zhblllokimi i tyre, dhe fondet gjenden të ngurtësuar në degën e Thesarit.

8 objekte jemë në proces dhe të pa marra në dorzim nga Bashkia për vlerën e ngurtësuar 13,214,965 lekë dhe për 40 objekte të marra në dorzim të përkohshëm deri në plotesimin e afatit të garancisë. Pëe vitin 2023 rezulton se është përmbushur afati i garancisë së punimeve sipas kushteve të kontratës përkatëse. Nga drejtoria e Financës janë ndjekur dhe zbatuar të gjitha procedurat financiare. Për të vazhduar procedurën e mëtejshme për marrjen në dorëzëm përfundimtar të objekteve dhe çngurtësimin e garancive i është drejtuar drejtorisë së Shërbimeve dhe Hartimit të Projekteve me shkresën nr. 1636 datë 28.06.2022 shoqëruar me listën e objekteve të cilat kanë plotësuar afatin e garancisë. Nuk ka pasur asnjë kthim përgjigje nga kjo drejtori dhe nga Drejtoria e Financës është bërë ridërgim kërkesë drejtorisë së Shërbimeve dhe Hartimit të Projekteve për ndjekjen e procesit të çngurtësimit të garancive me shkresën nr. 2233 datë 14.09.2022.

Nga Shërbimeve dhe Hartimit të Projekteve, nuk janë marrë masa për zhbllokimin e këtyre fondeve, nuk janë njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të duhur për likuidimin e vlerës së mësipërme, ose përdorimin për interes publik të këtyre fondeve, bazuar në kushtet e kontratës të lidhur me subjektet sipërmarrëse.

Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me UMF nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, ndryshuar me udhëzimin nr. 5 datë 21.02.2022, Kap. III, pikat 30, 50.

Pika 30. "Çdo njësi e qeverisjes së përgjithshme kryen verifikimin fizik të aktiveve dhe elementeve të tjera, konformë kriterëve të përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore, si dhe saktëson vërtetësinë e llogarive të të drejtave e të detyrimeve ndaj të tretëve. Mbi këtë bazë, në kontabilitet, bëhen veprimet për sistemin e diferencave të gjendjes fizike me gjendjen kontabël për llogari të vitit kontabël që mbyllet",

Pika 50. "Tepricat e llogarisë 520, "Disponibilitete në thesar" dhe të llogarisë 466, "Kreditorë për mjete në ruajtje" duhet të vërtetohen me akt rakordim me thesarin, një kopje e të cilit i bashkëngjitet llogarisë vjetore. Në akt rakordim, tepricat duhet të paraqiten të strukturuar sipas natyrës së të ardhurave të trashëguara (të ardhurat e papërdorura, si të çelura ashtu edhe ato të paçelura, mjetet në ruajtje, sponsorizimet dhe pjesën e grandit që trashëgohet)",

UKM nr. 3, datë 15.02.2011 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" i ndryshuar, Kap. II, pika 10.

Pika 10. Në përfundim të periudhës së garancisë, investitori, kolaudatori, mbikëqyrësi dhe zbatuesi i punimeve bëjnë kontrollin përfundimtar të veprës. Për defektet që nuk janë ndrequr gjatë periudhës së garancisë së punimeve të ndërtim-montimit, investitori llogarit koston e ndreqjes së tyre dhe bën ndalesën nga vlera e garancisë së punimeve.

-Testimi i llogarisë 600 "Pagat dhe shpërblime"

Për vitin 2023 numri i punonjësve është miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiakë nr.92 datë 19.12.2022. Miratuar në total numri 222 + 5 punonjësit të Gjendjes Civile gjithsej. Realizimi faktik është sipas listë pagesave gjithsej 213 punonjës, nuk ka tejkallim të numrit të punonjësve.

-Referuar kërkesave të VKM nr. 177 datë 08.03.2017, struktura e Bashkisë Patos, është miratuar me Urdhër të Kryetares të Bashkisë; për vitin 2023 nr.01 datë 04.01.2023.

Sipas listë pagesave të muajve Janar 2023, Mars 2023 dhe Gusht 2023, Nëntor 2023 konstatohet se është zbatuar struktura sipas vendimeve miratues.

Listë pagesat janë të firmosura nga Specialiste e pagave, Drejtoresha e Financës, dhe Kryetarët e Bashkisë, sipas periudhave përkatëse.

B. 2 - Hartimi i listë pagesave mbi bazën e listë prezencave të nënshkruara nga përpiluesi, për vitin 2023- 31.12.2023.

Me përzgjedhje u audituan listë pagesat e periudhës (Mars-Qershor 2023, Gusht-Nëntor 2023 dhe Tetor-Dhjetor 2023) dhe konstatohet se ato plotësohen konform rregullave të përcaktuara të cilat janë plotësuar mbi bazën e listë prezencave mujore të nënshkruara nga Titullari i Bashkisë. Nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore është hartuar përmbledhësja në përputhje me ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, "Kodi i Punës", i ndryshuar.

Ndalesat për tatimin mbi të ardhurat personale dhe kontributit të sigurimeve shoqërore të punonjësve të Bashkisë Patos, janë në përputhshmëri me kërkesat e ligjit nr. 8438, datë 28.11.2008 "Për tatimin mbi të ardhurat", me ndryshime dhe ligjit nr. 9136, datë 11.09.2003 "Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në RSH".

-Referuar kërkesave të VKM nr. 177 datë 08.03.2017.

Gjatë vitit 2023 është zbatuar VKM nr. 328 datë 31.05.2023 "për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njërive të vetëqeverisjes vendore për efekt page", për strukturën e Bashkisë Patos, miratuar me vendim të Këshillit Bashkiak nr. 37.06.2023.

Sipas listë pagesave të muajve (Mars-Qershor 2023, Gusht-Nëntor 2023 dhe Tetor-Dhjetor) konstatohet se është zbatuar struktura sipas vendimeve miratues.

Listë pagesat për Mars-Qershor 2023 janë të firmosura nga Specialiste e pagave A.H., Drejtoresha e Financës znj. M.SH. dhe Kryetare e Bashkisë znj. R.B.

Është përgatitur përmbledhësja e listë pagesave për Gusht-Nëntor dhe Tetor-Dhjetor 2023 e cila është e firmosur nga Specialiste e pagave znj. A.H., Drejtoresha e Financës M.SH. dhe Kryetari i Bashkisë F.D.

Janë mbajtur listë prezencat dhe janë të firmosura nga Drejtoresha e Burimeve Njerzore znj. J.SH. dhe nga Kryetare e Bashkisë znj. R.B.; Kryetari i Bashkisë F.D, sipas periudhave përkatëse.

Përveç ndalesave të sigurimeve shoqërore dhe tatimit mbi pagë, në Bashkinë Patos nuk është bërë asnjë ndalesë tjetër.

Paraqitja në formë table e burimit të Financimit.

000/lekë

Periudha	Plan	Fakt	%	Burimi i financimit			
				Trans. e Pakush.	Të ardhura	Trans. e Kushtëzuar	Transferte specifike
Viti 2023	165,227	151,637	92	48,347	31,254	7,280	64,756

Realizimi i fondit të pagave, sigurimeve shoqërore dhe fondit të veçantë

000/lekë

Nr.	Emërtimi	VITI 2023		
		Plani	Fakti	%
1	F. Pagave	165,227	151,637	92
2	F. Sig. Shoq	28,192	24,419	87
3	F. Veçantë	10,682	7,126	67

- ***Saktësia e plotësimin të Urdhër shpenzimeve.***

Për vitin 2023, u audituan urdhër shpenzimet e muajit Nëntor nga nr. 411 deri te urdhër shpenzimi nr. 456. Hartimi i urdhër shpenzimeve është bërë mbi bazën e një dokumentacioni mbështetës e justifikues, formati i tyre është sipas UMF dhe në të është aplikuar rregullisht sistemi i firmës së dyfishtë duke u nënshkruar nga nëpunësi autorizues dhe ai zbatues.

Plotësimi i tyre është bërë në të gjithë ekstremitetet, ku përcaktoheshin qartë objekti i shpenzimit sipas strukturës buxhetore, kreditori përfitues dhe dokumentet justifikues. Urdhër shpenzimet janë konfirmuar dhe nga Specialistët e Degës së Thesarit dhe janë likuiduar brenda limiteve të përcaktuara nga çelja e fondeve.

Urdhër shpenzimet, dokumentacioni mbështetës e justifikues ngarkohet në të gjitha rastet në portalin AFMIS Internal në degën e Thesarit Fier nënshkruar elektronikisht nga regjistruesi, nëpunësi zbatues, nëpunësi autorizues dhe nëpunësi thesarit.

*Për rastet e likuidimit të punimeve të ndërtimit, urdhër shpenzimet kanë të bashkangjitur përkatësisht këto dokumente: Urdhër Prokurimi, urdhri për ngritjen e KVO-së, formulari njoftim fituesi, buletini i APP për njoftim fituesi dhe njoftim kontrate, kontrata e lidhur midis palëve, situacioni i punimeve të kryera, fatura e tvsh së subjektit përfitues, certifikata e përkohshme ose përfundimtare e marrjes në dorëzim të punimeve, akt kolaudimi përfundimtar.

*Për rastet e blerjeve të materialeve të ndryshme, urdhër shpenzimet kanë të bashkangjitur përkatësisht këto dokumente: Urdhër Prokurimi, urdhër për ngritjen e KVO-së, fotokopje e buletinit të APP për njoftim fituesi dhe njoftim për lidhje kontrate, fotokopje e kontratës së lidhur midis palëve, fatura e subjektit përfitues, proces verbali i marrjes në dorëzim dhe numri i fletë hyrje e magazinës.

*Për rastet e likuidimeve të shërbimeve e konkretisht të shërbimit të pastrimit të qytetit, të shërbimit të gjelbërimit, të shërbimit të varrezave të qytetit, të shërbimit të trotuareve, urdhër

shpenzimet kanë të bashkangjitur dokumentet si Situacioni i punimeve të kryera në fakt, fatura e tvsh së subjektit përfitues, kontrata e lidhur midis Bashkisë dhe Subjektit, proces verbali i marrjes në dorëzim të punimeve e shërbimeve.

Transaksionet dhe ngjarjet që janë të regjistruara kanë ndodhur dhe i përkasin subjektit. Të gjitha transaksionet dhe ngjarjet që duhet të ishin regjistruar janë regjistruar. Shumat dhe të dhëna të tjera lidhur me transaksionet e regjistruara dhe ngjarjet janë regjistruar në mënyrë të përshtatshme. Transaksionet dhe ngjarjet janë regjistruar në periudhën e saktë kontabël dhe janë në përputhje me ndarjet buxhetore në dispozicion.

- *Evidenca e aktiveve të qëndrueshme dhe regjistrimi i tyre në pronësi të Bashkisë Patos.*

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezultoi se: për vitin 2023 struktura organizative është miratuar me Vendim të Kryetarit të Bashkisë nr.01 datë 04.01.2023., Referuar kërkesave të VKM nr. 177 datë 08.03.2017, struktura e Bashkisë Patos është miratuar me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë të sipërcituar. Rezulton se në strukturën aktuale organizative të bashkisë Patos nuk është krijuar sektori i Menaxhimit dhe Administrimit të Aseteve, por është caktuar një specialist në Drejtorinë e hartimit të projekteve, shërbimeve dhe emergjencave civile.

Me urdhrin nr. 204 prot datë 19.10.2023 të Kryetarit të Bashkisë “Për krijimin e komisionit për inventarizimin, plotësimin, përditësimin dhe ndjekjen e procesit deri në rregjistrimin e pronave të Njësisë Administrative Patos, Zharrëz dhe Ruzhdie të Bashkisë Patos” janë ngritur grupet e punës për përcaktimin e misionit dhe detyrat e tyre për administrimin e asetëve (toka, pyje, kullota, ndërtesa etj.).

Bashkisë Patos, me VKM nr. 443, datë 15.06.2016 “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në Bashkinë Patos, të Qarkut Fier”, i është miratuar lista inventarit dhe përfundon me numër rendorë 300.

Me urdhrin nr. 204 prot datë 19.10.2023 të Kryetares së Bashkisë “Për krijimin e komisionit për inventarizimin, plotësimin, përditësimin dhe ndjekjen e procesit deri në rregjistrimin e pronave të Njësisë Administrative Patos, Zharrëz dhe Ruzhdie të Bashkisë Patos” grupi i punës ka bërë përditësimin, inventarizimin dhe regjistrimin e pronave të paluajtshme shtetërore të përditësuara sipas ligjit 20/2020 të Njësisë Administrative dhe Bashkisë Patos. e përbërë nga 100 (njëqind) fletë dhe mbyllen me nr. rendor 1700 (njëmijë e shtatëqind) miratuar me VKB nr. 52, datë 04.11.2021, dërguar ASHK –së Fier me shkresën nr.2881 prot datë 08.11.2021 për vazhdimin e procedurave në inventarizimin e të gjitha pronave që janë në përdorim apo në pronësi të Bashkisë Patos.

Ish Komunës Ruzhdie, sot Njësia Administrative Ruzhdie me VKM nr. 432, datë 15.05.2013 “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore të Komunës Zharrëz, të Qarkut Fier”, i është miratuar lista inventarit dhe përfundon me numër rendorë 865. Me urdhrin nr. 2082 prot datë 01.09.2020 të Kryetares së Bashkisë “Për krijimin e komisionit për inventarizimin, plotësimin, përditësimin dhe ndjekjen e procesit deri në rregjistrimin e pronave të Njësisë Administrative Patos, Zharrëz dhe Ruzhdie të Bashkisë Patos” grupi i punës ka bërë përditësimin, inventarizimin dhe regjistrimin e pronave të paluajtshme shtetërore të përditësuara sipas ligjit 20/2020 të Njësisë Administrative dhe Bashkisë Patos. e përbërë nga 54 (pesëdhjetë e katër) fletë dhe mbyllen me nr. rendor 902 (nëntëqind e dy) miratuar me VKB nr. 50, datë 04.11.2021, dërguar ASHK –së Fier me shkresën nr.2883 prot datë 08.11.2021 për vazhdimin e procedurave në inventarizimin e të gjitha pronave që janë në përdorim apo në pronësi të Bashkisë Patos.

Ish Komunës Zharrëz sot Njësia Administrative Zharrëz e Bashkisë Patos, me VKM nr. 558, datë 27.07.2016 “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore të Njësia Administrative Zharrëz”, i është miratuar lista inventarit dhe përfundon me numër rendorë 178. Me urdhrin nr. 2082 prot datë 01.09.2020 të Krytares së Bashkisë “Për krijimin e komisionit për inventarizimin, plotësimin, përditësimin dhe ndjekjen e procesit deri në regjistrimin e pronave të Njësia Administrative Patos, Zharrëz dhe Ruzhdië të Bashkisë Patos” grupi i punës ka bërë përditësimin, inventarizimin dhe regjistrimin e pronave të paluajtshme shtetërore të përditësuar sipas ligjit 20/2020 të Njësive Administrative dhe Bashkisë Patos. e përbërë nga 20 (njëzetë) fletë dhe mbyllen me nr. rendor 201 (dyqind e një), miratuar me VKB nr. 51, datë 04.11.2021, dërguar ASHK–së Fier me shkresën nr.2882 prot datë 08.11.2021 për vazhdimin e procedurave në inventarizimin e të gjitha pronave që janë në përdorim apo në pronësi të Bashkisë Patos.

Pë sa më sipër Bashkia Patos ka krijuar regjistrin e aseteve por nuk i ka regjistruar në kontabilitet pasi me shkresat e sipërcituara janë dërguar në (ASHK), për vazhdimin e procedurave të mëtejshme mbështetur në nenin 8, të ligjit nr. 8743, datë 22.02.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, i ndryshuar, VKM nr. 500, datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore”, transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”, Udhëzimin nr.3, datë 18.07.2002 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme të shtetit nga njësitë e qeverisjes vendore”, si dhe Udhëzimit të Ministrisë së Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit nr. 15, datë 30.06.2003 “Për mënyrën e paraqitjes nga njësitë e qeverisjes vendore të kërkesave për transferim në pronësi të tyre, të pronave të paluajtshme publike”.

Në mënyrë të përmbledhur pronat e kaluara me VKM dhe të regjistruara në ASHK paraqiten si vijon:

Nr.	Bashkia/ Njesite	Nr. Pronave në Inventar	Nr. i Praktikave të Certifikuara Deri Dhjetor 2022	Nr. Praktikave te Certifikuara 2023	Prona te pa Rregjistruara
1	Zharrëz	178	6	1	171
2	Patos	300	9		291
3	Ruzhdië	865	3		862 *

Numri i pronave sipas iventarizimit fizik dhe të miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak dhe të dërguara në ASHK, për vazhdimin e procedurave për regjistrimin përfundimtar dhe certifikimin e tyre.

1	Zharrëz	201			Në Proces
2	Patos	1700			Në Proces
3	Ruzhdië	902			Në Proces

Në mënyrë të detajuar paraqiten pronat të cilat janë aplikuar për regjistrim në ASHK për periudhën 2023 si vijon:

	Emertimi i Pasurisë	Zona kadastral	Nr Pasurise	Indeksi I harte	Nr. rregjis	Siperfaqia sipas V.K.M.		Data e aplikimit Nr. Dt.	Vertetim ose certifikate Hipoteke	Siperfaqia sipas Faktit	
						Truall	Ndërt es			Truall	Ndert
43	Themele parafabrikat	2890	21/7	FA-F-6	5737	400	295	Aplikuar 01/03/2023	Për kthim nga ASHK	432	295
44	Pallati i Naftës	2890	6/235	FA-F-6	30073	211.30	211.30	Aplikuar 18/12/2023	Për kthim nga ASHK	211.30	211.30

Sipas ligjit nr. 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë” duhej bërë një inventarizim i plotë i të gjitha pronave që i janë transferuar organeve të pushtetit vendor duke saktësuar të dhënat mbi këto prona.

Ndërkohë në bazë të VKM nr. 28, datë 27.01.2023 duhet bërë edhe njëherë një përditësim i pjesshëm i pronave ku të përditësohen, përmirësohen të dhënat e sakta të një ose më shumë pronave

mbi gjendjen faktike të tyre, si sipërfaqja, pozicioni, numri i pasurisë dhe të krahasohen me inventarin që është bërë në përputhje me ligjin nr. 20/2020, që më pas të vijohet me procesin e regjistrimit për t'u pajisur me certifikatë pronësie.

- Evidenca e aktiveve të qëndrueshme dhe regjistrimi i tyre në pronësi të Bashkisë Patos të kaluara me VKM nr. 433, datë 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyje dhe kullota publike ndryshuar me VKM nr.684 datë 02.09.2020.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezultoi se në zbatim të ligjit Nr.9385 datë 04.05.2005 “Për Pyjet dhe Shërbimin Pyjor”, ligjit Nr.111/2018 “Për Kadastrën” dhe VKM Nr.433 datë 08.06.2016, Ministria Turizmit dhe Mjedisit nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithëshme të Politikave dhe Zhvillimit të Mjedisit dhe kompanisë së kontraktuar CSI-Piemonte & Datech, me mbështetjen e Bankës Botërore, Qeverisë Suedeze dhe Fondit për Mjedis Global, filloi “Rregjistrimin Fillestar të Pasurive të Tipit Pyje dhe Kullota” në pronësi/administrim të Bashkisë Patos.

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Drejtoria e Përgjithëshme e Politikave dhe Zhvillimit të Mjedisit me shkresën nr. 11423 prot. date 30.12.2019 ka njoftuar Bashkinë Patos mbi “Procesin e regjistrimit fillestar të pasurive të tipit Pyje dhe Kullota”, në pronësi të Bashkisë Patos. Në vijim të korrespondencës Bashkia Patos me shkresën nr.12/3 prot. datë 28.02.2020 i dërgoi informacion Ministrisë Turizmit dhe Mjedisit, mbi procesin e “Regjistrimit fillestar të pasurive të Tipit Pyje dhe Kullota” në pronësi të saj, bashkëlidhur vendimin e Këshillit Bashkiak nr.4 datë 04.02.2020 si dhe listën e inventarit të pasurive Pyje dhe Kullota e cila fillon me numër rendor 1-42 faqe 2, konfirmuar me shkresën nr.188/1 prot. datë 14.02.2020 të Prefektit të Qarkut Fier mbi ligjshmërinë e vendimit të Këshillit Bashkiak Patos.

Me shkresën nr. 5 prot. datë 25.08.2020, kompania “C”, i është drejtuar Bashkisë Patos, Drejtorisë Vendore të ASHK-së Fier për takim konsultativ dhe diskutim mbi kufijtë Kadastral në të cilat po kryhet Regjistrimi Fillestar i Pyjeve dhe Kullotave në emër të Bashkisë Patos dhe me shkresën nr.37 prot. datë 15.12.2020 i është drejtuar Bashkisë Patos, për dijeni Ministrisë Turizmit dhe Mjedisit mbi “Regjistrimin Fillestar të Pyjeve dhe Kullotave” të transferuara në pronësi të Bashkisë Patos me anë të VKM Nr.684 datë 02.09.2020.

Ministria Turizmit dhe Mjedisit me shkresë nr.5710 prot. datë 10.08.2021 i drejtohet Bashkisë Patos për të përshpejtuar miratimin e produktit përfundimtar të regjistrimit të pasurive Pyje dhe Kullota në administrim/pronësi të njësisë së qeverisjes vendore, nëpërmjet Drejtorisë Vendore ASHK Fier. Bashkia Patos me shkresën nr.2048/1 prot. datë 13.08.2021 i drejtohet Drejtorisë Vendore ASHK Fier për të përshpejtuar regjistrimin. Për këtë u njoftua Ministria e Turizmit dhe Mjedisit me shkresën nr. 2048/3 prot. datë 26.08.2021.

Bashkia Patos me shkresë nr. 391 datë 03.02.2022 ka kërkuar informacion “A”, Ministrisë Turizmit dhe Mjedisit, Drejtorisë Vendore të ASHK Fier se në çfarë faze është procesi dhe kur do të filloj certifikimi i pronave Pyje dhe Kullota. Përgjigja e Drjtorisë Vendore të ASHK-së Fier.

Për sa argumentuam me lartë Bashkia Patos është në proces regjistrimi të pronave të kaluara me VKM nr. 433, datë 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, ndryshuar me VKM nr.684 datë 02.09.2020.

- Auditimi mbi inventarizimin e llogarive të Aktiveve Afatgjata Materiale; Jo materiale dhe Qarkulluese, sipas klasifikimit të tyre e mbajtjes së kartelave, raportimi i shitesave, apo përmirësimeve të kryera për gjatë periudhës raportuese në aktivin e duhur, për periudhën ushtrimore raportuese 2023

Në zbatim të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar me ligjin nr. 110/2015, datë 15.10.2015; ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin e pasqyrat financiare”, pika (1), neni (7) “Inventari aktiveve e detyrimeve”; UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Kreu (IV)

“Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve, inventarizimi i aktiveve” pika (81) dhe UMF nr. 28, datë 15.12.2011 “Mbi paraqitjen e deklaratës dhe raportit vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësite publike”, në njësinë publike vendore Bashkia Patos u auditua procedurat e ndjekura për kryerjen e inventarizimit fizik të pasurisë të administruara në llogaritë; “aktive afatshkurtër”; “gjendje inventar qarkullues”; “materiale”; “inventar i imët”; “Aktive afatgjata jo materiale” dhe “Aktive afatgjata materiale”.

Nga auditimi mbi dokumentacionin e vendosur në dispozicion për periudhat raportuese objekt auditimi (2023), u konstatua se, për realizimin e procesit të inventarizimit fizik të “aktiveve afatgjata dhe afatshkurtër” (materiale e jo materiale) dhe “inventar qarkullues” të pasurisë, Aseteve dhe vlerave materiale në përdorim të njësisë publike vendore Bashkia Patos për periudhën raportuese ushtrimore 2023, Titullari ka nxjerr urdhrin e brendshëm nr. 204, datë 19.10.2023 “Për caktimin e komisionit përgjegjës për përditësimin, evidentimin dhe kontrollin fizik të inventarit të pronave publike të Bashkisë Patos” me përbërje: z. N.H. në cilësinë e kryetarit, z. O.G. në cilësinë e anëtarit, z. A.G. në cilësinë e anëtarit, znj. F.GJ. në cilësinë e anëtarit, z. A.T në cilësinë e anëtarit, z.A.R. në cilësinë e anëtarit si dhe z.A.K. në cilësinë e anëtarit. Në përfundim të procesit të inventarizimit fizik, komisioni ka paraqitur vetëm një relacion për fletë inventarët me gjendje fizike e kontabël në objektet e inventarizuara sipas llogarive inventariale, ka paraqitur përmbledhëse me rezultatet e inventarit fizik duke evidentuar materiale e nxiera jashtë funksionit.

Referuar të dhënave të inventarëve në fund të vitit 2023 dhe pasqyrave financiare dërguar në Degën e Thesarit Fier nga ku u konstatua se gjendja kontabël përputhet me gjendjen fizike në përputhje me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar me ligjin nr. 110/2015, datë 15.10.2015; ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin e pasqyrat financiare”, pika (1), neni (7) “Inventari aktiveve e detyrimeve”; UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Bashkia Patos për periudhën raportuese ushtrimore 2023. Titullari ka nxjerrë urdhrin e brendshëm nr. 203 prot, datë 19.10.2023 “Për caktimin e komisionit përgjegjës për përditësimin, evidentimin dhe kontrollin fizik të inventarit të pronave publike të Bashkisë Patos dhe njësisë Administrative Ruzhdie dhe Zharrëz”. Në përfundim të procesit të inventarizimit fizik, komisioni ka paraqitur relacion për fletë-inventarët me gjendje fizike e kontabël në objektet e inventarizuara sipas llogarive inventariale, ka paraqitur përmbledhëse me rezultatet e inventarit fizik duke evidentuar materiale të dëmtuara respektivisht:

- Llogaria 214 “Instalime teknike, makineri e pajisje” të dala jashtëpërdorimit në vlerën 44,680 lekë dhe të rakorduara me pasqyrën e gjendjes dhe ndryshimit të aktiveve afatgjata (vlera neto).
- Llogaria 218 “Inventar Ekonomik” të dala jashtë përdorimit në vlerën 4,640,574 lekë dhe të rakorduara me pasqyrën e gjendjes dhe ndryshimit të aktiveve afatgjata (vlera neto).
- Llogaria 218/1 “Inventar Ekonomik, pajisje informatike” të dala jashtë përdorimit në vlerën 774,956 lekë dhe të rakorduara me pasqyrën e gjendjes dhe ndryshimit të aktiveve afatgjata (vlera neto).
- Llogaria 327/1 “Inventar i Imët” të dala jashtë përdorimit në vlerën 1,991,482 lekë dhe të rakorduara me pasqyrën e gjendjes dhe ndryshimit të aktiveve afatgjata (vlera neto).
- - Llogaria 312/3 “Ndërtesa dhe konstruksione, Inventar magazia 312/3” të dala jashtë përdorimit në vlerën 0 lekë dhe të rakorduara me pasqyrën e gjendjes dhe ndryshimit të aktiveve afatgjata (vlera neto).

Në lidhje me procesin e inventarizimit të plotë periodik të aktiveve të institucionit, konstatohet se janë ndjekur procedurat sa më poshtë vijon:

Urdhri 203 datë 19.10.2023	Kryetari ka ngritur Komisionin e vlerësimit të Aktiveve të Bashkisë Patos
Shkresa nr. 153 prot. datë 19.01.2023.	Relacion shoqërues i inventarizimit dhe vlersimit të materialeve të inventarizimit të Aseteve të Bashkisë Patos + Njësitë Administrative Zharrëz dhe Ruzhdie.

Shkresa nr. 252/2 prot. datë 26.01.2024.	Informacion Këshillit Bashkiak mbi nxjerrjen jashtëpërdorimi të materialeve të inventarit viti 2023.
Vendimi nr. 252/1, datë 26.01.2024	Për nxjerrjen jashtëpërdorimit të materialeve të inventarit, viti 2020

Në analizë: Në formatin nr. 2 “Pasqyra e performancës financiare” paraqet llogaritë e të ardhurave dhe shpenzimeve me klasifikim sipas natyrës ekonomike të pasqyruara PF për vitin 2023 sipas zërave paraqitet në aneksin nr.12 pika 3, bashkëlidhur raportit të auditimit.

Sipas kësaj pasqyre paraqiten llogaritë financimi nga buxheti i shtetit për vitin 2023 (grant) në shumën 595,462,286 lekë. Të ardhurat e realizuara nga kjo njësi vendore në vlerën 107,504,593 lekë sipas aktit të rakordimit me Degën e Thesarit Fier. **Perfshirja në kete format të PF e gjendjes të të ardhurave sipas llogarive analitike është bërë nga jashte sipas ditarit të azhornuat nga drejtoria e taksave e tarifave vendore.** Gjendja e seciles llogari te te ardhurave rakordon me vlerat e paraqitura ne llogarite analitike te aktit te rakordimit me degen e thesarit Fier **Për vitin 2023** totali i te ardhurave ne vlere është 986,662,710 lekë dhe totali shpenzimeve eshte 762,228,325 lekë. Diferenca e tyre në vleren **224,434,385 lekë rakordon me gjendjen e llog.85 “Rezultatit e ushtrimit”**.

3.4. Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, si dhe zbatimin e kontratave të punimeve.

4.1. Programimi i nevojave dhe përgatitja e regjistrit të prokurimeve.

4.2. Verifikimi i shpenzimeve të programuara me nivelin e fondeve të buxhetuara.

4.3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të procedurave të prokurimit (vlerësimi i kriterëve kualifikuese, fondi limit, vlerësimi i ofertave dhe shpallja e fituesit etj.), si dhe për marrjen në dorëzim të mallrave dhe shërbimeve, sipas specifikimeve teknike dhe kontratave të lidhura.

4.1. Programimi i nevojave, përgatitja e regjistrit të prokurimeve.

Nga auditimi ka rezultuar se, janë hartuar regjistrat e parashikimeve dhe realizimeve për periudhën 01.01.2023– 31.12.2023. Mbas miratimit në sistem të regjistrit nga APP, me shkresa përcjellëse janë dërguar në Degën e Thesarit, regjistri i parashikimit të prokurimeve për vitet objekt auditimi mbështetur në VKB-në përkatëse "Mbi miratimin e buxhetit vjetor të Bashkisë Patos". Gjithashtu në të gjitha rastet e shtesave dhe pikësimeve është dërguar regjistri përkatës. Në këto regjistra janë pasqyruar shtesat dhe ndryshimet e bëra sipas VKB –ve përkatëse, në përputhje me VKM, ku citohet se “Regjistri i parashikimeve të procedurave të prokurimit publik”, pika 1. Dërgimi i regjistrit të parashikimeve në APP, është bërë brenda afateve të përcaktuara.

4.2. Verifikimi i shpenzimeve të programuara me nivelin e fondeve të buxhetuara:

Tabela nr. 1. Të dhënat mbi regjistrin e realizimit të procedurave periudha 01.01.2023 – 31.12.2023, në lekë

Lloji i procedurës	Nr. Proc	Fondi limit pa Tvsh	Kontrata pa Tvsh	Fondi total i kursyer pa Tvsh	% që zë fondi i kursyer ndaj fondit limit
<i>Procedurë e hapur</i>	3	62,002,143	50,788,070	11,214,073	18%
<i>Procedurë e hapur e thjeshtuar</i>	20	84,537,986	73,554,165	10,983,821	13%
<i>Kërkesë për propozime</i>	3	84,026,790	45,215,151	38,811,639	46%
SHUMA	26	230,566,919	169,557,386	61,009,533	26%

Burimi i të dhënave: Bashkia Patos punoi grupi i Auditimit.

Procedurat e prokurimit të audituara për vitin 2023 janë si më poshtë vijon:

1. Të dhëna mbi objektin e prokurimit: Rikualifikim Urban, Blloku i lagjes “Naftëtari”, pranë shkollës “Muhamet Shehu”

a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “ Rikualifikim Urban, Blloku i lagjës Naftëtari, pranë shkollës Muhamet Shehu”.			
1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit “E Hapur” REF-50536-11-18-2022 Urdhri Nr.2840/2prot datë 14.11.2022	1.1 Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe fondit limit nr. 2840/4, datë 17.11.2022 Ing. A.M Preventivuar: Ing. S.M Ing. A.M	2 Njësia e Prokurimit 1. D.K 2. Ing. A.M 3. M.N	3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhri nr. 2840/3 prot., datë 14.11.2022. 1. A.P 2. SH.B 3. B.M
4. Fondi Limit (pa tvsh) 34,804,483 lekë	5. Oferta fituese, vlera fituese: Operatori Fitues: BOE I shpk & M shpk 27,493,182 lekë pa tvsh.		6. Diferenca me fondin limit 7,311,301 lekë pa tvsh
7/1 Data e hapjes së tenderit: Data 06.12.2022 ora 11:00	8. Burimi Financimit Vetë financim.	9. Operoret Ekonomike a) S’kualifikuar 2 B/OE, 1. BOE K sh.p.k me & « C » 2. K b) Kualifikuar 3 B/OE BOE « I » shpk & « M » & «M» shpk A B	
7/2 Kohëzgjatja e kontratës: 8 muaj ditë			
10.Ankimime AK-s’ka APP-s’ka KPP-s’ka	11. Data e lidhjes të kontratës: Nr. 2840/16 prot., datë 09/03/2023		12.Përgjigje Ankesës nga APP, AK apo KKP: AK NUK KA

- AK në lidhje me “Hartimin e Specifikimeve Teknike” dhe “Përlllogaritjen e Fondit Limit” :

Nga dokumentacioni pjesë e dosjes së prokurimit, konstatohet se, Projekti dhe preventivi, dorëzuar në protokoll me shkresën Nr.2840 prot datë 11/11/2023 dhe shkresën Nr.2840/1prot datë 11/11/2023 “Mbi llogaritjen e fondi limit” janë përlllogaritur nga Ing. S.M. dhe Ing. A.M. Sipas dokumenti të datës Nr.2840/1prot datë 11/11/2023, të mbajtur për efekt të pasqyimit të veprimtarisë, konstatohet se komisioni për përlllogaritjen e fondit limit i është referuar manualit të shtetit për punimet përkatëse.

Fondit limit: 34,804,483.8 lekë pa TVSH, vënë në dispozicion nga të Ardhurat Lokale 2022-2023 për objektin "Rikualifikim Urban, Blloku i lagjes “Naftëtari”, pranë shkollës “Muhamet Shehu”.

Për vitin 2022 Financimi do të jetë në vlerën 20,743,000 lekë me Tvsh. Për vitin 2023 Financimi do të jetë në vlerën 21,022,380.5 lekë me Tvsh.

Nga ana e titullari i AK, në zbatim të LPP-së, është ngritur një komision me urdhrin nr. 2842/2 prot., datë 14.11.2023 “Për krijimin e komisionit të hartimit të specifikimeve teknike”, i përbërë prej, znj. D.K, përgjegjës i njësisë së prokurimit/juriste, z. A.M. drejtor/ specialist fushe dhe z. M.N. specialist prokurimi/ jurist. Për hartimin e specifikimeve teknike është mbajtur procesverbal me nr. 2840/4 prot., datë 17/11/2023 nga ing. A.M. i cili ka hartuar specifikimet teknike

Mbi ndryshimin e dokumentave standarte të tenderit

Autoriteti Kontraktor, Bashkia Patos, bazuar në rekomandimet e bëra nga Agjencia e Prokurimit Publik vendosi që të bëjë ndryshime në dokumentet standarde të tenderit me objekt: “Rikualifikim Urban, Blloku i lagjes Naftëtari, pranë shkollës Muhamet Shehu”, me fond limit 34,804,483 lekë pa tvsh sipas shtojcës nr. 2840/7 prot., datë 25.11.2022.

- Në lidhje me “Argumentimin dhe Hartimin e Kriereve”:

Kërkesat e veçanta të kualifikimit janë hartuar nga komisioni i përbërë prej (Inxhinier Ndërtimi: A.M.), të cilat janë evidentuar në procesverbalin e datës nr. 2840/4 prot., datë 17.11.2022. Në lidhje me kriteret e vendosura, u konstatuan kriteret e paargumentuara, si vijon:

Kërkesat e pikës 2.3.3 e DST e cila kërkon që operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastruktues dhe Energjise, ne baze te VKM nr. 42, Dt. 16.01.2008 i ndryshuar, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme: NP-1: Punime germimi ne toke “Kategoria A”; NP-4: Rruge, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvaj, metro, pista aeroportuale “Kategoria A”; NP-7: Ujësjiellës, gazsjellës, vajsjiellës, vepra kullimi e vaditje “Kategoria A”; NS-1: Punime për prishjen e ndërtimeve “Kategoria A”; NS-18: Punime topogjeodezike “Kategoria A”.

-Referuar licensave profesionale NP dhe NS të kërkuara nga AK janë të kategoris-A, janë për investime 0-20 milion, nërsa projekt preventivit i punimeve rezulton në vlerën 34,804 mijë lekë. Pra licensat e kërkuara nuk janë në përputhje me vlerën e kontratës sipas llojit të punimeve të përfshira në përkufizimin e kategorive të sipërcituara, sipas VKM nr. 42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Vendosja e kërkesës për disponimin e kategorive të mësipërme, nuk i përmbahet përcaktimeve të pikës 4; të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar , Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Kërkesat e pikës 2.3.6 e DST e cila kërkon që operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej **minimalisht 32 (tridhjetë e dy)** persona. Teknike ndertimi 2 (dy); Karpentiere 3 (tre); Hekurkthyes 2 (dy); Pllaka Shtrues 3 (tre); Specialist shtresash rrugore 3 (tre); Puntore te thjeshte 9 (nente); Shofere 3 (tre); Manovratore 3 (tre); Drejtues Teknik 4 (kater). Kriteri për stafin mbështetës dhe për punonjësit e kërkuar nuk është i argumentuar teknikisht dhe ligjërish referuar procesverbalin të argumentimit nr. 2840/4 prot., datë 17.11.2022, në kundërshtim me parashikimet e dispozitave ligjore të zbatueshme për prokurimin publik sipas nenit 7 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe pikës 4 të nenit 39 të VKM me nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar i cili përcakton se:

“Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës”.

Kërkesat e pikës 2.3.7 e DST e cila kërkon që operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Kamion me aftesi mbajttese mbi/ose 20 ton copë 3 (tre); Kamiocine me aftesi mbajttese (2 deri ne 3.5 ton) copë 1 (një); Ekskavator me goma 0.25 m3 copë 2 (dy); Ekskavator me zinxhire 0.5 m3 copë 2 (dy); Grejder copë 1 (një); Rul copë 2 (dy); Autobot uji mbi 5000 litra copë 1 (një); Rul me kompresor copë 1 (një); Autobitumatrice copë 1 (një); Asfalto shtruese copë 1 (një); Mini Fadrome copë 1 (një); Betoniere 0.15-0.5 m3 copë 1 (një); Autovinc mbi 5 ton copë 1 (një); Matrapik me fuqi mbi 2 KË copë 2 (dy).

- Në procesverbalin e datës 17.11.2022 nuk argumentohet numri i mjeteve të kërkuar në pikën 2.3.7. DST, pasi mungon dokumenti mbi përllogaritja dhe analiza e mjeteve për realizimin e investimit në përputhje me preventivin dhe grafikun e punimeve në kundërshtim me pikën 4, të Nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe Kreut V, Seksioni

III, Neni 39, pika 6, germa "d" të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Kërkesat e pikës 2.3.8. e DST Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me licensën profesionale nga Qendra Kombëtare e Liçensimit (QKL) Kodi III.2.B.

Kërkesa për licencë nuk është e argumentuara teknikisht dhe ligjërish në lidhje dhe në funksion të objektit të kontratës. Nuk është e nevojshme licenca e mësipërme, pasi shërbimin e grumbullimit të mbetjeve e ofron Bashkia Patos referuar paketës fiskale si dhe për subjektet që kryejnë punime ndërtimit aplikon tarifën ndotjes, shërbimit, për kohëzgjatjen e kantierit të ndërtimit.

Sa më sipër nuk përmbushin parashikimet e dispozitave ligjore të zbatueshme për prokurimin publik sipas nenit 7 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, dhe pikës 4 të nenit 39 të VKM me nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.

Sa më sipër mbanë përgjegjësi njësin e prokurimit me përbërje znj. D.K, z. A.M si dhe z. M.N.

b-Në lidhje me zhvillimin e procedurës dhe vlerësimin e ofertave nga KVO.

Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 5 OE, për të cilët, referuar procesverbalit nr. s'ka, të datës 13.01.2023, KVO-ja ka kryer në SPE vlerësimin dhe klasifikimin përkatës si më poshtë:

Nr	Operatori ekonomi	Oferta lekë pa Tvsh	Kualifikuar/S'kualifikuar
1	BOE "I" shpk & "M" & "M" shpk	27,493,182	Kualifikuar
2	A	28,847,853	Kualifikuar
3	B	29,621,025	Kualifikuar
4	BOE K sh.p.k me & C	27,464,744	BOE K sh.p.k me NIPT L...E & «C» shpk me NIPT L...O ka mangësi në dokumentacion si më poshtë : <ul style="list-style-type: none"> ▪ Te kriteret e përgjithshme për kualifikim Pika 2_Marrëveshje bashkëpunimi midis operatorëve_ ka pasaktësi në ndarjen në përqindje të punimeve që secili operator merr përsipër të kryej ku në Nenin 3 të marrëveshjes Shoqëria "C" merr përsipër 18.99% të punimeve dhe Shoqëria KMK merr përsipër 81.01% të punimeve, ndërsa në Nenin 4 ku specifikohet ndarja e fitimit sipas përqindjes së punimeve që do të kryejnë dhe preventiv "C" ka 18.85% dhe KMK ka 81.15%. ▪ Te kriteret e vecanta të kualifikimit nuk plotëson pikën 2.3.5_Punonjës të specializuar të kualifikuar ku kërkohen 3 pllakashtrues dhe operatorët së bashku kanë deklaruar vetëm 2 pllakashtrues, pra, mungon 1 pllakashtrues.
4	K	31,368,078	Shoqëria «K » me NIPT K...Ë ka mangësi në dokumentacion si më poshtë: Te kriteret e vecanta të kualifikimit nuk plotëson pikën 2.3.5 Punonjës të specializuar të kualifikuar. Nga 9 punëtor të thjeshtë që kërkoni ju plotësoni vetëm 5 pasi 4 prej tyre janë të deklaruar me funksione si: V.R. Karpentier dhe Punëtor i thjeshtë, A.D. Pllakashtrues dhe Punëtor i thjeshtë, SH.H Pllakashtrues dhe Punëtor i thjeshtë, S.S. Hekurthyes dhe Punëtor i thjeshtë.

Nga KVO është mbajtur Raporti përmbledhës nr.2840/15, 10.02.2023, në të cilin është përshkruar e gjithë procedura e ndjekur deri në shpalljen e fituesit. Sipas këtij Raporti përmbledhës dhe formularit të njoftimit të fituesit, nga 5 operatorë pjesëmarrës janë s'kualifikuar 2 OE, janë kualifikuar 3 OE. Në përfundim, mbi bazën e Raportit përmbledhës, Titullari i AK Nr. 2840/15 prot. Datë 10.02.2023 ka shpallur fituese ofertën e shoqërisë "BOE I shpk & M shpk" për të cilën është lidhur kontrata datë **Nr. 2840/16 prot., datë 09/03/2023 me vlerë 27,493,182 lekë pa TVSH**

dhe vlera **32,991,818 lekë me TVSH**, dhe me afat 8 (tetë) muaj/deri më 09.11.2023 / 245 ditë nga data e lidhjes së kontratës.

c- Në lidhje me procedurën shqyrtimit të ankimeve. (Nuk ka patur ankimime)

Në lidhje me klasifikimin dhe vlerësimin e BOE për procedurën e sipërcituar, ndër të tjera, rezulton se nuk janë paraqitur ankesa nga BOE, duke kundërshtuar skualifikimin dhe pretendimet e AK.

- Nga shqyrtimi i ofertës fituese, rezulton se BOE nuk përmbush të gjitha kriteret e vendosura në DST dhe konkretisht:

1. BOE nuk përmbush kriterin e pikës **2.3.7 të DST** pasi ka deklaruar mjeteve të transportit/ndërtimit sipas rastit, të deklaruar në shtojcën 8 nga OE “M” SHPK, si dhe për vërtetimin e disponimit të tyre ka dorëzuar dokumentacionin fizik, ku një pjesë e zotëron nëpërmjet qiramarrjes dhe një pjesë të tyre e ka në pronësi, konstatohet se për mjetet e mara me qira janë për përdorim veti konkretisht

1.1 Mjeti Eskavator me Goma Fiat Hitaci me targa AFMT88, i dorëzuar fizikisht në muajin korrik të vitit 2022 nëpërmjet kontratës së qirasë Nr.Rep:2998 dhe Nr.Kol:548 të nënshkruar ndërmjet me subjektin z. L.K dhe shoqërisë “M” SHPK rezulton se subjekt nuk disponon certifikatë për dhënien me qira të mjeteve për të tretë.

1.2. Kamjoncina Vetshkarkuese me vinç, Mercedens Benz me targa TR 1982 M i dorëzuar fizikisht në muajin Shtator të vitit 2022 nëpërmjet kontratës së qirasë Nr.Rep:3104 dhe Nr.Kol: 722 të nënshkruar ndërmjet me subjektin z. N.Z dhe shoqërisë “M” SHPK rezulton se subjekt nuk disponon certifikatë për dhënien me qira të mjeteve për të tretë.

1.3. Kamioni Mercedens Benz me targa AA 467 PE rezulton se subjekt nuk disponon certifikatë për dhënien me qira të mjeteve për të tretë, referur kontratës së qirasë Nr.Rep: 2940 dhe Nr.Kol: 630 të nënshkruar ndërmjet shoqërisë “B” SHPK dhe shoqërisë “M” SHPK.

1.4. Kamioni MAN me targa AA 835 EU, rezulton se subjekt nuk disponon certifikatë për dhënien me qira të mjeteve për të tretë, referur kontratës së qirasë Nr.Rep: 2940 dhe Nr.Kol: 630 të nënshkruar ndërmjet shoqërisë “B” SHPK dhe shoqërisë “M” SHPK.

1.5. Kamioni MAN me targa AA 933 NF, rezulton se subjekt nuk disponon certifikatë për dhënien me qira të mjeteve për të tretë, referur kontratës së qirasë Nr.Rep: 2940 dhe Nr.Kol: 630 të nënshkruar ndërmjet shoqërisë “B” SHPK dhe shoqërisë “M” SHPK.

1.6. Mercedens Benz me targa FR 3839 C, rezulton se subjekt nuk disponon certifikatë për dhënien me qira të mjeteve për të tretë, referur kontratës së qirasë Nr.Rep: 2940 dhe Nr.Kol: 630 të nënshkruar ndërmjet shoqërisë “B” SHPK dhe shoqërisë “M” SHPK rezulton se subjekt nuk disponon certifikatë për dhënien me qira të mjeteve për të tretë.

Lidhur me sa më sipër, për certifikatat e transportit sqarojmë se: Në nenin 81, pika 1, 2, 3, 4, 5 dhe 7, 8 “Destinacioni dhe përdorimi i mjeteve” i ligjit nr.8378 datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Në nenin 3, paragrafi 3.13 dhe 3.14 të ligjit nr. 8308, datë 18.3.1998 “Për transportet rrugore”, i ndryshuar.

Në nenin 41, të ligjit nr. 8308, datë 18.3.1998 “Për transportet rrugore”, i ndryshuar.

Në rastin konkret përmes dokumentacionit të dorëzuar vërtetohet se, certifikatat janë dhënë në përdorim të vet pronarëve të mjeteve për kryerjen e transportit të mallrave me kamion (vetëm për llogari të veprimtarisë së vet). Në këtë mënyrë, kryerja e transportit nga ana e OE të mallrave me mjetet e mësipërme do të jenë në kushtet e kryerjes së transportit të mallrave me qira dhe për të tretë pa certifikaten përkatëse, transport i cili në zbatim të nenit 41 të ligjit “Për Transportet Rrugore” është i ndaluar. Mungesa e certifikatave të mësipërme, vërteton faktin se përdorimi i tij

nga të tretë do të ishte i pamundur në zbatim të dispozitave të sipërcituar të Kodit Rrugor të RSh-së dhe të ligjit “Për Transportin Rrugor”.

1.7. Mjeti RUL; BOMAG BË213 – D3, rezulton se subjekt nuk disponon certifikatë regjistrimi si dhe certifikat për dhënien me qira të mjeteve për të tretë, referur kontratës së qirasë Nr.Rep: 3081 dhe Nr.Kol: 566 të nënshkruar ndërmjet shoqërisë “D” SHPK dhe shoqërisë “M” SHPK.

1.8. Mjeti RUL VIBRUES; MARKA SICOM; NR. SHASIE 100000040171, rezulton se subjekt nuk disponon certifikatë regjistrimi si dhe certifikate për dhënien me qira të mjeteve për të tretë, referur kontratës së qirasë Nr.Rep: 3504 dhe Nr.Kol: 793 të nënshkruar ndërmjet personit fizik z. D.C. dhe shoqërisë “M” SHPK.

Lidhur me sa më sipër, për certifikatat e regjistrimit sqarojmë se: në nenin 113, nenin 122 dhe nenin 230 pika 8, “Qarkullimi në rrugë i makinave teknologjike” i ligjit nr.8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

2. BOE nuk përmbush kriterin e pikës **2.3.6 të DST** e cila kërkon:

Manovratore 3 (tre)

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga OE i shpallur fitues, rezulton se referuar vetdeklarimit dhe sipas listëpagesa e Kontributeve të sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatami mbi të ardhurat nga punësimi “M” SHPK ka deklaruar sipas formularit 8, të punësuar në kompani ka deklaruar manovratorë z. A.O. i cili figurojnë në listë pagesa me kod punësimi 8322.01 – *shofer* në kundërshtim me VKM nr. 514, datë 20.09.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve LKP të Rishikuar”

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga OE i shpallur fitues, rezulton se referuar vetdeklarimit dhe sipas listëpagesa e Kontributeve të sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatami mbi të ardhurat nga punësimi “M” SHPK ka deklaruar sipas formularit 8, të punësuar në kompani ka deklaruar manovratorë z. R.P i cili figurojnë në listë pagesa me Kod punësimi 8322.01 – *shofer* në kundërshtim me VKM nr. 514, datë 20.09.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve LKP të Rishikuar”.

3. BOE fitues, nuk përmbush kriterin e pikës **2.2.3 të DST** e cila kërkon nga OE të paraqesë një dokument që ka plotësuar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore lëshuar nga Pushteti Vendor për vitin 2022, kudo ku operatori ushtron aktivitet, sipas regjistrimit në QKB.

Në dokumentacionin e ngarkuar në SPE, OE “I” SHPK ka deklaruar si punë të ngjashme kryerjen e punimeve për objektet;

1. “Ndërtimi i K.U.B dhe K.U.Z faza e parë”, Bashkia Selenicë, sipas kontratës datë 29.06.2017.

2. “Rikonstruksioni i fushës së sportit Selenicë”, Bashkia Selenicë, sipas kontratës nr. 1932 prot., datë 17.07.2018.

3. “Rikonstruksion ish kopshtit në “Lagje e Re në Banesa Sociale”, Bashkia Patos, sipas kontratës nr. 1264/11 prot., datë 19.09.2017.

4. “Ndërtimi i shërbimit me një ndalës (One Stop Shop) + Salla e Këshillit”, Bashkia Patos, sipas kontratës nr. 2164/10 prot., datë 27.02.2018.

5. “Adaptimi i ish-godinës së kualifikimit të “Lagja e Re” në banesa sociale”, Bashkia Patos, sipas kontratës nr. 2499/9 prot., datë 12.12.2018.

Sa më sipër, rezulton se OE nuk ka pasqyruar në QKB punimet e mësipërme. Gjithashtu sipas regjistrimit të pasqyruar në APP në “Open data” rezulton se OE “I” SHPK nuk ka deklaruar kontratat

e lidhura për vitin 2022, nuk i ka pasqyruar në QKB si dhe nuk ka paraqitur vërtetim për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore, lëshuar nga Pushteti Vendor për vitin 2022 si vijon:

Autoriteti kontraktues	Objekti i prokurimit	Data e mbylljes	Vlera e fituesit
Bashkia Selenicë	Ndërtim i rrjetit të ujërave të zeza Astane Kote	18.08.2022	34,945,247
Bashkia Selenicë	Rehabilitim i kanaleve ujëtare sekondare Lubonje , Picar Armen	22.04.2022	81,375,701
Reparti Ushtarak Nr.1001 Komanda e Forcës Tokësore Tiranë	Rikonstruksion i ambjentëve të jashtme e të brendshme dhe krijimi i hapësirave stërvitore, në Rep.Usht. nr.1001, Zall-Herr, Tiranë	18.08.2022	66,985,737
Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	Lot.2 “Rikonstruksion i disa QSH- ve në rajonet Elbasan dhe Vlorë (12 objekte)”	04.05.2022	31,931,653

Në dokumentacionin e ngarkuar në SPE, OE “M” SHPK ka deklaruar si punë të ngjashme kryerjen e punimeve për objektet:

1. “Investim në lagjen e qytetit, kënd lojrash, sistemim ndriçimi “Lagja nr. 1,2,3,4 dhe periferia Sarandë”, sipas kontratës datë 16.09.2020.

Sa më sipër, rezulton se OE nuk ka pasqyruar në QKB punimet e mësipërme. Gjithashtu sipas regjistrimit të pasqyruar në APP në “Open data” rezulton se OE “M” SHPK nuk ka deklaruar kontratat e lidhura për vitin 2022, nuk i ka pasqyruar në QKB si dhe nuk ka paraqitur vërtetim për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore, lëshuar nga Pushteti Vendor për vitin 2022 si vijon:

Autoriteti kontraktues	Objekti i prokurimit	Data e mbylljes	Vlera e fituesit
Bashkia Konispol	MBROJTJE LUMORE NË LUMIN “PAVËLL” PRANË URËS SË “BOGAZIT”	08.09.2022	14,152,950
Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore Vlorë	Punime mirembajtëse restauruese, gërmime arkeologjike në Parkun Arkeologjik Amantia, tek Varri i Çifutit dhe Struktura përballë Stadiumit”	26.10.2022	840,000
Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës Tiranë	Pastrim i mbeturinave të Midhjes tek Moli dhe Grykës së Kolektorit	04.04.2022	590,700
Bashkia Dropull	“Mbrojtja e rrugës me gabion në perroiin e Selos, muri mbajtës në Koshovic dhe Varrezat në fshatin Frashtan”	01.08.2022	4,910,500
Bashkia Sarandë	“Rikualifikim i hapësirash me lulishte dhe stola,rruga “Apostol Cuni” mbi adem shemen, posht shikut, mbi komisarariat dhe rikualifikim i rrugeve ne Berdenesh, Cuke, Manastir, Kodër”	11.11.2022	9,839,280
Drejtoria e Spitalit Rajonal Gjirokastër	Rikonstruksion i ambjentëve ne shërbimin e Imazherise , dhoma e grafisë	01.12.2022	1,733,229
Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor Tiranë	Hegje inertesh dhe rehabilitimi i sheshit në DRSHTRR Sarandë	23.03.2022	3,532,732
Bashkia Konispol	RIKONSTRUKSION I RRJETIT TË NDRIÇIMIT RRUGOR, KONISPOL	02.09.2022	7,677,777
Bashkia Himare	Rikonstruksion i pjesshëm i rrugës Lukovë	14.10.2022	5,651,426

Konkluzion

Sa më sipër OE **nuk** plotëson kriteret e vendosur në DST dhe në këto kushte KVO nuk duhet të kishte kualifikuar BOE “I & M” ShPK, si dhe nuk duhet t’i kishte propozuar titullarit shpalljen fitues të tyre. Në këto kushte, KVO ka vepruar në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenin 92 “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3.

Sa më sipër mban përgjegjësi KVO me përbërje: znj. A.P, z. SH.B si dhe znj. B.M.

Në observacionin e subjektit të audituar Bashkia Patos mbi projekt raportit e auditimit përcjell me shkresën nr. 30/6 prot., datë 08.04.2024, janë dërguar observacione nga Bashkia Patos me shkresën nr. 67/43 prot., datë 10.05.2024 dhe protokolluar në KLSH me shkresën nr. 30/8 prot., datë 14.05.2024, shprehur si më poshtë vijon:

Pretendimet e subjektit:

Në lidhje me hartimin e kriterëve teknike në DST për objektet e prokurimit si më poshtë:

1. "Rikualifikimi Urban, Blloku i lagjes Naftëtari, pranë shkollës Muhamet Shehu".

2. "Rikonstruktion i rrugës Industriale, Kryqëzimi ku bashkohet me rrugën Franc Nopce".

3. "Rikonstruktion i Rrugës Unaza Varreza pikë takimi rruga "Dhori Tanaka"po ju sqarojmë:

Kriteret teknike janë hartuar nga Ing. ndërtimit z. A.M me shkresën me nr. 2840/4, datë 17.11.2022, si specialist fushë, anëtar i njësisë së prokurimit , sikundër është caktuar edhe në urdhërin e prokurimit, kjo bazuar në pikat 2 dhe 4 të nenit 74 të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 "Për rregullat e prokurimit publik" i ndryshuar.

Ndërsa në pikën 3, neni 74 të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 "Për rregullat e prokurimit publik" i ndryshuar Referuar kuadrit ligjor të sipërcituar kriteret teknike janë hartuar nga Ing. A.M. me profesion Ing. ndërtimi dhe i janë përcjellë Njësisë së Prokurimit. Njësia e prokurimit është përgjegjëse për hartimin e dokumentave të tenderit në zbatim të bazës ligjore të sipërpërmëndur dhe nuk mban përgjegjësi për materialet që i përcillen për prokurim, të hartuar nga specialistët përkatës të fushës. Në rastet e mësipërme njësia e prokurimit përbëhej nga specialisti i fushës z. A.M, 1 (një) jurist z. M.N. dhe 1 (një) ekonomiste znj. D.K. z.M.N. dhe znj. D.K nuk kanë kompetencë të kundërshtojnë një material zyrtar të përgatitur nga specialisti i fushës. Njësia e prokurimit nuk mund të përcaktojë tipologjinë, sasinë e mjeteve, numrin e punonjesve apo kërkesat e tjera të karakterit teknik të cilat nuk janë atribut i saj. Si e tillë nuk mund të ngarkohet me përgjegjësi Nga të gjitha argumentat e listuara më sipër, njësia e prokurimit nuk është përgjegjëse për kriteret teknike të hartuara nga specialisti i fushës në këtë procedurë prokurimi.

1. Në lidhje me konstatimet tuaja mbi objektin e prokurimit" Rikualifikim Urban, Blloku i lagjes Naftëtari, pranë shkollës Muhamet Shehu ju sqarojmë se:

Përsa i përket konstatimit tuaj rreth pikës 2.3.3. të kapacitetit teknik në DST ju sqarojmë domosdoshmërinë e këtij kriteri sikundër e kemi argumentuar në procesverbalin "Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim", datë 17.11.2022 i cili është pjesë e dosjes: Mbështetur në VKM nr. 629, datë 15.07.2015 "Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre" dhe në VKM nr. 42, datë 16.01.2008 "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi" është bërë përzgjedhja e kategorive të licencave të kërkuara në DST.

Kategoria i është referuar zërave të punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv të cilat përfshihen në kategorinë përkatëse si dhe nivelit të punimeve të kryera për kategorinë përkatëse, të cilat sipas llojit të kategorisë së kërkuar në asnjë rast nuk e tejkalojnë vlerën 20,000,000 lekë që mund të përzgjedhim kategorinë B të licencës.

Licencat e shoqërive klasifikohen në nivele të ndryshme sipas vlerave të punimeve të kryera. Niveli i shoqërisë (psh A, B, C, D, E, F ose G) për vlera punimesh të kryera përcaktohet për secilën kategori punimesh dhe jo për shumën totale të punimeve të kryera nga shoqëria. Më poshtë paraqitet lidhja nr. 4, e VKM nr. 42, datë 16.01.2008 "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi", (ndryshuar me VKM nr.406, datë 22.4.2009, nr.835, datë 15.7.2009, nr. 92, datë 19.2.2014, nr. 534, datë 25.7.2019; nr. 42, datë 27.1.2021)

Në lidhje me konstatimin tuaj se nga shqyrtimi i ofertës fituese, rezulton se BOE nuk përmbush të gjitha kriteret e përcaktuara në DST ju sqarojmë si më poshtë:

1. Situata nr. 2 (faqja 77e projekt raportit)

BOE nuk përmbush kriterin e pikës 2.3.7 të DST pasi ka deklaruar mjeteve të transportit/ ndërtimeve sipas rastit, të deklaruara në Shtojcën 8 nga OE "M " shpk, si dhe për vërtetimin e disponimit të tyre ka dorëzuar dokumentacionin fizik, ku një pjesë e disponon nëpërmjet qiramarrjes dhe një pjesë e ka në pronësi, konstatohet se për mjetet e marra me qira janë për përdorim vetjak konkretisht:

1.1.Mjeti eskavator me goma Fiat Hitaci me targa AFMT88

1.2.Kamioncina vetshkarkuese me vinc, mercedes benz me targa TR 1982M

1.3.Kamioni Mercedes Benz me targa AA467PE,

1.4.Kamioni Man me targa AA835EU

1.5.Kamioni MAN me targa AA933NF

1.6.Mercedes Benz me targa FR 3839C

Nuk disponojnë certifikatë regjistrimi si dhe certifikatë për përdorim nga të tretë

1.7.Mjeti Rul, Bomag BĚ213-D3

1.8.Mjeti Rul Vibruës, Marka Sicom, Nr. Shasie 100000040171

Sqarim:

Pika 1.1 mjeti ekskavator me goma Fiat Hitaci me targa AFMT88

Në DST është kërkuar ekskavator me goma (2 copë)

Nga të cilat 1 ekskavator (me targa AFMT 88) e disponon M nëpërmjet qiramarrjes. Marrja me qira e mjetit është realizuar nëpërmjet kontratës së qirasë, e cila është e noterizuar ku shprehet se e lejon përdorimin për të tretë.

Mjetin tjetër e disponon "I", mjet në pronësi, ekskavator me goma me targë TR1138J.

Pika 1.2.Kamioncina vetshkarkuese me vinc, mercedes benz me targa TR 1982M,

Pika 1.6.Mercedes Benz me targa FR 3839C

Në DST është kërkuar Kamioncinë 2-3.5 ton (copë 1)

Këtë kriter e plotësojnë 3 kamioncina, kamioncina e "M" në pronësi me targa AA576 XF, kamioncina e M me qera me targa FR3839C, kamioncina e I në pronësi me targa AA432EB.

Pra, nga 1 mjet që kërkohet janë paraqitur 3 mjete të cilat përmbushin kriteret. Mjeti me targë TR1982M është mjet shtesë i vendosur në dosje nga operatori i cili nuk është marrë në konsideratë për plotësimin e kriterit pasi e kanë plotësuar mjetet e sipërpërmendura.

Në DST është kërkuar autovinç mbi 5 ton (copë 1)

Këtë kriter e plotëson mjeti me targa AA736CU në pronësi të M si dhe mjeti me targa AA206NJ me qera nga "I".

Pra nga 1 mjet që kërkohet e plotësojnë 2 mjete këtë kriter

Pika 1.3. Kamioni Mercedes Benz me targa AA467PE

Pika 1.4.Kamioni Man me targa AA835EU

Pika 1.5.Kamioni MAN me targa AA933NF

Në DST është kërkuar Kamion vetëshkarkues mbi/ose 20ton (3 copë)

Kjo pikë plotësohet nga këto 3 mjete: mjeti me targa AA506MZ në pronësi të "M", mjeti me qera me targa AA099GY i marr nga M dhe mjeti me targa SR7951B i marrë me qera nga M të cilët i plotësojnë të gjithë dokumentacionin e kërkuar sipas DST, pra, mjetet me targa AA467PE, AA835EU dhe AA933NF janë mjete shtesë të vendosura në dosje nga operatori të cilat nuk janë marrë në konsideratë për plotësimin e kriterit pasi e kanë plotësuar mjetet e sipërpërmendura.

Pika 1.7.Mjeti Rul, Bomag BĚ213-D3

Pika 1.8.Mjeti Rul Vibruës, Marka Sicom, Nr. Shasie 100000040171

Në DST është kërkuar Rul vibruës (copë 2)

Kjo pikë plotësohet nga mjeti M me qera sipas kontratës së qirasë me nr.3081 REP, nr.566 KOL si dhe mjeti me qera i M sipas kontratës së qirasë me nr.3080 REP nr.565 Kol si dhe mjeti i M në pronësi i pajisur me deklaratë doganore.

Pra këto mjete nuk kanë leje qarkullimi dhe sipas DST mjafton paraqitja e kontratës noteriale dhe faturës tatimore të blerjes ose dokumentat e zhdoganimit të mjetit dhe kontrata e qirasë përpara noterit nëse nuk e ka në pronësi mjetin.

Për sa më sipër operatori i plotëson kriteret e kërkuara.

BOE nuk përmbush kriterin e pikës 2.3.6 të DST e cila kërkon(faqja 79 e projekt raportit):

Manovratorë 3 (tre)

Referuar vetëdeklarimit dhe listpagesës së kontributeve të sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi M shpk ka deklaruar sipas formularit 8, të punësuar në kompani manovratorë z. A.O. i cili figuron në listpagesa me kodpunësimi 8322.01-shofer , M ka deklaruar si manovratorë z, R.P. i cili figuron në listpagesa me kod pune 8322.01- shofer.

Sqarim :

Referuar kriterëve në DST për manovratorët është kërkuar që të figurojë në listpagesën e shoqërisë nga muaj shtator 2022 e në vazhdim, si dhe të jetë i pajisur me

Kontratë pune

Dëshmi kualifikimi

Leje drejtimi

z.A.O. figuron në listpagesa për periudhën e kërkuar, gjithashtu është i pajisur me leje drejtimi, ka IQT të vlefshme për manovratorë si dhe është i pajisur me dëshmi të aftësisë profesionale për ekskavatoristë duke i plotësuar të gjitha kriteret e kërkuara në DST.

z.R.P. figuron në listpagesa për periudhën e kërkuar, gjithashtu është i pajisur me leje drejtimi, ka IQT të vlefshme për manovratorë si dhe është i pajisur me dëshmi të aftësisë profesionale për ekskavatoristë duke i plotësuar të gjitha kriteret e kërkuara në DST.

Përsa i përket kodeve të sigurimeve ku specifikohet profili i punës, KVO në asnjë procedurë nuk ka bërë kontroll të tyre, pasi në DST nuk është kërkuar një pikë e tillë si dhe nuk kemi pasur asnjëherë udhëzime/orientime nga APP apo ndonjë autoritet tjetër për ta marrë në konsideratë. Po ashtu, shofer dhe manovrator janë profesione me certifikata të formimit profesional dhe paga minimale është e njëjtë për të dy profesionet.

BOE fitues nuk përmbush kriterin e pikës 2.2.3 të DST (faqja 9 e Projekt Raportit)

BOE fitues nuk përmbush kriterin e pikës 2.2.3 të DST, vërtetim që ka plotësuar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore lëshuar nga Pushteti Vendor për vitin 2022, kudo ku operatori ushtron aktivitet, sipas regjistrimit në QKB.

OE I. shpk ka paraqitur si punë të ngjashme punë të realizuara në Bashkitë Selenicë, Patos, Tiranë, Elbasan dhe Vlorë të cilat nuk i ka të pasqyruara në QKB si dhe nuk ka paraqitur vërtetim për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore, lëshuar nga Pushteti Vendor për vitin 2022.

OE M. shpk ka kryer punime në qytetet Konispol, Sarandë, Tiranë, Dropull, Gjirokastrë, Himarë të cilat nuk i ka pasqyruar në QKB dhe në Open Data të APP punimet e vitit 2022 si dhe nuk ka paraqitur vërtetim për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore, lëshuar nga Pushteti Vendor për vitin 2022.

Sqarim:

Ashtu sikurse është e shkruar në kriterin e vendosur në DST “Vërtetim për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2022, kudo ku operatori ushtron aktivitet, sipas regjistrimit në QKB”

Për të 3 operatorët në bashkëpunim M. shpk, M. shpk, I. shpk është bërë verifikimi i taksave dhe tarifave vendore për të gjitha bashkitë ku operatori kishte deklaruar në QKB, ashtu si dhe është kërkuar në DST dhe BOE e plotësojnë këtë kriter.

Për punimet e mësipërme të shtrira në disa qytete ashtu si dhe ju shpreheni që operatori nuk i ka të pasqyruara në QKB dhe as në Open Data të APP për vitin 2022, KVO nuk i ka verifikuar pasi në kriterin e DST-së shprehet qartë taksat dhe tarifa vendore kudo ku operatori ushtron aktivitet sipas QKB, në DST nuk është kërkuar një pikë e tillë si dhe nuk kemi patur udhëzime nga APP apo ndonjë autoritet tjetër për të verifikuar taksat në këtë mënyrë.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Së pari observacioni juaj nuk mund të merret në konsideratë pasi pretendimet tuaja nuk gjejnë mbështetje ligjore dhe nuk janë paraqitur prova apo dokumentacion shtesë në mbështetje të pretendimeve.

Së dyti grupi i auditimit i është referuar procesverbalit të argumentimit të kriterëve, referuar procesverbalit të hartuar nga nr. 2840/4, datë 17.11.2022 Ing. A.M dhe miratuar nga Njesia e prokurimit e cila nuk i ka të ndara detyrat dhe përgjegjesit.

Së treti nuk vërehen pretendime, prova, fakte apo referenca ligjore të reja, nga ato çka janë përmendur në dokumentat e paraqitura nga Bashkia Patos, gjatë fazës së auditimit në terren ose sipas konstatimeve

*Së katërti referuar vlerësimit të ofertave KVO nuk ka paraqitur dokumenta shtesë po thjeshtë ka bërë analize. Sa më sipër trajtuar, ju nuk keni sjellë argumente që vërtetojnë të kundërtën e konstatimit të grupit të auditimit dhe, në këto kushte observacioni **nuk merret në konsideratë.***

2. Të dhëna mbi objektin e prokurimit: “Rikonstruksion i Çerdhes Patos me hapësirat përreth”.

a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Rikonstruksion i Çerdhes Patos me hapësirat përreth”.			
1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit Procedurë e Hapur REF-41416-09-13-2022 Urdhri nr. 19 prot., datë 02.09.2023	Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe fondit limit Preventivuan: Ing. S.M. Ing. A.M. Nr. 2104 prot., datë 31.08.2022.	2 Njësia e Prokurimit 1. D.K. Jurist 2. Ing. A.M. Specilist fushe inxhinier ndërtimi 3. M.N. Jurist	3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhri nr. 2104/4 prot., datë 13.09.2023 1. A.P. 2. SH.B. 3. I.SH. Urdhri për zv. nr.2104/10 prot datë 27/09/2023 1. A.P. 2. SH.B. 3. J.SH. Urdhri për zv. nr.2104/11 prot datë 27/09/2023 1. SH.B. 2. J.SH. 3. B.M.
4. Fondi Limit (pa tvsh) 13,735,075 lekë	5. Oferta fituese, vlera fituese: Operatori Fitues: S. Shpk 12,730,000 lekë pa tvsh.	6. Diferenca me fondin limit 1,005,075 lekë pa tvsh	
7/1 Data e hapjes së tenderit: Data	8. Burimi Financimit Të ardhura Lokale 2022	9. Operoret Ekonomike a)Pjesëmarrës në tender, 7 OE b) S’kualifikuar 6 OE V. OE A. B.O.E. N. dhe SH. OE E. OE I. OE Z. c) Kualifikuar 1 OE S Shpk	
7/2 Kohëzgjatja e kontratës: 5 (pesë) muaj nga nënshkrimi i kontratës			
10.Ankimime AK-s’ka APP-s’ka KPP-ka	11. Data e lidhjes së kontratës: Nr. 2104/20 prot., datë 19.01.2023	12.Përgjigje Ankesës nga APP, AK apo KKP: AK Vendim i KPP-se me Nr.1186/2022 me Nr.2455/4prot datë 01/12/2022 Protokolluar pranë Bashkisë Patos me nr 2804/7 prot datë 07.12.2022.	

- AK në lidhje me “Hartimin e Specifikimeve Teknike” dhe “Përlllogaritjen e Fondit Limit” :

-Nga dokumentacioni pjesë e dosjes së prokurimit, konstatohet se, nga DR. e hartimit të projekteve, monitorimit të investimeve dhe shërbimeve është dorëzuar projekti “ **Rikonstruksion i Çerdhes Patos me hapësirat përreth** ” dhe preventivi është hartuar nga Ing. S.T. dhe miratuar nga Ing. A.M.

Sipas preventivit të dorëzuar në projekt, konstatohet se komisioni (preventivuesit) për përlllogaritjen e fondit limit ka përdorur mënyrën e “cmimeve të manulit teknik”, pasi janë përgatitur specifikimet teknike në lidhje me objektin e prokurimit, e cila rezulton të jetë 13,735,075 lekë pa tvsh.

Nga ana e titullarit të AK-së, në zbatim të LPP-së, në projektin e objektit nr 2104 prot., datë 31.08.2022 janë hatuar edhe specifikimet teknike të objektit, nga Ing. A.M. me profesion inxhinier ndërtimi i cili është specialist i fushës. dhe S.T (M).

Auteriteti kontraktor dhe Njësia e prokurimit në hartimin e DST me Objekt "Rikonstruksion i Çerdhes Patos me hapësirat përreth" për pajisjet dhe grup pajisjet sipas tabelës se me poshtme u konstatua se nuk janë vendosur specifikimet teknike, "Treguesit kryesor teknik sipas pasaportës teknike", duke krijuar mundësin e spekulimit të OE-së pjesmarës në garë për të vendosur instaluar pajisje me tregues teknik me të ulët, duke mos garantuar funksionimin me efektivitet dhe eficensë të sistemit të ngrohjes dhe jo vetëm.

Tabela e zërave për të cilët nuk janë vendosur specifikimet teknike

A-PUNIME MNZ				
Nr.	Nr.Analiz	EMERTIMI PUNIMEVE	NJESIA	SASIA
5	An	F.V Grupi i pompimit të ujit për hidrantet e zjarrit. Karakteristikat Teknike: -Prurja----- m3/h -Prevalenca mk H2O -Lidhjet Ø ----- " PN 10 -Fuqia elektrike ----- kË 3-400v /50Hz	kompl	1.00
1	An	F.V Grupi i pompimit të ujit Karakteristikat Teknike: -Prurja----- m3/h -Prevalenca H2O -Lidhjet Ø 2 1/2" PN 10 -Fuqia elektrike 2.2kË 200-240v /50Hz	kompl	1.00
6	An	F.V Kaldaje çeliku me gaz (e kompletuar me aksesore dhe instrumentakontrolli të ndryshëm) Karakteristikat Teknike: -Fuqia termike ----- Kë -dimensionet e tubave dergim kthim Ø 2 1/2" -diametri i oxhakut të tymit Ø----- -kapaciteti i ujit 1	cope	1.00
7	An	F.V Brucator Kaldaje Karakteristikat Teknike: -Fuqia termike ----- Kë -me dy stade -prurja ----- kg/h -lenda djegese gas	cope	1.00
8	An	F.V Ena e zgjerimit. Karakteristikat Teknike: Kapacitet ----- 1 Diameter Ø----- Lartesia ----- mm Lidhjet 3/4"	cope	1.00
9	An	F.V Pompe riqarkullimi.kt 0 Prurja----- m3/h Prevalenca mk H2O Lidhjet DN40/PN 10 elektrike 0.37kË - 3-400v /50Hz	cope	1.00
10	An	F.V Pompe riqarkullimi.kt 1 Prurja----- m3/h Prevalenca mk H2O Lidhjet DN40/PN 10 elektrike 0.3kË -3-400v /50Hz	cope	1.00
11	An	F.V Pompe riqarkullimi.kaldaj-ndares hidraulikKarakteristikat Teknike: Prurja m3/h Prevalenca 5mk H2O Lidhjet DN50/PN 16 -Fuqia elektrike 0.75kË -3-400v /50Hz	cope	1.00
12	An	F.V Pompa e kondesës se kaldajesKarakteristikat Teknike: Prurja ----m3/h 1mk H2O Lidhjet Ø 2 / PN 10	cope	1.00
13	An	F.V Rezervuar gasi.Deposite horizontale dopio paretKarakteristikat Teknike: Kapaciteti 1 Diametri D= mm Lartesia H= mm Gjatesia L mm	cope	1.00

Sa më sipër nuk përmbushin parashikimet e dispozitave ligjore të zbatueshme për prokurimin publik sipas nenit 7 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, dhe

pikës 4 të nenit 39 të VKM me nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Sa më sipër mban përgjegjësi njësia e prokurimit me përbërje z. A.M. dhe znj. S.T (M).

- Në lidhje me “Argumentimin dhe Hartimin e Kritereve”:

Kërkesat e veçanta të kualifikimit janë hartuar nga Ing. A.M. në cilësinë e specialistit të fushës me shkresën me nr 2104/2 prot., datë 13/09/2023, dhe njësia e prokurimit të cilat janë evidentuar në procesverbalin e argumentimit të datës 13.09.2022. dhe ndryshuar sipas shtojcës nr. **2014/8 datë 21.09.2022 si më poshtë:**

Mbi ndryshimin e dokumentave standarte të tenderit

Autoriteti Kontraktor, Bashkia Patos, bazuar në rekomandimet e bëra nga Agjensia e Prokurimit Publik, vendosi që të bëjë ndryshime në dokumentat standarte të tenderit me objekt: **“Rikonstruksion i Çerdhes Patos me hapësirat përreth”**, me fond limit 13,735,075 lekë pa t.v.sh sipas stocjes nr. **2014/8 datë 21.09.2022 .**

b-Në lidhje me zhvillimin e procedurës dhe vlerësimin e ofertave nga KVO.

Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 7 OE, për të cilët, referuar procesverbalit nr. 2804/10, të datës 07.12.2022, KVO-ja ka kryer në SPE vlerësimin dhe klasifikimin përkatës si më poshtë:

Nr	Operatori ekonomi	Oferta lekë pa Tvsh	Kualifikuar/S’kualifikuar
1	S.	12,730,000	Kualifikuar
2	V.	11,237,803.7	S’kualifikuar; Në pikën 2.3.1 tek kriteret e vecanta të kualifikimit mungon dhe akt kolaudimi dhe kontrata e sipërmarrje së objektit.
3	A.	11,411,313.86	S’kualifikuar; Referuar formularit të ofertës ku ju deklaroni vlerën 11,411,313.86 pa tvsh dhe vlerën 13,273,176.63 me tvsh, nga kontrolli i bërë nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave rezulton shuma 11,654,313.86 lekë pa tvsh dhe vlera 13,516,176.63 leke me tvsh, ku diferenca midis tyre është në vlerë më të madhe se 2%.
4	B.O.E. N. dhe SH.	11,472,138.3	S’kualifikuar; Në pikën 2.3.7 tek kriteret e vecanta të kualifikimit ju nuk dispononi referencë për pajisjet që keni në pronësi. (Ngraçan) Në pikën 2.3.7 tek kriteret e veçanta të kualifikimit ju nuk dispononi referencë për pajisjet që keni në pronësi. (SH)
5	E.	12,620,715.2	S’kualifikuar; Nuk plotësoni pikën 2.3.1 (pika d) te Kriteret e vecanta të kualifikimit, ku operatori duhet të sjellë një dëshmi të përvojës së mëparshme;
6	I.	12,896,737.72	S’kualifikuar; Ne piken 2.3.7 tek kriteret e veçanta të kualifikimit ju nuk dispononi pajisjet e mëposhtme si: 2 pompe uje, 2 vibrator betoni, 2 trapano elektrik Me Autoritetin Kontraktor Bashkia Patos ju keni lidhur kontratën e sipërmarrjes me objekt “Përmirësimi i banesave dhe familjeve në nevojë”, në të cilin keni të angazhuar fuqinë punëtore si më poshtë: F.K – Teknik Ndërtimi L.P – Karpentier, nga 2 karpentierqe kerkohen ne DST D.S - Pllakashtrues nga 2 pllakashtrues qe kerkohen ne DST S.K - Hidroizolues T.L – Suvatues E.LL – Punëtor i thjeshtë E.D - Elekracist B.L – Hidraulik

			N.L, B.C– Bojaxhinj I.Z, A.R – Shoferë A.B, A.S, G.G – manovradorë Po ashtu mjete me targe AA027CB, lloji kamioncine janë të angazhuar në kontratën e sipërmarrjes “Përmirësimi i banesave sociale dhe familjet në nevojë”
7	Z.	13,219,546.96	S’kualifikuar; Në pikën 2.3.3 tek kriteret e veçanta të kualifikimit, ju nuk keni asnjë inxhinier hidroteknik të deklaruar në formularin e vetëdeklarimit.

c- Në lidhje me procedurën shqyrtimit të ankimeve.

Në lidhje me klasifikimin dhe vlerësimin e OE për procedurën e sipërcituar, ndër të tjera, rezulton se është paraqitur 1 ankesa nga OE, duke kundërshtuar skualifikimin dhe pretendimet e AK.

Titullari i AK, përkatësisht për ankesën e OE S. shpk nr. 2804, datë 09.11.2022, ka marrë vendimin (urdhër) nr. 2084/1 prot., datë 09.11.2022 me të cilin ka vendosur pezullimin e vazhdimit të procedurës dhe caktimin e një Komisioni për Shqyrtimin e Ankesës të përbërë nga tre anëtarë me shkresën me nr. 2084/2 prot., datë 09.12.2022. Brenda afateve ligjore u shqyrtua ankesa e paraqitur nga OE ankimues S. shpk.

Më datë 15/11/2022 K.SH.A jep vendim mbi ankesën e operatorit ekonomik nr.2804/3 prot, datë 15/11/2022 dhe Vendimi i titullarit të AK-së nr. 2804/4 prot, datë 15/11/2022. Më datë 15/11/2022 kthim përgjigje operatorit ankimues nr. 2804/5 prot, datë 15/11/2022 si dhe vënie në dijeni KPP rreth vendimit të shqyrtimit të ankesës nr. 2804/6 prot, datë 15/11/2022.

Me shkesën rotokolluar pranë bashkisë patos me nr 2804/7 prot., datë 07.12.2022. KPP dërgon vendimin nr.2455/5 prot., datë 01/12/2022 ku pranon ankesën e OE “S” . AK vijon mr urdhër për zbatimin e vendimit nr.2804/8prot datë 07/12/2022 ku hapet faza e rivlerësimit bazuar në vendimin e KPP-së dhe nga K.V.O. mbahet procesverbal i rivlerësimit nr.2804/10 prot., datë 07/12/2022, hapa të cilat i bëhen të ditur KPP-së me shkresën 2804/13 datë 09.12.2022 me objekt dërgim zbatim vendimi nr 1186/2022.

KPP me vendimin nr. 1254/2022 protokolluar pranë bashkisë Patos me nr. 2804/14 prot., datë 20.12.2022 lejon AK të vijojë me hapat pasardhës të procedurës.

Më datë 21/12/2022 Titullari i AK-së nxjerr urdhër për heqje nga pezullimi nr.2804/15 prot., datë 21/12/2022 dhe vijon me hapat e zhvillimit të mëtejshëm të procedurës.

Nga KVO është mbajtur Raporti përmbledhës nr. 2104/19 më datë 06.01.2023, në të cilin është përshkruar e gjithë procedura e ndjekur deri në shpalljen e fituesit. Sipas këtij Raporti përmbledhës dhe formularit të njoftimit të fituesit, nga 7 operatorë pjesëmarrës janë s’kualifikuar 6 OE, janë kualifikuar 1 OE. Në përfundim, mbi bazën e Raportit përmbledhës, Titullari i AK më datë 06.01.2023 ka shpallur fituese ofertën e shoqërisë “S” shpk për të cilën është lidhur kontrata datë 19.01.2023 për vlerën 12,730,000 lekë pa TVSH dhe vlera **14,965,000** lekë me TVSH, dhe me afat 5 (pesë) muaj nga nënshkrimi i kontratës nga data e lidhjes së kontratës.

Konkluzion: Arrihet në përfundimin se ky operator i plotëson të gjitha kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të vendosura në DST dhe vendimi i KPP nr. 1186/2022 për shpalljen fitues të këtij operatori është i drejtë.

Në observacionin e subjektit të audituar Bashkia Patos mbi projekt raportit e auditimit përcjell me shkresën nr. 30/6 prot., datë 08.04.2024, janë dërguar observacione nga Bashkia Patos me shkresën nr. 67/43 prot., datë 10.05.2024 dhe protokolluar në KLSH me shkresën nr. 30/8 prot., datë 14.05.2024, shprehur si më poshtë vijon:

Pretendimet e subjektit:

Në lidhje me konstatimet tuaja mbi objektin e prokurimit " Rikonstrukcion i Çerdhes Patos me hapësirat përreth " ju sqarojmë se:

Përsa i përket konstatimit lidhur me pikën 2.3.2 të kapacitetit teknik në DST ju sqarojmë nevojshmërinë e këtij kriteri për pikën NS-1-A të licencës që kemi kontratuar, ju sqarojmë:

*Në nenin 36, pika 4, të LPP parashikohet se: " Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë **markë** tregtare, patentë, tipi ose **originë** apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni.*

Në këtë rast kemi përcaktuar:

Fuqinë e kaldajës e cila është përcaktuar "3 KË-400v/50Hz",

fuqinë elektrike të grupit të pompimit të ujit "2.2KË-200-240V/50Hz",

diametrin e tubave të dërgimit (2 ½") e cila do të lidhet me kasetën e furnizimit dhe kthimit të ujit të ngrohtë, llojin e lëndës që do të përdoret për shkëmbimin e nxehtësisë në rastin konkret H2O,

presionin e pompës PN10 (presioni nominal 10 atmosferë),

stadin e "Brucatorit të kaldajës",

fuqinë e pompës së qarkullimit "0.37KË, 3faza-400V/50Hz,

lidhjet e kësaj pompe qarkullimi "DN 40/ PN 10" (diametri nominal 40 mm dhe presioni nominal 10 Atmosferë),

fuqinë e pompës së riqarkullimit "0.75 KË, 3-400 V/50 Hz"(fuqia elektrike e kësaj pompe riqarkullimi është 0.75 KË, 3fazore , tensioni 400 Volt dhe frekuenca e energjisë elektrike 50 Hz).

Prodhues të ndryshëm kanë pompa me parametra të ndryshme por që kryejnë të njëjtin funksion për ngrohjen e një ambienti të caktuar. Përcaktimi i parametrave shtesë do të sillte përcaktimin e një pompe të caktuar dhe do të binte ndesh me nenin 36, pika 4 të LPP.

Gjithashtu në kërkesat e vecanta që një OE duhet të plotësojë, është përcaktuar qartë se pas përfundimit të punimeve do të bëhen provat me ngarkesë dhe pa ngarkesë të të gjitha pajisjeve dhe sistemeve të vendosura në objekt.

Provat me ngarkesë dhe pa ngarkesë të sistemeve (si psh furnizimi me ujë, kanalizimi, rrjeti elektrik, alarmi i zjarrit etj) dhe pajisjeve (si psh kaladaja, kondicioneret, sistemi chiller, sistemi i fikjes së zjarrit etj) janë të përcaktuara në VKM- në nr. 610, datë 22.9.2022, "Për përcaktimin e rregullave të detajuara për mënyrën e caktimit të mbikëqyrësit, detyrat dhe përgjegjësitë e tij, kushtet dhe elementët e përgjithshme të sigurimit të përgjegjësisë profesionale, si dhe rregullat, procedurat dhe mënyrën e mbajtjes së dokumentacionit gjatë zhvillimit të punimeve".

Gjithashtu për këtë procedurë prokurimi nuk ka pasur rekomandim nga APP për këtë licencë.

Oëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Së pari observacioni juaj nuk mund të merret në konsideratë pasi pretendimet tuaja nuk gjejnë mbështetje ligjore dhe nuk janë paraqitur prova apo dokumentacion shtesë në mbështetje të pretendimeve.

Së dyti grupi i auditimit i është referuar procesverbalit të argumentimit të kriterëve, referuar procesverbalit të hartuara nga nr. 2104 prot., datë 31.08.2022 Ing. A.M. dhe miratuar nga Njesia e prokurimit e cila nuk i ka të ndara detyrat dhe përgjegjësit.

Së treti nuk vërehen pretendime, prova, fakte apo referenca ligjore të reja, nga ato çka janë përmendur në dokumentat e paraqitura nga Bashkia Patos, gjatë fazës së auditimit në terren ose sipas konstatimeve

*Së katërti referuar vlerësimit të ofertave KVO nuk ka paraqitur dokumenta shtesë po thjeshtë ka bërë analize. Sa më sipër trajtuar, ju nuk keni sjellë argumente që vërtetojnë të kundërtën e konstatimit të grupit të auditimit dhe, në këto kushte observacioni **nuk merret në konsideratë.***

3. Rikonstrukcion i rrugës Industriale, kryqëzimi ku bashkohet me rrugën “Franc Nopce”.

a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Rikonstrukcion i rrugës Industriale ,kryqëzimi ku bashkohet me rrugën “Franc Nopce”.			
1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit “E Hapur e thjeshtuar” REF-58016-02-06-2023 Urdhri Nr.2968/2 prot., datë 31.01.2023 nr. 03	1.1 Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe fondit limit nr. 2968/4 prot., datë 06/02/2023. 1. Ing. A.M Preventivuar: Ing. S.M Ing. A.M	2 Njësia e Prokurimit 1. D.K 2.Ing. A.M 3. F.K	3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhri nr. 2968/3 prot., datë 06.02.2023. 1. A.P 2. SH.B 3. A.K Urdhr për zëvendësimin e komisionit të ofertave Nr.2968/16 prot datë 27/04/2023 1.A.P 2. SH.B 3. B.M
4. Fondi Limit (pa tvsh) 10,322,909 lekë	5. Oferta fituese, vlera fituese: Operatori Fitues: OE K 7,186,750 lekë pa tvsh.		6. Diferenca me fondin limit 3,136,159 lekë pa tvsh
7/1 Data e hapjes së tenderit: Data 17.12.2023 ora 11:00	8. Burimi Financimit Vetëfinancim.	9. Operoret Ekonomike b) S’kualifikuar 4 B/OE, OE SH OE C OE L OE A c) Kualifikuar 5 B/OE OE K OE N BOE N dhe OE B OE E shpk OE R	
7/2 Kohëzgjatja e kontratës: 3 (tre) muaj nga nënshkrimi i kontratës.			
10.Ankimime AK-s’ka APP-s’ka KPP-s’ka	11. Data e lidhjes të kontratës: Nr. 2968/19prot datë 08/05/2023.	12.Përgjigje Ankesës nga APP, AK apo KKP: AK NUK KA	

a-AK në lidhje me “Hartimin e Specifikimeve Teknike” dhe “Përlllogaritjen e Fondit Limit” :

Nga dokumentacioni pjesë e dosjes së prokurimit, konstatohet se, se nga Drejtoria e hartimit të projekteve, monitorimit të investimeve dhe shërbimeve është dorëzuar projekti **“Rikonstrukcion i rrugës Industriale, kryqëzimi ku bashkohet me rrugën “Franc Nopce”** dhe preventivi është hartuar nga Ing. S.T dhe miratuar nga Ing. A.M.

Sipas preventivit të dorëzuar në projekt, konstatohet se komisioni (preventivuesit) për përlllogaritjen e fondit limit ka përdorur mënyrën e “çmimeve të manulit teknik”, pasi janë përgatitur specifikimet teknike në lidhje me objektin e prokurimit, e cila rezulton të jetë **10,322,909** lekë pa tvsh.

Nga ana e titullari i AK-së, në zbatim të LPP-së, në projektin e objektit nr 2968 prot., datë 01.12.2022 janë hatuar edhe specifikimet teknike të objektit, nga Ing. A.M. me profesion inxhinier ndërtimi i cili është është specialist i fushës dhe S.M. në përputhje me manualin.

- Në lidhje me “Argumentimin dhe Hartimin e Kritereve”:

Kërkesat e veçanta të kualifikimit janë hartuar nga Ing. A.M. në cilësinë e specialistit të fushës, me shkresën nr. 2968/4 prot., datë 06/02/2023 të të cilat janë evidentuar në procesverbalin e argumentimit të datës 06.02.2023. Në lidhje me kriteret e vendosura, u konstatuan kriteret të paargumentuara. Në mënyrë të detajuar kriteret e konstatuara si të paargumentuara paraqiten si vijon:

Kërkesat e pikës 2.3.6. e DST e cila kërkon që operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej **minimalisht 26 (njetetë e gjashtë) persona**. Referuar kategorisë së punimeve si dhe afatit, stafi i kërkuar duhet te jete:

Teknike ndërtimi 1 (nje); Karpentiere 2 (dy); Pllaka Shtrues 3 (tre); Specialist shtresash rrugore 1 (një); Puntore te thjeshte 9 (nëntë); Shofere 3 (tre); Manovratore 3 (tre); Drejtues Teknik 2 (dy); Hidraulik 2 (dy).

Kriteri për stafin mbështetës dhe për punonjësit e kërkuar nuk është i argumentuar teknikisht dhe ligjërish referuar procesverbalin të argumentimit nr. 2968/4 prot datës 06.02.2023, në kundërshtim me parashikimet e dispozitave ligjore të zbatueshme për prokurimin publik sipas nenit 7 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe pikës 4 të nenit 39 të VKM me nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar i cili përcakton se:

“Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës”.

Kërkesat e pikës 2.3.7. e DST e cila kërkon që operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, Kamion me aftesi mbajtese mbi/ose 10 ton cope 2 (dy); Kamiocine me aftësi mbajtese deri ne 3 ton cope 1 (nje); Kamion me vinc cope 1 (nje); Ekskavator me zinxhire 0.5 m3 cope 1 (nje); Rul cope 1 (nje); Betoniere cope 2 (dy); Autobitumatrice cope 1 (nje); Asfalto shtruese cope 1 (nje); Mini Fadrome cope 1 (nje).

- Në procesverbalin e datës 06.02.2023 nuk argumentohet numri i mjeteve të kërkuar në pikën 2.3.7. DST, pasi mungon dokumenti mbi përlllogaritja dhe analiza e mjeteve për realizimin e investimit në përputhje me preventivin dhe grafikun e punimeve në kundërshtim me pikën 4, të Neni të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe Kreut V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, germa ”d” të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Kërkesat e pikës 2.3.8 e DST e cila kërkon që Mbështetur në:

Ligj Nr. 9010, date 13.02.2003 Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta, Ndryshuar me Ligjin Nr 10137, date 11.05.2009 PER DISA NDRYSHIME NE LEGJISLACIONIN NE FUQI PER LICENCAT, AUTORIZIMET DHE LEJET NE REPUBLIKEN E SHQIPERISE

Kreu II Neni 9 Detyrime të krijuesit të mbetjeve

Neni 12 Përpunimi dhe asgjësimi i mbetjeve të ndertimit

Neni 24/1

Neni 25 Lejet mjedisore

Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me licensën profesionale nga Qendra Kombëtare e Liçensimit (QKL) Kodi III.2.B.

Këto kërkesa për licenca nuk janë të argumentuara teknikisht dhe ligjërish në lidhje dhe në funksion të objektit të kontratës. Nuk është e nevojshme licenca e mësipërme, pasi shërbimin e grumbullimit të mbetjeve e ofron Bashkia Patos referuar paketës fiskale si dhe për subjektet që kryejnë punime ndërtimit aplikon tarifën ndotjes, shërbimit, për kohëzgjatjen e kantierit të ndërtimit.

Sa më sipër, nuk përmbushin parashikimet e dispozitave ligjore të zbatueshme për prokurimin publik sipas nenit 7 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe pikës 4 të nenit 39 të VKM me nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Sa më sipër mban përgjegjësi njësia e prokurimit me përbërje znj. D.K, z. A.M.

b-Në lidhje me zhvillimin e procedurës dhe vlerësimin e ofertave nga KVO.

Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 9 OE, për të cilët, referuar procesverbalit nr. 2968/18, të datës 03.05.2023, KVO-ja ka kryer në SPE vlerësimin dhe klasifikimin përkatës si më poshtë:

Nr	Operatori ekonomi	Oferta lekë pa Tvsh	Kualifikuar/S'kualifikuar
1	OE K.M.K	7,186,750	Kualifikuar
2	N	7,457,950	Kualifikuar
3	L	7,820,950	S'KUALIFIKUAR Shoqëria «L» shpk me NIPT K...H ka mangësi në dokumentacion si më poshtë: Nuk plotëson pikën 2.2.2 Bilancet vjetore për vitet 2020, 2021. Në sistem mungon bilanci vjetor për vitin 2021
4	A	7,825,200	S'KUALIFIKUAR Shoqëria «A » shpk me NIPT K...C ka mangësi në dokumentacion si më poshtë: Nuk plotëson pikën 2.3.5 Punonjës të specializuar/ të kualifikuar. Mungon 1 ing. ndërtimi, 2 manovrator pasi punonjësit e deklaruar S.H (ing ndërtimi), GJ.SH, K.C, me profesion manovrator, jane te angazhuar tek procedura e “Rikonstruksioni i ish Kopështit Verbas në qendër ambulatorë”, Bashkia Patos, i cili eshte ne proces pune.
5	BOE N B	8,078,300	Kualifikuar
6	E shpk	8,333,340	Kualifikuar
7	SH	9,294,900	S'KUALIFIKUAR Shoqëria «SH » shpk me NIPT K...N ka mangësi në dokumentacion si më poshtë: Nuk plotëson pikën 2.3.5 Punonjës të specializuar/ të kualifikuar Mungon 1 ing. ndërtimi, 1 ing.mekanik, 1 ing. gjeodet, 1 pllakashtrues, 1 hidraulik, 1 punëtor i thjeshtë, 2 manovrator dhe 3 shofer pasi V.T (Inxhinier ndërtimi), J.K (inxhinier mekanik) , E.S (inxhinier gjeodet), H.P (Plakashtrues dhe punëtor i thjeshte), A.A (hidraulik), Y.RR (puntor I thjeshte), A.O (manovrator), A.B (manovrator), P.B (shofer), P.B (Shofer) janë të angazhuar tek procedura “Rikonstruksion i shkolles Muhamet Shehu dhe ndërtim i palestrës”, Bashkia Patos.
8	R	9,476,223	Kualifikuar
9	C »	9,507,150	S'KUALIFIKUAR Shoqëria «C » shpk me NIPT J...E ka mangësi në dokumentacion si më poshtë: Nuk plotëson pikën 2.3.5 Punonjës të specializuar/ të kualifikuar Nuk ka asnjë pllakashtrues te deklaruar ne shtojce.

Nga KVO është mbajtur Raporti përmbledhës Nr. 2968/18 prot., datë 03.05.2023, në të cilin është përshkruar e gjithë procedura e ndjekur deri në shpalljen e fituesit. Sipas këtij Raporti përmbledhës dhe formularit të njoftimit të fituesit, nga 9operatorë pjesëmarrës janë s'kualifikuar 4 OE, janë kualifikuar 5 OE. Në përfundim, mbi bazën e Raportit përmbledhës, Titullari i AK Nr. 2968/18 prot., datë 03.05.2023 ka shpallur fituese **OE K.M.K.” ShPK** për të cilën është lidhur kontrata datë **Nr. 2968/19 prot., datë 08/05/2023** për vlerën 7,186,750 lekë pa TVSH dhe **8,624,100 lekë me TVSH** , dhe me afat 3 (tre) muaj/deri nga data e lidhjes së kontratës.

c- Në lidhje me procedurën shqyrtimit të ankimeve. (Nuk ka patur ankime)

Në lidhje me klasifikimin dhe vlerësimin e OE-së për procedurën e sipërcituar, ndër të tjera, rezulton se nuk janë paraqitur ankesa nga OE, duke kundërshtuar skualifikimin dhe pretendimet e AK.

Konkluzion: Arrihet në përfundimin se ky operator i plotëson të gjitha kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të vendosura në DST dhe vendimi i KVO për shpalljen fitues të këtij operatori është i drejtë.

Në observacionin e subjektit të audituar Bashkia Patos mbi projekt raportit e auditimit përcjell me shkresën nr. 30/6 prot., datë 08.04.2024, janë dërguar observacione nga Bashkia Patos me shkresën nr. 67/43 prot., datë 10.05.2024 dhe protokolluar në KLSH me shkresën nr. 30/8 prot., datë 14.05.2024, shprehur si më poshtë vijon:

Pretendimet e subjektit:

Në lidhje me konstatimet tuaja mbi objektin e prokurimit” Rikonstruksion i Rrugës Idustriale, kryqëzimi ku bashkohet me rrugën “Franc Nopce” ju sqarojmë se:

Përsa i përket konstatimit tuaj rreth pikës 2.3.8. të kapacitetit teknik në DST e cila kërkon që mbështetur në kuadrin ligjor në fuqi operatori duhet të jetë i pajisur me licencën profesionale nga QKL Kodi III.2.B ju sqarojmë:

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 44, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Në bazë të legjislacionit shqiptar, cdo operator ekonomik që ushtron veprimtari në një territor të caktuar, duhet të hapë edhe një seli, NIPT sekondar si dhe të ushtroj aktivitetin e plotë si subjekt ekonomik. Mbështetur në ligjin për lejet e mjedisit si dhe VKM nr. 419, datë 25.06.2014 “ Mbi procedurat e pajisjes me leje mjedisi për ushtrimin e aktivitetit” , Subjekti që do të kryejë punimet, klasifikohet në operator që gjeneron mbetje urbane në atë njësi administrative ku do të kryejë punime. Për rrjedhojë , cdo subjekt duhet të jetë i pajisur me lejen përkatëse të mjedisit , ku detyrimisht përcaktohen format, detyrat dhe metodat e trajtimit të mbetjeve të gjeneruara, si dhe metodat e trajtimit dhe rekuperimit të ndërhyrjeve. Në këtë rast bashkia është bashkëpunëtori që bën të mundur trajtimin me efikasitet të mbetjeve, por theksojmë se , nga pikëpamja ligjore, është operatori, ai që bën gjenerimin e mbetjeve dhe për rrjedhojë ka edhe detyrimin ligjor të trajtojë këto mbetje. Gjithashtu kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 44 të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Sa më sipër kriteret teknike janë vendosur në mbështetje të pikës 1 të nenit 77 të LPP dhe pikës 4 të nenit 39 të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021 “Për rregullat e prokurimit publik”. Gjithashtu për këtë procedurë prokurimi nuk ka pasur rekomandim nga APP për këtë licensë.*

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Së pari observacioni juaj nuk mund të merret në konsideratë pasi pretendimet tuaja nuk gjejnë mbështetje ligjore dhe nuk janë paraqitur prova apo dokumentacion shtesë në mbështetje të pretendimeve.

4. “Rikonstruksion i rrugës Ish-Thertorja, Lagjja“29 Marsi”

a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Rikonstruksion i rrugës Ish-Thertorja,Lagjja“29 Marsi”			
1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit “E Hapur e thjeshtuar” REF-58261-02-07-2023 Urdhri Nr. 2967/2 prot., datë 31.01.2023 Nr.2 dt 31/01/2023	1.1 Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe fondit limit nr. 2967/4 prot., datë 07/02/2023. Ing. A.M Preventivuar: Ing. A.M	2 Njësia e Prokurimit 1. D.K 2.Ing. A.M 3. F.K	3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhri nr. 2967/3 prot., datë 07.02.2023. 1. A.P 2. SH.B 3. N.H
4. Fondi Limit (pa tvsh) 6,414,326 lekë	5. Oferta fituese, vlera fituese: Operatori Fitues: R 5,909,993 lekë pa tvsh.		6. Diferenca me fondin limit 504,332.41 lekë pa tvsh
7/1 Data e hapjes së tenderit: Data 27.22.2023 ora 11:00	8. Burimi Financimit Vetë financim.		9. Operatorët Ekonomikë 4 b) S’kualifikuar 3 B/OE, OE SH OE S OE A c) Kualifikuar 1 B/OE OE R
7/2 Kohëzgjatja e kontratës: 4 (katër) muaj nga nënshkrimi i kontratës			
10.Ankimime	11. Data e lidhjes të kontratës:	12.Përgjigje Ankesës nga	

AK-s'ka APP-s'ka KPP-s'ka	Nr. 2967/20 prot. datë 02/05/2023.	APP, AK apo KKP: AK NUK KA

a-Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.

AK në lidhje me “Hartimin e Specifikimeve Teknike” dhe “Përlllogaritjen e Fondit Limit” :

Nga dokumentacioni pjesë e dosjes së prokurimit, konstatohet se, nga DR. e hartimit të projekteve, monitorimit të investimeve dhe shërbimeve është dorëzuar projekti “**Rikonstruksion i rrugës Ish-Thertorja, Lagjja “29 Marsi”** dhe preventivi është hartuar nga Ing. S.T. dhe miratuar nga Ing. A.M.

Sipas preventivit të dorëzuar në projekt, konstatohet se komisioni (preventivuesit) për përlllogaritjen e fondit limit ka përdorur mënyrën e “cmimeve të manulit teknik”, pasi janë përgatitur specifikimet teknike në lidhje me objektin e prokurimit, e cila rezulton të jetë **6,414,326** lekë pa tvsh.

Nga ana e titullari i AK-së, në zbatim të LPP-së, në projektin e objektit nr 2967 prot., datë 01.12.2022 janë hatuar edhe specifikimet teknike të objektit, nga Ing. A.M. me profesion inxhinier ndërtimi i cili është është specialist i fushës.

Mbi ndryshimin e dokumentave standarte të tenderit

Autoriteti Kontraktor, Bashkia Patos, bazuar në rekomandimet e bëra nga Agjensia e Prokurimit Publik, vendosi që të bëjë ndryshime në dokumentat standarte të tenderit me objekt: “Rikonstruksion i rrugës Ish-Thertorja, Lagjja“29 Marsi”, me fond limit 6,414,326 lekë pa tvsh.

- Në lidhje me “Argumentimin dhe Hartimin e Kritereve”:

Kërkesat e veçanta të kualifikimit janë hartuar nga Ing. A.M. në cilësinë e specialistit të fushës, me shkresën nr. 2967/4 prot., datë 07/02/2023. Në lidhje me kriteret e vendosura, u konstatuar kriteret të paargumentuara. Në mënyrë të detajuar kriteret e konstatuara si të pa argumentuara paraqiten si vijon:

Kërkesat e pikës 2.3.2 e DST-së, e cila kërkon që operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, NS-1: Punime për prishjen e ndërtimeve. “Kategoria A”. -Referuar licensës profesionale NS- 1-A të projekt preventivit të punimeve, rezulton se: zërat e punimeve që nevojiten për realizimin e kontratës, nuk parashikohen në llojet e punimeve të përfshira në përkufizimin e kategorive të sipërcituara, sipas VKM nr. 42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”.

Vendosja e kërkesës për disponimin e kategorive të mësipërme, nuk i përmbahet përcaktimeve të pikës 4; të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar , Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Kërkesat e pikës 2.3.6. e DST-së, e cila kërkon që operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej **minimalisht 27 (njëzetë e shtatë) persona**. Referuar kategorise se punimeve si dhe afatit, stafi i kerkuar duhet te jete: Teknike ndertimi 1 (një); Karpentiere 2 (dy); Pllaka Shtrues 3 (tre); Specialist shtresash rrugore 1 (një); Puntore te thjeshte 9 (nëntë); Shofere 3 (tre); Manovratore 3 (tre); Hidraulik 2(dy); Drejtues Teknik 3 (tre)

Kriteri për stafin mbështetës dhe për punonjësit e kërkuar nuk është i argumentuar teknikisht dhe ligjërisht referuar procesverbalin të argumentimit nr. 2967/4 prot., datë 07/02/2023, në kundërshtim me parashikimet e dispozitave ligjore të zbatueshme për prokurimin publik sipas nenit 7 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe pikës 4 të nenit 39

të VKM-së me nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar i cili përcakton se:

“Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës”.

Kërkesat e pikës 2.3.7 e DST e cila kërkon që operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, Kamion me aftesi mbajtese mbi/ose 10 ton cope 2 (dy); Kamiocine me aftesi mbajtese deri ne 3 ton cope 1 (një); Kamion me vinç copë 1 (një); Ekskavator me zinxhire 0.5 m3 copë 1 (një); Rul copë 1 (nje); Betoniere cope 2 (dy); Autobitumatrice copë 1 (një); Asfalto shtruese cope 1 (nje); Mini Fadrome cope 1 (nje);

- Në procesverbalin e datës 07/02/2023 nuk argumentohet numri i mjeteve të kërkuar në pikën 2.3.7. DST, pasi mungon dokumenti mbi përlllogaritja dhe analiza e mjeteve për realizimin e investimit në përputhje me preventivin dhe grafikun e punimeve në kundërshtim me pikën 4, të Nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe Kreut V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, germa ”d” të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Kërkesat e pikës 2.3.8 e DST-së, e cila kërkon që, mbështetur në:

Ligj Nr. 9010, datë 13.02.2003 Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta, Ndryshuar me Ligjin Nr 10137, datë 11.05.2009 PËR DISA NDRYSHIME NË LEGJISLACIONIN NË FUQI PËR LICENCAT, AUTORIZIMET DHE LEJET NË REPUBLIKËN E SHQIPERISË

Kreu II Neni 9 Detyrime të krijuesit të mbetjeve

Neni 12 Përpunimi dhe asgjësimi i mbetjeve të ndërtimit

Neni 24/1

Neni 25 Lejet mjedisore

Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me licensën profesionale nga Qendra Kombëtare e Liçensimit (QKL) Kodi III.2.B.

Këto kërkesa për licenca nuk janë të argumentuara teknikisht dhe ligjrisht në lidhje dhe në funksion të objektit të kontratës. Nuk është e nevojshme licenca e mësipërme, pasi shërbimin e grumbullimit të mbetjeve e ofron Bashkia Patos referuar paketës fiskale si dhe për subjektet që kryejnë punime ndërtimit aplikon tarifën ndotjes, shërbimit, për kohëzgjatjen e kantierit të ndërtimit.

Sa më sipër nuk përmbushin parashikimet e dispozitave ligjore të zbatueshme për prokurimin publik sipas nenit 7 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe pikës 4 të nenit 39 të VKM me nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, **duke ngarkuar me përgjegjësi njësinë e prokurimit** .

b-Në lidhje me zhvillimin e procedurës dhe vlerësimin e ofertave nga KVO.

Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 4 OE, për të cilët, referuar procesverbalit nr. 2967/19, të datës 19.04.2023, KVO-ja ka kryer në SPE vlerësimin dhe klasifikimin përkatës si më poshtë:

Nr	Operatori ekonomi	Oferta lekë pa Tvsh	Kualifikuar/S’kualifikuar
1	S	5,358,775	S’KUALIFIKUAR Shoqëria «S» shpk me NIPT K...Ë ka mangësi në dokumentacion si më poshtë: Nuk plotësoni pikën 2.3.5. Punonjës të specializuar/të kualifikuar. Mungon 1 ing. ndërtimi, 2 karpentier, 1 pllakashtrues, 1 hidraulik, 1 manovrator, 1 shofer, 2 punëtor, pasi personat e deklaruar si K.SH ing. ndërtimi, A.M teknik ndërtimi, P.G karpentier, E.B karpentier, P.H pllakashtrues, V.S hidraulik, R.P manovrator, K.H shofer, S.Q punëtor, M.N punëtor, janë të angazhuar në kontratën “Rikonstruksioni i cerdhes Patos” e cila është në proces pune. Nuk plotësoni pikën 2.3.7 Mjete dhe pajisje teknike

			Mungon 1 kamion me vinc dhe njëkamion Man mbi 10 ton pasi mjeti Kamion me vinc me targ AB195ED dhe mjeti kamion Man mbi 10 ton me targ AA015ZX janë të angazhuar në kontratën “Rikonstruksioni i çerdhës Patos” e cila është në proces pune. <i>Në Shtojcën 8 deklarohet për punonjës dhe mjete të paangazhuara në asnjë kontratë tjetër.</i>
2	A	5,521,733.18	S’KUALIFIKUAR Shoqëria «A» shpk me NIPT K...C ka mangësi në dokumentacion si më poshtë: Nuk plotësoni pikën 2.3.5. Punonjës të specializuar/të kualifikuar. Mungon 1 ing. ndërtimi, 2 pllakashtrues, 1 hidraulik, 2 manovrator, 1 shofer, 3 punëtorë të thjeshtë pasi personat e deklaruar si: S.GJ ing. ndërtimi, K.GJ pllakashtrues, XH.XH pllakashtrues, R.F hidraulik, GJ.SH manovrator, K.C manovrator, F.R shofer, F.GJ punëtor, XH.K punëtor, XH.N punëtor, janë të angazhuar në kontratën “Rikonstruksioni i ish kopshtit Verbas në Qendër Ambulatore”, Bashkia Patos e cila është në proces pune. Nuk plotësoni pikën 2.3.7 Mjete dhe pajisje teknike Mungon 1 kamioncin me aftësi mbajtëse deri në 3 ton, pasi mjeti me targa AB549FJ I deklaruar nga ju është I angazhuar në kontratën “Rikonstruksioni i ish kopshtit Verbas në Qendër Ambulatore”, Bashkia Patos e cila është në proces pune. <i>Në Shtojcën 8 deklarohet për punonjës dhe mjete të paangazhuara në asnjë kontratë tjetër.</i>
3	SH	6,242,475	S’UALIFIKUAR Shoqëria «SH» shpk me NIPT K...N ka mangësi në dokumentacion si më poshtë: Nuk plotësoni pikën 2.3.5. Punonjës të specializuar/të kualifikuar. Mungon 1 ing. ndërtimi, 1 ing. gjeodet, 1 ing. hidro, 1 teknik ndërtimi, 2 karpentier, 1 pllakashtrues, 1 punëtor I thjeshtë, 2 manovrator pasi personat e deklaruar si: V.T ing. ndërtimi, E.S ing.gjeodet, A.G ing.hidro, A.R teknik ndërtimi, R.N karpentier, SH.L karpentier, H.P pllakashtrues, Y.RR punëtor, A.O manovrator, A.B manovrator, janë të angazhuar në kontratën “Rikonstruksioni i shkollës Mustafa Matohiti dhe ndërtim i palestrës” Bashkia Patos e cila është në proces pune. <i>Në Shtojcën 8 deklarohet për punonjës dhe mjete të paangazhuara në asnjë kontratë tjetër.</i>
4	R	5,909,993	Kualifikuar

Nga KVO është mbajtur Raporti përmbledhës nr. 2967/19, të datës 19.04.2023, në të cilin është përshkruar e gjithë procedura e ndjekur deri në shpalljen e fituesit. Sipas këtij Raporti përmbledhës dhe formularit të njoftimit të fituesit, nga 4 operatorë pjesëmarrës janë s’kualifikuar 3 OE, janë kualifikuar 1 OE. Në përfundim, mbi bazën e Raportit përmbledhës, Titullari i AK 2967/19, të datës 19.04.2023 ka shpallur fituese ofertën e shoqërisë **OE “R”** ShPK për të cilën është lidhur kontrata datë Nr. 2967/20 prot datë 02/05/2023 për vlerën 5,909,993 lekë pa TVSH, dhe 7,091,992.30 lekë me TVSH, dhe me afat 4 (katër) muaj nga data e lidhjes së kontratës.

Gjithashtu referuar raporti përmbledhës me nr. 2967/19, të datës 19.04.2023, në të cilin është përshkruar e gjithë procedura e ndjekur deri në shpalljen e fituesit rezulton se squalifikimi i OE nga KVO është i drejtë.

c- Në lidhje me procedurën shqyrtimit të ankimeve. (Nuk ka pasur ankimime)

Në lidhje me klasifikimin dhe vlerësimin e OE-së për procedurën e sipërcituar, ndër të tjera, rezulton se nuk janë paraqitur ankesa nga OE, duke kundërshtuar skualifikimin dhe pretendimet e AK-së.

- Nga shqyrtimi i ofertës fituese, rezulton se OE nuk përmbush të gjitha kriteret e vendosura në DST dhe konkretisht:

1.OE nuk përmbush kriterin e pikës 2.3.7 të DST pasi sipas shtojcës 8 të deklaruar në nga OE “R” ShPK, tek kriteret e vecanta të kualifikimit nuk disponon referencë për pajisjet që keni në pronësi

konkretisht: 1. ESKAVATOR ME ZINXHIRE HITACHI, 2. MINIFADROME si dhe 3. RRUL. Gjithashtu referuar procedures së prokurimit me objekt “ Rikonstruksion i Çerdhes Patos me hapësirat përreth”. KVO për të njëjtën arsye ka skualivikuar BOE. “N dhe SH” ShPK duke vepruar në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, sipas neneve të mëposhtëm:

- nenin 92 “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3:

2. OE nuk përmbush kriterin e pikës **2.3.7 të DST** pasi ka deklaruar mjeteve të transportit/ndërtimit sipas rastit, të deklaruar në shtojcën 8 nga OE “**R**” ShPK, si dhe për vërtetimin e disponimit të tyre ka dorëzuar dokumentacionin fizik, ku një pjesë e zotëron nëpërmjet qiramarrjes dhe një pjesë të tyre e ka në pronësi, konstatohet se për mjetet e mara me qira janë per përdorim vetiak konkretisht.

2.1. Mjeti Asfaltoshtrues; nr. Serial 09520080, rezulton se subjekt nuk disponon certifikatë regjistrimi si dhe certifikat për dhënien me qira të mjeteve për të tretë, referur kontratës së qirasë Nr.Rep: 804 dhe Nr.Kol: 214 të nënshkruar ndërmjet shoqërisë “A” ShPK dhe shoqërisë “R” ShPK.

2.2. Mjeti Autobitrumatriçe me targa; AA120U, shasi NMSA706200TE13398, rezulton se subjekt nuk disponon certifikatë regjistrimi si dhe certifikat për dhënien me qira të mjeteve për të tretë, referur kontratës së qirasë Nr.Rep: 804 dhe Nr.Kol: 214 të nënshkruar ndërmjet shoqërisë “A ” ShPK dhe shoqërisë “R” ShPK.

Lidhur me sa më sipër, për certifikatat e regjistrimit sqarojmë se: në nenin 113, nenin 122 dhe nenin 230 pika 8, “Qarkullimi në rrugë i makinave teknologjike” i ligjit nr.8378 datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Lidhur me sa më sipër, për certifikatat e transportit sqarojmë se: Në nenin 81, pika 1, 2, 3, 4, 5 dhe 7, 8 “Destinacioni dhe përdorimi i mjeteve” i ligjit nr.8378 datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Në nenin 3, paragrafi 3.13 dhe 3.14 të ligjit nr. 8308, datë 18.3.1998 “Për transportet rrugore”, i ndryshuar.

Në nenin 41, të ligjit nr. 8308, datë 18.3.1998 “Për transportet rrugore”, i ndryshuar, parashikohet se: “Transporti i mallrave me qira dhe për të tretë është i ndaluar të kryhet pa licencën përkatëse”. Pra, ligji “Për Transportet Rrugore”, bën qartësisht ndarjen midis certifikatës së lëshuar për “Transport për vete” përmes të cilës subjektet mund të kryejnë transport të mallrave me kamion, në ardhje ose në kthim, vetëm për llogari të veprimtarisë së vet, ku në këtë rast transporti është vetëm një veprimtari ndihmëse e veprimtarisë kryesore, e cila vërtetohet sipas ligjeve në fuqi; si edhe certifikatës së lëshuar për “Transport për të tretë dhe me qira” përmes të cilës subjektet mund të kryejnë transport të mallrave me kamion për persona fizikë a juridikë të tjerë ose dhënia e kamionit me qira.

Në rastin konkret përmes dokumentacionit të dorëzuar vërtetohet se, certifikatat janë dhënë në përdorim të vet pronarëve të mjeteve për kryerjen e transportit të mallrave me kamion (vetëm për llogari të veprimtarisë së vet). Në këtë mënyrë, kryerja e transportit nga ana e OE të mallrave me mjetet e mësipërme do të jenë në kushtet e kryerjes së transportit të mallrave me qira dhe për të tretë pa certifikaten përkatëse, transport i cili në zbatim të nenit 41 të ligjit “Për Transportet Rrugore” është i ndaluar. Mungesa e certifikatave të mësipërme, vërteton faktin se përdorimi i tij nga të tretë do të ishte i pamundur në zbatim të dispozitave të sipërcituar të Kodit Rrugor të RSh-së dhe të ligjit “Për Transportin Rrugor”.

3. OE nuk përmbush kriterin e pikës 2.3.6 të DST e cila kërkon:

• **Manovratore 3 (tre)**

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga OE i shpallur fitues, rezulton se referuar vetdeklarimit dhe sipas listëpagesa e Kontributeve të sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimi mbi të ardhurat nga punësimi OE “R” SHPK ka deklaruar sipas formularit 8, të punësuar në kompani ka deklaruar manovratorë z. M.G i punësuar pranë shoqërisë sipas kontratës së punës së datës 03.02.2022 i cili figurojnë në listë pagesa me Kod punësimi 7115.02 – karpentier në kundërshtim me VKM nr. 514, datë 20.09.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve LKP të Rishikuar”.

Konkluzion: Sa më sipër, OE nuk plotëson kriteret e vendosur në DST dhe në këto kushte KVO nuk duhet të kishte kualifikuar OE “R” SHPK, si dhe nuk duhet t’i kishte propozuar titullaritet shpalljen fitues të tyre. Në këto kushte, KVO ka vepruar në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenin 92 “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3 dhe eni 99 “Anulimi i një procedure prokurimi, pika 1, germa (b):

Sa më sipër mban përgjegjësi KVO me përbërje znj. A.P, z. SH.B si dhe znj. N.H.

Në observacionin e subjektit të audituar Bashkia Patos mbi projekt raportit e auditimit përcjell me shkresën nr. 30/6 prot., datë 08.04.2024, janë dërguar observacione nga Bashkia Patos me shkresën nr. 67/43 prot., datë 10.05.2024 dhe protokolluar në KLSH me shkresën nr. 30/8 prot., datë 14.05.2024, shprehur si më poshtë vijon:

Pretendimet e subjektit:

Në lidhje me konstatimet tuaja mbi objektin e prokurimit” Rikonstruksion i rrugës Ish – Thertorja, Lagjja 29 Marsi” ju sqarojmë se:

a) Përsa i përket konstatimit tuaj rreth pikës 2.3.2. të kapacitetit teknik në DST ju argumentojmë se:

Kërkesat për kriteret e licencave që duhet të jenë të pajisur operatorët ekonomik ofertues për kryerjen e punimeve të ndërtimit për objektin e prokuruar janë kryer mbështetur në preventivin e objektit.

Nga ana jonë është kërkuar që operatori të paraqesë licencën profesionale N.S –I Punime për prishjen e ndërtimeve.”Kategoria A’ sepse në këtë segment rrugor ka qenë i nevojshëm liri i territorit për ndërtimin e trupit të rrugës. Kjo përfshin prishjen e pjesëve të mureve rrethuese të disa objekteve e cila duhej realizuar pa dëmtuar pjesën jashtë trupit të rrugës. Këto punime përfshihen në kërkesat e licences N.S.I. Në VKM nr. 42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, përcaktohen punimet që përfshin kjo licencë si më poshtë:

“N.S –I Punime për prishjen e ndërtimeve

Konsiderohet çmontimi i impianteve industriale dhe prishja komplet e ndërtesave me pajisje speciale ose me përdorim eksploziv me prerje të strukturave betonarme dhe prishjeve në përgjithësi përfshi edhe grumbullimin e mbeturinave, ndarjen e tyre dhe riciklimin e materialeve.”

Ky kriter është vendosur bazuar ne logjikën inxhinierike për punime të mundshme të paparashikuara në preventivin e prokuruar. Këto punime hasen në shumicën e objekteve dhe në këtë rast ky objekt nuk bëri përjashtim nga trendi i daljes së punimeve të papritura që duhet të kryhen në terren.

Nga situata ne teritorin ku shtrihet objekti i prokuruar, pas fillimit të punimeve për shkaqe të cilat nuk vareshin nga pjesa e investimit, është shembur një mur mbajtës rrethues i cili ishte në kufi të rrugës lidhëse me krahun e majtë të saj. Kjo shembje rrezikonte dëmtimin e mëtejshëm të trupit të rrugës dhe për këtë arsye u vendos zëvendësimi i një pjesë të murit me themel betoni të ri. Kategoria që përfshin prishjen e themelit ekzistues përfshihet në pikën N.S.-I. Nga kjo pikë nuk është penalizuar asnjë operator ekonomik konkurues.

b) Përsa i përket konstatimit tuaj rreth pikës 2.3.8. të kapacitetit teknik në DST ju sqarojmë:

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 44, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.*

Në bazë të legjislacionit shqiptar, cdo operator ekonomik që ushtron veprimtari në një territor të caktuar, duhet të hapë edhe një seli, NIPT sekondar si dhe të ushtrij aktivitetin e plotë si subjekt ekonomik. Mbështetur në ligjin për lejet e mjedisit si dhe VKM nr. 419, datë 25.06.2014 “ Mbi procedurat e pajisjes me leje mjedisi për ushtrimin e aktivitetit ” , Subjekti që do të kryejë punimet, klasifikohet në operator që gjeneron mbetje urbane në atë njësi administrative ku do të kryejë punime. Për rrjedhojë , cdo subjekt duhet të jetë i pajisur me lejen përkatëse të mjedisit , ku detyrimisht përcaktohen format, detyrat dhe metodat e trajtimit të mbetjeve të gjeneruara, si dhe metodat e trajtimit dhe rekuperimit të ndërhyrjeve. Në këtë rast bashkia është bashkëpunëtori që bën të mundur trajtimin me efikasitet të mbetjeve, por theksojmë se , nga pikëpamja ligjore, është operatori, ai që bën gjenerimin e mbetjeve dhe për rrjedhojë ka edhe detyrimin ligjor të trajtojë këto mbetje.

Gjithashtu kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 44 të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Sa më sipër kriteret teknike janë vendosur në mbështetje të pikës 1 të nenit 77 të LPP dhe pikës 4 të nenit 39 të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021 “Për rregullat e prokurimit publik”. Gjithashtu për këtë procedurë prokurimi nuk ka pasur rekomandim nga APP për këtë licensë.

Nga shqyrtimi i ofertës fituse, se OE “R” sh.p.k, është parashikuar nga ana juaj se nuk përmbush të gjitha kriteret e vendosura në DST dhe konkretisht:

1. OE nuk përmbush kriterin 2.3.7 pasi sipas shtojcës 8 për 3 mjete nuk disponon referencë, konkretisht 1. Ekskavator me zinxhira Hitachi, 2. Minifadrom dhe 3. Rul.

Sqarim: Për mjetin Rul është përcaktuar referencë konkretisht targa CC232S. Kurse për dy mjetet e tjera është marrë si një devijim i vogël referuar paragrafit 2, pika 3, neni 92 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar në të cilën përcaktohet se:

Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit.

Vlerësimet nga ana e KVO janë kryer gjithmonë në mbështetje të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, akteve nënligjore në zbatim të tij dhe në mënyrë objektive, Për arsye të njëjta është vepruar me një standart për çdo procedurë dhe lidhur me procedurën “Rikonstruksioni i çerdhes Patos dhe hapsirat përreth” ku KVO ka skualifikuar BOE “N dhe SH ” për të njëjtën arsye ju sqarojmë se N.H nuk ka qënë anëtare e KVO.

2. OE nuk përmbush kriterin 2.3.7 konkretisht.

Mjeti asfaltoshtrues me nr. serial 09520080 për të cilin rezulton se subjekti nuk disponon certifikatë regjistrimi si dhe certifikatë për dhënien me qira të mjeteve për të tretë, referuar kontratës së qirasë nr.rep 804 dhe nr.kol 214 të nënshkruar ndërmjet shoqërisë “A ” dhe shoqërisë “R ” sh.p.k.

Sqarim: Referuar kriterëve teknike në DST për mjetet të cilat nuk kanë leje qarkullimi ofertuesi duhet të paraqesë:

- Kontratën noteriale të blerjes.
- Faturën tatimore të blerjes ose dokumenta zhdoganimi të mjetit.

Pranohet marrja me qira me kusht që kontrata të jetë përpara noterit.

Mjeti asfaltoshtrues është mjet me zinxhir i cili nuk certifikohet nga DPSHTRR pasi është mjet teknologjik i cili nuk qarkullon në rrugë por përdoret dhe funksionon vetëm në kantiere ndërtimi.

Pra ky mjet nuk ka leje qarkullim, dhe si sic është kërkuar në DST mjafton paraqitja e kontratës noteriale të blerjes, faturës tatimore të blerjes ose dokumenta zhdoganimi të mjetit, ose kontrata e qirasë përpara noterit nëse mjeti nuk është në pronësi të OE.

3. OE nuk përmbush kriterin e pikës 2.3.6

- Manovrator 3 (tre)

Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se OE i shpallur fitues “R” ka deklaruar në formularin nr. 8 të punësuar në shoqëri manovrator z. M.G, me kontratë pune datë 03.02.2022, i cili figuron në listëpagesë me kod punësimi 7115.02 – Karpentier në kundërshtim me VKM nr. 514, datë 20.09.2017.

Sqarim: Referuar kritereve teknike në DST për manovratorët është kërkuar që të figuroj në listepagesën e shoqërisë nga muaj dhjetor 2022 e në vazhdim.

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatori duhet të paraqesë:

- Diplomë
- Kontratë pune
- Dëshmi kualifikimi

KVO i është referuar faktit që në kontratë rezulton i punësuar si manovrator dhe në lispagesa duke plotësuar kriterin e vendosur në DST.

KVO nuk ka bërë një kontroll të detajuar të kodeve të sigurimeve pasi në DST nuk është kërkuar një gjë e tillë. Duke marrë parasysh që dhe karpentier dhe manovrator janë profesione me certifikata të formimit profesional për të cilat paga minimale është e njëjtë për të dy profesionet.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Së pari observacioni juaj nuk mund të merret në konsideratë pasi pretendimet tuaja nuk gjejnë mbështetje ligjore dhe nuk janë paraqitur prova apo dokumentacion shtesë në mbështetje të pretendimeve. Nuk vërehen pretendime, prova, fakte apo referenca ligjore të reja, nga ato çka janë përmendur në dokumentat e paraqitura nga Bashkia Patos, gjatë fazës së auditimit në terren ose sipas konstatimeve.

5. “Blerje Asfaltobeton për shtrim rrugësh”.

a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje Asfaltobeton për shtrim rrugësh”.			
1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit “E Hapur” Marrëveshje kuadër REF-59495-02-17-2023 Urdhri Nr.379/1prot datë 09.02.2023 nr. 6	1.1 Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe fondit limit nr. 379/2, datë 07.02.2023 4. Ing. A.M 5. Ing. A.L	2 Njësia e Prokurimit 1. D.K 2. Ing. A.L 3. M.N	3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhri nr. 379/3 prot., datë 09.02.2023 1. A.P 2. SH.B 3. J.B
4. Fondi Limit (pa tvsh) 33,332,449 lekë	5. Oferta fituese, vlera fituese: Operatori Fitues: SH » 21700 shumatorja e cmimeve për njësi		6. Diferenca me fondin limit Vlera e minikonstratës së parë 25,760,538 lekë pa TVSH
7/1 Data e hapjes së tenderit: Data 15.03.2023 ora 11:00	8. Burimi Financimit Vetë financim.		9. Operatorët Ekonomike «SH » « A » « A » « B » B.O.E. «C » & « G » b) S’kualifikuar XX B/OE , 1. « A » c) Kualifikuar XX B/OE «SH » « A » « B » B.O.E. «C » & « G »
7/2 Kohëzgjatja e kontratës: 8 muaj ditë			
10.Ankimime AK-s’ka APP-s’ka KPP-s’ka	11. Data e lidhjes të kontratës: Nr. 18/2 prot., datë 29/06/2023		12.Përgjigje Ankesës nga APP, AK apo KKP: AK NUK KA

a-Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.

- AK në lidhje me “Hartimin e Specifikimeve Teknike” dhe “Përlllogaritjen e Fondit Limit” :

- Me shkresën nr. 18 prot, datë 06.02.2023, kërkesë për nisjen e procedurës, drejtuar Njesisë së Prokurimeve Patos, nga Agjensia e Shërbimeve Publike Patos, ka kërkuar blerjen e bazës materiale **“Blerje Asfaltobeton për shtrim rrugësh”**, bazuar në parashikimet në buxhetin e miratuar për vitin 2023-2024.

- Sipas citimeve në shkresën 379/1 prot., datë 07.02.2023 është parashikuar volumi i punimeve që do të kryen për një periudhë 2 vjeçare, bazuar në verifikimin në terren, relacionin teknik si dhe tabelën bashkëngjitur kësaj shkresës me emërtimin “Shtrimi i rrugve me asfalt” (Marveshje kuadër 2023-2024) nënshkruar nga z.A.L me detyrë ing. në Drejtorinë e Hartimit të projekteve, Monitorimit të Investimeve dhe të Shërbimeve, znj. B.M. me detyrë ing në Drejtorinë e Hartimit të projekteve, Monitorimit të Investimeve dhe të Shërbimeve dhe z. A.M. ing. në pozicionin e Drejtorit në Drejtorinë e Hartimit të Projekteve, Monitorimit të Investimeve dhe të Shërbimeve
Volumi i punimeve paraqitet sipas tabelës më poshtë:

Nr	Analiza	Emërtimi	Njësia	Sasia	Çmimi	Vlera
1	An + treg	Çakull (për realizimin e shtresës t=10 cm)	m ³	1434.48	904	1,296,769.92
2	An + treg	Stabilizant (për realizimin e shtresës t=10 cm)	m ³	3416.275	1100	3,757,902.50
3	An + treg	Emulzion bitumi 0.5/m ²	litra	13133.74	80	1,050,700.00
4	An + treg	Binder (për realizimin e shtresës t=5 cm)	Ton	2887.565	9257	26,730,189.21
5	An + treg	Asfaltobeton	Ton	44.16	11252	496,888.32
		Shuma				33,332,449.95
		TVSH 20 %				6,666,489.99
		Totali				39,998,939.93

Kjo sasi është llogaritur për një periudhë 2 vjeçare.

Sipas procesverbalit datë 09.02.2023, mbi argumentimin e përzgjedhjes së procedurës së prokurimit, Njësia e Prokurimit argumenton se klasifikimi i procedurës “Tender i hapur” me objekt prokurimi “Blerje Asfaltobeton për shtrim rrugësh” sipas materialeve të paraqitura nga Drejtoria e Hartimit të projekteve, Monitorimit të Investimeve dhe të Shërbimeve sipas preventivit total dhe i ndarë sipas zonave.

Nga aditimi i dosjes së prokurimit konstatohet se në dosjen e prokurimit nuk administrohet dokumentacion teknik, në lidhje projekt zbatimin për objektin e kontratës, mungon dokumentacioni si planimetria e rrugëve dhe shesheve, gen plani, profili gjatësor i rrugës, profilat tërthorë tip, profilat tërthorë të rrugës, dokumentacion i cili do të shërbente për fillimin e procedurës. Referuar zërave të punimeve që do të kryen, është e detyrueshme hartimi i dokumentacionit teknik të sipërcituar sipas përcaktimeve ligjore. Gjithashtu referuar kontratave të viteve të mëparshme që vetë Bashkia Patos ka lidhur për punë të ngjashme është kërkuar i gjithë dokumentacioni i sipërcituar. Zërat e punimeve që do të kryen janë të natyrës punë, ka shmangur hartimin e dokumentacionit teknik të detyrueshëm përpara fillimit të procedurës së prokurimit. Veprimet më sipër bien në kundërshtim me kërkesat e Ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Neni 34, pika 3 dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2020 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Neni 40, pika 1, 2, 3, Neni 7, Neni 76, VKM nr. 42, datë 16.01.2008 (lidhja 2,3), Udhëzimit nr. 1, datë 22.02.2005 “Për disa shtesa në Udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2021 të KM “Për mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, pika 8 dhe VKM nr. 629, datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike të tyre”.

Në dosje nuk administrohet urdhër i titullarit për ngritjen e grupit të punës për verifikimin e gjëndjes së rrugëve dhe shesheve në Bashkin Patos, procesverbalet për verifikimin në terren të

gjëndjes së rrugëve, projekt zbatimi apo projekti i azhornuar që do të përcaktonte volumin e saktë të punimeve, gjithashtu nuk administrohen kërkesa, për ndërhyrje nga Njësiti Administrative, për të gjitha rrugët dhe sheshet e parashikuara për ndërhyrje sipas “*Evidenca e rrugëve dhe shesheve të parashikuara për rikonstrukcion në Bashkin Patos*” të administruar në dosjen e prokurimit. Sa sipër nga AK nuk dokumentohet argumentimi i volumit të punimeve që do të kryen, veprime këto në kundërshtim kërkesat e Ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Neni 34, pika 3 dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2020 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Neni 12, pika 4, Neni 7, Neni 76, **pika 2-Autoriteti/enti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet.**

Pika 3- Për përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, titullari i autoritetit/entit kontraktor mund të caktojë struktura të posaçme. Në rast se nuk ngrihen struktura të posaçme, kjo detyrë i ngarkohet specialistit të fushës ose njësisë së prokurimit.

Për mangësit më sipër ngarkohen me përgjegjësi:

z. A.L. me detyrë ing. në Drejtorinë e Hartimit të projekteve, Monitorimit të Investimeve dhe të Shërbimeve;

znj. B.M. me detyrë ing. në Drejtorinë e Hartimit të projekteve, Monitorimit të Investimeve dhe të Shërbimeve;

z. A.M. ing. në pozicionin e Drejtorit në Drejtorinë e Hartimit të projekteve, Monitorimit të Investimeve dhe të Shërbimeve;

znj. D.K. me detyrë përgjegjse e njësisë së prokurimit;

z. M.N. me detyrë specialist në njësinë e prokurimit si dhe znj. R.B. me detyrë *Ish/ Kryetar i Bashkisë.*

- Në lidhje me “Argumentimin dhe Hartimin e Kriterëve”:

- Kërkesat e veçanta të kualifikimit janë hartuar nga komisioni i përbërë prej (Ixhinier Ndërtimi: A.M. dhe z. Ing. z. A.L), sipas shkresës nr. 379/2 prot., datë 07.02.2023 të cilat janë evidentuar në procesverbalin e datës Nr. 379/4 prot., datë 17.02.2023. Në lidhje me kriteret e vendosura, u konstatuar kriteret të paargumentuara. Në mënyrë të detajuar kriteret e konstatuara si të pa argumentuara paraqiten si vijon:

Kriteret e vendosura në kërkesat e pikes 2.3.3 nuk është argumentuar teknikisht dhe ligjërisht pasi në rastet kur fabrika asfaltbetonit nuk janë në pronësi të ofertuesit rezulton se kërkesa për paraqitjen me leje mjedisore aktive Kodi III.1.B, për të cilën duhet të paraqesin dokumentacionin e pronësise/kontraten e qerases/kontraten e furnizimit shoqëruar me leje mjedisore Kodi III.1.B, u drejtohet personave të tretë që nuk janë konkurent në këtë procedurë prokurimi. Nuk përmbushin parashikimet e dispozitave ligjore të zbatueshme për prokurimin publik sipas nenit 7 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe pikës 4 të nenit 39 të VKM me nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, i cili përcakton se:

“Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.

Kriteret e vendosura në kërkesat e pikes 2.3.4 nuk është argumentuar teknikisht dhe ligjërisht ku citohet “Asfaltbetoni të përgatitet në fabrika të posaçme, të cilat këshillohet të jenë sa më afër depozitave të lendeve të para dhe vendit të përdorimit të tij (jo më larg se 20 km nga blloku i rrugëve që do të shtrohen), në mënyrë që ti përgjigjen kërkesës që do të lind për lëndë të parë (stabilizant ose asfalt). Gjithashtu kjo gjë do të mundësojë ruajtjen e parametereve fiziologjike

(temperature, shkruftim) të asfaltit. Për këtë kriter do të merret për bazë QKB e operatorit që ka asfaltoshtruesen si në rastin kur fabrika e asfaltobetonit është në pronësi, edhe kur fabrika është me kontratë qeraje ose me kontratë furnizimi.

Vendosja e këtij kriteri është i tepërt pasi kufizon pjesëmarrjen e operatorëve të tjerë të cilët kanë vendodhjen në një largësi jo më shumë se 20 km nga blloku i rrugëve që do të shtrohen, pasi disa nga OE mund të administrojnë makineri dhe mjete të cilat bëjnë të mundur ruatjen e temperaturës së përzjerjes në vlerat 130-150 C, të lejuara për shtrim, edhe gjatë transportimit.

Veprimet më sipër bien në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, Neni 2- Qëllimi, neni 3, neni 36, pika 2, Neni 77, pika 1, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Neni 41, pika 2¹⁰.

b-Në lidhje me zhvillimin e procedurës dhe vlerësimin e ofertave nga KVO.

Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 5 OE, për të cilët, referuar procesverbalit nr. ska prot, të datës 06.04.2023, KVO-ja ka kryer në SPE vlerësimin dhe klasifikimin përkatës duke kualifikuar OE SH ShPK, “A” ShPK dhe “A” ShPK.

KVO referuar OE të kualifikuar i pari me vlerën më të ulët OE “A” ShPK me ofert 17,095 lekë pa TVSH në datë 06.04.2023 ka njoftuar OE për paraqitjen e dokumentacionit brenda datës 11/04/2023. Referuar procesverbalit nr. 379/9 prot., datë 19.04.2023 KVO ka skualifikuar OE “A” për mangësitë e mëposhtme.

Me shkresën nr. 379/10 prot., datë 19.04.2023 ka njoftuar hapjen e fazës së rivlerësimit të ofertave duke njoftuar OE “A” ShPK me ofert 20,210 lekë pa TVSH për paraqitjen e dokumentacionit brenda datës 24.04.2023. Referuar procesverbalit nr. 379/14 prot., datë 19.05.2023 KVO ka skualifikuar OE “A” për mangësitë e mëposhtme.

Nga verifikimi fizik i dokumentacionit rezultoi se skualifikimi i OE të paraqitur në procedurën e prokurimit “Blerje Asfaltobeton për shtrim rrugësh” është i drejt pasi nuk plotësojnë kërkesat e vendosura në DST.

Nr	Operatori ekonomi	Oferta lekë pa Tvsh	Kualifikuar/S'kualifikuar
1	SH	21,700	Kualifikuar
2	B	16,940	Skualifikuar O. E. « B » shpk, Tiranë, me Nr. NIPT K...T ka mungesë të dokumentacionit si më poshtë: - Nuk plotëson pikën 2.3.4 ne DST -Asfaltobetonit të përgatitet në fabrika të posaçme, të cilat këshillohet të jetë sa me afer depozitave te lendeve te para dhe vendit të përdorimit të tij (jo më larg se 20 km nga blloku i rrugëve që do të shtrohen)... Për këtë kriter do të merret për bazë QKB e operatorit qe ka fabriken e asfaltobetonit, si në rastin kur fabrika e asfaltobetonit eshte ne pronesi , edhe kur fabrika është me kontratë qeraje ose me kontratë furnizimi. Operatori ka paraqitur një kontratë qeraje të lidhur me shoqërinë A shpk, për marrjen me qera të një impiant asfalti mobile, por adresa ne QKB e shoqërisë A është Tiranë (pra në distancë >20 km nga blloku i rrugëve që do të shtrohen). Se dyti, kjo fabrike asfaltobetonit duhet te jete e shoqeruar me leje mjedisore aktive LEJE MJEDISI me kod III.1.B, ç’ka Shoqëria A e disponon, por vendi i kryerjes se aktivitetit i percaktuar ne leje është “Pranë fshatit Cerkezë, Bashkia Tiranë”, qe do te thote qe kjo leje nuk i pergjigjet dot një impianti asfalti te levizshem sipas pretendimeve te operatorit. Në pikën 1.6 të KUSHTIT 1 të AKT

¹⁰ në të cilën citohet: “Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

			MIRATIMIT të lejes mjedisore specifikohet “Në këtë leje, vendodhje nenkupton zonen e percaktuar nga koordinatat e meposhtme. Veprihtarite e autorizuar sipas kushteve 1.1 nuk duhet te shtrihen pertej vendodhjes, qe eshte zona e percaktuar ne korrdinatat e meposhtme (ZK 2066, Nr pasurie 343/4, Adresa: Rrethi Tirane, Kamez, prane Fshatit Cerkeze, Rruga Argjinatura”.
3	A	20,210	<p>Skualifikuar</p> <p>O. E. «A » shpk, Fier me Nr. NIPT K...Ë ka mungese te dokumentacionit si me poshte :</p> <ul style="list-style-type: none"> Referuar pikës 2.3.5 ne DST, në fomularin përmbledhës të vetëdeklarimit, operatori “A” shpk ka deklaruar disponimin e 4 (kater) kamionëve vetëshkarkues me kapacitet mbajtes mbi 20 ton, përkatësisht me targat: <p>Ne pronësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Terheqes me targe AB334BI dhe Rimorkio me targe AHR235 -Terheqes me targe AB319BI dhe Rimorkio FR1517D/AIR611 -Terheqes me targe AB298B1 dhe Rimorkio AHR228 <p>Me qera:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Kamion me targe AB319AF <p>Nga verifikimi i dokumentacionit fizik shoqerues per mjetet e mesiperme eshte konstatuar se:</p> <ul style="list-style-type: none"> Mjeti koke terheqese me Targe AB319BI eshte i shoqeruar me gjysem-rimorkion me targe FRF1517D/ AIR611, nje gjysme- rimorkio e cila perfaqeson nje platforme te sheshte e cila nuk i pergjigjet funksionit te cilit ajo do te kryeje per transportin e bazes materiale te asfaltit. Mjeti Kamion me targe AB319AF i marre me qera nga shoqeria I disponon nje certifikate transporti vetem ne llogari te vete (pra te shoqerise I) dhe jo per te trete dhe me qera.
4	A	17,095	<p>Skualifikuar</p> <p>O. E. «A » shpk, Tirane, me Nr. NIPT L...E ka mungese te dokumentacionit si me poshte:</p> <p>Referuar pikes 2.3.5 ne DST, ne fomularin permbledhes te vetedeklarimit, operatori “A” shpk ka deklaruar disponimin e 4 (kater) kamionëve vetëshkarkues me kapacitet mbajtes mbi 20 ton, perkatesisht me targat:</p> <p>Kamion me targe AA168HO Kamion me targe AA327MU Kamion me targe AB311AA Kamion me targe AB417GE</p> <p>Nga verifikimi i dokumentacionit fizik shoqerues per mjetet e mesiperme eshte konstatuar se:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Kamioni me targe AA168HO nuk ploteson kriterin e kapacitetit mbajtes te kerkuar pasi aftesia e tij mbajttese eshte 16.5 ton nga >20 ton e kerkuar. - Kamionit me targe AB311AA i mungon leja e qarkullimit e plote, certifikata e transportit, foto e mjetit dhe siguracioni i mjetit nuk eshte i lexueshem. - Kamionit me targe AB417GE i mungon certifikata e pronesise se mjetit, certifikata e transportit dhe foto te mjetit.
5	C & G	19,225	<p>Skualifikuar</p> <p>B.O.E. «C» shpk, Fier me Nr. NIPT J...E & «G » shpk, Fier, Ballsh me Nr. NIPT K...A ka mungesë të dokumentacionit si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> Operatorët në bashkëpunim “C” shpk dhe “G” shpk nuk plotesojne piken 2.3.1 ne DST, ku operatorët ekonomik duhet te paraqesin dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40% të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate. <p>Nuk ploteson piken 2.3.3 të kapacitetit teknik, ku AK ka kërkuar: “<i>Fabrikë asfaltobetonit (shoqëruar me leje mjedisore e cila duhet të jetë aktive Leja e Mjedisit aktive III.1.B) (Ne pronesi ,kontrate qeraje ose kontrate furnizimi)</i>”.</p> <p>BOE ka deklaruar ne formularin permbledhes te vetedeklarimit, seksioni C.DEKLARATE, se operatori ne bashkëpunim “G ” shpk ka lidhur nje kontrate furnizimi me Shoqerine “S ” shpk, pa asnje te dhene per numrin e kontrates dhe lejes mjedisore) Pika 2.3.3 nuk permbushet vetem me vetedeklarimin ne shtojcen 8, por duhet te paraqitet kontrata e furnizimit dhe nje vetedeklarim i operatorit</p>

			ekonomik që furnizuesi i mallit të ofertuar e disponon lejen si me lart duke rezervuar të drejtën e verifikimit të vetedeklarimit, si dhe në rastin kur OE shpallet fitues të paraqese lejen e mesipërme.
--	--	--	---

Nga KVO është mbajtur Raporti përmbledhës Nr.379/18prot., datë 23.05.2023, në të cilin është përshkruar e gjithë procedura e ndjekur deri në shpalljen e fituesit. Sipas këtij Raporti përmbledhës dhe formularit të njoftimit të fituesit, nga 5 operatorë pjesëmarrës janë s'kualifikuar 4 OE, janë kualifikuar 1 OE. Në përfundim, mbi bazën e Raportit përmbledhës, Titullari i AK Nr. 379/24 prot datë 12.06.2023 ka shpallur fituese ofertën e shoqërisë “**SH**” shpk për të cilën është lidhur kontrata **Nr. 18/2 prot., datë 29/06/2023**, vlera e minikontratës së parë 25,760,538 lekë pa TVSH dhe vlera 30.912.612.6 lekë me TVSH.

- Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga OE fitues “**SH**” Shpk, lidhur kontrata **Nr. 18/2 prot., datë 29/06/2023** në fazat e procedurës rezulton se i ka plotësuar kriteret për kualifikim të përcaktuara në DST.

Në observacionin e subjektit të audituar Bashkia Patos mbi projekt raportit e auditimit përcjell me shkresën nr. 30/6 prot., datë 08.04.2024, janë dërguar observacione nga Bashkia Patos me shkresën nr. 67/43 prot., datë 10.05.2024 dhe protokolluar në KLSH me shkresën nr. 30/8 prot., datë 14.05.2024, shprehur si më poshtë vijon:

Pretendimet e subjektit:

Në lidhje me konstatimet tuaja mbi objektin e prokurimit “Blerje Asfalto Beton për Shtrim rrugësh” ju sqarojmë se në lidhje me konstatimin tuaj se në dosjen e prokurimit nuk administrohet dokumentacioni teknik si projekt zbatimi etj .po ju sqarojmë se procedura e prokurimit me objekt “Blerje asfaltobeton për shtrim rrugësh” është kontratë e mallrave “ bazuar në nenin 15.

Njësia e Prokurimit e ka filluar procedurën e prokurimit, duke u bazuar në gjithë dokumentacionin e nevojshëm sipas nenit 15 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021”Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik (i ndryshuar). Në dosje gjithashtu administrohen preventivat e parashikuar për cdo rrugë, argumentohen volumet e tyre që do të shtrohen me asfalt dhe grafiku i lëvrimit të tyre.

Megjithatë në relacionin teknik është përcaktuar trashësia e cakullit, stabilizantit, binderit dhe asfaltit dhe kjo në një farë mase justifikon prerjen tërthore.

Për sa i përket konstatimit tuaj në pikën 2.3.3 të kapacitetit teknik, AK ka kërkuar: “Fabrikë asfaltobetonit (shoqëruar me leje mjedisore e cila duhet të jetë aktive Leja e Mjedisit aktive III.1.B) copë I (Në pronësi ,kontratë qeraje ose kontratë furnizimi)” ju shpjegojmë se:

Në lidhje me këtë kriter AK, Bashkia Patos, bazuar dhe në rekomandimin e bërë nga Agjencia e Prokurimit Publik (APP) ka bërë shtojcë me shkresën me nr. 379/6 prot., datë 02.03.2023 si më poshtë:

2.3.3. “Fabrikë asfaltobetonit (shoqëruar me leje mjedisore e cila duhet të jetë aktive Leja e Mjedisit aktive III.1.B) copë I (Në pronësi ,kontratë qeraje ose kontratë furnizimi)”

*Në rastet kur fabrika e betonit, nuk është në pronësi apo qera nga OE, por me kontratë furnizimi, operatorët ekonomik duhet të paraqesin një **vetëdeklarim** që furnizuesi i mallit të ofertuar disponon lejen si më lart, duke rezervuar të drejtën e verifikimit të vetëdeklarimit, si dhe në rastin kur OE shpallet fitues të paraqesë lejen e mësipërme.*

Ndryshimi i këtij kriteri nuk u referohet palëve të treta dhe është bërë për analogji bazuar në rekomandimin e APP-së për procedurën me objekt “Blerje rërë bituminoze për shtrim rrugësh” si më poshtë:

Për sa i përket konstatimit tuaj rreth pikës 2.3.4 të kapacitetit teknik, AK ka kërkuar: “Asfaltobetonit të pregatit në fabrika të posacme, të cilat këshillohet të jetë sa më afer depozitave të lëndëve të para dhe vendit të përdorimit të tij (jo më larg se 20 km nga blloku i rrugëve që do të shtrohen), në mënyrë që ti përgjigjen kërkesës që do të lind për lëndë të parë (stabilizant ose asfalt) .Gjithashtu kjo gjë do të mundësoj ruajtjen e parametrave fiziologjike (temperaturë,shkriftim) të asfaltit. Për këtë kriter do të merret për bazë

QKB e operatorit që ka asfaltoshtruesen, si në rastin kur fabrika e asfaltobetonit është në pronësi, edhe kur fabrika është me kontaktë qeraje ose me kontratë furnizimi”.

Ing. A.L ka argumentuar domosdoshmërinë e këtij kriteri e cila është dhe pjesë e dosjes së tenderit si më poshtë:

Në kriteret teknike të kërkuara nga ana jonë per objektin ‘ASFALTIM RRUGE “ është kërkuar që fabrika e asfaltobetonit të jetë deri në 20 km larg bllokut të rrugëve që do të asfaltohen për arsyet e renditura më poshtë:

1. Për ruajtjen e temperaturës së asfaltit nga vendi i përgatitjes deri në objektet përkatëse.

2.Për vetë natyrën e punës në objektin asfaltim rruge del e domosdoshme që gjatë kryerjes së punimeve të përdoren lloji dhe sasia e materialeve që janë në preventiv. Nevojat për arsye të ndryshme mund të jenë në sasi të mëdha ose më të vogla pasi varet nga sipërfaqet që shtrojmë, llojin e nën shtresave, kohën dhe motin kur shtrohen etj.

Në rast se nevojat ditore do të ishin për 7 ton nuk mund që kjo sasi të vinte nga një fabrikë me një distancë prej 70 km.

2- Brenda perimetrit prej 20 km nga grupi i rrugëve që do të shtrohen janë minimalisht 6 (gjashtë) fabrika, nga të cilat 3 në fier, 1 në portëz, 1 në Patos, fakt që tregon që ka konkurrencë për këtë objekt prokurimi.

3-Nga ana e bashkisë Patos nuk ka kapacitete dhe nuk disponohen të gjitha mjetet e mjaftueshme për të përgatitur rrugën para shtresës së asfaltit apo binderit. (cakëll, stabilizant, rulim etj) për sipërfaqe të mëdha .Zbatimin e këtyre punimeve ne e kryejmë pjesë pjesë sipas mundësive reale dhe kapacitetit të mekanizmave që duhen në objekt.

4-Në disa raste mund të dal nevojë emergjente për materialet e preventiuara (sic është rasti i shembjes së rrugëve) dhe distancë më e afërt do të na ndihmonte në zgjidhjen e problemeve me shpejt dhe më me cilësi. Në këto kushte mendojmë që furnizimi me materialet e përcaktuara në preventiv në largësinë 20 km do të ishte më efikas për Bashkinë tonë.

Sa më sipër Kriteret teknike janë vendosur bazuar në volumin dhe natyrën e kontratës në mbështetje të pikës 1 të nenit 77 të LPP dhe pikës 4 të nenit 39 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar. Gjithashtu është bërë një mirëargumentim për këtë kriter. Gjithashtu ky kriter nuk sjell asnjë kufizim pasi operatoreve ekonomik u është lënë mundësia që nëse nuk e kanë asfaltoshtruesen në pronësi mund të lidhin kontrata qiraje ose furnizimi me subjekte.

Konkluzioni juaj që për këtë procedurë janë vendosur kriteret jo në përputhje me natyrën dhe volumin e kontratës, të cilat mund të sjellin kufizimin e pjesëmarrjes së ofertuesve të mundshëm për shkak të kriterëve teknike, përjashton pjesën tjetër të kriterëve ekonomike - financiare, profesionale, përvojës, punës së ngjashme etj të cilat japin mundësinë OE për ofertim rreth kapaciteteve që zotërojnë. Një operator ekonomik mund të mos marr pjesë në një procedurë prokurimi për arsyet të shumta që nuk mund të varen nga Autoritet Kontraktore. Për më tepër operatori ekonomik mund të jetë i angazhuar në kontrata të tjera në kohën e zhvillimit të procedurës, ose arsye të tjera nuk mund të shfaqë interes për këtë procedurë prokurimi.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Së pari observacioni juaj nuk mund të merret në konsideratë pasi pretendimet tuaja nuk gjejnë mbështetje ligjore dhe nuk janë paraqitur prova apo dokumentacion shtesë në mbështetje të pretendimeve. Nuk vërehen pretendime, prova, fakte apo referenca ligjore të reja, nga ato çka janë përmendur në dokumentat e paraqitura nga Bashkia Patos, gjatë fazës së auditimit në terren ose sipas konstatimeve .

6. “Rikonstrukcion i rrugës Unazë Varreza pikë takimi rruga “Dhori Tanaka”

a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Rikonstrukcion i rrugës Unazë Varreza pikë takimi rruga “Dhori Tanaka”			
1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit “Procedurë e hapur” REF-59198-02-15-2023	Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe fondit limit Preventivuan: 6. Ing. S.M	2 Njësia e Prokurimit 1. D.K 2. A.M (sp. Fushe Ing. Ndërtimi)	3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhri nr. 3169 prot/3., datë 15.02.2023 1. SH.B

Urdhri nr. 4 nr. 3169/1 prot datë 31/01/2023	7. Ing. A.M Hartuesi i kriterëve Nr.3169/2 prot datë 15/02/2023 Ing. A.M	3. M.N	2. J.SH 3. A.K Urdhri për zv. nr. 3169/17 prot datë 27/04/2023 1. SH.B 2. J.SH 3. B.M
4. Fondi Limit (pa tvsh) 13,462,585.5 lekë	5. Oferta fituese, vlera fituese: Operatori Fitues: 10,824,055 lekë pa tvsh.	6. Diferenca me fondin limit 2,638,530.5 lekë pa tvsh	
7/1 Data e hapjes së tenderit: Data 03.04.2023	8. Burimi Financimit Të ardhura Lokale 2023	9. Operoret Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender, 9 OE b) S'kualifikuar OE L shpk OE LL shpk OE S shpk OE A shpk B.O.E. A dhe A OE I shpk c) Kualifikuar OE C OE SH OE R	
7/2 Kohëzgjatja e kontratës: 4 (katër) muaj nga nënshkrimi i kontratës			
10. Ankimime AK-s'ka APP-s'ka KPP-s'ka	11. Data e lidhjes të kontratës: Nr. 3169/22 prot datë 22/05/2023	12. Përgjigje Ankesës nga APP, AK apo KKP: AK	

a-AK në lidhje me “Hartimin e Specifikimeve Teknike” dhe “Përlllogaritjen e Fondit Limit” :

Nga dokumentacioni pjesë e dosjes së prokurimit, konstatohet se, se nga DR. e hartimit të projekteve, monitorimit të investimeve dhe shërbimeve është dorëzuar projekti “Rikonstruksion i rrugës Unazë Varreza pikë takimi rruga “Dhori Tanaka” dhe preventivi është hartuar nga Ing. S.T dhe miratuar nga Ing. A.M.

Sipas preventivit të dorëzuar në projekt, konstatohet se komisioni (preventivuesit) për përlllogaritjen e fondit limit ka përdorur mënyrën e “cmimeve të manulit teknik”, pasi janë përgatitur specifikimet teknike në lidhje me objektin e prokurimit, e cila rezulton të jetë **10,824,055** lekë pa tvsh.

Nga ana e titullarit të AK-së, në zbatim të LPP-së, në projektin e objektit nr 3169 prot., datë 23.12.2022 janë hatuar edhe specifikimet teknike të objektit, nga Ing. A.M. me profesion inxhinier ndërtimi i cili është është specialist i fushës. dhe S.T (M).

- Në lidhje me “Argumentimin dhe Hartimin e Kriterëve”:

Kërkesat e veçanta të kualifikimit janë hartuar nga Ing. A.M në cilësinë e specialistit të fushës dhe njësia e prokurimit me shkresën nr. 3169/2 prot., datë 15/02/2023. Në lidhje me kriteret e vendosura, u konstatuar kriteret të paargumentuara. Në mënyrë të detajuar kriteret e konstatuara si të pa argumentuara paraqiten si vijon:

Kërkesat e pikës 2.2. e DST e cila kërkon që kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2019,2020,2021 , ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se **13,462,585 lekë pa TVSH.**

Kërkesa për paraqitjen e xhiros vjetore 2019-2021 është kërkesë e pa argumentuar pasi data e hapjes së tenderit është data 03.04.2023, pra është mbyllur viti ushtrimor 2022. Veprimet dhe

mosveprimet janë në kundërshtim me VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklarave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike". Në përcaktimin e vlerës së xhiros autoriteti kontraktor është referuar në pikën 2, gërma (c) të Nenit 43, Seksioni III të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2020,2021, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve ligjit nr.10091 date 5.3.2009 "Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar" i ndryshuar.

Kërkesa për paraqitjen e bilancit vjetore 2020-2021 është kërkesë e pa argumentuar pasi data e hapjes së tenderit është data 03.04.2023, pra është mbyllur viti ushtrimor 2022, i cili mbyllet brenda 31 marsi të vitit pasardhës referuar ligjit nr 9228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" i ndryshuar si dhe udhëzimit të MF nr. 08, datë 09.03.2018" Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njëjësive të Qeverisjes së Përgjithshme", i ndryshuar.

Kërkesat e pikës 2.3.2 e DST e cila kërkon që operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastruktura dhe Energji, -Referuar licensës profesionale NS- 1-A të projekt preventivit të punimeve, rezulton se: zërat e punimeve që nevojiten për realizimin e kontratës, nuk parashikohen në llojet e punimeve të përfshira në përkufizimin e kategorive të sipërcituara, sipas VKM nr. 42, datë 16.01.2008 "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi".

Kërkesat e pikës 2.3.8 e DST e cila kërkon që **mbështetur në:**

Ligj Nr. 9010, date 13.02.2003 Per administrimin mjedisor te mbetjeve te ngurta, Ndryshuar me Ligjin Nr 10137, date 11.05.2009 PER DISA NDRYSHIME NE LEGJISLACIONIN NE FUQI PER LICENCAT, AUTORIZIMET DHE LEJET NE REPUBLIKEN E SHQIPERISE

Kreu II Neni 9 Detyrime te krijuesit te mbetjeve

Neni 12 Perpunimi dhe asgjesimi i mbetjeve te ndertimit

Neni 24/1

Neni 25 Lejet mjedisore.

Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me licensën profesionale nga Qendra Kombëtare e Liçensimit (QKL) Kodi III.2.B.

Kërkesa për licenca nuk është e argumentuara teknikisht dhe ligjërish në lidhje dhe në funksion të objektit të kontratës. Nuk është e nevojshme licenca e mësipërme, pasi shërbimin e grumbullimit të mbetjeve e ofron Bashkia Patos referuar paketës fiskale si dhe për subjektet që kryejnë punime ndërtimit aplikon tarifën ndotjes, shërbimit, për kohëzgjatjen e kantierit të ndërtimit.

Sa më sipër nuk përmbushin parashikimet e dispozitave ligjore të zbatueshme për prokurimin publik sipas nenit 7 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, dhe pikës 4 të nenit 39 të VKM me nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.

Sa më sipër mbanë përgjegjësi njësin e prokurimit me përbërje: znj. D.K, z. A.M si dhe z.M.N.

b-Në lidhje me zhvillimin e procedurës dhe vlerësimin e ofertave nga KVO.

Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 9 OE, për të cilët, referuar procesverbalit nr. 3169/15, të datës 25.04.2023, KVO-ja ka kryer në SPE vlerësimin dhe klasifikimin përkatës si më poshtë:

Nr	Operatori ekonomi	Oferta lekë pa Tvsh	Kualifikuar/S'kualifikuar
1	L	10,705,467	S'kualifikuar; Operatori "L" shpk, pasi paraqiti dokumentacionin provues, rezultoi se dokumentacioni i dorëzuar kishte mangësitë e mëposhtme: Në licencën e zbatimit të shoqërisë "E" drejtuesi teknik V.SH është i deklaruar, ndërsa në licencën e re të shoqërisë "L" TVSH nuk është i deklaruar si drejtues teknik sipas shtojcës 8 të paraqitur nga dokumentacioni i dorëzuar fizikisht. Nuk plotësoni dokumentacionin për mjetin autobitumatrice sipas kriterve të vecanta të kualifikimit pasi mjeti me targë AA314XA është kamioncinë 3.5 ton sipas lejes së qarkullimit dhe fotos së dokumentur e cila nuk ka depozitë të montuar për primer si dhe elementët shtesë për kryerjen e punimeve. Ju nuk keni paraqitur foto për mjetet dhe pajisjet si: minifadromë, betoniere dhe gjeneratorë. Nuk keni paraqitur foto për pajisjen "depozitë uji >1000 litra", fotoja e paraqitur është depozitë naftë.
2	C	10,824,055	Kualifikuar
3	LL	10,824,109.2	
4	S	10,999,990	S'kualifikuar; "S" shpk, Fier, me Nr. NIPT K...Ë ka mungesë të dokumentacionit si më poshtë : Nuk plotëson pikën 2.3.5 Punonjës të specializuar/ të kualifikuar dhe 2.3.6 Kapaciteti teknik-fuqi punetore Mungon 1 inxhinier ndërtimi, 2 karpentier, 3 pllakashtrues, 1 specialist shtresash rrugore, 1 hidraulik, 1 shofer, 2 manovratorë, pasi punonjësit K.SH (Inxhinier ndërtimi dhe hidroteknik), P.G (pllakashtrues), E.M (Pllakashtrues), S.M (Pllakashtrues), B.D (Specialisht për shtresat rrugore), V.S (hidraulik), R.H (shofer), R.P (manovrator), I.P (manovrator), janë të angazhuar tek procedura "Rikonstruksioni i çerdhes Patos me hapësirat përreth", i cili është në proces pune.
5	A	11,009,213	S'kualifikuar; "A" shpk, Fier, me Nr. NIPT K...C ka mungesë të dokumentacionit si më poshtë: Mungon Bilanci i vitit 2020. Nuk plotëson pikën 2.3.5 Punonjës të specializuar/ të kualifikuar dhe 2.3.6 Kapaciteti teknik-fuqi punetore. Mungon 1 inxhinier hidrotekik, 1 teknik ndërtimi, 2 karpentier, 2 pllakashtrues, 1 hidraulik, 1 shofer, pasi S.GJ (inxhinier hidroteknik), P.V(teknik ndërtimi), L.R dhe E.D (karpentier), K.GJ dhe Xh.XH (pllakashtrues), R.F (hidraulik), F.R (shofer), janë të angazhuar tek procedura "Rikonstruksion dhe adaptim i ish kopshtit Verbas në qendër ambulatorë". Nuk plotëson pikën 2.3.7 Mjetet dhe pajisjet Mungon 1 kaminocinë me aftësi mbajtëse deri në 3 ton, pasi mjeti me targa AB54FJ dhe leje qarkullimi FRD00021122, dhe pajisjet si betoniere dhe vibrator betoni janë të angazhuara tek procedura "Rikonstruksion
6	B.O.E. A dhe A	11,136,229	S'kualifikuar; BOE «A » shpk, me Nr. NIPT L...E & «A » shpk, me Nr. NIPT J...Ë ka mungesë të dokumentacionit si më poshtë: Nuk plotësoni pikën 2.3.8, pasi mungon licenca profesionale nga qendra Kombëtare e Licensimit Kodi III.2.B.
7	I	11,461,563.6	S'kualifikuar; I shpk, me Nr. NIPT K...Q ka mungesë të dokumentacionit si më poshtë: Nuk plotëson pikën 2.3.6 Kapaciteti teknik-fuqi punetore Mungon 1 teknik ndërtimi, 1 pllakashtrues, 1 punëtor i thjeshtë, 1 shofer dhe 3 manovratorë, pasi F.K (teknik ndërtimi), D.S (pllakashtrues), B.L

Nr	Operatori ekonomi	Oferta lekë pa Tvsh	Kualifikuar/S'kualifikuar
			(puntor), I.Z(shofer), A.B, A.S, G.G (manovratorë), janë të angazhuar tek procedura “Përmirësimi i banesave sociale për familjet në nevojë”. Nuk plotëson pikën 2.3.7 Mjete dhe pajisjet Mungon 1 mjet kamion, pasi mjeti kamion me tragë AA629NA dhe nr. leje qarkullimi KOD0086421 është i angazhuar tek procedura “Përmirësimi i banesave sociale për familjet në nevojë”.
8	SH	11,531,678	Kualifikuar;
9	R	11,799,107	Kualifikuar;

Nga KVO është mbajtur Raporti përmbledhës më datë 15.05.2023, në të cilin është përshkruar e gjithë procedura e ndjekur deri në shpalljen e fituesit. Sipas këtij Raporti përmbledhës dhe formularit të njoftimit të fituesit, nga 9 operatorë pjesëmarrës janë s'kualifikuar 6 OE, janë kualifikuar 3 OE. Në përfundim, mbi bazën e Raportit përmbledhës, Titullari i AK më datë 15.05.2023 ka shpallur fituese ofertën e shoqërisë “C” shpk për të cilën është lidhur kontrata datës 22.05.2023 për vlerën **10,824,055** lekë pa TVSH dhe vlera **12,988,866** lekë me TVSH, dhe me afat 4 muaj nga data e lidhjes së kontratës.

- Nga shqyrtimi i ofertës fituese, rezulton se OE nuk përmbush të gjitha kriteret e vendosura në DST dhe konkretisht:

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga OE i shpallur fitues, rezulton se referuar vetdeklarimit dhe sipas listëpagesa e Kontributeve të sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatami mbi të ardhurat nga punësimi OE “C” ShPK ka deklaruar sipas formularit 8, të punësuar në kompani ka deklaruar manovratorë z. F.L. i punësuar pranë shoqërisë sipas kontratës së punës, figuron në listë pagesa me Kod punësimi 8322.01 – shofer dhe z. E.M. i punësuar pranë shoqërisë sipas kontratës së punës, figuron në listë pagesa me Kod punësimi 7123.03 – suvatues, në kundërshtim me VKM nr. 514, datë 20.09.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve LKP të Rishikuar”

Konkluzion: Sa më sipër OE nuk plotëson kriteret e vendosur në DST dhe në këto kushte KVO nuk duhet të kishte kualifikuar OE “C” ShPK, si dhe nuk duhet t’i kishte propozuar titullarit shpalljen fitues të tyre. Në këto kushte, KVO ka vepruar në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, sipas neneve të mëposhtëm:
- nenin 92 “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3.
Sa më sipër mbanë përgjegjësi KVO me përbërje: z. SH.B, znj. J.SH, si dhe znj. B.M.

7. Të dhëna mbi objektin e prokurimit: “Blerje autobot uji

a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje autobot uji”.			
1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit “E Thjeshtuar” REF-88653-11-12-2023 Urdhri Nr.3068prot datë 20.11.2023 nr. 36	1.1 Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe fondit limit datë 26.10.2022 Ing. B.M	2 Njësia e Prokurimit 1. F.K 2. Ing. B.M 3. SH.XH	3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhri nr. 3068/1 prot., datë 20.11.2023. 1. S.M 2. N.H 3. S.M
4. Fondi Limit (pa tvsh) 6,143,064 lekë	5. Oferta fituese, vlera fituese: Operatori Fitues: 5,885,000 lekë pa tvsh.		6. Diferenca me fondin limit 258,064 lekë pa tvsh

7/1 Data e hapjes së tenderit: Data 04.12.2023 ora 11:00	8. Burimi Financimit Vetë financim. Fonde të kushëzuara të buxhetit të shtetit për vitin 2023 për mbrojtjen civile	9. Operatorët Ekonomikë R SHPK b) S'kualifikuar XX c) Kualifikuar XX B/OE R SHPK
7/2 Kohëzgjatja e kontratës: 10 ditë		
10. Ankimime AK-s'ka APP-s'ka KPP-s'ka	11. Data e lidhjes të kontratës: Nr. 3068/13 prot., datë 19/12/2023	12. Përgjigje Ankesës nga APP, AK apo KKP: AK NUK KA

a-Në lidhje me “Argumentimin dhe Hartimin e Kriteve”:

Kërkesat e veçanta të kualifikimit janë hartuar nga komisioni i përbërë prej (Ishinier Ndërtimi: B.M, Ekonomist F.K dhe Jurist SH.XH), të cilat janë evidentuar në procesverbalin e datës Nr.3068/2 prot., datë 22.11.2022, nuk u konstatuan probleme Nga dokumentacioni pjesë e dosjes së prokurimit ***në lidhje me “Hartimin e Specifikimeve Teknike”***

b-Në lidhje me zhvillimin e procedurës dhe vlerësimin e ofertave nga KVO.

Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 1 OE, për të cilët, referuar procesverbalit nr. 3068/4prot, të datës 05.12.2023, KVO-ja ka kryer në SPE vlerësimin dhe klasifikimin përkatës si më poshtë:

Nr	Operatori ekonomi	Oferta lekë pa Tvsh	Kualifikuar/S'kualifikuar
1	R	5,885,000	Kualifikuar R

Nga KVO është mbajtur Raporti përmbledhës Nr.2840/15 10.02.2023, në të cilin është përshkruar e gjithë procedura e ndjekur deri në shpalljen e fituesit. Sipas këtij Raporti përmbledhës dhe formularit të njoftimit të fituesit, nga 1 operatorë pjesëmarrës janë s'kualifikuar 0 OE, janë kualifikuar 1 OE. Në përfundim, mbi bazën e Raportit përmbledhës, Titullari i AK Nr. 3068/1 lprot datë datë 13.12.2023 ka shpallur fituese ofertën e shoqërisë “R” për të cilën është lidhur kontrata datë **nr. 3068/13 prot., datë 19/12/2023** për vlerën 5,885,000 lekë pa TVSH dhe vlera 7,062,000 lekë me TVSH, dhe afat 10 ditë nga data e lidhjes së kontratës.

Konkluzion: Arrihet në përfundimin se ky operator i plotëson të gjitha kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të vendosura në DST dhe vendimi i KVO për shpalljen fitues të këtij operatori është i drejtë.

➤ **Mbi Procedurat e prokurimit të blerjeve me vlerë të vogël [BVV] për periudhën 01.01.2023 deri më 31.12.2023**

Për auditimin e kësaj procedure, u kërkua ky dokumentacion: regjistri i Parashikimeve 2023 dhe gjithë ndryshimet e miratuara; Regjistri i Realizimeve 2023; Ditari i bankës 2023.

Bashkia Patos çdo vit realizon blerje të punëve, furnizimit me mallrave ose shërbime nëpërmjet edhe procedurave të prokurimit me vlerë të vogël, në zbatim të Ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe paketës së Udhëzimeve të MF – APP.

Nga auditimi mbi dokumentacionin e kërkuar dhe të vënë në dispozicion nga Njësia e Prokurimit për blerje të vogla dhe Drejtoria e Financës, rezultoi si më poshtë vijon:

- Komisioni i prokurimit me vlerë të vogël për vitin 2023 është ngritur me Urdhrin e Kryetarit nr. 05 prot., datë 04.01.2023 i ndryshuar me atë nr. 181 datë 25.09.2023 i ndryshuar me atë nr. 210 datë 14.11.2023 dhe ka këtë përbërje:

Komisioni i Blerjeve e Vlerë të vogël Viti 2023				
Urdhri nr. 05 datë 04.01.2023	Urdhri nr. 181 datë 25.09.2023	Urdhri nr. 210 datë 14.11.2023	Pozicioni në komision	Njësia në strukturë
D.K	D.K	F.K	kryetar	NJP
M.N	SH.XH	SH.XH	anëtar	
F.K	F.K	M.N	anëtar	

Punoi: Grupi auditimit

Nga auditimi mbi dokumentacionin e vendosur në dispozicion, nga Njësia e Prokurimit dhe Drejtoria Financës për periudhën raportuese objekt i procesit të auditimit (nga data 01 janar deri 31 dhjetor 2023), lidhur me regjistrin e parashikimeve të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël rezultoi se ky regjistër ka pësuar 7 ndryshime (shtim procedurash) nga regjistri fillestar, si më poshtë:

Nr.	Regjistri i parashikimeve 2023		
	Regjistri i Parashikimeve	Numri i procedurave BVV	Vlera totale e llogaritur
1	Plani fillestar	40 nga këto 4 procedura janë të trashëguara në vlerën 3,225,732 lekë	18,781,705
2	Plani i ndryshuar datë 18.07.2023	1 i ri + 1 modifikuar	1,304,166
3	Plani i ndryshuar datë 21.07.2023	1 i ri + 1 i modifikuar	797,210
4	Plani i ndryshuar datë 04.09.2023	1	234,155
5	Plani i ndryshuar datë 13.09.2023	1 i ri + 1 i modifikuar	586,671
6	Plani i ndryshuar datë 22.09.2023	1	235,103
7	Plani i ndryshuar datë 12.10.2023	6	1,384,019
7	Totali	54	23,323,029

Burimi: Bashkia Patos/KBVV

Konstatim: Nga auditimi dhe informacioni i pasqyruar në tabelë rezultoi se ka një numër të lartë të ndryshimeve në regjistrin e parashikimeve për procedurat BVV për vitin 2023, në moszbatim Ligji nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” neni 2/b; VKM nr. 285/2021 “Procedurat e prokurimit publik” neni 1/b, neni 8/7, Kjo ka ardhur si rezultat i mungesës së analizave dhe të studimit të nevojave për mallra, shërbime e punë.

Referuar Regjistrin të parashikimeve dhe Regjistrin të realizimeve të procedurave të blerjeve me vlerë të vogël, pasqyrohen në tabelën e mëposhtme:

Tipi i kontratës	Planifikimi 2023		Realizimi 2023		Mbetur nga plani	
	Numri	Fondi limit	Numri	Vlera e kontratës	Numër	vlerë
Mallra	35		65			
Shërbime	18		29			
Punë	1		1			
Nëntotali I	54	23,323,029	93	17,212,133		6,110,896
Mallra			10			
Shërbime			2			
Punë			-			
Nëntotali II (shtuar)			12	698,881		(-)698,881
Totali	54	23,323,029	105	17,911,014		5,412,015

Nga auditimi dhe informacioni i pasqyruar në tabelën respektive, rezulton se ka një numër të lartë të ndryshimeve në regjistrin e parashikimeve për procedurat BVV për vitin 2023, në moszbatim Ligji nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” neni 2/b; VKM nr. 285/2021 “Procedurat e prokurimit publik” neni 1/b, neni 8/7, Kjo ka ardhur si rezultat i mungesës së analizave dhe të studimit të nevojave për mallra, shërbime e punë;

2. Referuar regjistrin të parashikimeve, u konstatua se nuk jepet përshkrim i qartë mbi procedurën nëse përfshin përvec mallrave dhe shërbimit nga OE edhe magazinimin apo jo në ambientet e tij apo në ato të bashkisë, si në rastin e "Blerje medikamente mjekësore" dhe “Blerje produkte pastrimi - detergjentë” në kundërshtim me nenin 1 pika 2 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

1. 3. Nga auditimi mbi regjistrin e parashikimeve për blerje me vlerë të vogël pasqyruar edhe në tabelat respektive, u konstatua se: për mallra/grupmallra dhe shërbime/grupshërbime të njëjta, janë parashikuar me copëzim të fondit në 12 raste, prej të cilave në 3 raste me vlera në tejkallim të vlerës limit prej 1,000,000 lekë, respektivisht vlera totale të fondit limit pa tvsh për G1 - 2,087,667 lekë, G4 - 1,416,667 lekë, G6 - 1,182,128 lekë, G9 -1,766,666 lekë, G10 – 1,083,333 lekë dhe G12 – 937,500 (+) lekë. Për sa më lart rezulton në kundërshtim me nenin 11 dhe nenin 56 pika 2 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Udhëzimi nr. 4 datë 18.06.2021 “Për hartimin e regjistrin të parashikimeve të procedurave të prokurimit publik dhe regjistrin të realizimeve të procedurave të prokurimit dhe krijimi i tyre në sistemin e prokurimit elektronik”, Udhëzimi nr.5 datë 25.06.2021 “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, Udhëzimi nr. 05, datë 29.07.2022 “Për disa ndryshime në manualin teknik që shoqëron Udhëzimin nr. 05, datë 25.06.2021 "Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike".

2. -Gjithashtu u konstatua se: për mallra/grupmallra apo shërbime/grupshërbime ka copëtim të fondit në vlera nën 100,000 lekë në 10 raste, konkretisht: G2/25 – 83,333 lekë, G3/28 & G3/29 – 83,333 lekë secili, G5/12 – 75,000 lekë, G6/34 – 83,333 lekë, G7/42 – 83,333 lekë, G7/43 – 70,723 lekë, G7/47 – 53,439 lekë, G10/23 – 83,333 lekë, G11/15 – 62, 905 lekë.

4. Nga auditimi i regjistrin të parashikimeve për vitin 2023 dhe informacioni i pasqyruar në tabelën e procedurave të parashikuara, rezulton se: nr.11 “Blerje materiale pastrimi-detergjentë”/mallra; nr. 20 “Shërbime e mirëmbajtje mjetesh” /shërbime dhe nr. 48 “Blerje baze materiale për rikonstrukcionin e banesave sociale” /mallra, u konstatua se edhe pse në të njëjtën vlerë të fondit limit, dy procedurat e para (nr. 11 dhe nr. 20) i janë nënshtruar prokurimit BVV ndërsa procedura e tretë (nr. 48) i është nënshtruar procedurës së hapur, referuar nenit 41, pika 3 e Ligjit nr. 162 dt. 23.12.2020 “Mbi prokurimin publik” i ndryshuar. Nga ana e NJP nuk janë dhënë detaje në përshkrimin e procedurës, për të saktësuar arsyet e përzgjedhjes së procedurës së prokurimit në secilin rast, në moszbatim të VKM nr. 285/2021 datë 21.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar neni 2 pika 2/a,b,ç, neni 11 pika 1/c, pika 2, pika 3 dhe neni 12.

5. Nga auditimi i regjistrin të parashikimeve dhe informacioni i pasqyruar edhe në tabelën përkatëse të tij, **rezulton** se është parashikuar në regjistrin e vitit 2023 procedurë me BVV “Siguracion, kolaudim dhe taksa vjetore e qarkullimit” (me nr. 21) në vlerën e fondit limit prej 437,500 lekë, tek i cili vetëm “siguracioni i mjeteve” duhet përfshirë në procedurën e prokurimit BVV, pasi është shërbim që ofrohet nga OE veprimtaria e të cilëve i nënshtrohet konkurrencës së lirë; ndërsa taksat vjetore të qarkullimit dhe kolaudimi i mjeteve ofrohet vetëm nga një njësi publike – DPSHTRR, njësi varësie e MIE.

6. Nga auditimi i regjistrin të parashikimeve dhe informacioni i pasqyruar edhe në tabelën përkatëse të tij, rezulton se janë parashikuar procedura të cilat janë pjesë e procedurave të nisura më parë

dhe duke u copëtuar apo shkëputur prej tyre, janë klasifikuar te blerjet me vlerë të vogël për vitin pasardhës 2023, konkretisht: procedura me nr. 13 “Blerje benzine për Klubin Sportiv, Sektori Ujitje Kullim dhe Pyje” me fondin limit prej 262,083 lekë; nr. 17 “Blerje dru zjarri dhe pelete druri per ngrohje shkolla M.Matohiti + K.Sheqisht” me fondin limit prej 672,333 lekë, për të cilat duhet të ishin zbatuar pikat 8,9/a,b dhe 10 (sipas rastit) të nenit 12 të VKM nr. 285 datë 21.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

7. Referuar regjistrin të realizimeve dhe informacionit të pasqyruar në tabelën përmbledhëse të procedurave të realizuara për vitin 2023, u përzgjedhën 25 procedura me BVV dhe u kërkuan dosjet përkatëse të tyre. Nga auditimi rezultoi se praktikat e procedurave nuk ishin të sistemuara në dosje, gjë që ka sjellë edhe mungesën e inventarizimit të dokumentacionit që përmban procedura e ndjekur.

8. Nga auditimi i regjistrin të realizimeve, janë pasqyruar grupimet për ato mallra/grupmallra e shërbime/grup shërbime që janë të të njëjtit lloj apo natyrë dhe i janë nënshtruar procedurave me copëtim të fondit. U konstatua se janë në total 14 grupime, të cilat duke iu referuar totalit të vlerës së kontratave respektive, rezultojnë se janë katër grupe dhe konkretisht: G7 në vlerën totale 1,604,953.29 lekë; G9 në vlerën 1,546,504.8 lekë; G10 në vlerën 2,313,800 lekë dhe G12 në vlerën 2,200,484 lekë, në kundërshtim me ligjin 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe VKM nr.285/2021 datë 21.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar neni 56 pika 2.

9. Nga auditimi rezultoi se dosjet e përzgjedhura kishin mangësi të theksuar të dokumentacionit, ku “testimi i tregut” ishte procedurë që në të shumtën e rasteve nuk zhvillohej, në kundërshtim me nenin 2, 13 dhe 15 të VKM nr. 285/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar; Urdhri i titullarit për ngritjen e komisioni të marrjes në dorëzim të mallit apo shërbimit, nuk është bërë pjesë e praktikës së procedurës së BVV në moszbatim të nenit 74 pika 3/ ç të VKM nr. 285/2021 “Për “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

- Nga auditimi i procedurave “emergjente”, rezultoi se përveçse dokumentacionit standard, procesverbali i konstatimit të avarisë apo dëmtimit të përpiluar nga personat përgjegjës dhe dokumenti faktik (foto) shoqërues i tij, ose nuk është përpiluar korrekt ose nuk i është bashkëngjitur formularit nr. 4 “Formulari i rasteve të emergjencës”; gjithashtu nuk është bërë pjesë e praktikës as Urdhri i brendshëm me anë të të cilit miratohet çmimi i mallit apo shërbimit (sipas rastit). Në mënyrë të detajuar paraqitet në aneksin nr 1 pika 4.4 bashkëlidhur raportit të auditimit. Veprime apo mosveprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 162 datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Udhëzimi nr. 4 datë 18.06.2021 “Për hartimin e regjistrin të parashikimeve të procedurave të prokurimit publik dhe regjistrin të realizimeve të procedurave të prokurimit dhe krijimi i tyre në sistemin e prokurimit elektronik”, Udhëzimi nr. 5 datë 25.06.2021 “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, Udhëzimi nr. 05, datë 29.07.2022 “Për disa ndryshime në manualin teknik që shoqëron Udhëzimin nr. 05, datë 25.06.2021 "Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike", Udhëzimit nr. 04 datë 20.05.2022, Udhëzimit nr. 1 dt 21.01.2022; Udhëzimit nr. 04 dt. 18.06.2021; Udhëzimit nr. 08.dt 01.09.2021 etj.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme, ngarkohen me përgjegjësi komisioni i BVV:

znj. D.K Kryetare nga dt.04.01.2023 deri në dt. 14.11.2023

z. M.N anëtar nga dt. 04.01.2023 deri në 25.09.2023

z. F.K anëtar/kryetar nga 14.11.2023 e në vijim

z. SH.XH anëtar

3.4.4. Auditim mbi zbatimin e kontratave të punimeve në investimet publike, kolaudimi dhe marrja në dorëzim e punimeve të kryera, sipas kontratave të lidhura me operatorët ekonomikë fitues.

Në zbatim të pikës 4.4 të Programit të Auditimit, në Bashkinë Patos, nga ana e audituesve të KLSH-së, u analizuan regjistrat e investimeve të përfunduara në periudhën e auditimit. Nga kjo analizë, u arsyetua që si objekte me risk në realizimin e punimeve, të cilat janë kërkuar për t'u audituar, janë përzgjedhur në bazë të vlerës së kontratës, llojit të punimeve të ndërtimit, zërave të punimeve të ndërtimit me risk të madh në zbatimin e veprave, të rishikimit të projekteve të zbatimit si dhe të shtyrjes së afatit të përfundimit të punimeve për objektet e paraqitura në tabelë:

Nr	Emërtimi i investimit të kryer	Operatori Ekonomik	Vlera e kontratës (Lekë me TVSH)	Data fillimit të punimeve	Afati i punimeve sipas kontratës	Data e përfundimit të punimeve sipas kontratës dhe shtyrjeve
1	Rikonstruksioni i magjistralit kryesor dhe rrjetit të brendshëm të ujësjellësit qytetit Patos Loti I (Rrjeti shpërndarës)	“T” SHPK	532,867,612.80	01.04.2020	21 muaj	31.12.2021
2	Rikonstruksioni i shkollës “Muhamet Shehu” dhe ndërtimi i palestrës.	“SH” SHPK	85,682,886	07.12.2022	10 muaj	04.10.2023
3	Rikonstruksioni i rrugës Banaj	“N ” SHPK	30,430,183	21.12.2022	6 muaj	26.06.2023
4	Rikonstruksioni Çerdhes Patos me hapësirat përreth.	“S ” SHPK	14,965,001	24.01.2023	5 muaj	19.06.2023
5	Përmirësimi i banesave ekzistuese për familjet në nevojë.	“I” SHPK	16,528,523	29.09.2022	10 muaj	02.10.2023
	SHUMA (Lekë me TVSH)	-	680,474,205.8	-	-	-

Mbështetur sa më sipër, është kryer auditimi i zbatimit të punimeve për periudhën e auditimit 01.01.2023 deri 31.12.2023, për 5 (pesë) kontrata për punë publike në shumën totale **567,061,838.16** lekë pa TVSH ose **680,474,205.80** lekë me TVSH.

Në zbatim të pikës së programit të auditimit, mbi zbatimin e kontratave për punë publike, u shqyrtua dokumentacioni tekniko-ligjor i ndodhur në dosjet e zbatimit ku, në vijim po pasqyrojmë Problematikat dhe Rekomandimet përkatëse si më poshtë:

1. Nga auditimi i zbatimit të punimeve për objektin: **“Rikonstruksioni i magjistralit kryesor dhe rrjetit të brendshëm të ujësjellësit qytetit Patos Loti I (Rrjeti shpërndarës)”** Bashkia Patos me të dhënat e përgjithshme sipas tabelës

13. Zbatimi i Kontratës së Punimeve “Rikonstruksioni i magjistralit kryesor dhe rrjetit të brendshëm të ujësjellësit qytetit Patos Loti I (Rrjeti shpërndarës)” Bashkia Patos.		
14.Lidhja e kontratës: nr. 2214/21 prot., datë 31.03.2020	15.Vlera e kontratës Vl e prev ofertues 532,867,612.8 lekë me Tvsh. Vl e prev të rishikuar 532,268,535.26,426.01 lekë me TVSH	16.Likuiduar/situacionet: Sit. 1 në vlerën 55,253,804.30 lekë me TVSH (periudha 01.04.2020-27.06.2020) Sit. 2 në vlerën 69,476,973.83 lekë me TVSH (periudha 28.06.2020-27.11.2020) Sit. 3 në vlerën 42,388,216.8 lekë me TVSH (periudha 28.11.2020-28.12.2020) Sit. 4 në vlerën 124,564,566.69 lekë me TVSH (periudha 02.04.2020-03.01.2021)
17- Situacioni Përfundimtar	18.Afati i kontratës: Fillimi punimeve: 01.04.2020	19. Zgjatja e kontratës 92 ditë

- Sit përf në vlerën 240,573,858.33 lekë me TVSH	Përfundimi punimeve: Datë 31.12.2021	
20. Mbikëqyrësi i punimeve “G” SHPK	Licenca MK.1676/12	Kontratë me nr. 2506/12 prot., datë 31.03.2020
21. Kolaudatori i punimeve 1. F.SH 2. A.M (C) 3. Inxh. M.K	Licenca MK.3544 Licenca MK. 0722/1 Licenca MK. 1200/4	Kontratë me nr. 2214/28 prot., datë 04.04.2020
22. Akt Kolaudimi. Datë nga 20.07.2022	23. Akt i marrjes në dorëzim të përkohshme: Me datë 29.07.2022.	

ku rezultoi me problematikat, si vijon:

Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me objekt “Rikonstruksioni i magjistralit kryesor dhe rrjetit të brendshëm të ujësjellësit qytetit Patos Loti I (Rrjeti shpërndarës)” Bashkia Patos, me vlerë 532,867,612.80 lekë me TVSH, fituar nga shoqëria “T” SHPK, rezultuan punime ndërtimi të pakryera në volumet e situacionuara, në vlerën **7,574,268 lekë pa TVSH** dhe, më konkretisht:

I. RRJETI SHPËRNDARËS QENDËR PATOS.

Zëri 4 (An) Prerje asfalti me makineri (Linjat e ujësjellësit rrjeti shpërndarës Qendër Patos).

Preventivi ofertues pasqyron volumin 9,300 ml dhe preventivi i ripunuar pasqyron volumin 18,408 ml me çmim 100 lekë. Situacioni përfundimtar pasqyron volumin 18,407.6 ml me çmim 100 lekë. Libreza e masave pasqyron volumin 18,407.6 ml prerje asfalti, pasqyruar në mënyrë analitike.

Nga auditimi i librezës së masave mbi pasqyrimin e këtij zëri pune konstatohet se, në pasqyrimin e prerje asfalti tek pusetat vertikale të shpërndarjes janë bërë gabime në llogaritjen e volumit, ku njësia është marrë në m² dhe jo në ml, konkretisht janë pasqyruar 1,116.2 m² prerje asfalti ku ndërkohë rezultojnë 380 ml. Pra, punë e kryer rezulton 18,299 ml dhe jo 18,407.6 ml.

Sa më sipër, diferenca prej 108.6 ml është pasqyruar tepër në librezën e masave dhe në situacionin përfundimtar, duke u përfutur në mënyrë ta parregullt nga sipërmarrësi i punimeve, në shumën **10,860 lekë pa TVSH** [108.6 ml x 100 lekë].

Për sa konstatuar më sipër, shoqëria mbikëqyrëse “G” SHPK, kontraktori i punimeve “T” SHPK, Kolaudatorët e punimeve F.SH, A.M, M.K, me shkresën nr. 25/1, datë 30.04.2024 (protokolluar në KLSH me nr. 30/7 prot., datë 30.04.2024) ka bërë komente dhe shpjegime për projekt raportin e auditimit, lidhur me problematikat e konstatuara nga grupi i auditimit si vijon:

Pretendimi i subjektit:

Referuar konstatimit tuaj në lidhje me “zëri 4 (An) Prerje asfalti me makineri (Linjat e ujësjellësit rrjeti shpërndarës Qendër Patos)”, si dhe mbështetur në librezat e masave dhe vizatimeve të situacionit përfundimtar sipas llogaritjeve të bëra gjykimi juaj është i pa saktë. Referuar llogaritjeve të paraqitura në tabelën e mëposhtme, llogaritja është bërë duke shumëzuar gjatësitë mesatare të prerjes të prerjes në pusetë me numrin total të kolonave të furnizimit me ujë. Sqaruar si më poshtë 3.4 ml (gjatësi mesatare e zonës së pusetës) = 659.60 ml prerje asfalti.

Nr.An.	Zeri i Punimeve	Njesia	Sasia	Faktoret			Prodhimi		Shuma progresive (m)	
				Gjatesia L (m)	Gjeresia B (m)	Thellessia H (m)	Pozitive	Negative		
A.LINJAT E UJESJELLESIT RRJETI SHPERNDARES QENDER PATOS										
An	Prerje asfalti me makineri									
	Prerje asfalti tek pusetat vertikale te shpemdajes									
68	Per linjat me 8 abonente	Asfalt	m	194	3.40	-	-	659.600	0.00	17,919.0
69	Per linjat me 7 abonente	Asfalt	m	52	4.20	-	-	218.400	0.00	18,137.4
70	Per linjat me 6 abonente	Asfalt	m	42	2.00	-	-	84.000	0.00	18,221.4
71	Per linjat me 5 abonente	Asfalt	m	11	5.00	-	-	55.000	0.00	18,276.4
72	Per linjat me 4 abonente	Asfalt	m	8	6.80	-	-	54.400	0.00	18,330.8
73	Per linjat me 9 abonente	Asfalt	m	8	3.80	-	-	30.400	0.00	18,361.2
74	Per linjat me 10 abonente	Asfalt	m	6	2.40	-	-	14.400	0.00	18,375.6
	Prerje asfalti tek linjat e kasetave metalike									
75		Asfalt	m	1	32.00	-	-	32.000	0.00	18,407.6
	Sasia totale		m							18,407.58

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Ju sqarojmë se:

-Së pari: Tabela e paraqitur në observacion nuk është e njëjtë me volumet e pasqyruara në librezën e masave të administruar në Bashkinë Patos në dosjen teknike të zbatimit, e cila konsiderohet dokument zyrtar dhe, rezulton thjesht një dokument i hartuar mbas konstatimit të problematikës nga grupi i auditimit, pra është hartuar thjeshtë sa për observacionin e paraqitur nga ana juaj.

-Së dyti: Konkluzioni i arritur nga grupi i auditimit, është bazuar në librezën e masave faktike të administruar në dosjen teknike në Bashkinë Patos, e cila në kuptimin ligjor, mbështetur në **UKM Nr. 3**, datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, pika 3.2 ku citon se: *“Libreza e masave për punimet e ndërtimit është dokumentacioni bazë për verifikimin e saktësisë së vëllimeve të punimeve të ndërtimit, të vendosura në situacion. Kjo librezë hartohet nga drejtuesi teknik i objektit dhe firmoset nga ai, nga mbikëqyrësi i punimeve dhe nga përfaqësuesi ligjor i sipërmarrësit, për të cilin është miratuar leja e ndërtimit”.*

Kjo tabelë (ky dokument) nuk disponohet në dosjen teknike në Bashkinë Patos, aq më tepër që nuk është nënshkruar nga drejtuesi teknik i objektit, nga mbikëqyrësi i punimeve dhe nga përfaqësuesi ligjor i sipërmarrësit, pra nuk është dokument zyrtar.

Sa më sipër trajtuar, ju nuk keni sjellë argumente që vërtetojnë të kundërtën e konstatimit të grupit të auditimit dhe, në këto kushte observacioni **nuk merret në konsideratë.**

Zëri 1 (3.89/a) Gërmim dheu me ekskavator goma 0.25 m³, në kanale gjerësi deri 2 m, tokë zak, kategoria III, me shk në mjet.

Preventivi i rishikuar pasqyron 24,449 m³ gërmim dheu me çmim 450 lekë. Situacioni përfundimtar pasqyron 24,449 m³ gërmim dheu me çmim 450 lekë.

Konstatim: Volume të librezuara dhe situacionuara tepër në zërin e gërmim dheu me ekskavator në hapjen e trasesë për **Tuba e rekorderi ujësjellësi PE d=50 mm, PN 16 + FV Tuba e rekorderi ujësjellësi PE d=50 mm, PN 10**, argumentuar si vijon:

Referuar pasqyrimin në librezën e masave mbi hapjen e trasesë për (FV Tuba e rekorderi ujësjellësi PE d=50 mm, PN 16 + FV Tuba e rekorderi ujësjellësi PE d=50 mm, PN 10), rezulton se sipas zërit 1(3.89/a) “ Gërmim dheu me ekskavator goma 0.25 m³, në kanale gjerësi deri 2 m, tokë zak, kategoria e tretë, me shk në mjet” është gërmuar (hapur trase kanali) për gjatësinë totale **6,772.32 ml**, ndërkohë që janë vendosur në total **5,207.40 ml** tuba (Tuba e rekorderi ujësjellësi PE d=50mm, PN 16 + Tuba e rekorderi ujësjellësi PE d=50mm, PN 10).

Sa më sipër, rezultojnë **1,564.92 ml (Gërmim dheu me ekskavator goma 0.25 m³)** më tepër se sa gjatësia e vendosjes së tubit PE d=50 mm PN 16 dhe PN 10, duke u përfituar nga sipërmarrësi i punimeve, më tepër në volumin **1,369.305 m³** gërmim {1,564.92 ml x [0.7 m (gjerësia e kanalit)

x 1.25 m (thellësia mesatare e gërmuar)]} ose në vlerën **616,187 lekë pa TVSH** [1,369.305 m³ x 450 lekë].

Për sa konstatuar më sipër, shoqëria mbikëqyrëse “G” SHPK, kontraktori i punimeve “T” SHPK, Kolaudatorët e punimeve F.SH , A.M , M.K , me shkresën nr. 25/1, datë 30.04.2024 (protokolluar në KLSH me nr. 30/7 prot., datë 30.04.2024) ka bërë komente dhe shpjegime për projekt raportin e auditimit, lidhur me problematikat e konstatuara nga grupi i auditimit si vijon:

Pretendimi i subjektit:

Referuar konstatimit tuaj në lidhje me zërin 1 (3.89/11) Gërmim dhe me ekskavator goma 0.25 m³, në kanale gjerësi deri 2 m, toke zak, kategoria III, me shk në mjet, si dhe mbështetur në librezat e masave të zërave Tuba e rekorderi ujësjellësi PE d=50 mm, PN 16 është librezuar 4,389.4 ml tub + FV Tuba e rekorderi ujësjellësi PE d=50 mm, PN 10 është librezuar 818 ml tub dhe në total janë librezuar gjithsej 5,207.4 ml tub.

Në bazë të volumeve në librezën e masave dhe të situacionuara për Gërmim dhe me ekskavator goma 0.25 m³, në kanale gjerësi deri 2 m, toke zak, kategoria III, me shk në mjet janë: librezuar gjithsej:

Rrjeti shpërndarës, në gjatësinë 3,008.28 ml kanal me volum 2710.6 m³ gërmim për linjat e rrjetit shpërndarës.

Linja shtesë, në gjatësinë 65 ml

Linjat e lidhjeve të pallateve: Volumi i gërmimit të marrë në librezë është zero, si rrjedhojë nuk duhet të përfshihet kjo gjatësi tek llogaritja totale e trasesë.

Për zërin 3.45/1 Gërmim kanalesh në tokë të zakonshme, me krahë, me seksion deri 0.75 m² janë librezuar gjithsej:

-737.12 ml kanal me volum 692.33 m³ gërmim për linjat e rrjetit shpërndarës

-704.2 ml kanal me volum 338.94 m³ gërmim për linjat shtesë

-749.2 ml kanal me volum 629.33 m³ gërmim për linjat e lidhjeve të pallateve

Linjat e lidhjeve të pallateve. Volumi i gërmimit të marrë në librezë është zero, si rrjedhojë nuk duhet të përfshihet kjo gjatësi tek llogaritja totale e trasesë.

*Pra në total janë hapur 3008.28 ml + 222.22 ml + 65 ml + 737.12 + 704.2 – 42 ml = **5,221.80 ml.***

*Në total janë hapur 5,221.80 ml trase kanali (Gërmim dhe me ekskavator me goma 0.25 m³, në kanale gjerësi deri 2 m, tokë zak, kategoria III, me shk. në mjet dhe 3.45/1 - Gërmim kanalesh në toke të zakonshme, me krahë, me seksion deri 0.75 m²) ndërsa janë librezuar **5,207.4 ml Tub d=50 mm Pn16 + Pn10, pra 14.4 ml trase kanali më shumë.***

*Sa më sipër, rezultojnë **14.4 ml** (Gërmim dhe me ekskavator goma 0.25 m³) më tepër se sa gjatësia e vendosjes së tubacionit PN d=50 mm PN 16 dhe PN 10, më tepër në volumin 12.06 m³ gërmim ose në vlerën **5,670 lekë pa TVSH** (12.6 m³ x 450 lekë). Për pasojë, këtë gjatësi kanali volumet në mbushje janë sipas tabelës bashkëlidhur në shumën **15,825.6 lekë pa TVSH.***

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

1. Mbikëqyrësi i punimeve pasqyron gjatësi traseje **5,221.80 ml** ku në fakt sipas librezës në dosjen teknike janë realizuar **6,772.32 ml.**

Lidhur me zërin Gërmim dhe me ekskavator goma 0.25 m³, në kanale gjerësi deri 2 m, tokë zak, kategoria III, me shk në mjet dhe zërin Gërmim kanalesh në toke të zakonshme, me krahë, me seksion deri 0.75 m², nga mbikëqyrësi i punimeve janë zbritur gjatësitë e trasesë në observacion, në volumin **1,550.52 ml** gjatësi traseje (rrjeti shpërndarës, linjat shtesë dhe linjat e lidhjeve të pallateve), ndërkohë që këto volume janë pasqyruar në librezën e masave dhe në situacionin përfundimtar të administruar në Bashkinë Patos. Sa më sipër pretenduar, argumenti nuk qëndron sepse janë bërë modifikime thjeshtë për të rakorduar volumet e konstatuara si mospërputhje. Libreza pjesë e observacionit nuk është e njëjtë me librezën e administruar në dosjen teknike.

2. Nga rishqyrtimi i pasqyrimit të volumeve në librezën e masave mbi hapjen e trasesë për (FV Tuba e rekorderi ujësjellësi PE d=50 mm, PN 16 + FV Tuba e rekorderi ujësjellësi PE d=50 mm, PN 10), rezulton se sipas zërit 1(3.89/a) “ Gërmim dhe me ekskavator goma 0.25 m³, në kanale gjerësi deri 2 m, tokë zak, kategoria e tretë, me shk në mjet” dhe zërit “Gërmim kanalesh në tokë të zakonshme, me krahë, me seksion deri 0.75 m²” është gërmuar (hapur trase kanali) për gjatësinë totale **6,772.32 ml** (514 m + 79.89 m + 100

m + 100 m + 122.07 m + 37 m + 8 m + 129 m + 60.7 m + 25 m + 25 m + 25 m + 25 m + 9.7 m + 136.34 m + 145.51 m + 204 m + 25 m + 20.44 m + 19.42 m + 16.08 + 8.47 m + 20.32 m + 16.17 m + 14.82 m + 25 m + 14 m + 33 m + 22.62 m + 17.6 m + 20.21 m + 39 m + 25 m + 25 m + 20.55 m + 12.92 m + 24.65 m + 38.2 m + 4 m + 36 m + 27 m + 32 m + 19 m + 25.7 m + 13 m + 24.7 m + 19.3 m + 19.6 m + 25.64 m + 22.56 m + 26.8 m + 25 m + 24.28 m + 25.72 m + 22.71 m + 23.92 m + 6.86 m + 61 m + 25 m + 25 m + 11.17 m + 47.84 m + 22 m + 93.8 m + 7.4 m + 46.6 m + 11.14 m + 25 m + 3.86 m + 95.5 m + 160 m + 44 m + 67 m + 20 m + 17 m + 114 m + 50.4 m + 66.3 m + 23 m + 28 m + 42 m + 25 m + 23 m + 27 m + 31.7 m + 35 m + 49.1 m + 27 m + 18 m + 66 m + 39 m + 35.7 m + 89.7 + 28.72 m + 30 m + 15 m + 15 m + 38 m + 43 m + 23 m + 40.4 m + 52 m + 712.12 ml + 1,573.4 ml), **ndërkohë që janë vendosur në total 5,207.40 ml** [4,389.4 ml + 818 ml] tuba (Tuba e rekorderi ujësjellësi PE d=50mm, PN 16 + Tuba e rekorderi ujësjellësi PE d=50mm, PN 10).

Sa më sipër, rezultojnë **1,564.92 ml** [6,772.32 ml (gjatësia e trasesë) – 5,207.40 ml (gjatësi tubacion)] (**Gërmim dheu me ekskavator goma 0.25 m³**) më tepër se sa gjatësia e vendosjes së tubit PE d=50 mm PN 16 dhe PN 10, duke u përfituar nga sipërmarrësi i punimeve, më tepër në volumin **1,369.305 m³** gërmim {1,564.92 ml x [0.7 m (gjerësia e kanalit) x 1.25 m (thellësia mesatare e gërmuar)]} ose në vlerën **616,187 lekë pa TVSH** [1,369.305 m³ x 450 lekë].

Pra kemi, trase e hapur në gjatësinë **6,772.32 ml** dhe tubacion i vendosur në gjatësinë **5,207.40 ml**, pra konstatohet mospërputhje.

Konkluzioni i arritur nga grupi i auditimit, është bazuar nga matjet faktike të pasqyruara në librezën e masave të administruar në dosjen teknike në Bashkinë Patos, e cila në kuptimin ligjor, mbështetur në **UKM Nr. 3, datë 15.02.2001** “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, **pika 3.2** ku citon se: “*Libreza e masave për punimet e ndërtimit është dokumentacioni bazë për verifikimin e saktësisë së vëllimeve të punimeve të ndërtimit, të vendosura në situacion. Kjo librezë hartohet nga drejtuesi teknik i objektit dhe firmoset nga ai, nga mbikëqyrësi i punimeve dhe nga përfaqësuesi ligjor i sipërmarrësit, për të cilin është miratuar leja e ndërtimit*”.

Sa më sipër trajtuar, ju nuk keni argumentuar mospërputhjen ndërmjet gjatësisë së trasesë prej **6,772.32 ml** dhe tubacionit të vendosur në gjatësinë **5,207.40 ml**, dhe, në këto kushte **observacioni nuk merret në konsideratë**.

Për pasojë, për gjatësinë kanali prej 1,564.92 ml, volumet në mbushje janë janë në shumën **1,700,573 lekë** dhe jo sipas tabelës bashkëlidhur në shumën **15,825.6 lekë pa TVSH** siç pretendoni në observacion.

Konstatim: Volume të librezuara dhe situacionuara tepër në zërin e gërmim dheu me ekskavator në hapjen e trasesë për **Tuba e rekorderi ujësjellësi PE d=63 mm, PN 16 + FV Tuba e rekorderi ujësjellësi PE d=63 mm, PN 10**, argumentuar si vijon:

Referuar pasqyrimin në librezën e masave mbi hapjen e trasesë për (FV Tuba e rekorderi ujësjellësi PE d=63 mm, PN 16 + FV Tuba e rekorderi ujësjellësi PE d=63 mm, PN 10), rezulton se sipas zërit 1(3.89/a) “Gërmim dheu me ekskavator goma 0.25 m³, në kanale gjerësi deri 2 m, tok zak, kategoria e tretë, me shk në mjet” është gërmuar (hapur trase kanali) për gjatësinë totale **4,782 ml**, ndërkohë që janë vendosur në total **4,131.4 ml** tuba (Tuba e rekorderi ujësjellësi PE d=63 mm, PN 16 + Tuba e rekorderi ujësjellësi PE d=63 mm, PN 10).

Sa më sipër, rezultojnë **650.60 ml** (**Gërmim dheu me ekskavator goma 0.25 m³**) më tepër se sa gjatësia e vendosjes së tubit PE d=63 mm PN 16 dhe PN 10, duke u përfituar nga sipërmarrësi i punimeve, më tepër në volumin **569.275 m³** gërmim {650.60 ml x [0.7 m (gjerësia e kanalit) x 1.25 m (thellësia mesatare e gërmuar)]} ose në vlerën **256,174 lekë pa TVSH** [569.275 m³ x 450 lekë].

Për sa konstatuar më sipër, shoqëria mbikëqyrëse “G” SHPK, kontraktori i punimeve “T” SHPK, Kolaudatorët e punimeve F.SH, A.M, M.K, me shkresën nr. 25/1, datë 30.04.2024 (protokolluar në KLSH me nr. 30/7 prot., datë 30.04.2024) ka bërë komente dhe shpjegime për projekt raportin e auditimit, lidhur me problematikat e konstatuara nga grupi i auditimit si vijon:

Pretendimi i subjektit:

Referuar konstatimit tuaj në lidhje me zërin 1 (3.89/11) **Gërmim dheu me ekskavator goma 0.25 m³, ne kanale gjerësi deri 2 m, toke zak, kategoria III, me shk në mjet, si dhe mbështetur në Librezat e masave të zërave Tuba e rekorderi ujësjellësi PE d=63 mm, PN 16 është librezuar 839 ml tub + FV Tuba e rekorderi ujësjellësi PE d=63 mm, PN 10 është librezuar 3,292.4 ml tub dhe në total janë librezuar gjithsej 4,131.4 ml tub.**

Në bazë të volumeve në librezën e masave dhe të situacionuara për **Gërmim dheu me ekskavator goma 0.25 m³, ne kanale gjerësi deri 2 m, toke zak, kategoria III, me shk në mjet janë librezuar gjithsej:**

- **2,030.87 ml kanal me volum 1,836.93 m³ gërmim për linjat e rrjetit shpërndarës**
- **196 ml kanal me volum 174.93 m³ gërmim për linjat shitesë**
- **Linjat e lidhjeve të pallateve. Volumi i gërmimit të marrë në librezë është zero, si rrjedhojë nuk duhet të përfshihet kjo gjatësi tek llogaritja totale e trasesë.**

Për zërin 3.45/1 **Gërmim kanalesh në tokë të zakonshme, me krahë, me seksion deri 0.75 m² janë librezuar gjithsej:**

- **808.4 ml kanal me volum 685.5 m³ gërmim për linjat e rrjetit shpërndarës, përkatësisht (32 ml + 233.7 ml + 50 ml + 50 ml + 44.5 ml + 60 ml + 50 ml + 25 ml + 17.04 ml + 89.14 ml + 30.6 ml + 33.76 ml + 21.92 ml + 10.72 ml + 26.48 ml + 33.53 ml)**
- **120 ml kanal me volum 100.8 m³ gërmim për linjat shitesë**
- **838.4 ml kanal me volum 629.33 m³ gërmim për linjat e lidhjeve të pallateve**

Në total janë hapur **3,993.66 ml** trase kanali, ndërsa janë librezuar 4,131.40 ml Tub d=63mm Pn16+Pn10, pra **137.74 ml** tub më shumë.

Në disa piketa ka kalim në kanal dhe kalim në tombino, ku merret vetëm gjatësi tub dhe jo kanali, referuar Librezës masave për zërin “Kalimet e tubacioneve në kanale”, në piketën Rr.shp.10 (Pk.9- Pk.1 0) dhe Rr.shp.109 (Pk.11-Pk.12) ka kalim tub në gjatësinë 5.5+6=11.5 ml. Prandaj gjatësi traseje kanali duhet të krahasohet me gjatësinë e tubit **4,119.9 ml** (4131.4 gjatësi totale -11.5 gjatësi në kalime = 4,119.9 ml).

Si rezultat **konstatojmë dhe pranojmë gabimin** për zërat Tuba e rekorderi ujësjellësi PE d=63 mm, PN 16 + FV Tuba e rekorderi ujësjellësi PE d=63 mm, PN 10 janë përfituar **126.24 ml** Tub d=63mm PN16+PN10 më shumë, argumentuar si më sipër.

Sa me sipër, rezultojnë **126.24 ml** tub (PE d=63 mm PN 16 dhe PN 10+ PE d=63 mm PN 16 dhe PN 116), me tepër në volum së trase kanali e hapur, ose në vlerën **56,808.0 Leke pa TVSH** (126.24 ml x 450) lekë.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Nga shqyrtimi me kujdes i observacionit, audituesi sqaron si më poshtë:

1. Mbikëqyrësi i punimeve mban qëndrime të ndryshme dhe është i pasktë me argumentimin e tij dhe, konkretisht:

- Në observacionin për akt konstatimin nr. 17, shoqëria mbikëqyrëse “G” SHPK, me shkresën nr. 25/1, datë 08.03.2024 (protokolluar në KLSH me nr. 30/3 prot., datë 12.03.2024) flet për gjatësi prej **2,068.7 ml** kanal për linjat e rrjetit shpërndarës, **ndërkohë** që në observacionin për projekt raportin shoqëria mbikëqyrëse “G” SHPK, me shkresën nr. 25/1, datë 30.04.2024 (protokolluar në KLSH me nr. 30/7 prot., datë 30.04.2024) gjatësinë e merr **2,030.87 ml**. Pra konstatohet mospërputhje në gjatësi me një diferencë **67.83 ml**.

2. Për linjat e lidhjeve të pallateve lidhur zëri “**Gërmim dheu me ekskavator goma 0.25 m³, ne kanale gjerësi deri 2 m, toke zak, kategoria III, me shk në mjet**”, shpreheni se volumi i gërmimit të marrë në librezë është zero, si rrjedhojë nuk duhet të përfshihet kjo gjatësi tek llogaritja totale e trasesë. (Ndërkohë që në librezën e masave ky volum pune është i librezuar). **Nga ana tjetër** për zërin “**Gërmim kanalesh në tokë të zakonshme, me krahë, me seksion deri 0.75 m²**”, volumi për linjat e lidhjeve të pallateve është marrë **838.4 ml**. Pra, nga mbikëqyrësi **argumenti jepet me 2 (dy) standrade** dhe nuk jeni bindës për sa pretendoni. **Fakti që Ju arrini në konkluzionin se rezultojnë 126.24 ml tub (PE d=63 mm PN 16 dhe PN 10+ PE d=63 mm PN 16 dhe PN 116), me tepër në volum së trase kanali e hapur, ose në vlerën 56,808.0 Leke pa TVSH (126.24 ml x 450) lekë, në kuptimin teknik në librezën e masave janë pasqyruar volume pune të gabuara.**

3. Pretendimi se, në disa piketa ka kalim në kanal dhe kalim në tombino, ku merret vetëm gjatësi tub dhe jo kanali, referuar Librezës masave për zërin “Kalimet e tubacioneve në kanale”, në piketën Rr.shp.10

(Pk.9- Pk.1 0) dhe Rr.shp.109 (Pk.11-Pk.12) ka kalim tub në gjatësinë 5.5+6=11.5 ml. rezulton gjatësi traseje kanali duhet të krahasohet me gjatësinë e tubit 4,119.9 ml (4131.4 gjatësi totale - 11.5 gjatësi në kalime = 4,119.9 ml), nuk qëndron sepse, në tabelën bashkëlidhur observacionit, për kalimin e tubacioneve në kanale, bëhet fjalë për tuba me diametër 160 mm dhe 90 mm, dhe jo për sa pretenduar nga grupi i auditimit, siç është konstatuar problematika për zërin “**Tuba e rekorderi ujësjellësi PE d=63 mm “FV Tuba e rekorderi ujësjellësi PE d=63 mm, PN 10”**”.

4. Nga riauditimi i pasqyrimin në librezën e masave mbi hapjen e trasesë për (**FV Tuba e rekorderi ujësjellësi PE d=63 mm, PN 16 + FV Tuba e rekorderi ujësjellësi PE d=63 mm, PN 10**), rezulton se sipas zërit 1(3.89/a) “ Gërmim dheu me ekskavator goma 0.25 m³, në kanale gjerësi deri 2 m, tok zak, kategoria e tretë, me shk në mjet” është gërmuar (hapur trase kanali) për gjatësinë totale **4,782 ml** (rrjet shpërndarës + linjat shtesë + linjat e lidhjeve të pallateve) [25 m + 25 m + 25 m + 25 m + 25 m + 25 m + 13.86 m + 50 m + 50 m + 50 m + 50 m + 25.91 m + 32.4 m + 50 m + 50 m + 50 m + 50 m + 50 m + 14 m + 156.98 m + 50 m + 50 m + 50 m + 50 m + 10.95 m + 155.53 m + 85.98 m + 30.06 m + 5.11 m + 15.31 m + 11.21 m + 9.74 m + 11.22 m + 14.64 m + 13.14 m + 17.05 m + 16.05 m + 5.44 m + 7.43 m + 8.93 m + 20 m + 26.9 m + 15.45 m + 21.66 m + 13.56 m + 9.36 m + 21.48 m + 22.31 m + 21.94 m + 15.18 m + 19.03 m + 15.06 m + 10.48 m + 15.91 m + 8.51 m + 5.75 m + 10.42 m + 28.39 m + 21.14 m + 20.88 m + 6.18 m + 11.65 m + 21.32 m + 16.13 m + 9.87 m + 10.93 m + 10.92 m + 15.53 m + 7.35 m + 11.64 m + 23 m + 32 m + 120 m + 126 m + 70 m + 61 m + 36 m + 35 m + 61 m + 36 m + 80 m + 48 m + 25.6 m + 17 m + 16 m + 52 m + 46 m + 50.4 m + 32 m + 39 m + 53 m + 38.4 m + 46 m + 47 m + 19.34 m + 758.39 m + 838 ml], **ndërkohë që** janë vendosur në total **4,131.4 ml** [3,292.4] tuba (Tuba e rekorderi ujësjellësi PE d=63 mm, PN 16 + Tuba e rekorderi ujësjellësi PE d=63 mm, PN 10).

Sa më sipër, rezultojnë **650.60 ml** [4,782 ml gjatësi në hapje traseje – 4,131.40 ml gjatësi tubacioni] (**Gërmim dheu me ekskavator goma 0.25 m³**) më tepër se sa gjatësia e vendosjes së tubit PE d=63 mm PN 16 dhe PN 10, duke u përfituar nga sipërmarrësi i punimeve, më tepër në volumn **569.275 m³** gërmim {650.60 ml x [0.7 m (gjerësia e kanalit) x 1.25 m (thellësia mesatare e gërmuar)]} ose në vlerën **256,174 lekë pa TVSH** [569.275 m³ x 450 lekë].

Pra kemi, trase e hapur në gjatësinë **4,782 ml** dhe tubacion i vendosur në gjatësinë **4,131.40 ml**, pra konstatohet mospërputhje.

Konkluzioni i arritur nga grupi i auditimit, është bazuar në nga matjet faktike të pasqyruara në librezën e masave të administruar në dosjen teknike në Bashkinë Patos, e cila në kuptimin ligjor, mbështetur në **UKM Nr. 3, datë 15.02.2001** “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, **pika 3.2** ku citon se: “*Libreza e masave për punimet e ndërtimit është dokumentacioni bazë për verifikimin e saktësisë së vëllimeve të punimeve të ndërtimit, të vendosura në situacion. Kjo librezë hartohet nga drejtuesi teknik i objektit dhe firmoset nga ai, nga mbikëqyrësi i punimeve dhe nga përfaqësuesi ligjor i sipërmarrësit, për të cilin është miratuar leja e ndërtimit*”.

Sa më sipër trajtuar, ju nuk keni argumentuar mospërputhjen ndërmjet gjatësisë së trasesë prej **4,782 ml** dhe tubacionit të vendosur në gjatësinë **4,131.40 ml**, dhe, në këto kushte **observacioni nuk merret në konsideratë**.

Konstatim: Volume të librezuara dhe situacionuara tepër në zërin e gërmim dheu me ekskavator në hapjen e trasesë për **Tuba e rekorderi ujësjellësi PE d=75 mm, PN 16 + FV Tuba e rekorderi ujësjellësi PE d=75 mm, PN 10**, argumentuar si vijon:

Referuar pasqyrimin në librezën e masave mbi hapjen e trasesë për (FV Tuba e rekorderi ujësjellësi PE d=75 mm, PN 16 + FV Tuba e rekorderi ujësjellësi PE d=75 mm, PN 10), rezulton se sipas zërit 1(3.89/a) “ Gërmim dheu me ekskavator goma 0.25 m³, në kanale gjerësi deri 2 m, tok zak, kategoria e tretë, me shk në mjet” është gërmuar (hapur trase kanali) për gjatësinë totale **5,557.07 ml**, ndërkohë që janë vendosur në total **5,467.50 ml** tuba (Tuba e rekorderi ujësjellësi PE d=63 mm, PN 16 + Tuba e rekorderi ujësjellësi PE d=63 mm, PN 10).

Sa më sipër, rezultojnë **89.57 ml** (**Gërmim dheu me ekskavator goma 0.25 m³**) më tepër se sa gjatësia e vendosjes së tubit PE d=75 mm PN 16 dhe PN 10, duke u përfituar nga sipërmarrësi i

punimeve, më tepër në volumin **78.37 m³** germim {89.57 ml x [0.7 m (gjerësia e kanalit) x 1.25 m (thelësia mesatare e gërmuar)] ose në vlerën **35,266 lekë pa TVSH** [78.37 m³ x 450 lekë].

Për sa konstatuar më sipër, shoqëria mbikëqyrëse “G” SHPK, kontraktori i punimeve “T” SHPK, Kolaudatorët e punimeve F.SH , A.M , M.K , me shkresën nr. 25/1, datë 30.04.2024 (protokolluar në KLSH me nr. 30/7 prot., datë 30.04.2024) ka bërë komente dhe shpjegime për projekt raportin e auditimit, lidhur me problematikat e konstatuara nga grupi i auditimit si vijon:

Pretendimi i subjektit:

*Referuar konstatimit tuaj në lidhje me zërin 1 (3.89/11) **Gërmim dheu me ekskavator goma 0.25 m³, në kanale gjerësi deri 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne mjet, si dhe mbështetur në Librezat e masave të zërave Tuba e rekorderi ujësjellësi PE d=75 mm, PN 16 është librezuar 3,897.5 ml tub + FV Tuba e rekorderi ujësjellësi PE d=75 mm, PN 10 është librezuar 1,583 ml tub dhe ne total janë librezuar gjithsej 5,480.5 ml tub.***

*Në bazë të volumeve në librezën e masave dhe të situacionuara për “**Gërmim dheu me ekskavator goma 0.25 m³, ne kanale gjerësi deri 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne mjet**” janë: librezuar gjithsej:*

- **3,058.08 ml kanal me volum 2,798.4 m³ germim për linjat e rrjetit shpërndarës**
- **108.4 ml kanal me volum 96.6 m³ germim për linjat shtesë**
- **1,473.8 ml kanal me volum 1,247.9 m³ germim për linjat e lidhjeve të pallateve**

*-Për zërin “**3.45/1 Gërmim kanalesh ne toke te zakonshme, me krahë, me seksion deri 0.75 m²”** janë librezuar gjithsej:*

- **916.79 ml kanal germim për linjat e rrjetit shpërndarës**
- **Linjat e lidhjeve të pallateve. Nuk ka volume në librezë.**

***Përfundim:** Sa më sipër rezutojnë 76.57 ml (Gërmim dheu me ekskavator goma 0.25 m³) me tepër se sa gjatësia e vendosjes së tubit PE d=75 mm PN 16 dhe PN JO, më tepër në volumin 66.99 m³ germim {76.57 ml x (0.7 m (gjerësia e kanalit) x 1.25 m (thelësia mesatare e gërmuar) ose në vlerën 30,145.5 Leke pa TVSH /66.99 m³ x 450 lekë).*

-Për këtë gjatësi kanali volumet në mbushje janë si tregohen ne tabelen bashkëlidhur observacionit në shumë 84,150.43 lekë.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Nga shqyrtimi me kujdes i observacionit, audituesi sqaron si më poshtë:

1. Mbikëqyrësi i punimeve mban qëndrime të ndryshme dhe është i pasktë me argumentimin e tij dhe, konkretisht:

- Në observacionin për akt konstatimin nr. 17, shoqëria mbikëqyrëse “G” SHPK, me shkresën nr. 25/1, datë 08.03.2024 (protokolluar në KLSH me nr. 30/3 prot., datë 12.03.2024) flet për gjatësi prej **819.30 ml** kanal për linjat e rrjetit shpërndarës, **ndërkohë** që në observacionin për projekt raportin shoqëria mbikëqyrëse “G” SHPK, me shkresën nr. 25/1, datë 30.04.2024 (protokolluar në KLSH me nr. 30/7 prot., datë 30.04.2024) gjatësinë e merr **916.79 ml**. Pra konstatohet mospërputhje në gjatësi me një diferencë **97.49 ml**.

2. Për linjat e lidhjeve të pallateve lidhur zëri “**Gërmim dheu me ekskavator goma 0.25 m³, ne kanale gjerësi deri 2 m, toke zak, kategoria III, me shk në mjet**”, shpreheni se volumi i gërmimit të marrë në librezë është **1,473.8 ml**, nga ana tjetër për zërin “**Gërmim kanalesh në tokë të zakonshme, me krahë, me seksion deri 0.75 m²”**, për volumin për linjat e lidhjeve të pallateve shpreheni se nuk ka volume në librezë. Pra, nga mbikëqyrësi **argumenti jepet me 2 (dy) standrade** dhe nuk jeni bindës për sa pretendoni.

3. Referuar pasqyrimin në librezën e masave mbi hapjen e trasesë për (FV Tuba e rekorderi ujësjellësi PE d=75 mm, PN 16 + FV Tuba e rekorderi ujësjellësi PE d=75 mm, PN 10), rezulton se sipas zërit 1(3.89/a) “**Gërmim dheu me ekskavator goma 0.25 m³, në kanale gjerësi deri 2 m, tok zak, kategoria e tretë, me shk në mjet**” është gërmuar (hapur trase kanali) për gjatësinë totale **5,557.07 ml** [rrjeti shpërndarës: 34.18 m + 50 m + 50 m + 50 m + 50 m + 50 m + 50 m + 38.15 m + 50 m + 50 m + 50 m + 50 m + 50 m + 576.11 m + 25 m + 25 m + 25 m + 25 m + 25 m + 25 m + 25 m + 25 m + 25 m + 25 m + 257 m + 16.34 m + 7.26 m + 16.75 m + 13.84 m + 17.55 m + 95 m + 59 m + 27.21 m + 25 m + 5.69 m + 5.28 m + 24.37 m + 6.48 m + 5.92 m + 15.47 m + 8.95 m + 14.51 m + 22.55 m + 20.37 m + 16.9 m + 21.7 m + 9.67 m + 20.91 m + 10.5 m + 25.31 m + 21.64 m + 11.92 m + 21.23 m + 15.61 m + 24.62 m + 25 m + 36.04 m + 13.96 m + 25

m + 18.03 m + 18.17 m + 27.23 m + 20.26 m + 16.3 m + 25 m + 15.25 m + 25 m + 24.41 m + 36.35 m + 7.04 m + 6.97 m + 20.34 m + 15.61 m + 18.85 m + 8.53 m + 18.96 m + 20.53 m + 22.42 m + 13.52 m + 13.76 m + 22.72 m + 19.12 m + 22.02 m + 10.53 m + 10.15 m + 8.26 m + 4.93 m + 24.17 m + 7.62 m + 25 m + 25 m + 28.52 m + 21.48 m + 23.04 m] + [linjat shtesë: 88 m + 20.4 m] + [linjat e lidhjeve të pallateve: 2 m + 45 m + 106 m + 138 m + 51 m + 69 m + 83 m + 195 m + 22 m + 48 m + 24.8 m + 66 m + 73.4 m + 40 m + 32 m + 193 m + 58 m + 61 m + 79.4 m + 67.2 m + 20 m + 916.79] m], ndërkohë që janë vendosur në total **5,467.50 ml** (3,884.5 ml + 1,583 ml) tuba (Tuba e rekorderi ujësjellësi PE d=63 mm, PN 16 + Tuba e rekorderi ujësjellësi PE d=63 mm, PN 10).

Sa më sipër, rezultojnë **89.57 ml (Gërmim dheu me ekskavator goma 0.25 m³)** më tepër se sa gjatësia e vendosjes së tubit PE d=75 mm PN 16 dhe PN 10, duke u përfitur nga sipërmarrësi i punimeve, më tepër në volumin **78.37 m³** gërmim {89.57 ml x [0.7 m (gjerësia e kanalit) x 1.25 m (thellësia mesatare e gërmuar)]}.

Sa më sipër, rezultojnë **89.57 ml [5,557.07 ml gjatësi në hapje traseje – 5,467.50 ml gjatësi tubacioni] (Gërmim dheu me ekskavator goma 0.25 m³)** më tepër se sa gjatësia e vendosjes së tubit PE d=63 mm PN 16 dhe PN 10, duke u përfitur nga sipërmarrësi i punimeve, më tepër në volumin **78 m³** gërmim {89.57 ml x [0.7 m (gjerësia e kanalit) x 1.25 m (thellësia mesatare e gërmuar)]} ose në vlerën **35,100 lekë pa TVSH** [78 m³ x 450 lekë].

Pra kemi, trase e hapur në gjatësinë **5,557.07 ml** dhe tubacion i vendosur në gjatësinë **5,467.50 ml**, pra konstatohet mospërputhje.

-Pretendimi se për gjatësi kanali 76.57 ml, volumet në mbushje janë në shumë 84,150.43 lekë nuk qëndron sepse diferenca e gjatësisë në trase për Tub PE d=75 mm PN 16 dhe PN 10, krahasuar me gjatësinë e tubacionit është **89.57 ml** dhe jo siç pretendoni 76.57 ml (Argumentuar më lartë).

Konkluzioni i arritur nga grupi i auditimit, është bazuar në nga matjet faktike të pasqyruara në librezën e masave të administruar në dosjen teknike në Bashkinë Patos, e cila në kuptimin ligjor, mbështetur në **UKM Nr. 3, datë 15.02.2001** “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, **pika 3.2** ku citon se: “*Libreza e masave për punimet e ndërtimit është dokumentacioni bazë për verifikimin e saktësisë së vëllimeve të punimeve të ndërtimit, të vendosura në situacion. Kjo librezë hartohet nga drejtuesi teknik i objektit dhe firmoset nga ai, nga mbikëqyrësi i punimeve dhe nga përfaqësuesi ligjor i sipërmarrësit, për të cilin është miratuar leja e ndërtimit*”.

Sa më sipër trajtuar, ju nuk keni argumentuar mospërputhjen ndërmjet gjatësisë së trasesë prej **5,557.07 ml** dhe tubacionit të vendosur në gjatësinë **5,467.50 ml**, dhe, në këto kushte **observacioni nuk merret në konsideratë**.

Konstatim: Volume të librezuara dhe situacionuara tepër në zërin e gërmim dheu me ekskavator në hapjen e trasesë për **Tuba e rekorderi ujësjellësi PE d=315 mm, PN 16**, argumentuar si vijon: Referuar pasqyrimin në librezën e masave mbi hapjen e trasesë për (FV Tuba e rekorderi ujësjellësi PE d=315 mm, PN 16), rezulton se sipas zërit 1(3.89/a) “Gërmim dheu me ekskavator goma 0.25 m³, në kanale gjerësi deri 2 m, tok zak, kategoria e tretë, me shk në mjet” është gërmuar (hapur trase kanali) për gjatësinë totale **138 ml**, ndërkohë që janë vendosur në total **126** tuba (Tuba e rekorderi ujësjellësi PE d=315 mm, PN 16).

Sa më sipër, rezultojnë **12 ml (Gërmim dheu me ekskavator goma 0.25 m³)** më tepër se sa gjatësia e vendosjes së tubit PE d=315 mm PN 16, duke u përfitur nga sipërmarrësi i punimeve, më tepër në volumin **16.632 m³** gërmim {12 ml x [0.9 m (gjerësia e kanalit) x 1.54 m (thellësia mesatare e gërmuar)]} ose në vlerën **7,484 lekë pa TVSH** [16.632 m³ x 450 lekë].

Konstatim: Volume (në mbushje kanali, FV Tuba e rekorderi ujësjellësi PE d=50 mm, PN 16 + FV Tuba e rekorderi ujësjellësi PE d=50 mm, PN 10) të librezuara dhe situacionuara tepër në zërat: [Shtresë rëre; Nënshtrësë zhavorri (për rrugët pa asfaltim); Mbushje me material të gërmuar; Shtresë çakelli mbeturinë kave t=20 cm, përhapur e gjeshur makineri; Shtresë stabilizanti t=10 cm; Shtresë binderi me granil gur kave, 6 cm, me mak; Shtresë asfaltobetoni, 4 cm, me mak; Shtresë rëre bituminoze, t=10 cm].

1. Në hapjen e trasesë për vendosjen e tubave PE d=50 mm PN 16 dhe PE d=50mm PN 10, rezultojnë **1,564.92 ml “Gërmim dheu me ekskavator goma 0.25 m3...”** më tepër se sa gjatësia e tubave, duke u përfituar nga sipërmarrësi i punimeve, më tepër në zërat e mbushjes së kanalit, argumentuar sipas tabelës, së mëposhtme:

FV Tub OD 50 mm PN 10

Nr.	Zërat mbushës të kanalit	Njësia	Çmimi (Lekë)	Gjatësia tepër në gërmim (m)	Gjerësia e kanalit (m)	Lartësia mesatare (m)	Sipërfaqe mesatare (m ²)	Vëllimi tepër (m ³)	Vlera tepër (lekë)
1	Shtresë rëre	m3	1,400	1,546.92	0.7	0.25	-	271	379,400
2	Nënshtresë zhavorri (për rrugët pa asfaltim)	m3	1,300	1,546.92	0.7	0.2	-	216.56	281,528
3	Mbushje me material të gërmuar në trupin e rrugës	m3	500	1,546.92	0.7	0.4	-	433.13	216,565
4	Shtresë çakelli mbeturinë kave t=20 cm, përhapur e gjeshur makineri	m2	400	1,546.92	0.7	-	1,083	-	433,200
5	Shtresë stabilizanti t=10 cm	m2	360	1,546.92	0.7	-	1,083	-	389,880
	Shuma								1,700,573

2. Në hapjen e trasesë për vendosjen e tubave PE d=63 mm PN 16 dhe PE d=63 mm PN 10, rezultojnë **650.6 ml “Gërmim dheu me ekskavator goma 0.25 m3...”** më tepër se sa gjatësia e tubave, duke u përfituar nga sipërmarrësi i punimeve, më tepër në zërat e mbushjes së kanalit, argumentuar sipas tabelës, së mëposhtme:

FV Tub OD 63 mm PN 16 dhe PN 10.

Nr.	Zërat mbushës të kanalit	Njësia	Çmimi (Lekë)	Gjatësia tepër në gërmim (m)	Gjerësia e kanalit (m)	Lartësia mesatare (m)	Sipërfaqe mesatare (m ²)	Vëllimi tepër (m ³)	Vlera tepër (lekë)
1	Shtresë rëre	m3	1,400	650.6	0.7	0.263	-	120	168,000
2	Nënshtresë zhavorri (për rrugët pa asfaltim)	m3	1,300	650.6	0.7	0.2	-	91	118,300
3	Mbushje me material të gërmuar	m3	500	650.6	0.7	0.4	-	91	45,500
4	Shtresë çakelli mbeturinë kave t=20 cm, përhapur e gjeshur makineri	m2	400	650.6	0.7	-	455.42	-	182,168
5	Shtresë stabilizanti t=10 cm	m2	360	650.6	0.7	-	455.42	-	163,951
	Shuma								677,919

3. Në hapjen e trasesë për vendosjen e tubave PE d=75 mm PN 16 dhe PE d=75 mm PN 10, rezultojnë **89.57 ml “Gërmim dhe me ekskavator goma 0.25 m3...”** më tepër se sa gjatësia e tubave, duke u përfutuar nga sipërmarrësi i punimeve, më tepër në zërat e mbushjes së kanalit, argumentuar sipas tabelës, së mëposhtme:

FV Tub OD 75 mm PN 16 dhe PN 10.

Nr.	Zërat mbushës të kanalit	Njësia	Çmimi (Lekë)	Gjatësia tepër në gërmim (m)	Gjerësia e kanalit (m)	Lartësia mesatare (m)	Sipërfaqe mesatare (m ²)	Vëllimi tepër (m ³)	Vlera tepër (lekë)
1	Shtresë rëre	m3	1,400	89.57	0.7	0.25	-	15.67	21,938
2	Nënshtresë zhavorri (për rrugët pa asfaltim)	m3	1,300	89.57	0.7	0.2	-	12.53	16,289
3	Mbushje me material të gërmuar	m3	500	89.57	0.7	0.4	-	25	12,500
4	Shtresë çakelli mbeturinë kave t=20 cm, përhapur e gjeshur makineri	m2	400	89.57	0.7	-	63	-	25,200
5	Shtresë stabilizanti t=10 cm	m2	360	89.57	0.7	-	63	-	22,680
	Shuma								98,607

4. Në hapjen e trasesë për vendosjen e tubit PE d=315 mm PN 16, rezultojnë **12 ml “Gërmim dhe me ekskavator goma 0.25 m3...”** më tepër se sa gjatësia e tubave, duke u përfutuar nga sipërmarrësi i punimeve, më tepër në zërat e mbushjes së kanalit, argumentuar sipas tabelës, së mëposhtme:

FV Tub OD 315 mm PN 16.

Nr.	Zërat mbushës të kanalit	Njësia	Çmimi (Lekë)	Gjatësia tepër në gërmim (ml)	Gjerësia e kanalit (m)	Lartësia mesatare (m)	Sipërfaqe mesatare (m ²)	Vëllimi tepër (m ³)	Vlera tepër (lekë)
1	Shtresë rëre	m3	1,400	12	0.9	0.515	-	5.562	7,787
2	Nënshtresë zhavorri (për rrugët pa asfaltim)	m3	1,300	12	0.9	0.2	-	2.16	2,808
3	Mbushje me material të gërmuar	m3	500	12	0.9	0.4	-	4.32	2,160
4	Shtresë çakelli mbeturinë kave t=20 cm, përhapur e gjeshur makineri	m2	400	12	0.9	-	10.8	-	4,320
5	Shtresë stabilizanti t=10 cm	m2	360	12	0.9	-	10.8	-	3,888
	Shuma								20,962.80

Konstatim: Nga auditimi mbi pasqyrimin e sasive të tubacioneve në librezën e masave, u konstatuan gabime dhe në 7(shtatë) raste volume (në FV. Tuba e rekorderi ujësjellësi PE d=90 mm, PN 16; FV. Tuba e rekorderi ujësjellësi PE d=110 mm, PN 16; FV. Tuba e rekorderi ujësjellësi PE d =125 mm, PN 16; FV. Tuba e rekorderi ujësjellësi PE d=140 mm, PN 16; FV. Tuba e rekorderi ujësjellësi PE d =160 mm, PN 16; FV. Tuba e rekorderi ujësjellësi PE d =200 mm, PN 16; FV. Tuba e rekorderi ujësjellësi PE d =250 mm, PN 16) **të librezuara dhe situacionuara tepër** për **711.63 ml** tubacione, argumentuar sipas tabelës së mëposhtme:

Nr. rend	Nr. An	Tubacionet	Njësia	Çmimi (lekë)	Situac përf (ml)	Gjatësia në gjërmim, sipas librezës masave	Diferenca (ml)	Fakti (ml)	Vlera (lekë)
2	21(2.49 1/h)	FV. Tuba e rekorderi ujësjellësi PE d=110 mm, PN 16	ml	1,080	2,194	2,194	150.03	2,043.97	162,032.4
3	22(2.49 1/i)	FV. Tuba e rekorderi ujësjellësi PE d=125 mm, PN 16	ml	1,200	2,070.50	2,070.50	266.81	1,803.69	320,172
4	23(Ant T)	FV. Tuba e rekorderi ujësjellësi PE d=140 mm, PN 16	ml	1,980	3,503	3,503	1.95	3501.05	3,861
5	24(An8 T)	FV. Tuba e rekorderi ujësjellësi PE d=160 mm, PN 16	ml	2,520	618.3	618.3	81.48	536.82	205,329.6
6	26(An1 0 T)	FV. Tuba e rekorderi ujësjellësi PE d=200 mm, PN 16	ml	3,960	223	223	205.96	17.04	67,478.4
7	27(An1 2 T)	FV. Tuba e rekorderi ujësjellësi PE d=250 mm, PN 16	ml	5,850	2,263	2,263	5.4	2,257.60	31,590
		Shuma					711.63		790,463.4

Sa më sipër pasqyruar në tabelë , rezultuan diferenca prej 711.63 ml volume të pa rakorduar saktë në librezën e masave në vlerën **790,463.4 lekë pa TVSH.**

Për sa konstatuar më sipër, shoqëria mbikëqyrëse “G” SHPK, kontraktori i punimeve “T” SHPK, Kolaudatorët e punimeve F.SH, A.M, M.K, me shkresën nr. 25/1, datë 30.04.2024 (protokolluar në KLSH me nr. 30/7 prot., datë 30.04.2024) ka bërë komente dhe shpjegime për projekt raportin e auditimit, lidhur me problematikat e konstatuara nga grupi i auditimit si vijon:

1. Pretendimi i subjektit:

Në lidhje me pretendimin se, nga auditimi mbi pasqyrimin e sasive të tubacioneve në librezën e masave, u konstatuan gabime dhe në 7(shtatë) raste volume (në F.V Tuba e rekorderi ujësjellësi PE d=90 mm PN 16, FV Tuba e rekorderi ujësjellësi PE d=110 mm PN 16, FV Tuba e rekorderi ujësjellësi PE d=125 mm PN 16, FV Tuba e rekorderi ujësjellësi PE d=140 mm PN 16, FV Tuba e rekorderi ujësjellësi PE d=160 mm PN 16, FV Tuba e rekorderi ujësjellësi PE d=200 mm PN 16, FV Tuba e rekorderi ujësjellësi PE d=250 mm PN 16, FV Tuba e rekorderi ujësjellësi PE d=315 mm PN 16,të librezuara dhe situacionuara me tepër, sqarojmë se:

F.V. Tuba e rekorderi ujësjellësi PE d=90 mm PN 16.

Në total janë hapur 4,923.29 ml trase kanali, ndërsa janë librezuar 4,935 ml Tub d=90 mm Pn16. Në disa piketa ka kalim në kanal, ku merret vetëm gjatësi tub dhe jo kanali, referuar Librezës masave për zërin "Kalimet e tubacioneve ne kanale", në piketën Rr.shp.08 (Pk.6-Pk.7) ka kalim tub në gjatësinë 12 ml. Prandaj gjatësi traseje kanali duhet të krahasohet me gjatësinë e tubit 4,923 ml (4935 gjatësi totale + 12 ml gjatësi në kalime). Në tabelat bashkëlidhur observacionit, të marra nga Libreza e Masave për Zërin (3.89/11) "Gërmim dheu me ekskavator goma 0.25 m3, në kanale gjerësi deri 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne mjet" dhe Zërin 3.4511 Gërmim kanalesh ne toke te zakonshme, me krahë, me seksion deri 0.75 m1, janë shënuar me ngjyre të verdhe gjatësitë e trasesë së kanalit, të cilat janë marre në llogaritje. Në gjatësi traseje kanali do të merret vetëm nëse ka volum gërmimi për atë gjatësi tubi.

1.1. Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Nga shqyrtimi me kujdes i observacionit, audituesi sqaron si më poshtë:

Referuar argumentit se, rezultojnë 0.29 ml (Gërmim dheu me ekskavator goma 0.25 m3) me tepër se sa gjatësia e vendosjes së tubit PE d=90 mm PN 16, diferencë kjo e cila vjen nga rrumbullakimet e gjatësive në llogaritje, prandaj pranojmë që trase kanali dhe gjatësi tubi i vendosur përputhen, **observacioni merret në konsideratë** dhe, për këtë do të reflektohet në projekt raportin e auditimit.

2. Pretendimi i subjektit:

F.V. Tuba e rekorderi ujësjellësi PE d=110 mm PN 16.

Në total janë hapur 2,043.97 ml trase kanali, ndërsa janë librezuar 2,194 ml Tub d=110 mm Pn16. Në tabelat bashkëlidhur observacionit, të marra nga Libreza e Masave për Zërin (3.89/11) "Gërmim dheu me ekskavator goma 0.25 m3, në kanale gjerësi deri 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne mjet" dhe Zërin 3.4511 Gërmim kanalesh ne toke te zakonshme, me krahë, me seksion deri 0.75 m1, janë shënuar me ngjyre të verdhe gjatësitë e trasesë së kanalit, të cilat janë marre në llogaritje. Në gjatësi traseje kanali do të merret vetëm nëse ka volum gërmimi për atë gjatësi tubi.

2.1. Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Nga shqyrtimi me kujdes i observacionit, audituesi sqaron si më poshtë:

Referuar argumentit se, rezultojnë 150.03 ml tub (PE d=110 mm PN 16), me tepër në volum se trase kanali e hapur, ose në vlerën 162,032.4 Leke pa TVSH {150.03 ml x 1080 lekë}, dakordësoheni me qëndrimin e audituesit.

3. Pretendimi i subjektit:

F.V. Tuba e rekorderi ujësjellësi PE d=125 mm PN 16.

Në total janë hapur 1,803.69 ml trase kanali, ndërsa janë librezuar 2,070.50 ml Tub d=125 mm Pn16, pra 266.81 ml tub më shumë se trase kanali e hapur.

Në tabelat bashkëlidhur observacionit, të marra nga Libreza e Masave për Zërin (3.89/11) "Gërmim dheu me ekskavator goma 0.25 m3, në kanale gjerësi deri 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne mjet" dhe Zërin 3.4511 Gërmim kanalesh ne toke te zakonshme, me krahë, me seksion deri 0.75 m1, janë shënuar me ngjyre të verdhe gjatësitë e trasesë së kanalit, të cilat janë marre në llogaritje. Në gjatësi traseje kanali do të merret vetëm nëse ka volum gërmimi për atë gjatësi tubi.

3.1. Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Nga shqyrtimi me kujdes i observacionit, audituesi sqaron si më poshtë:

Referuar argumentit se, rezultojnë 266.81 ml tub (PE d=125 mm PN 16), me tepër në volum se trase kanali e hapur, ose në vlerën 320,172 Leke pa TVSH {266.81 ml x 1200 lekë}, dakordësoheni me qëndrimin e audituesit.

4. Pretendimi i subjektit:

F.V. Tuba e rekorderi ujësjellësi PE d=140 mm PN 16.

Në total janë hapur 3,467.05 ml trase kanali, ndërsa janë librezuar 3,503 ml Tub d=140 mm Pn16. Në disa piketa ka kalim në kanal dhe tombino, ku merret vetëm gjatësi tub dhe jo kanali, referuar Librezës masave për zërin "Kalimet e tubacioneve ne kanale", në piketën Rr.shp.18 (Pk.5-Pk.6), Rr.shp.24 (Pk.9-Pk.10), Rr.shp.88 (Pk.9-Pk.10) dhe Rr.shp.103 (Pk.2-Pk.3) ka kalim tub në gjatësinë 12+6+8+8=34 ml. Prandaj gjatësi traseje kanali duhet të krahasohet me gjatësinë e tubit 3469 ml (3,503 gjatësi totale +34 gjatësi në kalime =3,469 ml).

Në tabelat bashkëlidhur observacionit, të marra nga Libreza e Masave për Zërin (3.89/11) "Gërmim dheu me ekskavator goma 0.25 m³, në kanale gjerësi deri 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne mjet" dhe Zërin 3.4511 Gërmim kanalesh ne toke te zakonshme, me krahë, me seksion deri 0.75 m¹, janë shënuar me ngjyre të verdhe gjatësitë e trasesë së kanalit, të cilat janë marre në llogaritje. Në gjatësi traseje kanali do të merret vetëm nëse ka volum gërmimi për atë gjatësi tubi.

4.1. Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Nga shqyrtimi me kujdes i observacionit, audituesi sqaron si më poshtë:

Pranohet argumenti se, rezultojnë 1.95 ml tub (PE d=140 mm PN 16), me tepër në volum se trase kanali e hapur, ose në vlerën 3,861 Lekë pa TVSH /1.95 ml x 1980 lekë), dakordësoheni me qëndrimin e audituesit, **observacioni merret pjesërisht në konsideratë** dhe, për këtë do të reflektohet në projekt raportin e auditimit duke zbritur shumën 71,181 lekë.

5. Pretendimi i subjektit:

F.V. Tuba e rekorderi ujësjellësi PE d=160 mm PN 16.

Në total janë hapur 536.82 ml trase kanali, ndërsa janë librezuar 613.30 ml Tub d=160 mm Pn16, pra 81.48 ml tub më shumë se trase kanali e hapur.

Në tabelat bashkëlidhur observacionit, të marra nga Libreza e Masave për Zërin (3.89/11) "Gërmim dheu me ekskavator goma 0.25 m³, në kanale gjerësi deri 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne mjet" dhe Zërin 3.4511 Gërmim kanalesh ne toke te zakonshme, me krahë, me seksion deri 0.75 m¹, janë shënuar me ngjyre të verdhe gjatësitë e trasesë së kanalit, të cilat janë marre në llogaritje. Në gjatësi traseje kanali do të merret vetëm nëse ka volum gërmimi për atë gjatësi tubi.

5.1. Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Nga shqyrtimi me kujdes i observacionit, audituesi sqaron si më poshtë:

Referuar argumentit se, rezultojnë 81.48 ml tub (PE d=160 mm PN 16), me tepër në volum se trase kanali e hapur, ose në vlerën 205,329.60 Lekë pa TVSH {81.48 ml x 2,520 lekë), dakordësoheni me qëndrimin e audituesit.

6. Pretendimi i subjektit:

F.V. Tuba e rekorderi ujësjellësi PE d=200 mm PN 16.

Në total janë hapur 205.96 ml trase kanali, ndërsa janë librezuar 223 ml Tub d=200 mm Pn16, pra 17.04 ml tub më shumë se trase kanali e hapur.

Në tabelat bashkëlidhur observacionit, të marra nga Libreza e Masave për Zërin (3.89/11) "Gërmim dheu me ekskavator goma 0.25 m³, në kanale gjerësi deri 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne mjet" dhe Zërin 3.4511 Gërmim kanalesh ne toke te zakonshme, me krahë, me seksion deri 0.75 m¹, janë shënuar me ngjyre të verdhe gjatësitë e trasesë së kanalit, të cilat janë marre në llogaritje. Në gjatësi traseje kanali do të merret vetëm nëse ka volum gërmimi për atë gjatësi tubi.

6.1. Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Nga shqyrtimi me kujdes i observacionit, audituesi sqaron si më poshtë:

Referuar argumentit se, rezultojnë 17.04 ml tub (PE d=200 mm PN 16), me tepër në volum se trase kanali e hapur, ose në vlerën 67,478.40 Lekë pa TVSH {81.48 ml x 3,960 lekë), dakordësoheni me qëndrimin e audituesit.

7. Pretendimi i subjektit:

F.V. Tuba e rekorderi ujësjellësi PE d=250 mm PN 16.

Në total janë hapur 2,257.60 ml trase kanali, ndërsa janë librezuar 2,263 ml Tub d=250 mm Pn16, pra 5.4 ml tub më shumë se trase kanali e hapur.

Në tabelat bashkëlidhur observacionit, të marra nga Libreza e Masave për Zërin (3.89/11) "Gërmim dheu me ekskavator goma 0.25 m³, në kanale gjerësi deri 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne mjet" dhe Zërin 3.4511 Gërmim kanalesh ne toke te zakonshme, me krahë, me seksion deri 0.75 m¹, janë shënuar me ngjyre të verdhe gjatësitë e trasesë së kanalit, të cilat janë marre në llogaritje. Në gjatësi traseje kanali do të merret vetëm nëse ka volum gërmimi për atë gjatësi tubi.

7.1. Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Nga shqyrtimi me kujdes i observacionit, audituesi sqaron si më poshtë:

Referuar argumentit se, rezultojnë 5.4 ml tub (PE d=250 mm PN 16), **me tepër** në volum se trase kanali e hapur, ose në vlerën 31,590 Lekë pa TVSH {5.4 ml x 5,850 lekë), dakordësoheni me qëndrimin e audituesit.

8. Pretendimi i subjektit:

F.V. Tuba e rekorderi ujësjellësi PE d=315 mm PN 16.

Në total janë hapur **138 ml** trase kanali, ndërsa janë librezuar **126 ml** Tub d=315 mm Pn16, pra **12 ml** tub më shumë se trase kanali e hapur.

Në tabelat bashkëlidhur observacionit, të marra nga Libreza e Masave për Zërin (3.89/11) "Gërmim dheu me ekskavator goma 0.25 m³, në kanale gjerësi deri 2 m, tokë zak, kategoria III, me shk në mjet" dhe Zërin 3.4511 Gërmim kanalesh në tokë të zakonshme, me krahë, me seksion deri 0.75 m¹, janë shënuar me ngjyre të verdhe gjatësitë e trasesë së kanalit, të cilat janë marre në llogaritje. Në gjatësi traseje kanali do të merret vetëm nëse ka volum gërmimi për atë gjatësi tubi.

8.1. Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Nga shqyrtimi me kujdes i observacionit, audituesi sqaron si më poshtë:

Sa më sipër, rezultojnë 12 ml (Gërmim dheu me ekskavator goma 0.25 m³) më tepër se sa gjatësia e vendosjes së tubit PE d=315 mm PN 16, më tepër në volumin 16.632 m³ gërmim {12.0 ml x (0.9 m (gjerësia e kanalit) x 1.54 m (thellësia mesatare e gërmuar), ose në vlerën 7,484 Leke pa TVSH{16.632 m³ x 450 lekë) siç është konstatuar nga audituesi.

Konkluzioni i arritur nga grupi i auditimit, është bazuar në nga matjet faktike të pasqyruara në librezën e masave të administruar në dosjen teknike në Bashkinë Patos, e cila në kuptimin ligjor, mbështetur në **UKM Nr. 3, datë 15.02.2001** "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" të ndryshuar, **pika 3.2** ku citon se: "Libreza e masave për punimet e ndërtimit është dokumentacioni bazë për verifikimin e saktësisë së vëllimeve të punimeve të ndërtimit, të vendosura në situacion. Kjo librezë hartohet nga drejtuesi teknik i objektit dhe firmoset nga ai, nga mbikëqyrësi i punimeve dhe nga përfaqësuesi ligjor i sipërmarrësit, për të cilin është miratuar leja e ndërtimit". Sa më sipër trajtuar, ju nuk keni argumentuar mospërputhjen ndërmjet gjatësisë së trasesë prej **138 ml** dhe tubacionit të vendosur në gjatësinë **126 ml**, dhe, në këto kushte **observacioni nuk merret në konsideratë.**

II. RRJETI SHPËRNDARËS ZONA DUKAS.

Zëri 1 (3.89/a) Gërmim dheu me ekskavator goma 0.25 m³, në kanale gjerësi deri 2 m, tokë zak, kategoria III, me shk. në mjet.

Preventivi i rishikuar pasqyron 13,974.7 m³ gërmim dheu me çmim 450 lekë. Situacioni përfundimtar pasqyron 13,974.7 m³ gërmim dheu me çmim 450 lekë.

Konstatim:

Nga auditimi i pasqyrimin në librezën e masave u konstatuan volume të librezuara dhe situacionuara më tepër në zërin e gërmim dheu me ekskavator në hapjen e trasesë për "**Tuba e rekorderi ujësjellësi PE d=50 mm, PN 16 + FV Tuba e rekorderi ujësjellësi PE d=50 mm, PN 10**", argumentuar si vijon:

Referuar pasqyrimin në librezën e masave mbi hapjen e trasesë për (FV Tuba e rekorderi ujësjellësi PE d=50 mm, PN 16 + FV Tuba e rekorderi ujësjellësi PE d=50 mm, PN 10), rezulton se sipas zërit 1(3.89/a) " Gërmim dheu me ekskavator goma 0.25 m³, në kanale gjerësi deri 2 m, tokë zak, kategoria e tretë, me shk në mjet" është gërmuar (hapur trase kanali) për gjatësinë totale **5,022.98 ml**, ndërkohë që janë vendosur në total **3,574 ml** tuba (Tuba e rekorderi ujësjellësi PE d=50mm, PN 16 + Tuba e rekorderi ujësjellësi PE d=50mm, PN 10).

Sa më sipër, rezultojnë **1,448.98 ml (Gërmim dheu me ekskavator goma 0.25 m³) më tepër** se sa gjatësia e vendosjes së tubit PE d=50 mm PN 16 dhe PN 10, duke u përfituar nga sipërmarrësi i punimeve, në volumin **1,268 m³** gërmim {1,448.98 ml x [0.7 m (gjerësia e kanalit) x 1.25 m (thellësia mesatare e gërmuar)]} ose në vlerën **570,600 lekë pa TVSH** [1,268 m³ x 450 lekë].

Për sa konstatuar më sipër, shoqëria mbikëqyrëse "G" SHPK, kontraktori i punimeve "T" SHPK, Kolaudatorët e punimeve F.SH, A.M, M.K, me shkresën nr. 25/1, datë 30.04.2024 (protokolluar në KLSH

me nr. 30/7 prot., datë 30.04.2024) ka bërë komente dhe shpjegime për projekt raportin e auditimit, lidhur me problematikat e konstatuara nga grupi i auditimit si vijon:

Pretendimi i subjektit:

Në bazë të volumeve në librezën e masave dhe të situacionuara për zërin “Gërmim dheu me ekskavator goma 0.25 m³, në kanale gjerësi deri 2 m, tokë zak, kategoria III, me shk në mjet” në lidhje me zërat “Tuba e rekorderi ujësjellësi PE d=50mm, PN16 + FV Tuba e rekorderi ujësjellësi PE d=50 mm, PN 10) janë librezuar gjithsej:

Rrjeti shpërndarës:

(2.8+1+5.88+170.27+31.79+220.8+97+9.22+10+23.88+21.26+21.53+24.45+41.62+59.43+29.17+33.82+36.9+52.43+15.86+5.6+25.78+91.8+8.8+16.21+9.95+7.3+5.78+12.62+18.95+90.8+69.78+34.35+35+35+45.4=1,422.12 ml).

Linjat shitesë. Nuk ka volume.

Linjat e lidhjeve të pallateve. Nuk ka volume.

Për zërin 3.45/1 Gërmim kanalesh në toke te zakonshme, me krahë, me seksion deri 0.75 m² janë librezuar gjithsej:

Rrjeti shpërndarës:

(48.7+19.03+161.62+32.53+ 17.02+129.4+49.23+19.55+5.22+8.36+9.41+9.65+122+132.16+83.10+65.60+49.45+4.9+28.78+18.5+11.34+9.9+14.12+20.05+70.22+6.87+71.32+31.14+36.64+21.94+27) 83+47.06+25.94+42.81+58.60+69.32=1,579.31 ml)

Linjat shitesë: (95+66+254.4+47+112 = 574.4 ml)

***Përfundim:** 1,422.12+1,579.31+574.4 = 3,575.83 ml*

Në total janë hapur 3,575.83 ml trase kanali, ndërsa janë librezuar 3,574 ml Tub d=50mm Pn16+Pn10, pra 1.83 ml trase kanali më shume se tub i vendosur.

Në tabelat bashkëlidhur observacionit për zërin (3.89/11) "Gërmim dheu me ekskavator goma 0.25 m³, ne kanale gjerësi deri 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne mjet" dhe zërin 3.45/1 Gërmim kanalesh në tokë të zakonshme, me krahë, me seksion deri 0.75 m², janë shënuar me ngjyrë të verdhe gjatësitë e trasesë se kanalit, të cilat janë marre në llogaritje. Në gjatësi traseje kanali do të merret vetëm nëse ka volum gërmimi për atë gjatësi tubi.

KONKLuzion:

Sa më sipër rezultojnë 1.83 ml (Gërmim dheu me ekskavator goma 0.25 m³) me tepër se sa gjatësia e vendosjes së tubit PE d=50 mm PN 16 dhe PN 10, me tepër në volumin 1.6 m³ gërmim {1.83 ml x (0.7 m (gjerësia e kanalit) x 1.25 m (thelësia mesatare e gërmimit) ose në vlerën 720 Lekë pa TVSH (1.6 m³ x 450 lekë).

-Për këtë gjatësi kanali volumet në mbushje janë si në tabelën bashkëlidhur këtij observacioni në shumë 2,017.58 lekë.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Nga shqyrtimi me kujdes i observacionit, audituesi sqaron si më poshtë:

1. Mbikëqyrësi i punimeve argumenton gjatësi traseje 3,575.83 ml ku në fakt sipas librezë janë realizuar 5,022.98 ml.

Lidhur me zërin “Gërmim dheu me ekskavator goma 0.25 m³, në kanale gjerësi deri 2 m, tokë zak, kategoria III, me shk në mjet” dhe zërin “Gërmim kanalesh në tokë të zakonshme, me krahë, me seksion deri 0.75 m²” nga mbikëqyrësi i punimeve në 41 raste ka zvogëluar gjatësitë e trasesë në observacion, në volumin 2,153.71 ml përkatësisht [69.32+32.53+17.02 + 129.40 + 49.23 + 19.55 + 5.22 + 8.36 + 9.41 + 9.65 + 122.00 + 132.16 + 83.10 + 65.60 + 19.03 + 161.62 + 49.45 + 4.90 + 28.78 + 18.50 + 11.34 + 9.90 + 14.12 + 20.05 + 70.22 + 6.87 + 71.32 + 31.14 + 36.64 + 21.94 + 27.83 + 47.06 + 25.94 + 42.81 + 8.70 + 58.60] dhe në 1(një) rast gjatësia e trasesë është rritur në volumin 132.16 ml, ndërkohë që këto volume janë pasqyruar në librezën e masave dhe në situacionin përfundimtar. Sa më sipër pretenduar, argumenti nuk qëndron.

2. Nga rishqyrtimi i pasqyrimin të volumeve në librezën e masave mbi hapjen e trasesë për (FV Tuba e rekorderi ujësjellësi PE d=50 mm, PN 16 + FV Tuba e rekorderi ujësjellësi PE d=50 mm, PN 10), rezulton se sipas zërit 1(3.89/a) “ Gërmim dheu me ekskavator goma 0.25 m³, në kanale gjerësi deri 2 m, tok zak, kategoria e tretë, me shk në mjet” është gërmuar (hapur trase kanali) për gjatësinë totale 5,022.98 ml [2.80 m + 1.00 m + 5.88 m + 170.27 m + 31.79 m + 220.80 m + 97.00 m + 9.22 m + 10.00 m + 23.88 m + 21.26

m + 21.53 m + 24.45 m + 41.62 m + 59.43 m + 29.17 m + 33.82 m + 36.79 m + 52.43 m + 15.86 m + 5.60 m + 25.78 m + 91.80 m + 8.80 m + 16.21 m + 9.95 m + 7.30 m + 5.78 m + 12.62 m + 18.95 m + 90.80 m + 69.78 m + 34.35 m + 35.00 m + 35.00 m + 45.40 m + 69.32 m + 32.53 m + 17.02 m + 129.40 m + 49.23 m + 19.55 m + 5.22 m + 8.36 m + 9.41 m + 9.65 m + 122.00 m + 132.16 m + 83.10 m + 65.60 m + 19.03 m + 161.62 m + 49.45 m + 4.90 m + 28.78 m + 18.50 m + 11.34 m + 9.90 m + 14.12 m + 20.05 m + 70.22 m + 6.87 m + 71.32 m + 31.14 m + 36.64 m + 21.94 m + 27.83 m + 47.06 m + 25.94 m + 42.81 m + 48.70 m + 58.60 m + 48.70 m + 19.03 m + 161.62 m + 32.53 m + 17.02 m + 129.40 m + 49.23 m + 19.55 m + 5.22 m + 8.36 m + 9.41 m + 9.65 m + 122 m + 83.10 m + 65.60 m + 49.45 m + 4.90 m + 28.78 m + 18.50 m + 11.34 m + 9.90 m + 14.12 m + 20.05 m + 70.22 m + 6.87 m + 71.32 m + 31.14 m + 36.64 m + 21.94 m + 27.83 m + 47.06 m + 25.94 m + 42.81 m + 58.60 m + 69.32 m + 95.00 m + 66.00 m + 254.40 m + 47.00 m + 112.00 m], ndërkohë që janë vendosur në total **3,574 ml** [3,491 ml + 83 ml] tuba (Tuba e rekorderi ujësjellësi PE d=50mm, PN 16 + Tuba e rekorderi ujësjellësi PE d=50mm, PN 10).

Sa më sipër, rezultojnë gjatësi traseje **1,448.98 ml (Gërmim dheu me ekskavator goma 0.25 m3)** më tepër se sa gjatësia e vendosjes së tubit PE d=50 mm PN 16 dhe PN 10, duke u përfituar nga sipërmarrësi i punimeve, në volumnin **1,268 m³** gërmim {1,448.98 ml x [0.7 m (gjerësia e kanalit) x 1.25 m (thellësia mesatare e gërmuar)]} ose në vlerën **570,600 lekë pa TVSH** [1,268 m³ x 450 lekë].

Pra kemi, trase e hapur në gjatësinë **5,022.98 ml** dhe jo në volumnin 3,575.83 ml dhe tubacion i vendosur në gjatësinë **3,574 ml**, pra konstatohet mospërputhje.

Konkluzioni i arritur nga grupi i auditimit, është bazuar në nga matjet faktike të pasqyruara në librezën e masave të administruar në dosjen teknike në Bashkinë Patos, e cila në kuptimin ligjor, mbështetur në **UKM Nr. 3, datë 15.02.2001** “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, **pika 3.2** ku citon se: “*Libreza e masave për punimet e ndërtimit është dokumentacioni bazë për verifikimin e saktësisë së vëllimeve të punimeve të ndërtimit, të vendosura në situacion. Kjo librezë hartohet nga drejtuesi teknik i objektit dhe firmoset nga ai, nga mbikëqyrësi i punimeve dhe nga përfaqësuesi ligjor i sipërmarrësit, për të cilin është miratuar leja e ndërtimit*”.

Sa më sipër trajtuar, ju nuk keni argumentuar mospërputhjen ndërmjet gjatësisë së trasesë prej **5,022.98 ml** dhe tubacionit të vendosur në gjatësinë **3,574 ml**, dhe, në këto kushte **observacioni nuk merret në konsideratë**.

-Për këtë gjatësi traseje **1,448.98 ml** volumi në mbushje është në shumën **1,597,595 lekë siç është përcaktuar nga audituesi dhe jo** si në tabelën bashkëlidhur këtij observacioni në shumë **2,017.58 lekë**. **Sa më sipër observacioni Juaj nuk qëndron**.

Konstatim: Nga auditimi i pasqyrimin në librezën e masave u konstatuan volume të librezuara dhe situacionuara tepër në zërin e gërmim dheu me ekskavator në hapjen e trasesë për “**Tuba e rekorderi ujësjellësi PE d=63 mm, PN 16 + FV Tuba e rekorderi ujësjellësi PE d=63 mm, PN 10**”, argumentuar si vijon:

Referuar pasqyrimin në librezën e masave mbi hapjen e trasesë për (FV Tuba e rekorderi ujësjellësi PE d=63 mm, PN 16 + FV Tuba e rekorderi ujësjellësi PE d=63 mm, PN 10), rezulton se sipas zërit 1(3.89/a) “ Gërmim dheu me ekskavator goma 0.25 m3, në kanale gjerësi deri 2 m, tok zak, kategoria e tretë, me shk në mjet” është gërmuar (hapur trase kanali) për gjatësinë totale **2,045.02 ml**, ndërkohë që janë vendosur në total **1,882.40 ml** tuba (Tuba e rekorderi ujësjellësi PE d=63 mm, PN 16 + Tuba e rekorderi ujësjellësi PE d=63 mm, PN 10).

Sa më sipër, rezultojnë **162.62 ml (Gërmim dheu me ekskavator goma 0.25 m3)** më tepër se sa gjatësia e vendosjes së tubit PE d=63 mm PN 16 dhe PN 10, duke u përfituar nga sipërmarrësi i punimeve, më tepër në volumnin **142 m³** gërmim {162.62 ml x [0.7 m (gjerësia e kanalit) x 1.25 m (thellësia mesatare e gërmuar)]} ose në vlerën **63,900 lekë pa TVSH** [142 m³ x 450 lekë].

Konstatim: Volume (në mbushje kanali, FV Tuba e rekorderi ujësjellësi PE d=50 mm, PN 16 + FV Tuba e rekorderi ujësjellësi PE d=50 mm, PN 10) të librezuara dhe situacionuara tepër në zërat: [Shtresë rëre; Nënshtrësë zhavorri (për rrugët pa asfaltim); Mbushje me material të gërmuar, t=40

cm; Shtresë çakelli mbeturinë kave t=20 cm, përhapur e ngjeshur makineri; Shtresë stabilizanti t=10 cm; Shtresë binderi me granil gur kave , 6 cm, me mak; Shtresë asfaltbetoni, 4 cm, me mak; Shtresë rërë bituminoze, t=10 cm].

1. Në hapjen e trasesë për vendosjen e tubave PE d=50 mm PN 16 dhe PE d=50mm PN 10, rezultojnë **1,448.98 ml** “**Gërmim dheu me ekskavator goma 0.25 m3...**” më tepër se sa gjatësia e tubave, duke u përfituar nga sipërmarrësi i punimeve, më tepër në zërat e mbushjes së kanalit, argumentuar sipas tabelës, së mëposhtme:

FV Tub OD 50 mm PN 16+PN10.

Nr.	Zërat mbushës të kanalit	Njësia	Çmimi (Lekë)	Gjatësia tepër në gërmim (m)	Gjerësia e kanalit (m)	Lartësia mesatare (m)	Sipërfaqe mesatare (m2)	Vëllimi tepër (m3)	Vlera tepër (lekë)
1	Shtresë rëre	m3	1,500	1,448.98	0.7	0.25	-	253.57	380,355
2	Nënshtresë zhavorri (për rrugët pa asfaltim)	m3	1,200	1,448.98	0.7	0.2	-	203	243,600
3	Mbushje me material të gërmuar në trupin e rrugës	m3	500	1,448.98	0.7	0.4	-	406	203,000
4	Shtresë çakelli mbeturinë kave t=20 cm, përhapur e ngjeshur makineri	m2	400	1,448.98	0.7	-	1,014	-	405,600
5	Shtresë stabilizanti t=10 cm	m2	360	1,448.98	0.7	-	1,014	-	365,040
	Shuma								1,597,595

2. Në hapjen e trasesë për vendosjen e tubave PE d=63 mm PN 16 dhe PE d=63 mm PN 10, rezultojnë **162.62 ml** “**Gërmim dheu me ekskavator goma 0.25 m3...**” më tepër se sa gjatësia e tubave, duke u përfituar nga sipërmarrësi i punimeve në vlerën **181,740** lekë pa TVSH, më tepër në zërat e mbushjes së kanalit, argumentuar sipas tabelës, së mëposhtme:

FV Tub OD 63 mm PN 16 dhe PN 10.

Nr.	Zërat mbushës të kanalit	Njësia	Çmimi (Lekë)	Gjatësia tepër në gërmim (m)	Gjerësia e kanalit (m)	Lartësia mesatare (m)	Sipërfaqe mesatare (m2)	Vëllimi tepër (m3)	Vlera tepër (lekë)
1	Shtresë rëre	m3	1,500	162.62	0.7	0.263	-	30	45,000
2	Nënshtresë zhavorri (për rrugët pa asfaltim)	m3	1,200	162.62	0.7	0.2	-	23	27,600
3	Mbushje me material të gërmuar	m3	500	162.62	0.7	0.4	-	45	22,500
4	Shtresë çakelli mbeturinë kave t=20 cm,	m2	400	162.62	0.7	-	114	-	45,600

	përhapur gjesur makineri								
5	Shtresë stabilizanti t=10 cm	m2	360	162.62	0.7	-	114	-	41,040
	Shuma								181,740

Për sa konstatuar më sipër, shoqëria mbikëqyrëse “G” SHPK, kontraktori i punimeve “T” SHPK, Kolaudatorët e punimeve F.SH , A.M , M.K , me shkresën nr. 25/1, datë 30.04.2024 (protokolluar në KLSH me nr. 30/7 prot., datë 30.04.2024) ka bërë komente dhe shpjegime për projekt raportin e auditimit, lidhur me problematikat e konstatuara nga grupi i auditimit si vijon:

Pretendimi i subjektit:

Në bazë të volumeve në librezën e masave dhe të situacionuara për zërin “Gërmim dheu me ekskavator goma 0.25 m3, në kanale gjerësi deri 2 m, tokë zak, kategoria III, me shk në mjet” janë librezuar gjithsej:

Rrjeti shpërndarës:

(9.53+35.02+31.57+28.78+48.33+411+6.92+6.77+18.47+12.68+19.79+13+37.32+10.85+15.75+18.01+9.53+9.47+12.44+63.14+27.38+7.37+7.94+12.52+21.3+12.8+16.4+24.3+26.25+248.04+10.4 + 24.45+102=1,359.52 ml)

Linjat shtese: Nuk ka volume.

Linjat e lidhjeve te pallateve: Nuk ka volume.

Për zërin “3.45/1 Gërmim kanalesh në tokë të zakonshme, me krahë, me seksion deri 0.75 m2” janë librezuar gjithsej:

Rrjeti shpërndarës:

(26.88+16.42+5.42+18.8+15.45+12.33+77.45=172.75 ml)

Linjat shtese: (94+171+75=340 ml).

Përfundim: 1359.52+172.75+340 = 1,872.27 ml

Në total janë hapur 1,872.27 ml trase kanali, ndërsa janë librezuar 1,882.38 ml “Tub d=63 mm Pn16+Pn10, pra 10.11 ml tub i vendosur me shume trase kanali.....

KONKLuzion:

Sa me sipër, rezultojnë 10.11 ml tub (PE d=63 mm PN10+PN16), me tepër në volum se trase kanali e hapur, ose ne vlerën 5,560.5 Leke pa TVSH (10.11 ml x 550 leke).

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Nga shqyrtimi me kujdes i observacionit, audituesi sqaron si më poshtë:

1. Mbikëqyrësi i punimeve argumenton gjatësi traseje **1,872.27 ml** ku në fakt sipas librezë janë realizuar **2,045.02 ml**.

Lidhur me zërin “Gërmim dheu me ekskavator goma 0.25 m3, në kanale gjerësi deri 2 m, tokë zak, kategoria III, me shk në mjet” nga mbikëqyrësi i punimeve në 7 (shtatë) raste ka zvogëluar gjatësitë e trasesë në observacion, në volumin **172.75 ml** përkatësisht [26.88 ml + 16.42 ml + 5.42 ml + 18.80 ml + 15.45 ml + 12.33 ml + 77.45 ml], ndërkohë që këto volume janë pasqyruar në librezën e masave dhe në situacionin përfundimtar të administruar në Bashkinë Patos. Sa më sipër pretenduar, argumenti nuk qëndron. Libreza pjesë e observacionit nuk është e njëjtë me librezën e administruar në dosjen teknike.

2. Nga rishqyrtimi i pasqyrimin të volumeve në librezën e masave mbi hapjen e trasesë për (FV Tuba e rekorderi ujësjellësi **PE d=63 mm**, PN 16 + FV Tuba e rekorderi ujësjellësi **PE d=63 mm**, PN 10), rezulton se sipas zërit 1(3.89/a) “Gërmim dheu me ekskavator goma 0.25 m3, në kanale gjerësi deri 2 m, tokë zak, kategoria e tretë, me shk në mjet” është gërmuar (hapur trase kanali) për gjatësinë totale **2,045.02 ml**, ndërkohë që janë vendosur në total **1,882.40 ml** tuba (Tuba e rekorderi ujësjellësi PE d=63 mm, PN 16 + Tuba e rekorderi ujësjellësi PE d=63 mm, PN 10).

Sa më sipër, rezultojnë gjatësi traseje **162.62 ml** (Gërmim dheu me ekskavator goma 0.25 m3) më tepër se sa gjatësia e vendosjes së tubit PE d=63 mm PN 16 dhe PN 10, duke u përfutur nga sipërmarrësi i punimeve, më tepër në volumin **142 m³** gërmim { 162.62 ml x [0.7 m (gjerësia e kanalit) x 1.25 m (thellësia mesatare e gërmuar)] } ose në vlerën **63,900 lekë pa TVSH** [142 m³ x 450 lekë].

Sa më sipër, rezultojnë **2,045.02 ml** [9.53 m + 35.02 m + 31.57 m + 28.78 m + 48.33 m + 411.00 m + 26.88 m + 16.42 m + 5.42 m + 18.80 m + 15.45 m + 12.33 m + 77.45 m + 6.92 m + 6.77 m + 18.47 m + 12.68 m + 19.79 m + 13.00 m + 37.32 m + 10.85 m + 15.75 m + 18.01 m + 9.53 m + 9.47 m + 12.44 m + 63.14 m + 27.38 m + 7.37 m + 7.94 m + 12.52 m + 21.30 m + 12.80 m + 16.40 m + 24.30 m + 26.25 m + 248.04 m + 10.40 m + 24.45 m + 102.00 m + 26.88 m + 16.42 m + 5.42 m + 18.80 m + 15.45 m + 12.33 m + 77.45 m + 94.00 m + 171.00 m + 75.00 m] (**Gërmim dhe me ekskavator goma 0.25 m³**) dhe F.V tubacioni në gjatësinë 1,882.40 ml [385 ml + 1,497.40 ml].

Pra, janë trasuar **162.62 ml më tepër** se sa gjatësia e vendosjes së tubit (FV Tuba e rekorderi ujësjellësi PE d=63 mm, PN 16 + FV Tuba e rekorderi ujësjellësi PE d=63 mm, PN 10), duke u përfutur nga sipërmarrësi i punimeve, në volumin **142 m³** gërmim { 162.62 ml x [0.7 m (gjerësia e kanalit) x 1.25 m (thellësia mesatare e gërmuar)]} ose në vlerën **63,900 lekë pa TVSH** [142 m³ x 450 lekë].

Pra kemi, trase e hapur në gjatësinë **2,045.02 ml** dhe tubacion i vendosur në gjatësinë **1,882.02 ml**, pra konstatohet mospërputhje.

Konkluzioni i arritur nga grupi i auditimit, është bazuar në matjet faktike të pasqyruara në librezën e masave të administruar në dosjen teknike në Bashkinë Patos, e cila në kuptimin ligjor, mbështetur në **UKM Nr. 3, datë 15.02.2001** “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, **pika 3.2** ku citon se: “*Libreza e masave për punimet e ndërtimit është dokumentacioni bazë për verifikimin e saktësisë së vëllimeve të punimeve të ndërtimit, të vendosura në situacion. Kjo librezë hartohet nga drejtuesi teknik i objektit dhe firmoset nga ai, nga mbikëqyrësi i punimeve dhe nga përfaqësuesi ligjor i sipërmarrësit, për të cilin është miratuar leja e ndërtimit*”.

Sa më sipër trajtuar, ju nuk keni argumentuar mospërputhjen ndërmjet gjatësisë së trasesë prej **2,045.02 ml** dhe tubacionit të vendosur në gjatësinë **1,882.04 ml** dhe, në këto kushte **observacioni nuk merret në konsideratë**.

-Për këtë gjatësi traseje **1,448.98 ml** volumi në mbushje është në shumën **181,740 lekë** siç është përcaktuar nga audituesi dhe jo si në tabelën bashkëlidhur këtij observacioni në shumë 5,560.5 lekë, siç pretendohet nga mbikëqyrësi. Sa më sipër **observacioni Juaj nuk qëndron**.

Konstatim: Nga auditimi mbi pasqyrimin e sasive të tubacioneve në librezën e masave, u konstatuan gabime dhe në 1(një) rast volum në “FV. Tuba e rekorderi ujësjellësi PE d =90 mm, PN 16” **të librezuara dhe situacionuara tepër** për **20.44 ml** tubacione, argumentuar sipas tabelës së mëposhtme:

Nr. rend	Nr. An	Tubacionet	Njësia	Çmimi (lekë)	Situac përf (ml)	Gjatësia në gërmim, sipas librezës masave	Diferenca (ml)	Fakti (ml)	Vlera (lekë)
1	22(2.491/g)	FV. Tuba e rekorderi ujësjellësi PE d=90 mm, PN 16	ml	730	2,160.30	2,139.86	20.44	2,139.86	14,921.2
		Shuma							14,921

Sa më sipër pasqyruar në tabelë , rezultoi **2,139.86 ml** hapje traseje dhe **2,160.30 ml** vendosje tub PE d=90 mm, PN 16. Diferenca prej 20.44 ml tub është i pa rakorduar saktë në librezën e masave në vlerën **14,921 lekë pa TVSH**.

Konstatim:T01/1 Pusetat vertikale të shpërndarjes (Ana ndërtimore).

Kostoja për 1 pusete është 51,950.4 lekë. Vlera për 138 puseta vertikale është 7,169,155.2 lekë. Situacioni përfundimtar pasqyron 138 puseta vertikale. Libreza e masave pasqyron 138 puseta vertikale, trajtuar analitikisht.

Nga auditimi mbi realizimin në objekt mbi zbatimin e këtij zëri, rezultoi se pusetat vertikale nuk janë suvatuar nga pjesa e prapme në volumin prej 2.4 m2 dhe as lyer me gëlqere. Pra, nuk është realizuar nënëzëri i punës 4(2.31) dhe 5(2.399). Nga llogaritja rezulton punë e pa kryer:

- 2.4 m2 x 750 lekë x 138 puseta = 248,400 lekë pa TVSH (suvaja)
- 2.4 m2 x 100 lekë x 138 puseta = 33,120 lekë pa TVSH (Sherbetisje)

Sa më sipër, është përfituar nga sipërmarrësi i punimeve për punë të pakryer në shumën **281,520 lekë pa TVSH**.

Konstatim:T05 . Lidhjet e banesave individuale (me kasete metalike) ujësjellësit).

Kostoja për 1 kasete metalike është 21,750 lekë. Vlera për 57 copë kasete metalike është 2,066,250 lekë. Situacioni përfundimtar pasqyron 57 copë kasete metalike. Libreza e masave pasqyron 57 copë, trajtuar analitikisht.

Nga auditimi mbi realizimin në objekt mbi zbatimin e këtij zëri, rezultoi se kasetat metalike nuk janë vendosur fare në banesat individuale. Pra, nën zëri 8(An122/Lidhje) nuk është realizuar.

Sa më sipër, është përfituar nga sipërmarrësi i punimeve për punë të pakryer në shumën **285,000 lekë pa TVSH** (57 copë kasete metalike x 5,000 lekë/kasete).

Për sa konstatuar më sipër, shoqëria mbikëqyrëse “G” SHPK, kontraktori i punimeve “T” SHPK, Kolaudatorët e punimeve F.SH, A.M, M.K, me shkresën nr. 25/1, datë 30.04.2024 (protokolluar në KLSH me nr. 30/7 prot., datë 30.04.2024) ka bërë komente dhe shpjegime për projekt raportin e auditimit, lidhur me problematikat e konstatuara nga grupi i auditimit si vijon:

1. Pretendimi i subjektit:

Për zërin Nr.22, 2.491/g “FV Tuba e rekorderi ujësjellësi PE d=90 mm, PN 16” në bazë të volumeve në librezën e masave dhe të situacionuara për zërin “Gërmim dheu me ekskavator goma 0.25 m3, ne kanale gjeresi deri 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne mjet” janë librezuar gjithsej:

Rrjeti shpëmdares:

(139+14.52+28.45+33.07+27.68+42.82+12.06+16.47+21.25+42.81+12.59+307.47+18.91+28.4+42.29+74+28.61+20.13+20.1+6.52+16.92+21.13+70.25+21.12+18.7+26.3+43+9.5+23.3+11.14+90.37+757.76+93.22=2,139.86 ml)

Në total janë hapur 2,139.86 ml trase kanali, ndërsa janë librezuar 2,160.30 ml “F.V Tub d=90mm Pn16” , pra 20.44 ml tub i vendosur më shumë.

KONKLuzion:

Sa më sipër, rezultojnë 20.44 ml tub (PE d=90 mm PN16), me tepër në volum se trase kanali e hapur, ose në vlerën 14,921.2 Leke pa TVSH (20.44 ml x 730 lekë).

1. Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Argumenti Juaj përputhet me qëndrim e audituesit, sepse janë hapur 2,139.86 ml trase kanali, ndërsa janë librezuar 2,160.30 ml “F.V Tub d=90 mm Pn16”, pra 20.44 ml tub i vendosur më shumë. Problematika e konstatuar qëndron.

2. Pretendimi i subjektit:

Për zërin T01/1 “Pusetat vertikale të shpërndarjes (Ana ndërtimore)”, Konstatimi se pusetat vertikale nuk janë suvatuar dhe lyer nga pjesa e pasme është i sakte për disa puseta për të cilat ka qenë e pamundur suvatimi dhe lyerja me gëlqere për arsye hapësirë. Këto puseta janë të mbështetura në mure dhe rrethime ekzistuese nga ana e pasme. Nga konstatimi ynë në vend janë 56 puseta që nuk janë suvatuar nga ana e pasme.

2. Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Lidhur për sa ju sqaroni se, për disa puseta për të cilat ka qenë e pamundur suvatimi dhe lyerja me gëlqere për arsye hapësirë, këto puseta janë të mbështetura në mure dhe rrethime ekzistuese nga ana e pasme, ju sqarojmë se volumi për nënzërat “Suva mur tulle llaç përzier M 25” dhe “Sherbetisje e bojatosje me gëlqere” duhej që ana Juaj të ish-in hequr nga rishikimi i projekt preventivit dhe jo të situacionoheshin duke u përfituar nga sipërmarrësi i punimeve pa u realizuar në fakt. Sa më sipër **observacioni nuk merret në konsideratë.**

3. Pretendimi i subjektit:

Për zërin “T05. Lidhjet e banesave individuale (me kaseta metalike) ujësjellësit”, Konstatimi për nën zërin 8 (An 122/) Lidhje - Kaseta metalike 60x40x30cm është i pasakte pasi në objekt janë vendosur të gjitha kasetat metalike dhe është bere azhurnimi i plotë i tyre nga të gjitha palët. Në rast mospranimi kërkojmë nga ana juaj ri-inspektimin në terren për verifikimin e plote të tyre sipas projektit faktik të miratuar.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Pretendimi Juaj qëndron për vendosjen e kasetave me përmasa (100 x 30 x 120) cm të cilat janë miratuar me proces verbal nr. 2 (pa datë dhe nr. prot.) mbi evidentimin dhe pasqyrimin e zërave të rinj të punimeve për objektin: “Rikonstruksioni i magjstralit kryesor dhe rrjetit të brendshëm të ujësjellësit të qytetit Patos Loti I (Rrjeti shpërndarës)”, nënshkruar nga palët: Investitori Bashkia Patos; Kontraktori i punimeve “T” SHPK dhe mbikëqyrësi i punimeve “G” SHPK. Ju sqarojmë se problematika e konstatuar nga grupi i auditimit ka të bëjë me zërin “An 122/lidhje” Kaseta metalike (60 x 40 x 30) cm, ku nga auditimi në vepër në prezencë të mbikëqyrësit të punimeve, u konstatua se nuk është realizuar. Sa më sipër **observacioni nuk merret në konsideratë.**

III. RRJETI SHPËRNDARËS ZONA PATOSI VJETËR.

Zëri 16(2.491/i) F.V Tuba e rekorderi ujësjellësi PE d=125 mm, t=8.6 mm, PN 10.

Nga auditimi mbi realizimin e këtij zëri në objekt, rezultoi se gjatësia e “Tuba e rekorderi ujësjellësi PE d=125 mm, t=8.6 mm, PN 10” është 439 ml, ndërkohë gjatësia e hapjes së trasesë në zërin “Gërmim dheu me ekskavator...” është 431.92 ml. Pra u konstatua një diferencë e tubit në gjatësinë **7.08 ml**, argumentuar sipas tabelës së mëposhtme:

Nr. rend	Nr. An	Tubacionet	Njësia	Çmimi (lekë)	Situac. përf (ml)	Gjatësia në gërmim, sipas librezës masave	Diferenca (ml)	Fakti (ml)	Vlera (lekë)
1	16(2.491/i)	FV. Tuba e rekorderi ujësjellësi PE d=125 mm, PN 10	ml	1,200	439	431.92	7.08	431.92	8,496
		Shuma							8,496

Diferenca prej 7.08 ml tub është i pa rakorduar saktë në librezën e masave në vlerën **8,496 lekë pa TVSH.**

Konstatim:T01/1 Pusetat vertikale të shpërndarjes (Ana ndërtimore).

Kostoja për 1 pusetë është 51,950.4 lekë. Vlera për 23 puseta vertikale është 1,194,859.20 lekë. Situacioni përfundimtar pasqyron 23 puseta vertikale. Libreza e masave pasqyron 23 puseta vertikale, trajtuar analitikisht.

Nga auditimi mbi realizimin në objekt mbi zbatimin e këtij zëri, rezultoi se pusetat vertikale nuk janë suvatuar nga pjesa e prapme në volumin prej 2.4 m2 dhe as lyer me gëlqere. Pra, nuk është realizuar nënzëri i punës 4(2.31) dhe 5(2.399). Nga llogaritja rezulton punë e pa kryer:

- 2.4 m² x 750 lekë x 23 puseta = 41,400 lekë pa TVSH (suvaja)
 - 2.4 m² x 100 lekë x 23 puseta = 5,520 lekë pa TVSH (Sherbetisje)
- Sa më sipër, është përfituar nga sipërmarrësi i punimeve për punë të pakryer në shumën **46,920 lekë pa TVSH**.

Për sa konstatuar më sipër, shoqëria mbikëqyrëse “G” SHPK, kontraktori i punimeve “T” SHPK, Kolaudatorët e punimeve F.SH, A.M, M.K, me shkresën nr. 25/1, datë 30.04.2024 (protokolluar në KLSH me nr. 30/7 prot., datë 30.04.2024) ka bërë komente dhe shpjegime për projekt raportin e auditimit, lidhur me problematikat e konstatuara nga grupi i auditimit si vijon:

1. Pretendimi i subjektit:

Për zërin “16 (2.491/i) F.V Tuba e rekorderi ujësjellësi PE d=125 mm, t=8.6mm, PN 10”, në bazë të volumeve në librezën e masave dhe të situacionuara për zërin “Gërmim dheu me ekskavator goma 0.25 m³, në kanale gjerësi deri 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne mjet ne lidhje me zërat Tuba e rekorderi ujësjellësi PE d=125mm, t=8.6 mm PN 10) janë librezuar gjithsej:

Rrjeti shpemdases:

(16.45+38.12+19.11+15.18+11.14+26.26+9.96+13.77+50+50+20+22.93+12.06+45.02+50+31.92=431.92 ml).

Përfundim: Në total janë hapur **431.92 ml** trase kanali, ndërsa janë librezuar **439 ml** Tub d=125mm t=8.6mm Pn 10, pra **7.08 ml**, tub më shumë se trase kanali.

KONKLuzion:

*Sa me sipër, rezultojnë **7.08 ml** tub (PE d=125 mm PN16), me tepër në volum se trase kanali e hapur, ose në vlerën **8,496 Leke** pa TVSH (7.08 ml x 1200 lekë).*

1.1. Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Argumenti Juaj përputhet me qëndrim e audituesit, sepse janë hapur **431.92 ml** trase kanali, ndërsa janë vendosur **439 ml** gjatësi “Tub d=90 mm Pn16”, pra **20.44 ml** tub i vendosur më shumë. Problematika e konstatuar nga grupi i auditimit qëndron.

2. Pretendimi i subjektit:

*Për zërin T01/I Pusetat vertikale të shpërndarjes (Ana ndërtimore), Konstatimi se pusetat vertikale nuk janë suvatuar dhe lyer nga pjesa e pasme është i sakte për disa puseta për të cilat ka qenë e pamundur suvatimi dhe lyerja me gëlqere për arsye hapësirë. Këto puseta janë të mbështetura në mure dhe rrethime ekzistuese nga ana e pasme. Nga konstatimi ynë ne vend janë **8 puseta** që nuk janë suvatuar nga ana e pasme.*

2. Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Lidhur për sa ju sqaroni se, për disa puseta për të cilat ka qenë e pamundur suvatimi dhe lyerja me gëlqere për arsye hapësirë, këto puseta janë të mbështetura në mure dhe rrethime ekzistuese nga ana e pasme, ju sqarojmë se volumi për nënzërat “Suva mur tulle llaç përzier M 25” dhe “Sherbetisje e bojatosje me gëlqere” duhej që ana Juaj të ishin hequr nga rishikimi i projekt preventivit dhe jo të situacionoheshin duke u përfituar nga sipërmarrësi i punimeve pa u realizuar në fakt. Sa më sipër **observacioni nuk merret në konsideratë**.

IV. RRJETI SHPËRNDARËS ZONA LENGINAS.

Zëri 15(2.491/e) F.V Tuba e rekorderi ujësjellësi PE d=50 mm, t=8.6 mm, PN 16.

Nga auditimi mbi realizimin e këtij zëri në objekt, rezultoi se gjatësia e “Tuba e rekorderi ujësjellësi PE d=50 mm, PN 16” është 1,140.50 ml, ndërkohë gjatësia e hapjes së trasesë në zërin “Gërmim dheu me ekskavator...” është 1,137.55 ml. Pra u konstatua një diferencë e tubit në gjatësinë 2.95 ml, argumentuar sipas tabelës së mëposhtme:

Nr. rend	Nr. An	Tubacionet	Njësia	Çmimi (lekë)	Situac përf (ml)	Gjatësia në gërmim, sipas librezës masave	Diferenca (ml)	Fakti (ml)	Vlera (lekë)
1	15(2.491/e)	FV. Tuba e rekorderi ujësjellësi PE d=50 mm, PN 16	ml	360	1,140.5	1,137.55	2.95	1,137.55	1,062
		Shuma							1,062

Diferenca prej 2.95 ml tub është i pa rakorduar saktë në librezën e masave në vlerën **1,062 lekë pa TVSH**.

Konstatim: T01/1 Pusetat vertikale të shpërndarjes (Ana ndërtimore).

Situacioni përfundimtar pasqyron 15 puseta vertikale. Kostoja për 1 pusetë është 51,950.4 lekë. Vlera për 15 puseta vertikale është 779,256 lekë. Libreza e masave pasqyron 15 puseta vertikale, trajtuar analitikisht.

Nga auditimi mbi realizimin në objekt mbi zbatimin e këtij zëri, rezultoi se pusetat vertikale nuk janë suvatuar nga pjesa e prapme në volumin prej 2.4 m² dhe as lyster me gëlqere. Pra, nuk është realizuar nënzhëri i punës 4(2.31) dhe 5(2.399). Nga llogaritja rezulton punë e pa kryer:

- 2.4 m² x 750 lekë x 15 puseta = 27,000 lekë pa TVSH (suvaja)
- 2.4 m² x 100 lekë x 15 puseta = 3,600 lekë pa TVSH (Sherbetisje)

Sa më sipër, është përfituar nga sipërmarrësi i punimeve për punë të pakryer në shumën **30,600 lekë pa TVSH**.

Konstatim: T05 . Lidhjet e banesave individuale (me kaseta metalike) ujësjellësit).

Situacioni përfundimtar pasqyron 9 copë kaseta metalike. Kostoja për 1 kasetë metalike është 11,450 lekë. Vlera për 9 copë kaseta metalike është 103,050 lekë. Libreza e masave pasqyron 9 copë kaseta metalike, trajtuar analitikisht.

Nga auditimi mbi realizimin në objekt mbi zbatimin e këtij zëri, rezultoi se kasetat metalike nuk janë vendosur fare në banesat individuale. Pra, nënzhëri i punës 8 (An122/Lidhje) nuk është realizuar.

Sa më sipër, është përfituar nga sipërmarrësi i punimeve për punë të pakryer në shumën **45,000 lekë pa TVSH** (9 copë kaseta metalike x 5,000 lekë/kasetë).

Për sa konstatuar më sipër, shoqëria mbikëqyrëse “G” SHPK, kontraktori i punimeve “T” SHPK, Kolaudatorët e punimeve F.SH, A.M, M.K, me shkresën nr. 25/1, datë 30.04.2024 (protokolluar në KLSH me nr. 30/7 prot., datë 30.04.2024) ka bërë komente dhe shpjegime për projekt raportin e auditimit, lidhur me problematikat e konstatuara nga grupi i auditimit si vijon:

1. Pretendimi i subjektit:

Në baze të volumeve në librezën e masave dhe te situacionuara për zërin “Gërmim dheu me ekskavator goma 0.25 m³, ne kanale gjerësi deri 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne mjet” në lidhje me zërat Tuba e rekorderi ujësjellësi PE d=50mm, t=8.6 mm PN16) janë librezuar gjithsej:

Rrjeti shpërndarës:

(34.44+29.09+42.36+48.50+12.40+25.00+25.00+25.00+4.50+50.00+50.00+50.00+2.87+9.15+15.85+25.00+25.00+25.00+20.33+25.00+25.00+25.00+25.00+25.00+17.02+10.48+50.00+50.00+50.00+54.40=976.39 ml)

Për zërin 3.45/1 Gërmim kanalesh në tokë të zakonshme, me krahë, me seksion deri 0.75 m² janë librezuar gjithsej: (25.00+25.00+25.00+5.58=80.58 ml)

Përfundim: $976.39+80.58=1,056.97$ ml trase kanali e hapur nga gërmimet.

Në total janë hapur 1,056.97 ml trase kanali, ndërsa janë librezuar 1,140.50 ml Tub d=50mm t=8.6mm Pn16, pra 83.53 ml tub me shume se trase kanali.

KONKLuzion:

Sa me sipër, rezultojnë 83.53 ml tub (PE d=50 mm PNJ 6), më tepër në volum se trase kanali e hapur, ose në vlerën 30,070.8 Leke pa TVSH {83.53 ml x 360 leke).

1. Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Nga shqyrtimi me kujdes i observacionit, audituesi sqaron si më poshtë:

1. Në observacionin e bërë nga shoqëria mbikëqyrëse “G ” SHPK, me shkresën nr. 25/1, datë 08.03.2024 (protokolluar në KLSH me nr. 30/3 prot., datë 12.03.2024) për Akt Konstatimin nr. 17, datë 01.03.2024, jeni shprehur se “Për zërin 15 (2.491/i) F.V Tuba e rekorderi ujësjellësi PE d=50mm, t=8.6mm, PN 16, konstatimi se gjatësia e situacionuar e tubit është 2.95 ml me e vogël se shuma e gjatësive të tubave e librezuar për gërmim kanali për to është e saktë por nuk do të thotë që janë vendosur 2.95 ml tub më pak, sepse kjo gjatësi është gjatësia e tubave PE d=50 brenda pusetave, të cilat nuk janë llogaritur në gjatësi për gërmim kanali. Pra është një volum tubi i vendosur jo në gjatësi kanali por në pusesta”.

Ndërsa për observacionin mbi projekt raportin e auditimit, shpreheni, se në total janë hapur **1,056.97** ml trase kanali, ndërsa janë librezuar **1,140.50** ml Tub d=50mm t=8.6mm Pn16, pra **83.53 ml** tub me shume se trase kanali. Pra, nga mbikëqyrësi **argumenti jepet me 2 (dy) qëndrime** dhe nuk jeni bindës për sa pretendoni.

2. Mbikëqyrësi i punimeve pasqyron gjatësi traseje **1,056.97 ml** ku në fakt sipas librezë janë realizuar **1,137.55 ml**.

Lidhur me zërin “Gërmim dheu me ekskavator goma 0.25 m3, në kanale gjerësi deri 2 m, tokë zak, kategoria III, me shk në mjet” dhe zërin “Gërmim kanalesh në tokë të zakonshme, me krahë, me seksion deri 0.75 m2 ” nga mbikëqyrësi i punimeve në 32 raste ka zvogëluar gjatësitë e trasesë në observacion, në volumin **976.39 ml** përkatësisht [34.44 + 29.09 + 42.36 + 48.50 + 12.40 + 25.00 + 25.00 + 25.00 + 4.50 + 50.00 + 50.00 + 50.00 + 2.87 + 9.15 + 15.85 + 25.00 + 25.00 + 25.00

20.33 + 25.00 + 25.00 + 25.00 + 25.00 + 25.00 + 17.02 + 10.48 + 50.00 + 50.00 + 50.00 + 50.00 + 54.40], ndërkohë që këto volume janë pasqyruar në librezën e masave dhe në situacionin përfundimtar të administruar në Bashkinë Patos. Sa më sipër pretenduar, argumenti nuk qëndron. Libreza pjesë e observacionit nuk është e njëjtë me librezën e administruar në dosjen teknike.

3. Nga rishqyrtimi i pasqyrimin të volumeve në librezën e masave mbi hapjen e trasesë për (FV Tuba e rekorderi ujësjellësi PE d=50 mm, t=8.06 m, PN 16, rezulton se sipas zërave “Gërmim dheu me ekskavator goma 0.25 m3, në kanale gjerësi deri 2 m, tokë zak, kategoria III, me shk në mjet” dhe “Gërmim kanalesh në tokë të zakonshme, me krahë, me seksion deri 0.75 m2 ” është gërmuar (hapur trase kanali) për gjatësinë totale **1,137.55 ml** [rrjeti shpërndarës: 25.00 + 25.00 + 25.00 + 5.58 + 34.44 + 29.09 + 42.36 + 48.50 + 12.40 + 25.00 + 25.00 + 25.00 + 4.50 + 50.00 + 50.00 + 50.00 + 50.00 + 2.87 + 9.15 + 15.85 + 25.00 + 25.00 + 25.00 + 20.33 + 25.00 + 25.00 + 25.00 + 25.00 + 25.00 + 17.02 + 10.48 + 50.00 + 50.00 + 50.00 + 50.00 + 54.40 + 25.00 + 25.00 + 25.00 + 5.58], ndërkohë që janë vendosur në total **1,140.50 ml** (Tuba e rekorderi ujësjellësi PE d=50 mm, t=8.6 mm,PN 16).

Sa më sipër, rezultojnë **2.95 ml (Gërmim dheu....)** gjatësi tubacioni më tepër se sa gjatësia e trasesë. duke u përfutur nga sipërmarrësi i punimeve, më tepër në vlerën **1,062 lekë pa TVSH** [2.95 x 360 lekë].

Pra kemi, trase e hapur në gjatësinë **1,137.55 ml** dhe tubacion i vendosur në gjatësinë **1,140 ml**, pra konstatohet mospërputhje.

Konkluzioni i arritur nga grupi i auditimit, është bazuar në nga matjet faktike të pasqyruara në librezën e masave të administruar në dosjen teknike në Bashkinë Patos, e cila në kuptimin ligjor, mbështetur në **UKM Nr. 3, datë 15.02.2001** “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, **pika 3.2.** Sa më sipër trajtuar, ju nuk keni argumentuar mospërputhjen ndërmjet gjatësisë së trasesë prej **1,137.55 ml** dhe tubacionit të vendosur në gjatësinë **1,140.50 ml**, dhe, në këto kushte **observacioni nuk merret në konsideratë.**

2. Pretendimi i subjektit:

Për zërin T01/I Pusetat vertikale të shpërndarjes (Ana ndërtimore), Konstatimi se pusetat vertikale nuk janë suvatuar dhe lyer nga pjesa e pasme është i saktë për disa pusesta për të cilat ka qenë e pamundur

suvatimi dhe lyerja me gëlqere për arsye hapësirë. Këto puseta janë të mbështetura në mure dhe rrethime ekzistuese nga ana e pasme. Nga konstatimi ynë ne vend janë 5 puseta që nuk janë suvatuar nga ana e pasme.

2. Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Lidhur për sa ju sqaroni se, për disa puseta për të cilat ka qenë e pamundur suvatimi dhe lyerja me gëlqere për arsye hapësirë, këto puseta janë të mbështetura në mure dhe rrethime ekzistuese nga ana e pasme, ju sqarojmë se volumi për nënzërat “Suva mur tulle llaç përzier M 25” dhe “Sherbetisje e bojatosje me gëlqere” duhej që ana Juaj të ishin hequr nga rishikimi i projekt preventivit dhe jo të situacionoheshin duke u përfituar nga sipërmarrësi i punimeve pa u realizuar në fakt. Sa më sipër **observacioni nuk merret në konsideratë.**

3. Pretendimi i subjektit:

Për zërin “T05. Lidhjet e banesave individuale (me kaseta metalike) ujësjellësit”, Konstatimi për nën zërin 8 (An 122/) Lidhje - Kaseta metalike 60x40x30cm është i pasakte pasi në objekt janë vendosur të gjitha kasetat metalike dhe është bere azhurnimi i plotë i tyre nga të gjitha palët. Në rast mospranimi kërkohet nga ana juaj ri-inspektimin në terren për verifikimin e plote të tyre sipas projektit faktik të miratuar.

3. Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Pretendimi Juaj qëndron për vendosjen e kasetave me përmasa (100 x 30 x 120) cm të cilat janë miratuar me proces verbal nr. 2 (pa datë dhe nr. prot.) mbi evidentimin dhe pasqyrimin e zërave të rinj të punimeve për objektin: “Rikonstruksioni i magjistralit kryesor dhe rrjetit të brendshëm të ujësjellësit të qytetit Patos Loti I (Rrjeti shpërndarës)”, nënshkruar nga palët: Investitori Bashkia Patos; Kontraktori i punimeve “T” SHPK dhe mbikëqyrësi i punimeve “G” SHPK. Ju sqarojmë se problematika e konstatuar nga grupi i auditimit ka të bëjë me zërin “An 122/lidhje” Kaseta metalike (60 x 40 x 30) cm, ku nga auditimi në vepër në prezencë të mbikëqyrësit të punimeve, u konstatua se nuk është realizuar. Sa më sipër **observacioni nuk merret në konsideratë.**

V. RRJETI SHPËRNDARËS ZONA RRËRËZ.

Zëri 1 (3.89/a) Gërmim dheu me ekskavator goma 0.25 m³, në kanale gjerësi deri 2 m, tokë zak, kategoria III, me shk. në mjet.

Preventivi i rishikuar pasqyron 3,991 m³ gërmim dheu me çmim 450 lekë. Situacioni përfundimtar pasqyron 3,991 m³ gërmim dheu me çmim 450 lekë.

Konstatim: Nga auditimi i pasqyrimin në librezën e masave u konstatuan volume të librezuara dhe situacionuara **tepër** në zërin e gërmim dheu me ekskavator në hapjen e trasesë për “**Tuba e rekorderi ujësjellësi PE d=50 mm, PN 10**”, argumentuar si vijon:

Referuar pasqyrimin në librezën e masave mbi hapjen e trasesë për (FV Tuba e rekorderi ujësjellësi PE d=50 mm, PN 10, rezulton se sipas zërit 1(3.89/a) “ Gërmim dheu me ekskavator goma 0.25 m³, në kanale gjerësi deri 2 m, tokë zak, kategoria e tretë, me shk në mjet” është gërmuar (hapur trase kanali) për gjatësinë totale **809.13 ml**, ndërkohë që janë vendosur në total **735 ml** tuba (Tuba e rekorderi ujësjellësi PE d=50 mm, PN 10).

Sa më sipër, rezultojnë **74.13 ml (Gërmim dheu me ekskavator goma 0.25 m³) më tepër** se sa gjatësia e vendosjes së tubit PE d=50 mm PN 10, duke u përfituar nga sipërmarrësi i punimeve, në volumin **65 m³** gërmim {74.13 ml x [0.7 m (gjerësia e kanalit) x 1.25 m (thellësia mesatare e gërmuar)]} ose në vlerën **29,250 lekë pa TVSH** [65 m³ x 450 lekë].

Konstatim: Volume (në mbushje kanali, FV Tuba e rekorderi ujësjellësi PE d=50 mm, PN 10) të librezuara dhe situacionuara **tepër** në zërat: [Shtresë rëre; Nënshtrësë zhavorri (për rrugët pa asfaltim); Mbushje me material të gërmuar, t=40 cm; Shtresë çakelli mbeturinë kave t=20 cm, përhapur e ngjeshur makineri; Shtresë stabilizanti t=10 cm; Shtresë binderi me granil gur kave , 6 cm, me mak; Shtresë asfaltobeton, 4 cm, me mak; Shtresë rërë bituminoze, t=10 cm].

Në hapjen e trasesë për vendosjen e tubave PE d=50 mm PN 10, rezultojnë **74.13 ml “Gërmim dheu me ekskavator goma 0.25 m³...”** më tepër se sa gjatësia e tubave, duke u përfitur nga sipërmarrësi i punimeve, më tepër në zërat e mbushjes së kanalit, argumentuar sipas tabelës, së mëposhtme:

FV Tub OD 50 mm PN 10

Nr.	Zërat mbushës të kanalit	Njësia	Çmimi (Lekë)	Gjatësia tepër në gërmim (m)	Gjerësia e kanalit (m)	Lartësia mesatare (m)	Sipërfaqe mesatare (m ²)	Vëllimi tepër (m ³)	Vlera tepër (lekë)
1	Shtresë rëre	m ³	1,500	74.13	0.7	0.25	-	13	19,500
2	Nënshtresë zhavorri (për rrugët pa asfaltim)	m ³	1,200	74.13	0.7	0.2	-	10	12,000
3	Mbushje me material të gërmuar në trupin e rrugës	m ³	500	74.13	0.7	0.4	-	20	10,000
4	Shtresë çakelli mbeturinë kave t=20 cm, përhapur gjeshur makineri	m ²	400	74.13	0.7	-	52	-	20,800
5	Shtresë stabilizanti t=10 cm	m ²	360	74.13	0.7	-	52	-	18,720
	Shuma								81,020

Diferenca prej 74.13 ml tub është i pa rakorduar saktë në librezën e masave në vlerën **81,020 lekë pa TVSH.**

Për sa konstatuar më sipër, shoqëria mbikëqyrëse “G” SHPK, kontraktori i punimeve “T” SHPK, Kolaudatorët e punimeve F.SH, A.M, M.K, me shkresën nr. 25/1, datë 30.04.2024 (protokolluar në KLSH me nr. 30/7 prot., datë 30.04.2024) ka bërë komente dhe shpjegime për projekt raportin e auditimit, lidhur me problematikat e konstatuara nga grupi i auditimit si vijon:

Pretendimi i subjektit:

Në bazë të volumeve në librezën e masave dhe të situacionuara për zerin Gërmim dheu me ekskavator goma 0.25 m³, në kanale gjerësi deri 2 m, toke zak, kategoria III, me shk në mjet në lidhje me zërat Tuba e rekorderi ujësjellësi PE d=50mm, PN 10 janë librezuar gjithsej:

Rrjeti shpemdare: (73.40+7.47+6.95+5.31+4.84+55.81+28.40+21.61+50+11.8+114.12=**379.71 ml**)

Për zërin 3.45/1 Gërmim kanalesh në tokë të zakonshme, me krahë, me seksion deri 0.75 m² janë librczuar gjithsej:

Rrjeti shperndarës:

(66+7.40+9.0+8.1 +22.5+15.01+27.70+34.84+29.51+23.70+40.84+70.05=**354.65 ml**)

Përfundim: 379.71+354.65=**734.36 ml** trase kanali e hapur nga gërmimet

Në total janë hapur **734.36 ml** trase kanali, ndërsa janë librezuar 735 ml Tub d=50 mm Pn 10, pra një diference shumë e vogël **0.64 ml** tub më shume se trase kanali, që vjen si rezultat i rumbullakimeve të gjatësive.

Sa më sipër, rezultojnë **0.64 ml** tub(PE d=50 mm PN 10), me shumë se trase kanali. që vjen si rezultat i rumbullakimeve të gjatësive. Prandaj gjatësi tubi dhe gjatësi kanali përfutën.

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

1. Mbikëqyrësi i punimeve argumenton gjatësi traseje **734.36 ml** ku në fakt sipas librezë janë realizuar **809.13 ml**.

Lidhur me zërat “Gërmim dheu me ekskavator goma 0.25 m³, në kanale gjerësi deri 2 m, tokë zak, kategoria III, me shk në mjet” dhe “Gërmim kanalesh në tokë të zakonshme, me krahë, me seksion

deri 0.75 m²” nga mbikëqyrësi i punimeve në 3 (raste raste ka zvogëluar gjatësitë e trasesë në observacion, në volumin **75.40 ml** përkatësisht [9.19 ml + 37.21 ml + 29 ml], ndërkohë që këto volume janë pasqyruar në librezën e masave dhe në situacionin përfundimtar të administruar në Bashkinë Patos. Sa më sipër pretenduar, argumenti nuk qëndron. Libreza pjesë e observacionit nuk është e njëjtë me librezën e administruar në dosjen teknike.

2. Nga rishqyrtimi i pasqyrimet të volumeve në librezën e masave mbi hapjen e trasesë për (**FV Tuba e rekorderi ujësjellësi PE d=50 mm, PN 10, t=3.7 mm** rezulton se sipas zërit 1(3.89/a) “Gërmim dheu me ekskavator goma 0.25 m³, në kanale gjerësi deri 2 m, tok zak, kategoria e tretë, me shk në mjet” dhe “Gërmim kanalesh në tokë të zakonshme, me krahë, me seksion deri 0.75 m²” është gërmuar (hapur trase kanali) për gjatësinë totale **809.13 ml** dhe konkretisht [73.4 m + 7.47 m + 6.95 m + 5.31 m + 4.84 m + 55.81 m + 28.4 m + 21.61 m + 50 m + 11.8 m + 114.12 m + 66 m + 7.4 m + 9 m + 8.1 m + 22.5 m + 15.01 m + 27.7 m + 9.19 m + 37.21 m + 29 m + 34.84 m + 29.51 m + 23.07 m + 40.84 m + 70.05 m], ndërkohë që janë vendosur në total **735 ml** tuba (Tuba e rekorderi ujësjellësi PE d=50 mm, PN 10).

Sa më sipër, rezultojnë **74.13 ml (Gërmim dheu me ekskavator goma 0.25 m³) më tepër** se sa gjatësia e vendosjes së tubit PE d=50 mm PN 10, duke u përfutur nga sipërmarrësi i punimeve, në volumin **65 m³** gërmim {74.13 ml x [0.7 m (gjerësia e kanalit) x 1.25 m (thellësia mesatare e gërmuar)]} ose në vlerën **29,250 lekë pa TVSH** [65 m³ x 450 lekë].

Pra kemi, trase e hapur në gjatësinë **809.13 ml** dhe tubacion i vendosur në gjatësinë **735 ml**, pra konstatohet mospërputhje.

Konkluzioni i arritur nga grupi i auditimit, është bazuar në nga matjet faktike të pasqyruara në librezën e masave të administruar në dosjen teknike në Bashkinë Patos, e cila në kuptimin ligjor, mbështetur në **UKM Nr. 3, datë 15.02.2001** “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, **pika 3.2** ku citon se: “Libreza e masave për punimet e ndërtimit është dokumentacioni bazë për verifikimin e saktësisë së vëllimeve të punimeve të ndërtimit, të vendosura në situacion. Kjo librezë hartohet nga drejtuesi teknik i objektit dhe firmoset nga ai, nga mbikëqyrësi i punimeve dhe nga përfaqësuesi ligjor i sipërmarrësit, për të cilin është miratuar leja e ndërtimit”.

Sa më sipër trajtuar, ju nuk keni argumentuar mospërputhjen ndërmjet gjatësisë së trasesë prej **809.13 ml** dhe tubacionit të vendosur në gjatësinë **734.36 ml**, dhe, në këto kushte **observacioni nuk merret në konsideratë**.

Zëri 16(2.491/f) F.V Tuba e rekorderi ujësjellësi PE d=63 mm, t=4.7 mm, PN 10.

Nga auditimi mbi realizimin e këtij zëri në objekt, rezultoi se gjatësia e “Tuba e rekorderi ujësjellësi PE d=63 mm, PN 10” është 1,565 ml, ndërkohë gjatësia e hapjes së trasesë në zërin “Gërmim dheu me ekskavator...” është 1,490.92 ml. Pra u konstatua një diferencë e tubit në gjatësinë 74.08 ml, argumentuar sipas tabelës së mëposhtme:

Nr. rend	Nr. An	Tubacionet	Njësia	Çmimi (lekë)	Situac. përf (ml)	Gjatësia në gërmim, sipas librezës masave	Difere nca (ml)	Fakti (ml)	Vlera (lekë)
16	16(2.49 2/f	FV. Tuba e rekorderi ujësjellësi PE d=63 mm, PN 10	ml	450	1,565	1,490.92	74.08	1,490.92	33,336
		Shuma							33,336

Diferenca prej 2.95 ml tub është i pa rakorduar saktë në librezën e masave në vlerën **33,336 lekë pa TVSH**.

Konstatim: T01/1 Pusetat vertikale të shpërndarjes (Ana ndërtimore).

Kostoja për 1 puseta është 51,950.4 lekë. Vlera për 42 puseta vertikale është 2,181,916.80 lekë. Situacioni përfundimtar pasqyron 42 puseta vertikale. Libreza e masave pasqyron 42 puseta vertikale, trajtuar analitikisht.

Nga auditimi mbi realizimin në objekt mbi zbatimin e këtij zëri, rezultoi se pusetat vertikale nuk janë suvatuar nga pjesa e prapme në volumn prej 2.4 m2 dhe as lyster me gëlqere. Pra, nuk është realizuar nënzeri i punës 4(2.31) dhe 5(2.399). Nga llogaritja rezulton punë e pa kryer:

- 2.4 m2 x 750 lekë x 42 puseta = 75,600 lekë pa TVSH (suvaja)
- 2.4 m2 x 100 lekë x 42 puseta = 10,080 lekë pa TVSH (Sherbetoje)

Sa më sipër, është përfituar nga sipërmarrësi i punimeve për punë të pakryer në shumën **85,680** lekë pa TVSH.

Konstatim: T05 . Lidhjet e banesave individuale (me kasete metalike) ujësjellësit).

Situacioni përfundimtar pasqyron 2 copë kasete metalike. Kostoja për 1 kasete metalike është 22,000 lekë. Vlera për 2 copë kasete metalike është 44,000 lekë. Libreza e masave pasqyron 2 copë, trajtuar analitikisht.

Nga auditimi mbi realizimin në objekt mbi zbatimin e këtij zëri, rezultoi se kasetat metalike nuk janë vendosur fare në banesat individuale. Pra, nënzeri 8(An122/Lidhje) nuk është realizuar.

Sa më sipër, është përfituar nga sipërmarrësi i punimeve për punë të pakryer në shumën **10,000** lekë pa TVSH (2 copë kasete metalike x 5,000 lekë/kasete).

Për sa konstatuar më sipër, shoqëria mbikëqyrëse “G” SHPK, kontraktori i punimeve “T” SHPK, Kolaudatorët e punimeve F.SH, A.M, M.K, me shkresën nr. 25/1, datë 30.04.2024 (protokolluar në KLSH me nr. 30/7 prot., datë 30.04.2024) ka bërë komente dhe shpjegime për projekt raportin e auditimit, lidhur me problematikat e konstatuara nga grupi i auditimit si vijon:

1. Pretendimi i subjektit:

Në bazë të volumeve në librezën e masave dhe të situacionuara për zërin Gërmim dheu me ekskavator goma 0.25 m3, në kanale gjerësi deri 2 m, toke zak, kategoria III, me shk në mjet në lidhje me zërat Tuba e rekorderi ujësjellësi PE d=63mm, PN 10, janë librezuar gjithsej:

Rrjeti shpëmdares:

(129.40+236.35+28.26+11.6+101.9+21.73+59.1+116.1+6.6+12.33+12+91.76+9.91+3.95+11.91+9.92+12.93+15.47+29.21+7.56+10.02+17+8.1+9.15+10.45+78.50+24.20+18.87+40.36+34.44+29.09+168.64=1,376.82 ml)

Për zërin 3.45/1 Gërmim kanalesh në toke të zakonshme, me krahë, me seksion deri 0.75 m2 janë librezuar gjithsej:

Rrjeti shpëmdares: (9.19+37.21+29+26.50+5.30+6+49.1+27.2=189.5 ml)

Përfundim: 1376.82+189.5=1,566.32 ml trase kanali e hapur nga gërmimet.

Në total janë hapur 1,566.32 ml, trase kanali, ndersa janë librezuar 1,565 ml, Tub d=63mm Pn 10, pra

1.32 ml trase kanali më shume se tub.

Sa më sipër. rezultojnë 1.32 ml tub (PE d=63 mm PN16), me tepër në volum se trase kanali e hapur, ose në vlerën 594.0 Leke pa TVSH [1.32 ml x 450 lekë).

1. Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Nga shqyrtimi me kujdes i observacionit, audituesi sqaron si më poshtë:

1. Në observacionin e bërë nga shoqëria mbikëqyrëse “G” SHPK, me shkresën nr. 25/1, datë 08.03.2024 (protokolluar në KLSH me nr. 30/3 prot., datë 12.03.2024) për Akt Konstatimin nr. 17, datë 01.03.2024, jeni shprehur se “Për zërin “16 (2.491/f) F.V Tuba e rekorderi ujësjellësi PE d =63 mm, t = 4.7 mm, PN 10”, konstatimi se gjatësia e situacionuar e tubit është 74.08 ml me e vogël se shuma e gjatësive të tubave e librezuar për gërmim kanali për to është e saktë por nuk do te thotë që janë vendosur **74.08 ml tub më pak** sepse kjo gjatësi është gjatësia e tubave PE d = 63 brenda pusetave, të cilat nuk janë llogaritur në gjatësi për gërmim kanali. Pra është një volum tubi i vendosur jo në gjatësi kanali por në puseta”.

Ndërsa për observacionin mbi projekt raportin e auditimit, shpreheni, se në total janë hapur **1,566.32 ml** trase kanali, ndërsa janë librezuar **1,565 ml** Tub d=63 mm PN 10, pra **1.32 ml** tub më shumë se trase kanali. Pra, nga mbikëqyrësi **argumenti jepet me 2 (dy) qëndrime** dhe nuk jeni bindës për sa pretendoni.

2. Mbikëqyrësi i punimeve pasqyron gjatësi traseje 1,566.32.97 ml ku në fakt sipas librezë janë realizuar **1,490.92 ml**.

Lidhur me zërin “Gërmim kanalesh në tokë të zakonshme, me krahë, me seksion deri 0.75 m² ” nga mbikëqyrësi i punimeve në 3 (tre) raste ka shtuar gjatësitë e trasesë në observacion, në volumin **75.40 ml** përkatësisht [9.19 ml + 37.21 ml + 29 ml], ndërkohë që këto volume nuk janë pasqyruar në librezën e masave dhe në situacionin përfundimtar të administruar në Bashkinë Patos. Sa më sipër pretenduar, argumenti nuk qëndron. Libreza pjesë e observacionit nuk është e njëjtë me librezën e administruar në dosjen teknike.

3. Nga rishqyrtimi i pasqyrimin të volumeve në librezën e masave mbi hapjen e trasesë për (FV Tuba e rekorderi ujësjellësi PE d=63 mm, t=4.7 m, PN 10, rezulton se sipas zërave “Gërmim dheu me ekskavator goma 0.25 m³, në kanale gjerësi deri 2 m, tokë zak, kategoria III, me shk në mjet” dhe “Gërmim kanalesh në tokë të zakonshme, me krahë, me seksion deri 0.75 m² ” është gërmuar (hapur trase kanali) për gjatësinë totale **1,490.92 ml [rrjeti shpërndarës: 129.4+236.35+28.26+11.6+101.9+**

21.73+59.11+116.1+6.6+12.33+12+91.76+9.91+3.95+11.91+9.92+12.93+15.47+29.21+7.56+10.02+17+8.1+9.15+10.45+78.5+24.2+18.87+40.36+34.44+29.09+168.64+26.5+5.3+6+49.1+27.2], ndërkohë që janë vendosur në total **1,565 ml (Tuba e rekorderi ujësjellësi PE d=63 mm, t=4.7 mm, PN 10).**

Sa më sipër, rezultojnë **74.08 ml (Gërmim dheu me ekskavator + gërmim me krahë...)** gjatësi tubacioni më tepër se sa gjatësia e trasesë, duke u përfituar nga sipërmarrësi i punimeve, më tepër në vlerën **33,336 lekë pa TVSH** [74.08 x 450 lekë].

Pra kemi, trase e hapur në gjatësinë **1,490.92 ml** dhe tubacion i vendosur në gjatësinë **1,565 ml**, pra konstatohet mospërputhje.

Konkluzioni i arritur nga grupi i auditimit, është bazuar në nga matjet faktike të pasqyruara në librezën e masave të administruar në dosjen teknike në Bashkinë Patos, e cila në kuptimin ligjor, mbështetur në **UKM Nr. 3, datë 15.02.2001** “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, **pika 3.2.** Sa më sipër trajtuar, ju nuk keni argumentuar mospërputhjen ndërmjet gjatësisë së trasesë prej **1,490.92 ml** dhe tubacionit të vendosur në gjatësinë **1,565 ml**, dhe, në këto kushte **observacioni nuk merret në konsideratë.**

2. Pretendimi i subjektit:

Për zërin T01/I Pusetat vertikale të shpërndarjes (Ana ndërtimore), konstatimi se pusetat vertikale nuk janë suvatuar dhe lyer nga pjesa e pasme është i saktë për disa puseta për të cilat ka qenë e pamundur suvatimi dhe lyerja me gëlqere për arsye hapësire. Këto puseta janë të mbështetura në mure dhe rrethime ekzistuese nga ana e mbrapme. Nga konstatimi ynë ne vend janë 16 puseta që nuk janë suvatuar nga ana e pasme.

2. Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Lidhur për sa ju sqaroni se, për disa puseta për të cilat ka qenë e pamundur suvatimi dhe lyerja me gëlqere për arsye hapësirë, këto puseta janë të mbështetura në mure dhe rrethime ekzistuese nga ana e pasme, ju sqarojmë se volumi për nënzërat “Suva mur tulle llaç përzier M 25” dhe “Sherbetisje e bojatosje me gëlqere” duhej që ana Juaj të ishin hequr nga rishikimi i projekt preventivit dhe jo të situacionoheshin duke u përfituar nga sipërmarrësi i punimeve pa u realizuar në fakt. Sa më sipër **observacioni nuk merret në konsideratë.**

3. Pretendimi i subjektit:

Për zërin “T05. Lidhjet e banesave individuale (me kaseta metalike) ujësjellësit”, konstatimi për nën zërin 8 (An 122/) Lidhje - Kaseta metalike 60 x 40 x 30) cm është i pasakte pasi në objekt janë vendosur të gjitha kasetat metalike dhe është bërë azhurnimi i plotë i tyre nga të gjitha palët. Në rast mospranimi kërkohet nga ana juaj ri-inspektimin në terren për verifikimin e plote të tyre sipas projektit faktik të miratuar.

3. Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Pretendimi Juaj qëndron për vendosjen e kasetave me përmasa (100 x 30 x 120) cm të cilat janë miratuar me proces verbal nr. 2 (pa datë dhe nr. prot.) mbi evidentimin dhe pasqyrimin e zërave të rinj të punimeve për objektin: “Rikonstruksioni i magjstralit kryesor dhe rrjetit të brendshëm të ujësjellësit të qytetit Patos

Loti I (Rrjeti shpërndarës)”, nënshkruar nga palët: Investitori Bashkia Patos; Kontraktori i punimeve “T” SHPK dhe mbikëqyrësi i punimeve "G" SHPK. Ju sqarojmë se problematika e konstatuar nga grupi i auditimit ka të bëjë me zërin “An 122/lidhje” Kasete metalike (60 x 40 x 30) cm [Lidhjet e banesave individuale (me kasete metalike) ujësjellësit)], ku nga auditimi në vepër në prezencë të mbikëqyrësit të punimeve, u konstatua se nuk është realizuar. Sa më sipër **observacioni nuk merret në konsideratë.**

Sa më sipër Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12; Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” e konkretisht Kreu II, Pika 3; Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit me nr. 2214/21 prot., datë 31.03.2020; - Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 2506/12 prot., datë 31.03.2020 dhe Kontratën e kolaudimit të punimeve me nr. 2214/28 prot., datë 04.04.2020.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: (1) z. G.B, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve të objektit; **(2) z. F.SH,** në cilësinë e kolaudatorit të punimeve të objektit; **(3) znj. A.M (C),** në cilësinë e kolaudatorit të punimeve të objektit; **(4) znj. M.K,** në cilësinë e kolaudatorit të punimeve të objektit.

Konstatim: Nga auditimi i dosjes teknike të zbatimit për kontratën me objekt “Rikonstruksioni magjistralit kryesor dhe rrjetit të brendshëm të ujësjellësit qytetit Patos Loti I (Rrjeti shpërndarës)” u konstatua se, kjo dosje është e pa inventarizuar dhe, e pa arkivuar në Autoritetin Kontraktor Bashkinë Patos, veprim ky në kundërshtim me ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 Për arkivat” i ndryshuar dhe, **duhet të jetë në vëmendjen e Kryetarit të Bashkisë Patos z. F.D. dhe përgjegjësit të protokollit dhe arkivës znj. E.G.**

2. Nga auditimi i zbatimit të punimeve për objektin: “Rikonstruksioni i shkollës “Muhamet Shehu” dhe ndërtimi i palestrës” Bashkia Patos me të dhënat e përgjithshme sipas tabelës:

13. Zbatimi i Kontratës së Punimeve “Rikonstruksioni i shkollës “Muhamet Shehu” dhe ndërtimi i palestrës” Bashkia Patos.		
14.Lidhja e kontratës: nr. 1784/18 prot., datë 05.12.2022	15.Vlera e kontratës Vl e prev ofertues 85,682,886 lekë me TVSH Punime të realizuara në vlerën 85,630,556.11 lekë me TVSH	16.Likuiduar/situacionet: Sit. 1 në vlerën 32,434,150 lekë me TVSH Sit. 2 në vlerën 20,008,306 lekë me TVSH Sit. 3 në vlerën 9,280,060 lekë me TVSH Sit. 4 në vlerën 20,620,416 lekë pa TVSH
17- Situacioni Përfundimtar - Sit përf në vlerën 3,234,100 lekë pa TVSH	18.Afati i kontratës: Fillimi punimeve: 07.12.2022 Përfundimi punimeve: Datë 04.10.2023	19. Zgjatja e kontratës Nuk ka shtyrje afati
20. Mbikëqyrësi i punimeve OE “G” SHPK	Licenca MK.2928/9	Kontratë me nr. 1784/19 prot., datë 05.12.2022
21. Kolaudatori i punimeve OE “A” SHPK	Licenca Nr: MK.2463/7	Kontratë nr. 1784/25 prot., datë 16.10.2023
22.Akt Kolaudimi. Datë: -----	23.Akt i marrjes në dorëzim: Me datë -----	

ku rezultoi me problematikat, si vijon:

Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me objekt “Rikonstruksioni i shkollës “Muhamet Shehu” dhe ndërtimi i palestrës” Bashkia Patos, me vlerë 85,682,886 lekë me TVSH, fituar nga OE “SH” SHPK, rezultuan punime ndërtimi të pakryera në volumet e situacionuara, për zërat e punimeve: [Kasetë shkarkimi me llamarinë xingat; Hidroizolim me emulsion bitumi dhe 1 shtresë katrama; Kolona b/a monolite C 20/25 h-4 m

(koloncinat e kangjellave); Dritare duralumini dyfish xham], me pasojë dëm ekonomik në buxhetin e Bashkisë Patos, në vlerën **1,161,868 lekë pa TVSH** nga ku:

-Vlera prej **332,430 lekë pa TVSH**, përfaqëson volume pune të likuiduara më tepër në situacionin nr. 1, datë për zërat e punimeve (Zëri 7(An). Prishje suvatim i jashtëm t=2-3 cm dhe Zëri 8(An). Prishje suvatim i brendshëm t=2-3 cm). Kjo shumë duhet ti mbahet sipërmarrësit të punimeve nga Autoriteti Kontraktor Bashkia Patos.

-Vlera prej **616,840 lekë pa TVSH**, përfaqëson volume pune të pa realizuara, për zërat e punimeve Zëri 5 (2.206). Kasetë shkarkimi me llamarinë xingat; Zëri 2 (2.196). Hidroizolim me emulsion bitumi dhe 1 shtresë katrama; Zëri 24(2.117/1) Kolona b/a monolite C 20/25 h-4 m (koloncinat e kangjellave); Zëri 27 (2.a-121). Kanalinë metalike 150x50. Kjo shumë duhet të dëmshpërblehet nga mbahet sipërmarrësit të punimeve.

-Vlera **212,598 lekë pa TVSH**, përfaqëson realizimin e zërit “Zëri 25 (2.375/a) Dritare duralumini dyfish xham” jo në përputhje me specifikimet teknike dhe kushtet e kontratës. Kjo shumë duhet të dëmshpërblehet nga mbahet sipërmarrësit të punimeve.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

(1) Znj. R.B., në cilësinë e ish Kryetarit të Bashkisë Patos dhe **(2) z. L.H.**, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve.

Konstatim: Për projektin e zbatimit të objektit: “Rikonstruksioni i shkollës “Muhamet Shehu” dhe ndërtimi i palestrës” Bashkia Patos, nuk është kryer oponencë teknike nga Bashkia Patos. Ky veprim është në kundërshtim me Ligjin Nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, neni 6, germa (a).

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: Znj. R.B , në cilësinë e ish Kryetarit të Bashkisë Patos.

Sa më sipër është në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 6, neni 7 dhe neni 12; Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” e konkretisht Kreu II, Pika 3; Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit me nr. 1784/18 prot., datë 05.12.2022; Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 1784/19 prot., datë 05.12.2022 dhe Kontratën e kolaudimit të punimeve me nr. 2214/28 prot., datë 04.04.2020.

3. Nga auditimi i zbatimit të punimeve për objektin: “Rikonstruksion dhe shtrim me asfaltobeton të rrugës Banaj” Bashkia Patos me të dhënat e përgjithshme sipas tabelës,

13. Zbatimi i Kontratës së Punimeve “Rikonstruksion dhe shtrim me asfaltobeton të rrugës Banaj” Bashkia Patos.		
14.Lidhja e kontratës: nr. 2085/22 prot., datë 20.12.2022	15.Vlera e kontratës Vl e prev ofertues 30,430,183 lekë me Tvsh.	16.Likuiduar/situacionet: Sit. 1 në vlerën 14,894,588lekë me TVSH
17- Situacioni Përfundimtar - Sit përf në vlerën 14,894,588 lekë me TVSH	18.Afati i kontratës: Fillimi punimeve: 21.12.2022 Përfundimi punimeve: Datë 26.06.2023	19. Zgjatja e kontratës Nuk ka shtytje afati
20. Mbikëqyrësi i punimeve OE “R” SHPK	Licenca MK.1506/10	Kontratë me nr. 2085/23 prot., datë 20.12.2022
21. Kolaudatori i punimeve OE “A” SHPK	Licenca Nr: MK.2463/7	Kontratë nr. 2089/28 prot., datë 04.04.2023
22.Akt Kolaudimi. Datë: 23.10.2023	23.Akt i marrjes në dorëzim: Me datë 23.10.2023. Certifikata e përkohshme e marrjes në dorëzim është nënshkruar nga: Kontraktori i punimeve “N” SHPK përfaqësuar nga z. I.L; nga Mbikëqyrësi i punimeve shoqëria “R” SHPK përfaqësuar nga Ing. R.N dhe nga	

	Kolaudatori i punimeve shoqëria “A” SHPK e përfaqësuar nga z. A.SH; komisioni i marrjes në dorëzim me përbërje (B.M, S.M, A.R) si dhe Kryetari i Bashkisë z. F.D. Periudha e garancisë është deri me datë 23.05.2025.
--	--

ku rezultoi me problematikat, si vijon:

Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me objekt “Rikonstruksion dhe shtrim me asfaltobeton të rrugës Banaj” Bashkia Patos, me vlerë 30,430,183 lekë me TVSH, fituar nga OE “N” SHPK, rezultuan punime ndërtimi të pakryera në volumet e situacionuara, për zërat e punimeve: [Bankinë, shtresë stabilizanti t=10cm; Struktura monolite betoni C 16/20], me pasojë dëm ekonomik në buxhetin e Bashkisë Patos, në vlerën **877,040 lekë** pa TVSH, argumentuar si vijon:

Nr Anal	Zëri i punimeve	Njësi a	Çmimi i ofertës	Situacioni përfundimtar	Libri i masave	Fakti	Diferenca në +	
							Vol.	Vlera
	Punime shtresash.							-
Zëri 5(3.2 12/b)	Bankinë, shtresë stabilizanti t=10cm	m ²	320	2,945	2,945	1,240	1,705	545,600
	Punime elektrike							-
Zëri 6(3.2 43)	Struktura monolite betoni C 16/20	m ³	8,000	16.3	16.3	-	16.3	130,400
	Punime mure mbajtës							-
Zëri 3(3.2 43)	Struktura monolite betoni C 16/20	m ³	8,000	167.3	167.3	142.17	25.13	201,040
	Totali në lekë pa TVSH							877,040

Për projektin e zbatimit të objektit: “Rikonstruksion dhe shtrim me asfaltobeton të rrugës Banaj” Bashkia Patos, **nuk është kryer oponencë teknike** nga Bashkia Patos. Ky veprim është në kundërshtim me Ligjin Nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, neni 6, germa (a).

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: Znj. R.B , në cilësinë e ish Kryetarit të Bashkisë Patos.

Konstatim 1:-Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit për objektin “Rikonstruksion dhe shtrim me asfaltobeton të rrugës Banaj” Kryetari i Bashkisë Patos, ka lidhur kontratën e shërbimit të kolaudimit me nr. 2089 prot., datë 04.04.2023, ka ngarkuar si kolaudator i punimeve shoqërisë “A” SHPK e përfaqësuar nga z. A.SH me nr. licence MK.2463/7.

-Kolaudimi i punimeve është bërë me datë 23.10.2023, ndërkohë që punimet e objektit kanë përfunduar me datë 26.06.2023, pra, rreth 4 (katër) muaj me vonesë, veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, neni 12 ku citohet: “Emërimi i kolaudatorit apo grupit të kolaudimit... bëhet brenda 30 ditëve nga përfundimit i punimeve të ndërtimit”. Proces verbali mbi kolaudimin është nënshkruar nga: Kontraktori i punimeve “N” SHPK përfaqësuar nga z. I.L; nga Mbikëqyrësi i punimeve shoqëria “R” SHPK përfaqësuar nga Ing. R.N dhe nga Kolaudatori i punimeve shoqëria “A” SHPK e përfaqësuar nga z. A.SH. Ky veprim ngarkon me përgjegjësi titullarin e Bashkisë Patos z. F.D.

Konstatim 2: Kolaudimi i punimeve të ndërtimit për objektin “Rikonstruksion dhe shtrim me asfaltobeton të rrugës Banaj” Kryetari i Bashkisë Patos, është bërë me datë 23.10.2023, ndërkohë që punët e objektit kanë përfunduar me datë 26.06.2023, pra, rreth 4 (katër) muaj me vonesë, veprim ky në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, neni 12 ku citohet: “Emërimi i kolaudatorit apo grupit të kolaudimit... bëhet brenda 30 ditëve nga përfundimit i punimeve të ndërtimit”. Proces verbali mbi kolaudimin është nënshkruar nga: Kontraktori i punimeve “N” SHPK përfaqësuar nga z. I.L; nga Mbikëqyrësi i punimeve shoqëria “R” SHPK përfaqësuar nga Ing. R.N dhe nga Kolaudatori i punimeve shoqëria “A” SHPK e përfaqësuar nga z. A.SH. Ky veprim ngarkon me përgjegjësi Titullarin e Bashkisë Patos z. F.D.

Sa më sipër është në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi”, i ndryshuar, Kreu III, neni 6, neni 7 dhe neni 12; Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” e konkretisht Kreu II, Pika 3; Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit me nr. 2085/22 prot., datë 20.12.2022; Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 2085/23 prot., datë 20.12.2022.

4. Nga auditimi i zbatimit të punimeve për objektin: “Rikonstruksion i çerdhes Patos me hapësirat përreth” Bashkia Patos me të dhënat e përgjithshme sipas tabelës:

13. Zbatimi i Kontratës së Punimeve “Rikonstruksion i çerdhes Patos me hapësirat përreth” Bashkia Patos.		
14. Lidhja e kontratës: nr. 2104/20 prot., datë 19.01.2023	15. Vlera e kontratës V1 e prev ofertues 14,965,001 lekë me Tvsh. V1 e prev të rishikuar 14,953,267 lekë me TVSH	16. Likuiduar/situacionet: Sit. 1 në vlerën 7,731,045 lekë me TVSH (likuiduar) Sit. 2 në vlerën 3,062,775 lekë me TVSH (i palikuiduar)
17- Situacioni Përfundimtar - Sit përf në vlerën 4159447 lekë me TVSH (i pa likuiduar dhe i pa miratuar nga Kryetari i Bashkisë)	18. Afati i kontratës: Fillimi punimeve: 24.01.2023 Përfundimi punimeve: 19.06.2023	19. Zgjatja e kontratës Nuk ka shtyrje afati
20. Mbikëqyrësi i punimeve OE “D” SHPK	Licenca MK.1676/12	Kontratë me nr. 2109/21 prot., datë 19.01.2023
21. Kolaudatori i punimeve OE “A” SHPK	Licenca Nr: MK.2463/7	Urdhër nr. 2104/25 prot., datë 04.04.2023
22. Akt Kolaudimi. Datë nga 07.07.2023 deri 12.07.2023	23. Akt i marrjes në dorëzim: ----	

ku rezultoi me problematikat, si vijon:

-Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike, me objekt “Rikonstruksion i çerdhes Patos me hapësirat përreth” Bashkia Patos, me vlerë 14,965,001 lekë me TVSH, fituar nga OE “S” SHPK, specifikisht për volumet e punimeve të ndërtimit të pasqyruara në situacionin nr. 1, datë 07.04.2023 dhe në situacionin nr. 2, datë 19.01.2023, rezultuan punime të pasqyruara në volume më tepër, krahasuar me volumet faktike sipas preventivit të ripunuar dhe tabelës së rakordimeve të punimeve që shtohen dhe punimeve që pakësohen, në vlerën **1,921,946 lekë pa TVSH**, për **26** zëra pune ndërtimi, argumentuar si vijon:
-Për **zërin 7(An). Prishje suvatim i brendshëm**, është përfituar tepër, në mënyrë ta parregullt nga sipërmarrësi i punimeve në vlerën **125,088 lekë pa TVSH** (625.44 m² x 200 lekë), nga likuidimi në situacionit nr. 1, pa bërë azhurnimin e projekt preventivit me volumet e faktit në objekt.

-Për zërin 8 (An). Prishje suvatim tavan, t=3cm, është përfituar tepër, në mënyrë ta parregullt nga sipërmarrësi i punimeve në vlerën **8,000 lekë pa TVSH (40 m² x 200 lekë)**, nga likuidimi në situacionit nr. 1, pa bërë azhurnimin e projekt preventivit me volumet e faktit në objekt.

-Për zërin 1(2.196/c). Hidroizolim pllake dhe tualetesh me dy shtresa mapej , është përfituar tepër, në mënyrë ta parregullt nga sipërmarrësi i punimeve në vlerën **4,116 lekë pa TVSH (13.72 m² x 300 lekë)**, nga likuidimi në situacionit nr. 1, pa bërë azhurnimin e projekt preventivit me volumet e faktit në objekt.

-Për zërin 6 (2.200). Shtresë llustër çimento 1:2, është përfituar tepër, në mënyrë ta parregullt nga sipërmarrësi i punimeve në vlerën **18,090 lekë pa TVSH (36.18 m² x 500 lekë)**, nga likuidimi në situacionit nr. 1, pa bërë azhurnimin e projekt preventivit me volumet e faktit në objekt.

-Për zërin 1(2.300). Suva solete h-4m me drejtues, me krah, është përfituar tepër, në mënyrë ta parregullt nga sipërmarrësi i punimeve në vlerën **35,766 lekë pa TVSH (39.74 m² x 900 lekë)**, nga likuidimi në situacionit nr. 1 dhe nr. 2, pa bërë azhurnimin e projekt preventivit me volumet e faktit në objekt.

-Për zërin 2(2.310). Suva brenda mur tulle, h-4m me krah, llaç i përzier M 25, është përfituar tepër, në mënyrë ta parregullt nga sipërmarrësi i punimeve në vlerën **695,961 lekë pa TVSH (773.29 m² x 900 lekë)**, nga likuidimi në situacionit nr. 1, pa bërë azhurnimin e projekt preventivit me volumet e faktit në objekt.

-Për zërin 3(2.388/1). FV Dyer të brendshme tamburato të rimesuara, është përfituar tepër, në mënyrë ta parregullt nga sipërmarrësi i punimeve në vlerën **57,600 lekë pa TVSH (3.84 m² x 15,000 lekë)** nga likuidimi në situacionin nr. 2, pa bërë azhurnimin e projekt preventivit me volumet e faktit në objekt.

-Për zërin 2(2.200). Shtresë llustër çimento 1:2, t=20 mm, është përfituar tepër, në mënyrë ta parregullt nga sipërmarrësi i punimeve në vlerën **24,985 lekë pa TVSH (49.97 m² x 500 lekë)** nga likuidimi në situacionin nr. 1, pa bërë azhurnimin e projekt preventivit me volumet e faktit në objekt.

-Për zërin 3(2.328). Patinim muresh, është përfituar tepër, në mënyrë ta parregullt nga sipërmarrësi i punimeve në vlerën **596,395 lekë pa TVSH (1,192.79 m² x 500 lekë)** nga likuidimi në situacionin nr. 1, pa bërë azhurnimin e projekt preventivit me volumet e faktit në objekt.

-Për zërin 4(2.330). Patinim tavanesh, është përfituar tepër, në mënyrë ta parregullt nga sipërmarrësi i punimeve në vlerën **19,870 lekë pa TVSH (39.74 m² x 500 lekë)** nga likuidimi në situacionin nr. 1 në volumin 280 m² dhe 10 m² në situacionin nr. 2, pa bërë azhurnimin e projekt preventivit me volumet e faktit në objekt.

-Për zërin 5(2.401). Bojë vaji sipërfaqe metalike, është përfituar tepër, në mënyrë ta parregullt nga sipërmarrësi i punimeve në vlerën **233,750 lekë pa TVSH (935 m² x 250 lekë)** nga likuidimi në situacionin nr. 2, pa bërë azhurnimin e projekt preventivit me volumet e faktit në objekt.

-Për zërin 4(2.209). Ulluk shkarkimi vertikal me llamarinë xingat Ø 110 mm, është përfituar tepër, në mënyrë ta parregullt nga sipërmarrësi i punimeve në vlerën **1,125 lekë pa TVSH (1.25 m² x 900 lekë)** nga likuidimi në situacionin nr. 2 , pa bërë azhurnimin e projekt preventivit me volumet e faktit në objekt.

-Për zërin 10(An). F.V. Valvol ndërpresese radiatorit me sferë ½, është përfituar tepër, në mënyrë ta parregullt nga sipërmarrësi i punimeve në vlerën **3,000 lekë pa TVSH (2 copë x 1,500 lekë)** nga likuidimi në situacionin nr. 1, pa bërë azhurnimin e projekt preventivit me volumet e faktit në objekt.

-Për zërin 11(An). F.V. Valvol termostatike ½” të drejta, është përfituar tepër, në mënyrë ta parregullt nga sipërmarrësi i punimeve në vlerën vlerën **3,000 lekë pa TVSH (2 copë x 1,500 lekë)** nga likuidimi në situacionin nr. 1, pa bërë azhurnimin e projekt preventivit me volumet e faktit në objekt.

-Për zërin 1(An. F.V. Kablo të TU, Un=0.6/1 Kv; tip RG7R; S=4x6 mm, Cu (furnizim paneli kryesor), është përfituar tepër, në mënyrë ta parregullt nga sipërmarrësi i punimeve në vlerën vlerën **1,000 lekë pa TVSH** (1 ml x 1,000 lekë) nga likuidimi në situacionin nr. 2, pa bërë azhurnimin e projekt preventivit me volumet e faktit në objekt.

-Në vijim, në të njëjtën logjikë sa më sipër trajtuar (për 9 zëra pune), po paraqesim zëra pune të çertifikuara në situacionin nr. 1 dhe, në situacionin nr. 2 në shumën **94,200 lekë** pa TVSH, pasqyruar tepër në volume krahasuar me volumet e preventivit të ripunuar si dhe tabelën e punimeve që shtohen dhe punimeve që zbriten në objektin “Rikonstruksioni i Çerdhes në lagjen “Naftëtari””, argumentuar sipas tabelës së mëposhtme:

Nr Anal	Zëri i punimeve	Njësia	Çmimi i ofertës	Preventivi i ripunuar	Situacioni nr. 1 (i likuiduar)	Situacioni nr. 2	Libri i masave	Fakti	Diferenca në +	
									Vol. +	Vlera
E.2 Kuadri elektrik										-
Zëri 1(2.490/1b)	FV Automat termo/el manj. Deferencial 2P 220 V, 16 A	Copë	5,000	0	0	4	4	0	4	20,000
Zëri 6(FV Automat termo/el . manj)	FV Automat termo/el manj. Deferencial 2P 220 V, 10 A	Copë	5,000	3	0	10	3	3	7	35,000
E.3 Sistemi i fuqisë, ndriçimit dhe sinjalizimit										-
Zëri 2(2.481/2)	Përcjellës i veshur, flex; k.z.: S=2.5 mm2	ml	100	980	1050	-	980	980	70	7,000
Zëri 7(2.485/2)	F. Çelës 1 polarë, 10A devijat	copë	500	17	-	18	17	17	1	500
Zëri 9(2.485/b)	F.V. Priza bivalente 220V 10A 2P-T Gevis	copë	500	10	-	19	10	10	9	4,500
Zëri 10(2.485/d)	FV Prizë “Schuko” 16A dy module të bardha Gevis universale	copë	500	61	63	-	61	61	2	1,000
E.5 Mbrojtja nga shkarkimet atmosferike										-
Zëri 3(2.a-93)	FV Përcjellës bakri i zhveshur S=16 mm2	ml	100	0	12	-	0	0	12	1,200
E.6 Montimi i pajisjeve elektrike										-
Zëri 1(2.a-130)	Ndriçues fluoreshent, planfonere FLCIX40ë, IP 65	copë	3,500	15	0	20	15	15	5	17,500
Zëri 3(2.a-131)	Ndriçues fluoreshent, planfonere IP-40, FL 1x18 ë (me mbishkrim dalje) bat.NiCd me autonomi 2 orë	copë	2,500	2	0	5	2	2	3	7,500
Totali në lekë pa TVSH										94,200

Kjo problematikë ka ardhur sepse, është bërë pasqyrimi i volumeve në situacionin nr. 1 dhe nr. 2, pa bërë azhurnimin e projekt preventivit.

-Grupi i auditimit konstaton se situacioni përfundimtar nuk pasqyron volumet faktike sipas preventivit të ripunuar dhe tabelës së rakordimit të punimeve që shtohen dhe punimeve që pakësohen.

-Nga akti i kolaudimit për objektin: “Rikonstruksioni i çerdhes Patos me hapësirat përreth” datë 12.07.2023 i nënshkruar nga palët: (1) Sipërmarrësi i punimeve “S” SHPK, (2) Mbikëqyrësi i punimeve “D” SHPK dhe, (3) Kolaudatori i punimeve “A” SHPK, edhe pse, nuk janë konstatuar problematika nga palët mbi zbatimin e kontratës dhe realizimin e punimeve të ndërtimit, aktualisht deri me datë 01.03.2024 nuk ka filluar procedura e marrjes së përkohshme në dorëzim të objektit. Titullari i AK Bashkisë Patos, duhet të ngrejë grupin e punës për marrjen në dorëzim të investimit. Sa më sipër është në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi”, i ndryshuar, Kreu III, neni 6, neni 7 dhe neni 12; Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” e konkretisht Kreu II, Pika 3; Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit me nr. 2104/20 prot., datë 19.01.2023; Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 2109/21 prot., datë 19.01.2023.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. Znj. R.B., në cilësinë e ish-Kryetarit të Bashkisë Patos.

2. Z. V.T., në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve të objektit.

Konstaim:Për projektin e zbatimit të objektit: “Rikonstruksion i çerdhes Patos me hapësirat përreth” nga AK Bashkia Patos, **nuk është kryer oponencë teknike**, veprim është në kundërshtim me Ligjin Nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi”, i ndryshuar, neni 6, germa (a) dhe, **ngarkohet me përgjegjësi ish-Kryetari i Bashkisë Patos Znj. R.B.**

5. Nga auditimi i zbatimit të punimeve për objektin: “Përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra të pa favorizuara” Bashkia Patos me të dhënat e përgjithshme sipas tabelës:

13. Zbatimi i Kontratës së Punimeve “Përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra të pa favorizuara” Bashkia Patos. REF-39389-08-2-2022		
14.Lidhja e kontratës: nr. 2104/20 prot., datë 19.01.2023	15.Vlera e kontratës VI e prev ofertues 16,527,174 lekë me Tvsh.	16.Likuiduar/situacionet: Sit. 1 në vlerën 8,673,190 lekë me TVSH Sit. 2 (përfundimtar) në vlerën 6,223,930 lekë me TVSH
17- Situacioni Përfundimtar total - Sit përf në vlerën 14,897,119 lekë me TVSH	18.Afati i kontratës: Fillimi punimeve: 29.09.2022 Përfundimi punimeve: Datë 02.10.2023	19. Zgjatja e kontratës 60 ditë bazuar ne Nr. 1707.2023
20. Mbikëqyrësi i punimeve OE “D” SHPK	Licenca MK.1676/12	Kontratë me nr. 1867/17 prot., datë 28.09.2022
21. Kolaudatori i punimeve OE “A” SHPK	Licenca Nr: MK.2463/7	Urdhër nr. 1867/22 prot., datë 04.10.2023 Kontratë nr. 1867/23 prot., datë 04.10.2023
22.Akt Kolaudimi. 04.10.2023 - 26.12.2023	23.Akt i marrjes në dorëzim: Me datë 29.12.2023	

ku rezultoi me problemikat, si vijon:

1. Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me objekt “Përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra të pa favorizuara” Bashkia Patos, me vlerë 16,528,523 lekë me TVSH, fituar nga OE “I” SHPK, rezultuan punime ndërtimi të pakryera në volumet e situacionuara, për zërat e punimeve: [Transport materiale ndërtimi, dheu me auto deri 5.0 km; Suva e zakonshme fasade mur tulle lartësi mbi 8 m; Hidroizolim me emulsion bitumi

dhe 2 shtrese k katrama; F.V Dritare duralumini dyfish xham;] si dhe, penaltet për kryerje punime ndërtimi jashtë afatit të përfundimit të kontratës, me pasojë dëm ekonomik në buxhetin e Bashkisë Patos, në vlerën **237,762 lekë pa TVSH**, argumentuar si vijon:

Nr Anal	Zëri i punimeve	Njësia	Çmimi i ofertës	Situacioni përfundimtar	Libri i masave	Fakti	Diferenca në +	
							Vol.	Vlera
A. Punime rikonstruksioni (Ll. G., Verbas).								-
Zëri 5(2.37 /1a)	Transport materiale ndërtimi, dheu me auto deri 1.0 km	m ³	420	11.5	11.5	9.29	1.21	508
Punime suvatimi e bojatisje (I. M., Rrushdie).								-
Zëri 2(2.33 4)	Suva e zakonshme fasade mur tulle lartësi mbi 8 m	m ²	920	65.44	65.44	56.09	9.35	8,593
Punime rikonstruksioni (A. J., Zharrëz).								-
Punime mure mbajtës								-
Zëri 4(2.37 /5a).	Transport materiale ndërtimi, dheu me auto deri 5.0 km	m ³	358	15.9	15.9	-	15.9	5,692
Zëri 1(2.19 7)	Hidroizolim me emulsion bitumi dhe 2 shtrese k katrama.	m ²	933	73.98	73.98 m ² me çmim 933 lekë	73.98 m ² me çmim 696 lekë	-	17,533
Punime rikonstruksioni (V.B , Qeshishte).								-
Zëri 1(2.19 7)	Hidroizolim me emulsion bitumi dhe 2 shtrese k katrama	m ²	933	113	113 m ² me çmim 933 lekë	113 m ² me çmim 696 lekë	-	26,781
Punime rikonstruksioni (A.G , Zharrëz).								
Zëri 4(2.37 /5a)	Transport materiale ndërtimi, dheu me auto deri 5.0 km.	m ³	358	15.63	15.63	-	15.63	5,596
Punime rikonstruksioni (R.P, Sheqisht).								
Zëri 3(2.37 /5a)	Transport materiale ndërtimi, dheu me auto deri 5.0 km	m ³	358	8.19	8.19	-	8.19	1,407
Punime rikonstruksioni (L.B, Sheqishte).								
Zëri 3(2.37 /5a)	Transport materiale ndërtimi, dheu me auto deri 5.0 km	m ³	358	7.73	7.73	-	7.73	1,722
Zëri 1 (2.375 /a)	Dritare duralumini dyfish xham	m ²	13,500	2.4	2.4 m ² me çmim 13,500 lekë	2.4 m ² me çmim 9,063 lekë	-	10,649
Punime rikonstruksioni (M.H, 29 Marsi).								
Zëri 4(2.37 /1a)	Transport materiale ndërtimi, dheu me auto deri 1.0 km	m ³	420	25.68	25.68	-	25.68	4,822
Punime rikonstruksioni (A.H, Dukan).								
Zëri 4(2.37 /1a)	Transport materiale ndërtimi, dheu me auto deri 1.0 km	m ³	420	32.02	32.02	-	32.02	6,258
Zëri 3 (2.375 /a)	Dritare duralumini dyfish xham	m ²	13,500	3.6	3.6 m ² me çmim	3.6 m ² me çmim 9,063 lekë	-	15,973

					13,500 lekë			
	Penalitet për realizim punime ndërtimi jashtë afatit të kontratës.	-	-	-	-	-	-	132,228
	Totali në lekë pa TVSH							237,762

Sa më sipër është në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 6, neni 7 dhe neni 12; Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” e konkretisht Kreu II, Pika 3; Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit me nr. 1861/16 prot., datë 28.09.2022; Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 1867/17 prot., datë 28.09.2022.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. V.T, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve të objektit.

2. Për projektin e zbatimit të objektit: “Përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra te pa favorizuara” Bashkia Patos, nuk është kryer oponente teknike nga Bashkia Patos. Ky veprim është në kundërshtim me Ligjin Nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, neni 6, germa (a).

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: znj. R.B, në cilësinë e ish Kryetarit të Bashkisë Patos.

Konstatim: Nga auditimi mbi realizimin e Zërit 1(2.219. Çati vendi zakonshme HD-8m, mbuluar, tjegulla marseleze në banesën e z. K.G, Zharrëz u konstatua si vijon:

Situacioni përfundimtar pasqyron volumin 48.15 m² çati vendi, me çmim 2150 lekë pa TVSH. Libreza e masave pasqyron 48.15 m² çati vendi.

Nga auditimi mbi realizimin e këtij zëri pune u konstatua se, edhe pse janë realizuar punimet për ndërtimin e çatisë, në një dhomë ka lagështirë të theksuar shoqëruar me dëmtim të suvasë dhe bojatisjes. Në gjykimin e audituesit, duhet të merren masa të menjëhershme për eliminimin e lagështirës.

Konstatim 2:

Nga auditimi i dosjes teknike të zbatimit për kontratën me objekt “Përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra te pa favorizuara” u konstatua se dosje teknike është e pa inventarizuar, veprim ky në kundërshtim me ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 Për arkivat” i ndryshuar dhe **ngarkon me përgjegjësi Kryetarin e Bashkisë z. F.D dhe Përgjegjës in e Protokollit dhe Arkivës znj. E.G.**

3.5. Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e planifikimit dhe zhvillimit të territorit.

Bashkia Patos ka të miratuar **Planin e Përgjithshëm Vendor dhe Rregulloren e Planit të Përgjithshëm të Territorit** me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit (KKT), nr. 02, datë 28.12.2020, ku përfshihen Plani i Zhvillimit, Rregullorja e PPV-së, Strategjia Territoriale, Vlerësim Strategjik Mjedisor, si dhe hartat e përdorimit të tokës sipas kategorive, ndarja e territorit në sisteme, ifrastruktura e transportit, fazat e zbatimit të PPV-së, vizioni strategjik, ndarja e territorit në zona dhe njësi.

LEJET E NDËRTIMIT, ZHVILLIMIT DHE PËRDORIMIT PËR PERIU DHËN
01.01.2023 - 31.12.2023

Referuar të dhënave në sistemin elektronik *e-lejet* për Bashkinë Patos, rezulton se për afatin e auditimit **01.01.2022 deri në 31.12.2022**, ka pasur **98 aplikime në sistem për lloje të ndryshme lejesh** si: leje zhvillimi, leje ndërtimi, deklarata për kryerje punimesh, leje për ndryshim funksioni, leje për shtesa në objekte ekzistuese, rikonstruksione dhe çertifikata përdorimi etj., përkatësisht: 29 aplikime për leje zhvillimi, 8 për leje ndërtimi, 3çertifikata përdorimi, 39 deklarata paraprake per kryerje punimesh, 7 ndryshime funksioni, 3 rikonstruksione dhe 11 leje infrastrukture dhe 5 njoftim për fillim punimesh, të evidentuara në tabelën përmbledhëse në **Aneksin 1**.

Aneksi 1 – Viti 2023

Lloji i lejes	Total	Miratuar	Refuzuar	Në proces
Leje zhvillimi	29	17	12	0
Leje ndërtimi mbi 250m ²	4	2	2	0
Leje ndërtimi deri 250m ²	4	4	0	0
Deklaratë paraprake për kryerje punimesh	39	32	7	0
Rikonstruksion pa ndryshim funksioni	2	1	1	0
Rikonstruksion me ndryshim funksioni	1	1	0	0
Çertifikatë përdorimi	3	1	2	0
Njoftim fillim punimesh	5	3	2	0
Shtyrje afati leje ndërtimi	0	0	0	0
Leje infrastrukture	11	9	2	0

Burimi: DPKKZHU, Bashkia Patos

Përpunoi: Grupi i auditimit

Duke u bazuar tek të dhënat e vëna në dispozicion nga DPKKZHU e Bashkisë Patos, leje për ndërtim të ri me sipërfaqe më të madhe se 250 m² janë miratuar **2 leje**, leje ndërtimi për shtesë në ndërtim ekzistues me sipërfaqe deri në 250 m² janë miratuar **4 leje**, është miratuar **1 certifikate përdorimi**, të pasqyruara në tabelën e mësipërme. Në bazë të analizës së riskut dhe me shqyrtimin rast pas rasti të tipologjive të ndryshme të ndërtimit janë përzgjedhur për t’u audituar rastet e mëposhtme të lejeve të ndërtimit për ndërtime me sipërfaqe deri ose më të madhe se 250 m², çertifikata përdorimi dhe leje rindërtimi, rikonstruksioni dhe riparimi të ndërtesës së dëmtuar me shtim apo ndryshim vëllimi:

Nr.	Objekti	Zhvilluesi	Data e lëshimit të lejes	Preventivi
1	Leje ndërtimi “Objekt 1 kat për rritjen e dhive me adresë "Verbas, Bashkia Patos.	z.F.H	12.06.2023	5,333,867.14 lekë
2	Leje ndërtimi për godinë shërbimi 1 katnë pasurinë me nr.228/16 ZK 3922 e llojit arë me sipërfaqe prej 2940 m ² në pronësi të z.F.K. me adresë Fshati Zharrëz, Bashkia Patos.	F.K	24.03.2023	4.852.979,34 lekë
3	Çertifikatë përdorimi “objekt dy kabanone 1 kat për grumbullimin dhe ruajtjen e produkteve bujqësore dhe blegtorale“ , në pasurinë me nr. 64/40, ZK 3743 me sipërfaqe trualli 8880 m ² dhe sipërfaqe objekti 3160 m ² , me zhvillues D. ShPK, Verbas, Bashkia Patos.	D. ShPK	18.04.2023	-

Në lidhje auditimin e procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit dhe certifikatave të përdorimit, vërehen parregullsitë si më poshtë:

- Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit u konstatua se në **1 (një)** rast nuk janë respektuar kondicionet urbane të parashikuara në ligj, siç janë distancat që objekti me funksion stallë duhet të ruajë nga banesa më e afërt, e veçuar nga qendra urbane. Më konkretisht, kjo anomali është konstatuar në:

a. Leje ndërtimi për objekt 1 kat për rritjen e dhive me adresë në fshatin Verbas, Bashkia Patos, me zhvillues z. F.H, për të cilën është marrë Vendimi Nr. 1337/3 Prot; datë 12.06.2023, me problematika si më poshtë vijon:

- Objekti i miratuar nuk respekton kondicionet urbane sipas përcaktimeve të pikës II.b. të VKM-së nr. 283, datë 01.04.2015, “*Për përcaktimin e tipave, rregullave, kritereve dhe procedurave për ndërtimin e objekteve për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale, në tokë bujqësore*”, nën-pika 3.a), pasi nuk respekton distancat urbane nga banesa më e afërt, e veçuar nga qendra urbane. Distanca që objekti me funksion stallë do të duhej të ruante është 100 metra. Distanca faktike është 85 metra.

Për gjetjet e konstatuara në procedurat e miratimit të lejeve të ndërtimit të trajtuar më sipër, ngarkohen me përgjegjësi:

- **Znj. R.B**, në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë Patos;
- **Z. L.Ç**, në cilësinë e drejtorit të DPKKZHU-së;
- **Z. D.XH**, në cilësinë specialist i aseteve publike të DPKKZHU-së;
- **Znj. E.B**, në cilësinë e specialist-jurist, sektori juridik.

- Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit dhe përdorimit u konstatua se në **3 (tre) raste**, projekti ndërtimor nuk është i plotë ose i saktë, sipas përcaktimeve në ligj dhe rregullore. Më konkretisht, këto anomali janë konstatuar në rastet e mëposhtme:

a. Leje ndërtimi për objekt 1 kat për rritjen e dhive, me adresë në Verbas, Bashkia Patos, me zhvillues z. F.H, për të cilën është marrë Vendimi Nr. 1337/3 Prot; datë 12.06.2023, me problematika si më poshtë vijon:

- Projekti konstruktiv është nënshkruar elektronikisht nga ing. A.M. në cilësinë e drejtorit të Drejtorisë së Hartimit të Projekteve, Shërbimeve dhe Emergjencave Civile, pranë Bashkisë Patos. Gjithashtu, z. M. ka kryer dhe aplikimin online për lejen e ndërtimit gjatë orarit të punës, veprime këto në kundërshtim me neni 3 të Ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, “*Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike*”, i ndryshuar, pika 1, si dhe në kundërshtim nenet 45, 46, 47 të Ligjit nr. 152, datë 30.05.2013 “*Për nëpunësin Civil*”.

- Kartelat e pasurisë nuk janë rifreskuar gjatë tre muajve të fundit, veprime këto në kundërshtim me nenin 17 të Ligjit Nr.111/2018 “*Për kadastrën*”, pika 4 dhe 6 dhe VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, “*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit*”, neni 18, 21 dhe 45, pika c). Nga auditimi i kësaj procedure, është konstatuar se kartelat janë rifreskuar në datën 16/12/2022, ndërsa aplikimi për pajisje me leje ndërtimi është bërë në datë 30.05.2023.

b. Leje ndërtimi për magazinë për grumbullimin dhe ruajtje produktesh, me adresë në Zharrëz, Bashkia Patos, me subjekt zhvillues z. F.K, për të cilën është marrë Vendimi Nr. 492/3 Prot; datë 24.03.2023, me problematika si më poshtë vijon:

- Projekti konstruktiv është nënshkruar elektronikisht nga ing. A.M. në cilësinë e drejtorit të Drejtorisë së Hartimit të Projekteve, Shërbimeve dhe Emergjencave Civile, pranë Bashkisë Patos. Gjithashtu, z. M. ka kryer dhe aplikimin online për lejen e ndërtimit gjatë orarit të punës, veprime këto në kundërshtim me neni 3 të Ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, “*Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike*”, i ndryshuar, pika 1, si dhe në kundërshtim nenet 45, 46, 47 të Ligjit nr. 152, datë 30.05.2013 “*Për nëpunësin Civil*”.

- Kartelat e pasurisë nuk janë rifreskuar gjatë tre muajve të fundit, veprime këto në kundërshtim me nenin 17 të Ligjit Nr.111/2018 “*Për kadastrën*”, pika 4 dhe 6 dhe VKM-së nr. 408, datë

13.05.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, neni 18, 21 dhe 45, pika c). Nga auditimi i kësaj procedure, është konstatuar se kartelat janë rifreskuar në datën 11/02/2021, ndërsa aplikimi për pajisje me leje ndërtimi është bërë në datë 16.02.2023.

c. Çertifikatë përdorimit për dy kabanone 1 kat për grumbullimin dhe ruajtjen e produkteve bujqësore dhe blegtorale, me adresë në Verbas, Bashkia Patos, zhvilluesi “D” ShPK, për të cilën është marrë vendimi nr. 377/3 prot; datë 18.04.2023, me problematika si më poshtë vijon:

- Aktet e kontrollit sipas fazave të ndërtimit nuk janë përpiluar dhe dorëzuar elektronikisht sipas përcaktimeve të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, neni 27/1, pika 1, pasi nuk kanë të përcaktuar datën e përpilimit dhe numrin e protokollit.

- Mungon akti përkatës i lëshuar nga institucionet kompetente për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin, kjo në kundërshtim me VKM-në nr. 408, datë 13.05.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, neni 27/2, pika 1, nënpika ë).

- Mungon projekti as-built, kjo në kundërshtim me VKM-në nr. 408, datë 13.05.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, neni 27/2, pika 1, nënpika g).

- Mungojnë fotografitë e objektit në të gjitha drejtimet, kjo në kundërshtim me VKM-së nr. 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, në nenin 27/2, në pikën 1, nënpika j).

Për gjetjet e konstatuara në procedurat e miratimit të lejeve të ndërtimit të trajtuar më sipër, ngarkohen me përgjegjësi:

- **Znj. R.B.**, në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë Patos; (për miratimin e lejeve a, b, c)

- **Z. L.Ç.**, në cilësinë e drejtorit të DPKKZHU; (për miratimin e lejeve a, b, c)

- **Z. D.XH.**, në cilësinë spec. i aseteve publike të DPKKZHU; (për miratimin e lejes a)

- **Znj. E.B.**, në cilësinë e specialist-jurist, sektori juridik. (për miratimin e lejeve a, c)

- **Znj. N.H.**, në cilësinë e përgjegjës sektori juridik. (për miratimin e lejes b)

- **Znj. A.K.**, në cilësinë e spec. pranë DPKKZHU; (për miratimin e lejeve b, c)

- Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit u konstatua se në **2 (dy) raste** Bashkia Patos dhe Drejtoria e Planifikimit, Kadastrës dhe Kontrollit të Zhvillimit Urban (DPKKZHU) nuk kanë kërkuar ose respektuar mendimin e autoriteteve publike që duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit. Referuar VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, Neni 21, pika 6, DPKKZHU ka detyrimin të kërkojë dhe respektojë mendimin e autoriteteve që duhet të shprehen përpara miratimit të lejeve të ndërtimit. Më konkretisht, këto anomali janë konstatuar në rastet e mëposhtme:

a. Leje ndërtimi për objekt 1 kat për rritjen e dhive me adresë në fshatin Verbas, Bashkia Patos, me zhvillues z. F.H, për të cilën është marrë Vendimi Nr. 1337/3 Prot; datë 12.06.2023, me problematika si më poshtë vijon:

- Nuk është marrë mendimi nga Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (ASHK);

- Nuk është kërkuar mendimi i Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST).

b. Leje ndërtimi për magazinë për grumbullimin dhe ruajtje produktesh, me adresë në Zharrëz, Bashkia Patos, me subjekt zhvillues z. F.K, për të cilën është marrë Vendimi Nr. 492/3 Prot; datë 24.03.2023, me problematika si më poshtë vijon:

- Nuk është marrë mendimi nga Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (ASHK);

- Nuk është kërkuar mendimi i Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST).

Për gjetjet e konstatuara në procedurat e miratimit të lejeve të ndërtimit të trajtuar më sipër, ngarkohen me përgjegjësi:

- **Znj. R.B.**, në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë Patos; (për miratimin e lejeve a, b)

- **Z. L.Ç**, në cilësinë e drejtorit të DPKKZHU; (për miratimin e lejeve a, b)
- **Z. D.XH**, në cilësinë spec. i aseteve publike të DPKKZHU; (për miratimin e lejes a)
- **Znj. E.B**, në cilësinë e specialist-jurist, sektori juridik. (për miratimin e lejeve a)
- **Znj. N.H**, në cilësinë e përgjegjës sektori juridik. (për miratimin e lejes b)
- **Znj. A.K**, në cilësinë e spec. pranë DPKKZHU; (për miratimin e lejeve b)

- Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit u konstatua se në **1 (një) rast** Drejtoria e Planifikimit, Kadastrës dhe Kontrollit të Zhvillimit Urban (DPKKZHU) dhe Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV) nuk kanë kryer detyrat e tyre funksionale në lidhje me evidentimin e shmangies nga projekti i miratuar, për rastin:

c. Çertifikatë përdorimit për dy kabanone 1 kat për grumbullimin dhe ruajtjen e produkteve bujqësore dhe blegtorale, me adresë në Verbas, Bashkia Patos, zhvilluesi “D” ShPK, për të cilën është marrë vendimi nr. 377/3 prot; datë 18.04.2023, me problematika si më poshtë vijon:

- Referuar përcaktimeve të nenit 42 të Ligjit 107/2014, datë 31.7.2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, pika 3, marrim informacionin se çertifikata e përdorimit lëshohet vetëm kur aktet e kontrollit vërtetojnë realizimin e punimeve, në përputhje me kushtet e lejes ose deklaratës paraprake për kryerje punimesh. Në pikën 4 të këtij vendimi përcaktohet se në rast se konstatohet mospërputhje e punimeve të kryera me kërkesat, autoriteti i planifikimit lëshon aktin e konstatimit të mospërputhshmërisë. Autoriteti vendor nuk ka kryer verifikimet në terren përpara miratimit të çertifikatës së përdorimit. Nga inspektimi në terren konstatohet se aksesi për në objekt nuk është ndërtuar sipas projektit të miratuar. Hyrjet e objekteve në projektin e miratuar ndodhen në fasadën lindore ndërsa ato faktike janë njëra në fasadën jugore dhe tjetra në fasadën veriore.

Për gjetjet e konstatuara në procedurat e miratimit të lejeve të ndërtimit të trajtuar më sipër, ngarkohen me përgjegjësi:

- **Znj. R.B**, në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë Patos;
- **Z. L.Ç**, në cilësinë e drejtorit të DPKKZHU-së;
- **Znj. E.B**, në cilësinë e specialist-jurist, sektori juridik;
- **Znj. A.K**, në cilësinë e specialist pranë DPKKZHU-së.

3.6. Mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Mbrojtjes së Territorit të Njësisë Vendore.

1. Në lidhje me plotësimin e kritereve arsimore të punonjësve të IMT-së, sipas përcaktimeve të nenin 11 të Ligjit nr. 183/2014, datë 24.12.2014, “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit në ndërtimet e kundërligjshme” janë konstatuar:

Në bazë të të dhënave të vendosura në dispozicion nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore të Bashkisë Patos, të paraqitur në tabelën e mëposhtme, dy inspektorë nuk kanë kualifikimin e duhur për pozicionin e punës.

Nr.	Emër Mbiemër	Funksioni sipas strukturës	Lloji i arsimit/dega	Data emërimit në detyrë	Aktualisht në punë apo larguar, data
	A.G.	K/Inspektor	I Lart	01.07.2021	Vazhdim
	XH.Ç.	Inspektor	I Lart	16.09.2016	Vazhdim
	D.L.	Inspektor	Mesme	10.12.2013	Larguar 21.12.2023

- Në bazë të të dhënave të vendosura në dispozicion nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore të Bashkisë Patos, dy inspektorë nuk kanë kualifikimin e duhur për pozicionin e punës dhe nuk

plotësojnë kriterin e arsimit të nevojshëm për pozicionin e punës si kryeinspektorë/ inspektorë, të evidentuar më poshtë: 1. z. D.L. me pozicion inspektor ka përfunduar shkollën e Mesme Ushtarake të Oficerëve me titull oficerë rezervist; 2. z. XH.C. me pozicion inspektori ka diplomë bachelori në Menaxhim Biznesi.

Veprimet apo mosveprimet janë në kundërshtim me ligji nr.183/2014, datë 24.12.2014, neni 11, ku përcaktohet që: “Kryeinspektorët dhe inspektorët në nivel kombëtar dhe qeverisjeje vendore duhet të kenë arsimin e lartë të nevojshëm profesional në fushat e drejtësisë, inxhinierisë së ndërtimit, arkitekturës, urbanistikës, konstruksionit, transportit, tekno-logjisë së materialeve, gjeologjisë, hidrogjeologjisë dhe mjedisit”.

Në mënyrë të përmbledhur paraqitet pasqyra e vendimeve të marra nga IMTV për vitin 2023

Nr.	Lloji i aktit	2023
1	PV/Akte kontrolli	-
2	PV/Akte konstatimi	26
3	Vendime gjobe	-
4	Vendime pezullimi	3
5	Vendime prishje	13
6	PV ekzekutimi të prishjeve	-
7	Kallëzime penale	-
8	Kërkesa drejtuar gjykatës për kthimin e gjobave në titull ekzekutiv	-
9	Informacion periodik 3 mujor që dërgohet pranë IKMT	-
10	Plane vjetore të punës të miratuara nga k/inspektori	1
11	Plane mujore të punës të miratuara nga k/inspektori	12

Nga auditimi rezultoi se Sektori i IMT-së, Bashkia Patos për periudhën 01.01.2023 deri me 31.12.2023 ka miratuar planin vjetor të punës si dhe ka miratuar planet mujore për periudhën objekt sipas përcaktimeve të ligjit nr. 107/2014, ligji 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar.

Më poshtë pasqyrohet tabela e vendimeve “Për prishje objekti”, për periudhën 01.01.2023-31.12.2023 dhe vendimet e ekzekutuara.

Nr.	Emri Subjektit (Shoqëria)	Lloj objektit	Vendimi	
			Nr.	Datë
1	E.B	Shtesë pallati	141	28.07.2023
2	F.SH	Shtesë verande	139	28.07.2023
3	F.B	Murë rrethues	138	28.07.2023
4	B.L	Shtesë pallati	70	19.04.2023
5	F.T	Murë rrethues	70	19.04.2023
6	R.M	Murë rrethues	70	19.04.2023
7	P.S	Murë rrethues	70	19.04.2023
8	P.H	Murë rrethues	70	19.04.2023
9	V.P	Shtesë pallati	70	19.04.2023
10	N.M	Murë rrethues	70	19.04.2023
11	A.F	Shtesë pallati	70	19.04.2023
12	F.H	Shtesë pallati	213	24.11.2023
13	Z.S	Murë rrethues	70	19.04.2023

-Për periudhën objekt auditimi 01.01.2023 deri më 31.12.2023 gjatë ushtrimit të veprimtarisë dhe në përmbushje të detyrës funksionale të parashikuar në ligji 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, IMT Bashkia Patos, ka marrë 13 vendime për prishje objektësh pa leje për të cilat nuk kanë ndërmarrë asnjë procedurë për prishjen e ndërtimeve dhe

kthimin e gjendjes në situatën e mëparshme, për të cilat nga IMT duhej vepruar në përputhje me përcaktimet e ligjit 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar.

3.7. Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme

7.1. Hartimi i programit (Plan veprimit) me persona përgjegjës dhe respektimi i afatit 20 ditor për zbatimin e rekomandimeve.

7.2. Realizimi i programit (plan veprimi) e raportimi në KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6/mujor.

7.3. Statusi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

- Për sa më poshtë në mbështetje të shkronjave (a) dhe (b) e nenit 15 “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin e Lartë të Shtetit”, Kontrolli i Lartë i Shtetit në RPA dërguar me shkresën nr. 119/19 prot., datë 21.06.2023, për përmirësimin e gjendjes është kërkuar marrja e masave për zbatimin e rekomandimeve të cilat janë konsideruar të zbatuara pjesërisht dhe rekomandimet e pa zbatuara si më poshtë vijon:

a. Për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar 46 masa organizative, të cilat janë pranuar plotësisht: 13 masa janë zbatuar, 31 masa janë në proces zbatimi, 1 masë është pjesërisht zbatuar dhe 2 masa janë pa zbatuar.

b. Për masat shpërblim dëmi janë rekomanduar 4 masa në vlerën 2,081,633 lekë të cilat janë pranuar plotësisht, nga të cilat janë zbatuar pjesërisht 2 masa në vlerën 578,095 lekë si dhe janë në proces gjyqësor 2 masa në vlerën 1,503,538 lekë të cilat janë konsideruar në proces zbatimi.

c. Për shpenzime në kundërshtim me principet e 3 E-të dhe të ardhura të munguara janë rekomanduar 7 masa në vlerën totale 165,992,712 lekë nga të cilat nuk është ndërmar asnjë procedur për 1 masë në vlerën 1,963,641 lekë si dhe janë në proces zbtimi 6 masa në vlerën 164,029,071 lekë.

KLSH i ka rekomanduar Kryetarit të Bashkisë Patos, fillimin e dhënies së masave disiplinore për të gjithë punonjësit e konstatuar me përgjegjësi sipas çështjeve të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, në proporcion me shkallën e shkeljes. Nga verifikimi rezultoi se referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion janë vendosur 32 masa disiplinore.

- DREJTIMET E AUDITIMIT:

1. Hartimi i programit (Plan veprimit) dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në nenin 15 shkronja (j) të ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit”.

- Bashkia Patos ka hartuar dhe miratuar nga kryetari i bashkisë me nr. 312/33 prot., datë 12.07.2023, Planin e veprimeve “Për zbatimin e rekomandimeve të KLSH të lëna në raportin përfundimtar të auditimit” dërguar me shkresën nr. 119/19 prot., datë 21.06.2023, duke plotësuar edhe rubrikën mbi nivelin e zbatimit të tyre. “Plani i veprimit” është dërguar në KLSH me nr. 312/34 prot., datë 12.07.2023 dhe rezulton të jetë hartuar dhe miratuar brenda afatit 20 ditor, gjë që ka ndikuar edhe në angazhimin brenda afatit të strukturave ngarkuar me përgjegjësi, në marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve të lëna. Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” Bashkia Patos ka kthyer përgjigje zyrtare në KLSH brenda afatit 20 ditor nga marrja e shkresës, sipas të cilës KLSH duhet të vihet në dijeni mbi marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së, dërgon “Planin e Veprimeve”, duke shprehur qëndrimin e saj për pranimin e

rekomandimeve të KLSH-së, ose refuzimin e zbatimit të rekomandimit në rastin e masës për shpërblim dëmi.

Zbatuar

2. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014“Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit

- Bashkia Patos iu përgjigj kërkesës së grupit të auditimit dërguar në rrugë elektronike për çdo rekomandim të lënë, duke bërë me dije statusin e zbatimit të tyre: Në zbatim të ligjit nr.154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 30 pika 2, njësia e vetëqeverisjes vendore duhet të raportojë brenda afatit 6 mujor nga data e mbërritjes së RPA shkresërisht me objekt “Raportim mbi zbatimin e Rekomandimeve të lëna nga KLSH në Raportin Përfundimtar të Auditimit” dërguar me shkresën nr. 119/19 prot., datë 21.06.2023, mbërritur dhe regjistruar në Bashkinë Patos me nr. 312/32 prot., datë 28.06.2023. Nga auditimi rezultoi se ky raportim **është bërë** me nr. 312/37 prot., datë 29.12.2023, brenda afatit 6 mujor.

Zbatuar

3. Mbi raportimin rregullisht në Këshillin Bashkiak të ecurisë të zbatimit të rekomandimeve të KLSH, siç përcaktohet në nenin 50 -Auditimi i jashtëm, pika 5, të ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.

- Bashkia Patos **ka raportuar** në Këshillin Bashkiak lidhur me “Gjetjet dhe Rekomandimet e lëna në RPA të KLSH-së” dhe për masat e marra për zbatimin e tyre me nr. 2772 prot., datë 19.10.2023 dhe futur në rendin e ditës me nr. 2782/2 datë 23.10.2023.

Zbatuar

A. MASA ORGANIZATIVE

Nga KLSH i janë rekomanduar Bashkisë Patos 46 masa organizative, të cilat janë pranuar plotësisht: 13 masa janë zbatuar, 31 masa janë në proces zbatimi, 1 masë është pjesërisht zbatuar dhe 2 masa janë pa zbatuar; Në mënyrë të detajuar realizimi i masave organizative paraqitet si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: a. Nga auditimi u konstatua se Bashkia Patos nuk ka ngritur një sistem efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke mos hartuar një kuadër të plotë rregullash dhe procedurash të shkruara për këtë qëllim.

-Nuk ka hartuar, miratuar, arkivuar gjurmët e auditimit e cila përfaqëson rrjedhën e dokumentuar të transaksioneve financiare dhe të transaksioneve të tjera, nga fillimi deri në përfundim të tyre, që synon të ripërshkrojë të gjitha veprimtaritë individuale dhe vendimmarrjen lidhur me to.

-Nuk ka procedurë të veçantë për mbledhjen dhe dokumentimin e gabimeve, ankesave për analizën e tyre, identifikimin e shkaqeve dhe për eliminimin e problemeve të dala gjatë kryerjes së detyrave. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 4, pika 20, neni 16, pikat 2-3.

b. Nga auditimit i organizimit dhe funksionimit të Njesisë së Auditit të Brendshëm Bashkia Patos u konstatuan paregullsitë si më poshtë:

-Struktura e NJAB nuk është e plotësuar me numrin maksimal të punonjësve gjë e cila ndikon në mos funksionimin me kapacitet të plotë të kësaj njësie.

-NJAB nuk ka kryer auditimin e Drejtorisë së Financës e cila ka qenë pjesë e planit vjetor dhe është fushë me risk të lartë.

-Nga Përgjegjësi i NJAB nuk është vepruar konform me Manualin e Auditimit të Brendshëm të miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016, Kapitullin VII, pika 7.1.1

“Vlerësimi i brendshëm i cilësisë” që kryhet nga vetë nga kjo njësi. Për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së veprimtarisë së auditimit të brendshëm, duhen bërë vlerësimet e brendshme të cilësisë me përcaktimin nëse politikat dhe procedurat e aplikueshme, janë krijuar dhe zbatuar për vlerësimin e përputhshmërisë me standardet dhe kodin e etikës. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 19-28 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1. Rekomandimi: Nga Kryetari i Bashkisë Patos të merren masa për njohjen nga stafi të ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe komponentëve të tij, për hartimin e gjurmës së auditimit dhe një procedure për mbledhjen dhe dokumentimin e gabimeve, ankesave për analizimin e tyre.

Nga verifikimi rezultoi se: Nga ana e Kryetarit të Bashkisë në cilësinë edhe të Nëpunësit autorizues, nëpërmjet Urdhrit nr. 201 datë 17.10.2023 me nr. 2751 prot., datë 17.10.2023 është miratuar që nga ana e NJAB të zhvillohet “Auditim këshillimi” për gjithë stafin e Bashkisë dhe si dhe hartimin e gjurmëve të auditimit; Me Urdhrin nr. 215 datë 01.12.2023 dhe nr. 3149 prot., datë 01.12.2023 është ngritur grupi i punës prej 10 anëtarësh për hartimin e gjurmëve të auditimit. Deri më 31.12.2023 Gjurmët e auditimit janë hartuar dhe miratuar vetëm nga disa struktura të bashkisë, dhe si rrjedhojë Bashkia patos nuk ka hartuar gjurmët standarde të auditimit të unifikuara. Pra ***Rekomandimi 1.1*** është pranuar nga subjekti, pjesërisht zbatuar dhe në proces zbatimi.

1.2. Rekomandimi: Bashkia Patos të marrë masa për plotësimin me kapacitet të plotë me burimet njerëzore të nevojshme të strukturës së NJAB me qëllim mirë organizimin dhe mirëfunksionimin e saj.

Nga verifikimi rezultoi se: Nga ana e Kryetarit të Bashkisë nëpërmjet vendimit nr. 250 datë 02.08.2023 me nr. 1525/11 prot., datë 02.08.2023 dhe Vendimit nr. 350 datë 01.11.2023 me nr. 2128/9 prot., datë 01.11.2023, është plotësuar NJAB sipas strukturës së miratuar prej 3 audituesish të brendshëm. Pra ***Rekomandimi 1.2*** është pranuar nga subjekti dhe zbatuar.

1.3. Rekomandimi: Nga NJAB të merren masa që, pjesë e planit vjetor të vitit 2023 të përfshihen edhe auditimi të Drejtorisë së Financës. Nga Përgjegjësi i NJAB të kryhet vlerësimi i brendshëm i cilësisë në zbatim të dispozitave ligjore përkatëse.

Në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi se: Nga NJAB është planifikuar auditim për Drejtorinë e Financës, por nuk është realizuar pasi kjo drejtori iu nënshtroi auditimit nga KLSH. Gjithashtu NJAB ka hartuar “Programin e sigurimit të cilësisë” me nr. 2033 prot., datë 28.07.2023. Pra ***Rekomandimi 1.3*** është pranuar nga subjekti dhe zbatuar.

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se realizimi i shpenzimeve buxhetore vetëm me të ardhurat e veta të Bashkisë Patos së bashku me transfertat e pa kushtëzuara, për vitin 2022 kanë diferencë të dukshme me vlerën e planifikuar. Për vitin 2022 planifikimi i shpenzimeve ka vlerën 808,235 mijë lekë, ndërsa realizimi vlerën 502,679 mijë lekë, ose në masën 62.1%. Në mos realizimin e buxhetit ka ndikuar niveli i realizimit të investimeve të planifikuara, i cili është zëri më kryesor i buxhetit në lidhje me ndikimin që ka në ofrimin e të mirave publike ndaj komunitetit, është akoma më i ulët se mesatarja e realizimit të buxhetit. Për vitin 2022 investimet janë planifikuar në vlerën 314,595 mijë lekë, realizuar 81,879 mijë lekë, ose në masën 26%. Gjithashtu edhe shpenzimet operative të cilat janë planifikuar në vlerën 104,140 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 55,539 mijë lekë ose në masën 53.5%.

Ky mos realizim vjen si rezultat i mosrealizimit të të ardhurave, që do të thotë se nga Bashkia Patos në fillim të vitit buxhetor planifikohen angazhime buxhetore, duke mos u mbështetur në planifikime realiste të të ardhurave të veta nga taksat dhe tarifatat vendore dhe ky planifikim nuk

korrigjohet gjatë vitit, duke mos përshtatur shpenzimet buxhetore të miratuara me të ardhurat reale të realizuara. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar me Ligjin nr. 114/2012, datë 07.12.2012, dhe Ligjin nr. 57/2016, datë 02.06.2016, nenet 2, 3, 6, 9, 10, 15, 27 dhe 32, Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, Ligjin nr. 9228, datë 29.4.2004, “Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” i ndryshuar me Ligjin nr. 9477, datë 9.2.2006, Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 9 pika 1.3 gërma “c” dhe “ç”, Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore” nenet 2 dhe 3 pika 3, UMFE nr. 9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar, nenet 79, 80 dhe 81, UMFE nr. 22, datë 30.07.2018, “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësisive të vetëqeverisjes vendore”; UMFE nr. 23, datë 22.11.2016, “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm” dhe Vendimet përkatëse të Këshillit Bashkiak. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 28-50 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1. Rekomandimi: Bashkia Patos, të marrë masat për programimin e buxheteve afat mesëm, bazuar në radhë të parë me burimet e veta të financimit, duke zbatuar të gjitha procedurat ligjore me qëllim hartimin sa më real të buxhetit, mbështetur në realizimin sa më objektiv të të ardhurave dhe shpenzimeve.

Në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi se: Nga Bashkia Patos, GMS dhe Drejtoria e Financës janë marrë masat që Buxheti vjetor për vitin 2024 dhe në vazhdim, të hartohet nga një analizë e të ardhurave vjetore dhe nga nevojat e konfirmuara nga konsultimet publike. Pra **Rekomandimi 2.1** është pranuar nga subjekti dhe në proces zbatimi.

3. Gjetje nga auditimi: Referuar planifikimit dhe realizimit të të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore konstatohet se për disa zëra realizimi paraqitet në vlera të ulta dhe për disa zëra realizimi paraqitet me tejkalim mbi planin, gjë e cila tregon se planifikimi i të ardhurave nuk është real, si dhe nuk ka një ndarje për efekt planifikimi, të të ardhurave të vitit aktual buxhetor, me të ardhurat që sigurohen nga detyrimet e prapambetura. Veprime këto në kundërshtim Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 64, Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore” i ndryshuar, neni 5, neni 42, pikat 1-2 dhe pika 4, neni 54, nënpika “c”, Udhëzimin e MFE nr. 9, datë 20.03.2018, “Procedurat standarde për menaxhimin e të ardhurave” Kreu IV, pika 200, Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Kreu II, pika 2, gërma “a” dhe “b”, Kreu III, pika 32, Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për Sistemin e taksave vendore” i ndryshuar dhe Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.2, faqe 28-50 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave Vendore të marrë masa që gjatë hartimit të planit për realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore, të eliminojë planifikimet formale dhe të kryej parashikime të besueshëm bazuar në analiza të hollësishme për secilin zë, duke marrë në konsideratë realizimin e të ardhurave të vitit të mëparshëm por edhe arkëtimet nga detyrimet e prapambetura nga taksat dhe tarifave vendore nga vitet paraardhëse me qëllim pasqyrimin real të situatës të të ardhurave vjetore të bashkisë.

3.2. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave Vendore të marrë masa që për secilin vit buxhetor, të mbajë të ndara për efekt planifikimi, të ardhurat e përfituara nga detyrimet e prapambetura, nga të ardhurat e përfituara nga taksat dhe tarifave vendore të vitit buxhetor aktual.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi se: Nga Bashkia Patos janë marrë masat që me hartimin dhe miratimin e PBA 2024-2026 dhe Planit vjetor të buxhetit për vitin 2024, të mbështetet në analizën e të ardhurave të vet bashkisë sipas realizimeve të 3 viteve të fundit. Pra ***Rekomandimi 3.1*** është pranuar nga subjekti dhe në proces zbatimi.

Nga verifikimi rezultoi se: Nga Bashkia Patos/Drejtoria e të Ardhurave Vendore dhe Drejtoria e Financës kanë marrë masat që me hartimin e Raportit të Monitorimit nr. 2423/1 prot., datë 29.09.2023, të pasqyrojnë të ardhurat edhe sipas kërkesave të rekomandimit. Pra ***Rekomandimi 3.2*** është pranuar nga subjekti dhe zbatuar.

4. Gjetje nga auditimi: Nga të dhënat e paraqitura nga Drejtoria e të Ardhurave Vendore, të ardhurat nga agjentët tatimorë (Drejtoria Rajonale Tatimore Fier në lidhje me TFTH, Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit, Drejtoria e Menaxhimit të Buxhetit pranë Ministrisë së Financave në lidhje me rentën minerare, Agjencia Shtetërore e Kadastrës (ASHK) në lidhje me taksën e ndikimit në infrastrukturë dhe Drejtoria Rajonale e Shërbimeve të Transportit Rrugor (DRSHTRR) në lidhje me taksën vjetore të mjeteve të përdorura) derdhen automatikisht në fund të çdo muaji, për llogari të Bashkisë Patos nuk ka krijuar bazë të plotë të dhënash për detyrimet që vilen nëpërmjet agjentëve tatimorë, në bazë të të cilave të bëjë akt-rakordimet. Në lidhje me mosrealizimet e taksave nga agjentët tatimorë, Bashkia Patos, duhet të marrë masa për evidentimin e diferencave të pa mbledhura sipas llojit të taksës/tarifës, të cilat përbëjnë mungesë të ardhurash për buxhetin e saj dhe të fillojë procedurat për gjobitjen e këtyre agjentëve tatimorë me 50% të shumës së plotë të taksave/tarifave të pa arkëtuara apo të shmangura sipas Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore”, neni 117. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 9632, datë 30.10.20106, “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, nenet 4, 5, 6, 20, 21, 22, 23, 24, 26, 27, 28, etj., dhe Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 7, Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 15, dhe UMF nr. 26, datë 04.09.2008, “Për taksat Kombëtare”. (Më hollësisht trajtuar në nën pikën 2.2, faqe 28-50 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave Vendore, të marrë masa për të kryer rakordimin periodik mujor me agjentët tatimorë, për të evidentuar gjendjen reale të të ardhurave që përfiton Bashkia Patos nga taksat që mblidhen nga këta agjentë. Për agjentët tatimorë që nuk realizojnë mbledhjen e saktë të ardhurave, Bashkia të fillojë procedurat për penalizmin e tyre me 50% të shumës së plotë të taksave/tarifave të pa mbledhura apo të shmangura.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi se: Nga Bashkia Patos/ Drejtoria e të Ardhurave Vendore janë marrë masat për bashkëpunim dhe Akt rakordim mujor me Drejtorinë Rajonale të Tatimeve/Dega e Doganës Vlorë dhe Drejtorinë Rajonale të Shërbimeve të Transportit Rrugor; me shkresën nr. 3165 prot., datë 22.12.2022, është kërkuar bashkëpunim me ASHK - Fier për të cilën deri tani nga ana e saj nuk është kthyer përgjigje duke treguar neglizhencë. Pra ***Rekomandimi 4.1*** është pranuar nga subjekti, pjesërisht zbatuar dhe në proces zbatimi.

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i ligjshmërisë së 9 kontratave për dhënien me qira të ndërtesave/objekteve janë konstatuar mangësi në dokumentacionin e paraqitur nga subjektet në fazën e konkurimit si më poshtë:

-Në 9 raste nuk disponohet kërkesa e subjektit për marrje me qira të pasurisë shtetërore;

-Në 9 raste nuk disponohet planbiznesi në mënyrë të hollësishme për vënien në funksionim të objektit, ku të përshkruhen qartë: plani i punësimit, plani i investimeve, si dhe treguesit që do të realizohen;

-Në 9 raste nuk disponohet oferta për vlerën e detyrimit mujor të qirasë;

-Në 9 raste nuk disponohet certifikata e regjistrimit dhe certifikata historike e regjistrimit të subjektit në QKR;

-Në 9 raste nuk disponohet NUIS-i dhe vërtetimi nga dega e tatimeve se subjekti ka shlyer detyrimet tatimore dhe sigurimet shoqërore;

-Në 9 raste nuk disponohet vërtetimi nga institucionet përkatëse që nuk është në ndjekje penale, si dhe nuk ka procese gjyqësore në lidhje me aktivitetin.

-Gjithashtu pas lidhjes së kontratës nga Bashkia Patos nuk janë masat e duhura për ngritjen e një grupi pune për monitorimin e 9 kontratave të sipërpërmendur për dhënien me qira të ndërtesave/objekteve. Veprime këto në kundërshtim me VKM nr. 54, datë 05.02.2014, “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, pikat 1-3 dhe pika 7. (Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.2, faqe 28-50 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave Vendore dhe Sektori Juridik të marrin masa që para lidhjes së kontratës për dhënien e ndërtesave me qira, për subjektet që nuk paraqesin dokumentacionin sipas kërkesave të dispozitave ligjore përkatëse të bëjë skualifikimin e tyre.

5.2. Rekomandimi: Nga Kryetari i Bashkisë të merren masa për ngritjen e një grupi pune për monitorimin e kontratave të dhënies me qira të ndërtesave, në zbatim të dispozitave ligjore përkatëse.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi se: Bashkia Patos për vitin 2023 nëpërmjet Vendimit të kryetarit nr. 18 datë 20.01.2023 dhe me nr. 186 prot., datë 20.01.2023, ka përcaktuar tarifën e qirasë mujore për objektet që Bashkia Patos jep me qira; gjatë vitit 2023 janë lidhur 7 kontrata qiraje, praktika e të cilave iu vu në dispozicion grupit të auditimit. Praktikën përmbanin gjithë dokumentacionin e domosdoshëm konform VKM nr. 54/2014 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”. Pra **Rekomandimi 5.1** është pranuar nga subjekti dhe është zbatuar.

5.2 Rekomandimi është zbatuar me urdhërin nr. 94, datë 19.06.2023

Nga verifikimi rezultoi se: Kryetari i Bashkisë Patos me Urdhërin nr. 94 datë 19.06.2023, ka ngritur grupin e punës për monitorimin e kontratave të dhënies me qira të ndërtesave në pronësi të Bashkisë Patos. Ky grup ka ushtruar kontroll, vërtetuar kjo nga procesverbalet e mbajtura nr. 1469/1 datë 12.07.2023; nr. 1469/7 datë 12.07.2023. Pra **Rekomandimi 5.2** është pranuar nga subjekti dhe rezultoi i zbatuar.

6. Gjetje nga auditimi: Nga Drejtoria e të Ardhurave Vendore nuk disponohet regjistër në formë shkresore për taksapaguesit familjarë dhe privatë për taksën mbi token bujqësore, por të dhënat mbahen në programin “Excel” nga kjo drejtori. Drejtoria e të Ardhurave Vendore nuk harton raporte periodike gjatë vitit dhe as raporte vjetore me shkrim për titullarin e institucionit dhe Këshillit Bashkiak, për ta informuar për situatën e arkëtimeve dhe debitorëve. Gjithashtu nga kjo drejtori nuk dorëzohet lista shkresore e debitorëve të vitit buxhetor në arkiv dhe as në Drejtorinë e Financës për efekt kontabilizimi. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 19 dhe Regulloren e Brendshme të institucionit miratuar me Vendimin nr. 21, datë 30.01.2022, neni 36, pika 5. (Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.2, faqe 28-50 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.1. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave Vendore të hartojë raporte periodike mujore dhe në fund të vitit raportin vjetor drejtuar titullarit të institucionit dhe Këshillit Bashkiak, mbi realizimin e të ardhurave dhe gjendjen debitorë. Lista e debitorëve në fund të vitit buxhetor të protokollohet dhe një kopje e saj të dorëzohet në Drejtorinë e Financë për efekt kontabilizimi.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi se: Në Bashkinë Patos Drejtoria e të Ardhurave Vendore ka hartuar raporte mujore të cilat i ka dorëzuar në Drejtorinë e Financës; janë hartuar dhe dërguar në MFE raportet e monitorimit: për 4 mujorin I me nr. 1187/10 prot., datë 30.05.2023; për 4 mujorin II me nr. 2423/2 prot., datë 29.09.2023. Është duke u hartuar Raporti vjetor i monitorimit 2023. Në mbyllje të vitit ushtrimor 2023 është përpiluar lista e debitorëve prej: vitit 2021 me 1526 debitorë, për vitin 2022 me 106 debitorë dhe për vitin 2023 me 48 debitorë dhe dorëzuar në Drejtorinë e Financës (elektronikisht dhe fizikisht), kopje e së cilës iu vu në dispozicion edhe grupit të auditimit. Pra **Rekomandimi 6.1** është pranuar nga subjekti dhe është zbatuar.

7. Gjetje nga auditimi: Gjendja e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” paraqitet më datë 31.12.2021, në vlerën 14,298,391 lekë ndërsa në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2022, paraqitet në vlerën 14,234,425 lekë, me një ulje në vlerë 63,966 lekë. Nga krahasimi i të dhënave të vlerës së debitorëve për taksat dhe tarifatat vendore të paraqitur në bilanc, në listën e debitorëve të administruar nga Drejtoria e të Ardhurave Vendore në datën 31.12.2022, konstatohet se vlera e pasqyruar në bilanc nuk është e saktë. Në bilanc detyrimet për taksat dhe tarifatat vendore janë në vlerën 14,234,425 lekë ndërkohë që vlera reale e këtyre detyrimeve është në vlerën 151,141,148 lekë, me një diferencë paraqitje më pak në bilanc prej 136,906,723 lekë. Veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 5. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 50-69 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës të sistemojë në kontabilitet llogarinë 468 “Debitorë të ndryshëm”, duke pasqyruar në të vlerën reale të debitorëve për taksat dhe tarifatat vendore të kategorisë privat dhe familjar.

Deri më datë 31.12.2023

Nga verifikimi rezultoi se: Me dorëzimin e listës së plotë të debitorëve, Drejtoria e Financës ka sistemuar llogarinë 468 “Debitorë të ndryshëm”, duke pasqyruar vlerën reale të debitorëve për taksat dhe tarifatat vendore, të kategorisë privat dhe familjar. Pra **Rekomandimi 7.1** është pranuar nga subjekti dhe është zbatuar.

8. Gjetje nga auditimi: 1. Në total aktivet të cilat i përkasin llogarisë 210 “Toka, troje, terrene”, për koston historike në vlerën 4,220,846 lekë Bashkia Patos prej 1039 prona, të cilat janë transferuar sipas VKM respektive vetëm për 29 prona posedon titull pronësie si dhe vetëm 91 prej tyre janë të regjistruara në kontabilitet. Veprime këto në kundërshtim me VKM nr. 510, datë 14.08.2001, “Për inventarizimin dhe hipotekimin e të gjithave pronave të paluajtshme dhe të luajtshme”, Kreu VI, “Transferimi i pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme”, pika 1 dhe 2. Për rrjedhojë edhe kontabilizimi i aktiveve afatgjata materiale, nuk është mbështetur në dokumentacionin e duhur, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pika 35, gërma “a”, “b” dhe “c”. **2.** Llogaria 211 “Pyje, platacione” paraqitet me vlerën 0 lekë, ndërkohë në pasqyrat financiare të vitit 2022, nuk është pasqyruar vlera e pyjeve dhe e kullotave të transferuara në pronësi të Bashkisë Patos me VKM nr. 684, datë 02.09.2020, “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 433, datë 08.06.2016, “Për transferim në pronësi të Bashkive, të pyjeve dhe kullotave, sipas inventarit,

aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-Komunave/Bashkive” i ndryshuar, sipas listës në faqen 555 të VKM, janë transferuar 682.75 ha pyje. Të regjistruara në ASHK janë 4 pasuri me nr. 2/8, 2/1, 2/5, 2/3 me sipërfaqe 4 ha në ekonominë pyjore “Ana e Lumit Seman 2”, ndërsa pjesa tjetër është në proces certifikimi, mbasi ka përfunduar faza e parë dhe e dytë e regjistrimit e inicuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe kompanisë së kontraktuar “CSI-Piemonte & Datech”.

3. Nga auditimi i llogarisë 210 “Troje, toka, terrene” konstatohet se është përlllogaritur normë amortizimi në vlerën 1,074,287 lekë. Duke u bazuar në Standardin Kombëtar të Kontabilitetit (SKK) nr. 5, “Afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jo materiale”, i përmirësuar, pika 30, nuk mund të aplikohet normë amortizimi për këtë llogari. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 50-69 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

8.1. Rekomandimi: Bashkia Patos të marrë masat e duhura ligjore për regjistrimin në kontabilitet të të gjithë asetëve të llogarisë 210 “Toka, troje, Terrene” dhe llogarisë 211 “Pyje, Kullota Plantacione”, duke përfshirë këtu edhe asetet e ish-komunave, sot NJA të Bashkisë. Bazuar në legjislacionin në fuqi të bëhet vlerësimi i asetëve për vlerën e tyre reale, sipas zonave kadastrale. Të merren masa për regjistrimin e asetëve si pasuri e saj në ASHK.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi se: Me Urdhrin e Kryetarit nr. 204 datë 19.10.2023 dhe me nr. 2778 prot., datë 19.10.2023, është ngritur komisioni për inventarizimin dhe vlerësimin e asetëve të Bashkisë Patos, regjistrimin e tyre në ASHK. Kjo procedurë është pjesërisht zbatuar dhe nuk është përfunduar ende. Pra **Rekomandimi 8.1** është pranuar nga subjekti, pjesërisht zbatuar dhe në proces zbatimi.

8.2. Rekomandimi: Drejtoria e Financës në pasqyrat e vitit 2023 të bëjë sistemimin e vlerës 1,074,287 lekë, e cila ka të bëjë me kontabilizimin dhe paraqitjen e gabuar të normës së amortizimit për llogarinë 210 “Toka, troje, terrene”, si dhe për këto llogari mos të aplikohet normë amortizimi referuar parashikimeve në dispozitat ligjore përkatëse.

Deri më datë 31.12.2023

Nga verifikimi rezultoi se: Drejtoria e Financës ka marrë masat dhe ka sistemuar vlerën 1,074,287 lekë në llog.210 “Toka, troje, terrene”, e cila do pasqyrohet me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2023 deri në 31.03.2024. Pra **Rekomandimi 8.2** është pranuar nga subjekti dhe është zbatuar.

9. Gjetje nga auditimi: Për llogarinë 215 “Mjete transporti” në pasqyrat financiare është kontabilizuar vlera 8,525,957 lekë. Në këtë vlerë është përfshirë edhe automjeti tip Benz me targë AA993CV me vlerë kosto historike 1,450,000 lekë i cili nuk është në gjendje pune dhe është nxjerrë jashtë përdorimit sipas Vendimit nr. 27, datë 13.02.2023, të Kryetarit të Bashkisë. Në zbatim të Udhëzimit të MFE nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Aneksi nr. 1, “Analiza, përbërja sipas klasave dhe trajtimi kontabël i llogarive të kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme (NJQP)”, 2.1, “Trajtimi kontabël dhe funksionimi i llogarive të klasës 2”, vlera 1,450,000 lekë e cila i përket koston historike mjete të dëmtuara duhej të debitohej në llogarinë 24 “Aktive afatgjata të dëmtuara”. Pra nga llogaria 215 “Mjete transporti”, duhet të zbritet vlera e automjeteve të dëmtuara dhe të regjistrohet në llogarinë 24 “Aktive afatgjata të dëmtuara”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 50-69 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

9.1. Rekomandimi: Bashkia Patos, Drejtoria e Financës në pasqyrat e vitit 2023 të bëjë sistemimin e vlerës 1,450,000 lekë e cila ka të bëjë me kontabilizimin dhe paraqitjen e gabuar të 1 automjeti

të dëmtuar në llogarinë 215 “Mjete transporti”, sistemimi të kryhet referuar trajtimit kontabël në llogarinë 24 “Aktive afatgjata të dëmtuara”.

Deri më datë 31.12.2023

Nga verifikimi rezultoi se: Nga Drejtoria e financës janë bërë sistemimet kontabël të vlerës 1,450,000 lekë e cila i përket kostos historike të mjeteve të dëmtuara, dhe pasqyrimi i tyre konfirmohet me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2023 në datën 31.03.2024. Pra **Rekomandimi 9.1** është pranuar nga subjekti dhe zbatuar.

10. Gjetje nga auditimi: Llogaria 466 “Kreditorë për mjetet në ruajtje” në pasqyrat financiare është në vlerën 35,722,934 lekë e rakorduar me Degën e Thesarit. Gjatë vitit 2022 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 13,225,145 lekë dhe pakësim në vlerën 7,894,511 lekë ndërsa në datën 31.12.2022, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 35,722,934 lekë.

Nga analiza e kësaj llogarie konstatohet se janë ngurtësuar fonde në vlerën 2,208,274 lekë të cilat i përkasin ngurtësimeve të viteve 2020 e para, të cilave u ka kaluar afati i garancisë, Bashkia Patos nuk ka kryer asnjë veprim sipas kushteve të kontratës për ç’bllokimin e këtyre fondeve. Veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin i MF nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Kapitulli III, pikat 29, 30, 39, 50 dhe UKM nr. 3, datë 15.02.2011, “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kapitulli II, pika 10. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 50-69 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

10.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Patos, Drejtoria e Financës dhe Drejtoria e e Hartimit të Projekteve, Shërbimeve dhe Emergjencave Civile të marrë masa për kalimin e fondeve te secili kontraktor për të cilin ka mbaruar periudha e garancisë dhe Autoriteti Kontraktor nuk ka pretendime për cilësinë e investimin të kryer për periudhën e garancisë.

Deri më datë 31.12.2023

Nga verifikimi rezultoi se: Drejtoria e Financës /Bashkia Patos në bashkëpunim me Drejtorinë e Hartimit të Projekteve, Shërbimeve dhe Emergjencave Civile me vëmendje të shtuar ndjekin përfundimin e investimit për të kaluar vlerën prej 5% të fondit të investimit të ngurtësuar si garanci nga AK. Pra **Rekomandimi 10.1** është pranuar nga subjekti dhe është në proces zbatimi.

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi me zgjedhje i praktikave për veprimet e kryera me bankë kontatohet se, në 10 raste janë zhvilluar projekte artistike, të cilat nuk janë përfituar nëpërmjet zhvillimit të procedurave të prokurimit, të parashikuara në Ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik” nenet 7-9 dhe nenet 65-70 dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar me VKM nr. 710, datë 24.11.2021, neni 8. Miratimi i përdorimit të fondeve për realizimin e projekteve artistike është kryer sipas VKB nr. 71, datë 14.12.2021, me objekt “Për miratimin e numrit të përgjithshëm të punonjësve, dokumentin përfundimtar të Projekt Buxhetit AFM 2022-2024 dhe buxhetin e Bashkisë Patos për vitin 2022”. Duke u bazuar në VKB e mësipërme fondet e miratuara për projektet artistike është në vlerën 3,690,000 lekë nga të cilat është shpenzuar shuma 2,550,000 lekë. Nga Bashkia Patos për periudhën nga data 01.01.2022 deri më 31.12.2022, për 10 subjekte është likuiduar shuma 2,550,000 lekë. Për këto projekte nuk ka as kontrata të lidhura ndërmjet palëve, por pagesa e këtij shërbimi është kryer mbi bazën e faturave tatimore të lëshuara nga subjektet përkatëse. Vlera 2,550,000 lekë përbën shpenzime të kryera jo në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi të prokurimit publik. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 50-69 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

11.1. Rekomandimi: Nga Kryetari i Bashkisë dhe Drejtoria e Financës të evidentohen të gjitha rastet të cilat janë objekt i Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, për të

cilat nuk është zhvilluar procedurë prokurimi si dhe për rastet që nuk janë nënshtruar procedurës së prokurimit, të merren masat e nevojshme për ndërprerjen e tyre referuar akteve ligjore në fuqi.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi se: Deri tani nga ana e Kryetarit dhe e Drejtorisë së financës nuk rezulton të jenë marrë masa për zbatimin e rekomandimit. Pra ***Rekomandimi 11.1*** është pranuar nga subjekti dhe nuk është zbatuar.

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi me zgjedhje i 10 dosjeve të punonjësve të aparatit të Bashkisë Patos konstatohet se, në një rast punonjësi nuk është emëruar në përputhje me kriteret e pozicionit të punës. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 50-69 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

12.1. Rekomandimi: Bashkia Patos, Drejtoria e Burimeve Njerëzore të marrë masa që rekrutimet e punonjësve të kryhen në përputhje me kriteret e pozicioneve të punës.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi se: Nga Bashkia Patos, Drejtoria e Burimeve njerëzore dhe Komiteti i Përhershëm i Pranimeve kanë marrë masat për rekrutime në përputhje me kriteret e pozicionit të punës të përcaktuara në Formularin e përshkrimit të punës. Pra ***Rekomandimi 12.1*** është pranuar nga subjekti dhe në proces zbatimi.

13. Gjetje nga auditimi: 1. Bashkia Patos ka të hartuar regjistrin e aktiveve në formë elektronike në programin Excel në vartësi të llojit të aktiveve afatgjata apo afatshkurtra si dhe grupit përkatës brenda llojit. Regjistri nuk është i plotësuar me të gjithë elementët përbërës konkretisht: datën e skadencës, vendodhjen, personin përgjegjës, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes dhe datën e daljes nga pronësia. Veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pika 30.

2. Për vitin 2022, Kryetari i Bashkisë Patos ka nxjerrë Urdhrin nr. 168, datë 02.11.2022, për krijimin e komisionit të inventarizimit dhe vlerësimit të aktiveve të vetë institucionit dhe NJA Zharrëz dhe Ruzhdie i përbërë nga 15 punonjës si dhe Urdhrin nr. 169, datë 02.11.2022, për krijimin e komisionit të inventarizimit dhe vlerësimit të aseteve i përbërë nga 7 punonjës. Procesi i inventarizimit të aktiveve të institucionit është kryer dy herë radhazi nga i njëjti komision i cili ka ushtruar këtë funksion në vitin 2021 në zbatim të Urdhrit nr. 131, datë 21.10.2021, të Kryetarit të Bashkisë. Veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pika 84. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 50-69 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

13.1. Rekomandimi: Nëpunësi zbatues të marrë masa për hartimin dhe plotësimin e regjistrit të aktiveve me të gjithë elementët e tij të domosdoshëm, me qëllim identifikimin në këtë dokument të të gjitha aktiveve të njësisë vendore, si dhe uljen e riskut nga humbjet dhe keq menaxhimin e tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi se: Nëpunësi zbatues në Bashkia Patos ka hartuar regjistrin e aseteve me dorëzimin e bilancit nr. 616 datë 27.02.2023. Pra ***Rekomandimi 13.1*** është pranuar nga subjekti dhe është zbatuar.

13.2. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Patos të marrë masa për të eliminuar praktikën e kryerjes së procesit të inventarizimit periodik të aktiveve, dy herë me radhë në të njëjtin vend nga i njëjti komision.

Në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi se: Me Urdhrat e Kryetarit nr. 203 datë 19.10.2023 dhe nr. 2777 prot., datë 19.10.2023 “për krijimin e komisionit të inventarizimit dhe vlerësimit të inventareve”; nr. 204 datë 19.10.2023 dhe nr. 2778 prot., datë 19.10.2023 “për krijimin e komisionit të inventarizimit dhe vlerësimit të aseteve”; nr. 205 datë 19.10.2023 dhe nr. 2779 prot., datë 19.10.2023 “për ngritjen e komisionit të inventarizimit dhe vlerësimit të mjeteve të transportit, makinerive dhe mjeteve të punës”; nr. 206 datë 19.10.2023 dhe nr. 2780 prot., datë 19.10.2023 “për ngritjen e komisionit të inventarizimit për punonjësit që ndërpresin marëdhëniet e punës”. Pra **Rekomandimi 13.2** është pranuar nga subjekti dhe është zbatuar.

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i 10 procedurave me vlerë totale të fondit limit 1,323,416 mijë lekë, janë konstatuar me shkelje të akteve ligjore/nënligjore të LPP 10 procedura me vlerë kontrate 1,275,339 mijë lekë. Në 10 raste janë vendosur kriteret të cilët nuk janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, elementë të cilët kanë efekt në kufizimin e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë. Në 7 raste janë kualifikuar dhe shpallur fitues dhe lidhur kontrata me operatorë ekonomikë, të cilët nuk plotësojnë kriteret e vendosura në dokumentet e tenderit, në papajtueshmëri me legjislacionin e prokurimit publik në vlerën totale 162,874 mijë lekë, respektivisht:

1. Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Rikonstruksion i shkollës “Mustafa Matohiti” Bashkia Patos, Viti 2021, me fond limit 74,258 mijë lekë, me fitues BOE “G” Shpk & “SH” Shpk & “A” Shpk, me vlerë të ofertës 72,259 mijë lekë, rezulton, në aplikimin e kriterëve në DT, janë të ekzagjeruara dhe të pa argumentuara.

Kriteret në DT nuk janë në përputhje me nenin 26, pika 5 të VKM nr. 914, datë 24.12.2014, “Për rregullat e prokurimit publik” sipas të cilit: “Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.

Mos disponimi, apo mos ngarkimi në SEP i dokumenteve, përbën shkak të ligjshëm për skualifikimin e BOE dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO dhe nuk duhet të ishte shpallur fitues. Gjithashtu nga titullari nuk duhet të ishte miratuar shpallja fitues e BOE “G” Shpk & “SH” Shpk & “A” Shpk.

Sa sipër, KVO nuk ka vepruar në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e nenit 1 “Objekti dhe qëllimi”, pika “d,” neni 2, “Parimet e përzgjedhjes”, neni 24 “Anulimi i një procedure prokurimi”, pika nr.1, gërma “ç”, neni 46 “Kualifikimi i ofertuesve”, pika 1, neni 53 “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3 dhe pika 5, neni 55, “Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese”, pika 1, gërma “a” e Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik” i ndryshuar.

Aplikimi i kriterëve në DT, të ekzagjeruara dhe të paargumentuara, nga NJP, shpallja fituese BOE “G” Shpk & “SH” Shpk & “A” Shpk, me ofertë 72,259 mijë lekë, ku ka rezultuar se KVO ka vlerësuar dhe shpallur fituesin në kushtet e mos plotësimit të kërkesave për kualifikim të DT-së, me pasojë përdorimin me paligjshmëri të fondeve publike për vlerën 72,259 mijë lekë pa tvsh (86,710,948 lekë me Tvsh). (Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.4 faqe 69-121 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2. Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Rikonstruksioni i magjistrallit kryesor dhe rrjetit të brendshëm të ujësjellësit Qytetit Patos Loti I” (Rrjeti shpërndarës) Bashkia Patos, viti 2019, me fond limit 450,024 mijë lekë, me fitues OE “T” Shpk, me vlerë të ofertës 444,056 mijë lekë, rezulton, në aplikimin e kriterëve në DT, janë të ekzagjeruara dhe të pa argumentuara.

Kriteret në DT nuk janë në përputhje me përcaktimet e gërmën “c”, “ç”, d”, të pikë 2, neni 1; gërmën “a”, “b”, “c” të nenit 2; neni 20; neni 23, neni 46 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 26 “Kontratat për punë publike” Kreu III, “Dokumentet e tenderit”, pika 3, “Informacione të veçanta VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e

rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.4 faqe 69-121 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3. Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Rikonstruksioni i rrugës Çamëria”. Bashkia Patos, viti 2021, me fond limit 8,042 mijë lekë, me fitues BOE “H” Shpk & “SH” Shpk, me vlerë të ofertës 7,397 mijë lekë, rezulton, në aplikimin e kriterëve në DT, janë të ekzagjeruar dhe të paargumentuara.

Kriteret në DT nuk janë në përputhje me nenin 26, pika 5 të VKM nr. 914, datë 24.12.2014, “Për rregullat e prokurimit publik” sipas të cilit: “Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.

Mos disponimi, apo mos ngarkimi në SEP i dokumenteve, përbën shkak të ligjshëm për skualifikimin e BOE-së dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO dhe nuk duhet të ishte shpallur fitues. Gjithashtu nga titullari nuk duhet të ishte miratuar shpallja fitues e BOE “H” Shpk & “SH” Shpk.

Sa sipër, KVO nuk është vepruar në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e nenit 1 “Objekti dhe qëllimi”, pika “d” neni 2, “Parimet e përzgjedhjes”, neni 24 “Anulimi i një procedure prokurimi”, pika nr. 1, germa “ç”, neni 46 “Kualifikimi i ofertuesve”, pika 1, nenin 53 “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3 dhe pika 5, neni 55, “Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese”, pika 1, germa “a” e Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Aplikimi i kriterëve në DT, të ekzagjeruar dhe të paargumentuara, nga NJP, shpallja fituese BOE “H” Shpk & “SH” Shpk, me ofertë 7,397 mijë lekë, ku ka rezultuar se KVO ka vlerësuar dhe shpallur fituesin në kushtet e mos plotësimit të kërkesave për kualifikim të DT, me pasojë përdorimin me paligjshmëri të fondeve publike për vlerën 7,937 mijë lekë pa Tvsh (8,877,048 lekë me Tvsh). (Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.4 faqe 69-121 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4. Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Rikonstruksioni i magjstralit kryesor dhe rrjetit të brendshëm të Ujësjetës Qytetit Patos Loti II” Bashkia Patos, Viti 2020, me fond limit 608,941 mijë lekë, me fitues OE “T” Shpk, me vlerë të ofertës 596,422 mijë lekë, rezulton, në aplikimin e kriterëve në DT, janë të ekzagjeruara dhe të paargumentuara.

Kriteret në DT nuk janë në përputhje me përcaktimet e germën “c”, “ç”, d”, të pikë 2, neni 1; germën “a”, “b”, “c” të nenit 2; neni 20; neni 23, nenit 46 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik” i ndryshuar, neni 26 “Kontratat për punë publike” Kreu III, “Dokumentet e tenderit”, pika 3, “Informacione të veçanta VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.4 faqe 69-121 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5. Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Rikonstruksioni i rrugës rrugës së Varrezave, Dukas”. Bashkia Patos, Viti 2021, me fond limit 12,160 mijë lekë, me fitues BOE “H” Shpk & “SH” Shpk, me vlerë të ofertës 8,956 mijë lekë, rezulton, në aplikimin e kriterëve në DT, janë të ekzagjeruara dhe të paargumentuara.

Kriteret në DT nuk janë në përputhje me nenin 26, pika 5 të VKM nr. 914, datë 24.12.2014, “Për rregullat e Prokurimit Publik” sipas të cilit: “Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.

Mos disponimi, apo mos ngarkimi në SEP i dokumenteve, përbën shkak të ligjshëm për skualifikimin e BOE dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO dhe nuk duhet të ishte shpallur fitues. Gjithashtu nga titullari nuk duhet të ishte miratuar shpallja fitues e BOE “H” Shpk & “SH” Shpk.

Sa sipër, KVO nuk ka vepruar në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e nenit 1 “Objekti dhe qëllimi”, pika “d,” neni 2, “Parimet e përzgjedhjes”, neni 24 “Anulimi i një procedure prokurimi”, pika nr.1, gërma “ç”, neni 46 “Kualifikimi i ofertuesve”, pika 1, nenin 53 “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3 dhe pika 5, neni 55, “Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese”, pika 1, gërma “a” e Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Aplikimi i kriterëve në DT, të ekzagjeruara dhe të paargumentuara, nga NJP, shpallja fituese BOE “H” Shpk & “SH” Shpk, me ofertë 8,956 mijë lekë, ku ka rezultuar se KVO ka vlerësuar dhe shpallur fituesin në kushtet e mos plotësimit të kërkesave për kualifikim të DT, me pasojë përdorimin me paligjshmëri të fondeve publike për vlerën 8,956 mijë lekë pa Tvsh (10,747,930.80 lekë me Tvsh). (Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.4 faqe 69-121 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6. Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Sistemim i hapësirave, lagjja “29 Marsi”, Blloku të zjarrëfiksja”, Bashkia Patos, viti 2021, me fond limit 49,795 mijë lekë, me fitues BOE “M” Shpk & “L” Shpk, me vlerë të ofertës 40,828 mijë lekë, rezulton, në aplikimin e kriterëve në DT, janë të ekzagjeruara dhe të paargumentuara.

Kriteret në DT nuk janë në përputhje me nenin 26, pika 5 të VKM nr. 914, datë 24.12.2014, “Për rregullat e prokurimit publik” sipas të cilit: “Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.

Mos disponimi, apo mos ngarkimi në SEP i dokumenteve, përbën shkak të ligjshëm për skualifikimin e BOE dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO dhe nuk duhet të ishte shpallur fitues. Gjithashtu nga titullari nuk duhet të ishte miratuar shpallja fituese e BOE “M” Shpk & “H” Shpk & “SH” Shpk.

Sa sipër, KVO nuk ka vepruar në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e nenit 1 “Objekti dhe qëllimi”, pika “d,” neni 2, “Parimet e përzgjedhjes”, neni 24 “Anulimi i një procedure prokurimi”, pika nr.1, gërma “ç”, neni 46 “Kualifikimi i ofertuesve”, pika 1, nenin 53 “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3 dhe pika 5, neni 55, “Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese”, pika 1, gërma “a” e Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik” i ndryshuar.

Aplikimi i kriterëve në DT, të ekzagjeruara dhe të paargumentuara, nga NJP, shpallja fituese BOE “M” Shpk & “L” Shpk, me ofertë 39,473 mijë lekë, ku ka rezultuar se KVO ka vlerësuar dhe shpallur fituesin në kushtet e mos plotësimit të kërkesave për kualifikim të DT, me pasojë përdorimin me paligjshmëri të fondeve publike për vlerën 40,828 mijë lekë pa Tvsh (48,994,499 lekë me Tvsh). (Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.4 faqe 69-121 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7. Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Rehabilitimi i rrjetit ujitës zona Belinë Patos”, Bashkia Patos, Viti 2021, me fond limit 10,537 mijë lekë, me fitues BOE “I” Shpk dhe “Z” Shpk, me vlerë të ofertës 7,685 mijë lekë, rezulton, në aplikimin e kriterëve në DT, janë të ekzagjeruara dhe të paargumentuara.

Kriteret në DT nuk janë në përputhje me nenet 1, 2 dhe pika 1 e nenit 21 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, si dhe nenet 39 “Kërkesat e veçanta për kontratat për punë publike” dhe neni 78 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

Mos disponimi, apo mos ngarkimi në SEP i dokumenteve, përbën shkak të ligjshëm për skualifikimin e BOE dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO dhe nuk duhet të ishte shpallur fitues. Gjithashtu nga titullari nuk duhet të ishte miratuar shpallja fituese e BOE “I” Shpk & “Z” Shpk.

Sa sipër, KVO ka vepruar jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e pikës nenit 80 “Parimet e procesit të përzgjedhjes” të Ligjit 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik” i ndryshuar, ku

citohet “Autoriteti kontraktor nuk e pranon një ofertë kur oferta e tij nuk përputhet me specifikimet e përcaktuara në dokumentet e tenderit”.

Aplikimi i kriterëve në DT, të ekzagjeruara dhe të paargumentuara, nga NJP, shpallja fituese BOE “I” Shpk & “Z” Shpk, me ofertë 7,685 mijë lekë, ku ka rezultuar se KVO ka vlerësuar dhe shpallur fituesin në kushtet e mos plotësimit të kërkesave për kualifikim të DT, me pasojë përdorimin me paligjshmëri të fondeve publike për vlerën 7,685 mijë lekë pa Tvsh (9,222,252 lekë me Tvsh). (Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.4 faqe 69-121 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

8. Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Rikonstruksioni i ambienteve të Qendrës Shëndetësore Ruzhdie dhe Ambulancës Dukas, Çoban”, Bashkia Patos, viti 2021, me fond limit 12,568 mijë lekë, me fitues BOE “A” Shpk & “D” Shpk, me vlerë të ofertës 11,973 mijë lekë, rezulton, në aplikimin e kriterëve në DT, janë të ekzagjeruara dhe të paargumentuara.

Kriteret në DT nuk janë në përputhje me nenet 1, 2 dhe pika 1 e nenit 21 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, si dhe nenet 39 “Kërkesat e veçanta për kontratat për punë publike” dhe neni 78 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Mos disponimi, apo mos ngarkimi në SEP i dokumenteve, përbën shkak të ligjshëm për skualifikimin e BOE dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO dhe nuk duhet të ishte shpallur fitues. Gjithashtu nga titullari nuk duhet të ishte miratuar shpallja fituese e BOE “A” Shpk & “D” Shpk.

Sa sipër, KVO ka vepruar jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e pikës nenit 80 “Parimet e procesit të përzgjedhjes” të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik” i ndryshuar ku citohet “Autoriteti kontraktor nuk e pranon një ofertë kur oferta e tij nuk përputhet me specifikimet e përcaktuara në dokumentet e tenderit”.

Aplikimi i kriterëve në DT, të ekzagjeruara dhe të paargumentuara, nga NJP, shpallja fituese BOE “A” Shpk & “D” Shpk, me ofertë 7,685 mijë lekë, ku ka rezultuar se KVO ka vlerësuar dhe shpallur fituesin në kushtet e mos plotësimit të kërkesave për kualifikim të DT, me pasojë përdorimin me paligjshmëri të fondeve publike për vlerën 11,973 mijë lekë pa Tvsh (14,368,211.30 lekë me Tvsh). (Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.4 faqe 69-121 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

9. Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Përmirësim i banesave ekzistuese për familjet në nevojë”, Bashkia Patos, viti 2021, me fond limit 15,932 mijë lekë, me fitues OE “I” Shpk, me vlerë të ofertës 13,773 mijë lekë, rezulton, në aplikimin e kriterëve në DT, janë të ekzagjeruara dhe të paargumentuara.

Kriteret në DT nuk janë në përputhje me nenet 1, 2 dhe pika 1 e nenit 21 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, si dhe nenet 39 “Kërkesat e veçanta për kontratat për punë publike” dhe neni 78 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Mos disponimi, apo mos ngarkimi në SEP i dokumenteve, përbën shkak të ligjshëm për skualifikimin e BOE dhe për këtë arsye nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO dhe nuk duhet të ishte shpallur fitues. Gjithashtu nga titullari nuk duhet të ishte miratuar shpallja fituese e OE “I” Shpk.

Sa sipër, KVO ka vepruar jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e pikës nenit 80 “Parimet e procesit të përzgjedhjes” të Ligjit 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik” i ndryshuar, ku citohet “Autoriteti kontraktor nuk e pranon një ofertë kur oferta e tij nuk përputhet me specifikimet e përcaktuara në dokumentet e tenderit”.

Aplikimi i kriterëve në DT, të ekzagjeruara dhe të paargumentuara, nga NJP, shpallja fituese OE “I” Shpk, me ofertë 7,685 mijë lekë, ku ka rezultuar se KVO ka vlerësuar dhe shpallur fituesin në kushtet e mos plotësimit të kërkesave për kualifikim të DT, me pasojë përdorimin me paligjshmëri

të fondeve publike për vlerën 13,773 mijë lekë pa Tvsh (16,528,523 lekë me Tvsh). (Më hollësisht trajtuar në nën pikën 2.4 faqe 69-121 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

10. Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Rikonstrukcion i shkollës “Muhamet Shehu” dhe ndërtim i palestres”, Bashkia Patos, Viti 2022, me fond limit 81,153 mijë lekë, me fitues OE “SH” Shpk, me vlerë të ofertës 71,986 mijë lekë, rezulton, në aplikimin e kriterëve në DT, janë të ekzagjeruara dhe të pa argumentuara.

Kriteret në DT nuk janë në përputhje me nenet 1, 2 dhe pika 1 e nenit 21 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, si dhe nenet 39 “Kërkesat e veçanta për kontratat për punë publike” dhe neni 78 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. (Më hollësisht trajtuar në nën pikën 2.4 faqe 69-121 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

14.1. Rekomandimi: AK në hartimin e DT, të shmang aplikimin e kriterëve që nuk janë përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, në mënyrë jo të mirë argumentuara dhe në përputhje me procedurën e zhvilluar, pasi këto veprime direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE në procedurë ose çojnë në skualifikimin e OE me ofertë më të leverdishme. Gjithashtu, Titullari i Bashkisë Patos dhe KVO, të marrin masa për eliminimin e rasteve të mësipërme, duke analizuar arsyet e skualifikimit të padrejtë të operatorëve ekonomikë, të cilët plotësojnë kriteret e DT, në mënyrë që në të ardhmen të mos përsëriten veprime të tilla, për të mirë përdorur fondet e Bashkisë.

Menjëherë

Nga verifikimi rezultoi se: Lidhur me këtë rekomandim, është trajtuar hollësisht në pikën 4 të programit të auditimit. Pra **Rekomandimi 14.1** është pranuar nga subjekti dhe është në proces zbatimi.

15. Gjetje nga auditimi: Për periudhën nga data 01.07.2019, deri më 31.12.2022, Bashkia Patos në total ka zhvilluar 469 procedura prokurimi me vlera të vogla të publikuara në sistemin e prokurimit elektronik të APP-së, me fond limit në vlerën 60,374,830 lekë pa Tvsh dhe realizim kontrate kontrate në vlerën 52,892,301 lekë pa Tvsh me një diferencë mosrealizimi të fondit limit në vlerën 7,482,529 lekë pa Tvsh. Nga të cilat me zgjedhje janë audituar në total 48 procedura prokurimi me vlera të vogla me fond limit në vlerën 21,099,954 lekë pa Tvsh dhe realizim kontrate në vlerën 18,743,115 lekë pa Tvsh ose në masën 34.9% të totalit të vlerës së fondit limit, ku janë konstatuar parregullsitë si më poshtë:

-Për vitin 2021 dhe 2022 në 2 raste janë shmangur procedurat normale të prokurimit duke copëzuar fondin limit.

-Në 13 raste nuk argumentohet dhe dokumentohet mënyra e përlllogaritjes së fondit limit.

-Në 3 raste në dosjet e prokurimeve nuk disponohet të gjitha dokumentacionet e përcaktuara në kriteret e ftesës për ofertë (numër llogarie, vërtetimi për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore, deklarata e garancisë, të cilat përbëjnë skualifikim të operatorëve për mos plotësimin e tyre ndërkohë që nga komisioni i prokurimit me vlera të vogla edhe këto kriteret nuk janë përmbushur operatorët janë shpallur fitues.

-Në 4 raste fatura tatimore nuk është nënshkruar nga të anëtarët e komisionit.

-Në 17 raste kanë rezultuar vonesa nga Bashkia Patos në likuidimin e faturave tatimore ndaj operatorëve ekonomikë duke sjell risk për krijimin e detyrimeve kontraktuale.

-Në 48 raste dosjet e procedurave të prokurimit me vlera të vogla nuk janë të inventarizuara dhe arkivuara. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 48/2014, datë 24.04.2014, “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”, neni 7, “Norma tekniko profesionale dhe metodologjisë të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë”, neni 3 dhe neni 29 miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, në zbatim të Ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003, “Për arkivat”,

VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 40, pika 1, neni 59, pika 2, Udhëzimi nr. 3, datë 08.01.2018, “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike” i ndryshuar, pika 19. (Më hollësisht trajtuar në nën pikën 2.4 faqe 69-121 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

15.1. Rekomandimi: Bashkia Patos, Drejtoria e Financës dhe Sektori Juridik përgjatë zhvillimit të procedurave të prokurimeve me vlera të vogla të marrë masa që:

-Përgjatë hartimit të regjistrimit të parashikimeve të prokurimeve, të shmangët mundësia e copëzimit të fondeve për të njëjtin grup mallrash apo shërbimesh.

-Përpara fillimit të procedurës së prokurimit me vlera të vogla të argumentojë dhe të dokumentojë nevojat e institucionit për mallra dhe shërbime.

-Për raste në të cilat nga operatorët ekonomikë nuk paraqesin dokumentacionin e kërkuar në kriteret e ftesës për ofertë të bëhet skualifikimi i tyre.

-Për çdo rast faturat tatimore të nënshkruhen sipas përcaktimeve ligjore.

-Për çdo rast likuidimi i faturave të kryhet brenda afateve ligjore duke shmangur krijimin e detyrimeve kontraktuale.

-Të gjitha aktet e hartuara në lidhje me procedurat e prokurimit, të kalojnë përmes arkivës së institucionit, me qëllim evidentimin e rrjedhshmërisë së veprimeve gjithashtu pas përfundimit të çdo procedure të kryhet arkivimi i tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi se: Lidhur me këtë rekomandim, është trajtuar hollësisht në pikën 4 të programit të auditimit. Pra **Rekomandimi 15.1** është pranuar nga subjekti dhe është në proces zbatimi.

16. Gjetje nga auditimi: Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatuan pesë praktika tek të cilat pasqyrohej e njëjta situatë, në lidhje me moskonvertimin e resursit të tokës “arë” në “truall”, përpara miratimi të lejes të ndërtimit dhe zbatimit të punimeve, përkatësisht në lejen e ndërtimit të miratuar me objekt: 1. “Ndërtim kantineve 1 kat+bodrum beton arme”, për të cilën është marrë vendimi nr. 21 datë 13.01.2020, me zhvillues B.G, Dukas, Patos; 2. “Dy kapanone 1 kat për grumbullimin dhe ruajtjen e produkteve bujqësore dhe blegtorale”, për të cilën është marrë vendimi nr.1, datë 03.02.2020, me zhvillues “D” Shpk, NJA Zharrëz, Patos; 3. “Shtesë anësore në objekt ekzistues”, për të cilën është marrë vendimi nr.9, datë 23.10.2020, me zhvillues F.S , NJA Zharrëz, Patos; 4. “Banesë 1 kat beton arme”, për të cilën është marrë Vendimi nr. 17, datë 17.06.2022, me zhvillues N.K e I.K , Sheqishtë, NJA Zharrëz, Bashkia Patos; 5. “Objekt 1 kat për grumbullimin e produkteve bujqësore”, për të cilën është marrë Vendimi nr. 6, datë 13.08.2020, me zhvillues M.S, Sheqishtë, NJA Zharrëz, Bashkia Patos. Veprime këto në kundërshtim me Vendimin nr. 5, datë 07.03.2016; Vendimin nr. 1, datë 30.07.2015; Vendimin nr. 5, datë 29.12.2014; Vendimin nr. 283, datë 01.04.2015. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 131-143 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

16.1. Rekomandimi: Nga DPZHT Patos të merren masa për të verifikuar dokumentacionin e pronësisë dhe statusin e pronës që të jetë në përputhje me kriteret e përcaktuara për zhvillimin e zonës përkatëse, përpara miratimit të lejes së ndërtimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi se: Lidhur me këtë rekomandim, është trajtuar hollësisht në pikën 5 të programit të auditimit. Pra **Rekomandimi 16.1** është pranuar nga subjekti dhe është në proces zbatimi.

17. Gjetje nga auditimi: Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatuan një praktikë tek e cila pasqyrohej situata, në lidhje me mosrespektimin e lartësisë së lejuar në përputhje me tipologjinë e

ndërtimit, në bazë të rregullave dhe kriterëve ligjore, përkatësisht në lejen e ndërtimit me objekt: “Stallë për rritje derrash 1 kat b/a+metalike”, për të cilën është marrë Vendimi nr.2, datë 27.02.2020, me zhvillues K.S, në Sheqishtë, NJA Zharrëz, Patos. Veprime këto në kundërshtim me Vendimin nr. 283, datë 01.04.2015. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 131-143 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

17.1. Rekomandimi: Nga DPZHT Patos të merren masa për të verifikuar lartësitë e lejuara të strukturës së ndërtimit, në përputhje me rregulloren dhe kriteret e përcaktuara.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi se: Lidhur me këtë rekomandim, është trajtuar hollësisht në pikën 5 të programit të auditimit. Pra **Rekomandimi 17.1** është pranuar nga subjekti dhe është në proces zbatimi.

18. Gjetje nga auditimi: Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatua një praktikë tek e cilat pasqyrohej situata, në lidhje me mos përcaktimin e saktë të numrit të kateve në planvendosje dhe të dhënat e treguesve të zhvillimit, në përputhje me rregulloren dhe legjislacionin në fuqi, përkatësisht në lejen e ndërtimit me objekt: “Shtesë anësore në objekt ekzistues”, për të cilën është marrë Vendimi nr. 9, datë 23.10.2020, me zhvillues F.S, me adresë NJA Zharrëz, Patos. Veprime këto në kundërshtim me VKM nr. 408, neni 37. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 131-143 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

18.1. Rekomandimi: Nga DPZHT Patos të merren masa për të shqyrtuar me vëmendje të dhënat e paraqitura në planvendosje, në lidhje me përcaktimin e saktë të numrit të kateve të objektit, duke i verifikuar me projektin e ndërtimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi se: Lidhur me këtë rekomandim, është trajtuar hollësisht në pikën 5 të programit të auditimit. Pra **Rekomandimi 18.1** është pranuar nga subjekti dhe është në proces zbatimi.

19. Gjetje nga auditimi: Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatua një praktikë tek e cilat pasqyrohej situata, në lidhje me mosparaqitjen e saktë të rilevimit topografik duke pasqyruar gjendjen ekzistuese të parcelës dhe objekteve të tjera që zhvillohen në të, përkatësisht në lejet e ndërtimit me objekt: “Objekt për grumbullimin dhe ruajtjen e produkteve bujqësore e blegtorale, përfshirë edhe ato frigoriferike”, për të cilën është marrë Vendimi nr.6, datë 23.08.2021, me zhvillues “S” Shpk, Patos, Rrethi Patos. Veprime këto në kundërshtim me VKM nr. 408, neni 15. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 131-143 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

19.1. Rekomandimi: Nga DPZHT Patos të merren masa për të mos miratuar lejet e ndërtimit pa shqyrtuar me vëmendjen përputhshmërinë ndërmjet gjendjes ekzistuese dhe dokumentacionit të ngarkuar në sistem.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi se: Lidhur me këtë rekomandim, është trajtuar hollësisht në pikën 4 të programit të auditimit. Pra **Rekomandimi 19.1** është pranuar nga subjekti dhe është në proces zbatimi.

20. Gjetje nga auditimi: Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatua një praktikë tek e cilat pasqyrohej situata, në lidhje me mosparaqitja në sistemin “e-Leje” të marrëveshjes me pronarin e tokës dhe ndërmjet palëve të treta, në bazë të legjislacionit në fuqi, përkatësisht leja e ndërtimit me objekt: “Objekt për grumbullimin dhe ruajtjen e produkteve bujqësore e blegtorale, përfshirë edhe ato frigoriferike”, për të cilën është marrë Vendimin nr. 6, datë 23.08.2021, me zhvillues “S” Shpk, Patos, Rrethi Patos. Anomalitë e trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me në bazë të

VKM-së nr. 408, neni 15, pika b. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 131-143 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

20.1. Rekomandimi: Nga DPZHT Patos të merren masa për të verifikuar në sistemin e-Leje paraqitjen e të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, përpara miratimit të lejes së ndërtimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi se: Lidhur me këtë rekomandim, është trajtuar hollësisht në pikën 4 të programit të auditimit. Pra **Rekomandimi 20.1** është pranuar nga subjekti dhe është në proces zbatimi.

21. Gjetje nga auditimi: Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatuan një praktikë tek e cila pasqyrohej situata në lidhje me mungesën e marrjes së miratimeve dhe autorizimeve përkatëse në lejen e zhvillimit dhe në lejen e ndërtimit, në zbatim të legjislacionit të posaçëm në fuqi, përkatësisht leja e ndërtimit me objekt: “Objekt për grumbullimin dhe ruajtjen e produkteve bujqësore e blegtorale, përfshirë edhe ato frigoriferike”, për të cilën është marrë Vendimi nr. 6, datë 23.08.2021, me zhvillues “S” Shpk, Patos, Rrethi Patos. Veprime këto në kundërshtim me VKM nr. 408, neni 10/1, dhe neni 14, pika 3.(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 131-143 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

21.1. Rekomandimi: Nga DPZHT Patos të merren masa për të marrë miratimet nga institucionet përkatëse dhe konformitetin përpara miratimit të lejes së zhvillimit dhe lejes së ndërtimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi se: Lidhur me këtë rekomandim, është trajtuar hollësisht në pikën 5 të programit të auditimit. Pra **Rekomandimi 21.1** është pranuar nga subjekti dhe është në proces zbatimi.

22. Gjetje nga auditimi: Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatua një praktikë tek e cila pasqyrohej situata në lidhje me mospërputhjen ndërmjet tipologjisë së objektit dhe tipologjisë së objekteve të lejuara në njësinë përkatëse, përkatësisht në lejet e ndërtimit me objekt: “Magazinë për grumbullimin e produkteve bujqësore”, për të cilën është marrë Vendimi nr. 10, datë 12.07.2022, me zhvillues E.Ç, Patos. Veprime këto në kundërshtim me zbatimin e kushteve të lejes së ndërtimit të miratuar sipas pikës 6 dhe pikës 7. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 131-143 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

22.1. Rekomandim: Nga DPZHT Patos të merren masa për të ndjekur zhvillimin e lejeve të miratuara edhe gjatë fazave të zbatimit, në mënyrë që tipologjia e ndërtimit dhe objekti të jetë në përputhje me lejen e ndërtimit të miratuar.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi se: Lidhur me këtë rekomandim, është trajtuar hollësisht në pikën 5 të programit të auditimit. Pra **Rekomandimi 22.1** është pranuar nga subjekti dhe është në proces zbatimi.

23. Gjetje nga auditimi: Gjatë verifikimit në terren të objekteve të cilat ishin pajisur me leje ndërtimi u konstatuan katër praktika në të cilat pasqyrohej e njëjta situatë lidhur me mungesën e pajisjes me “Certifikatë përdorimi” të objektit pasi ishte në përdorim, përkatësisht në lejen e ndërtimit me objekt: 1. “Dy kapanone 1 kat për grumbullimin dhe ruajtjen e produkteve bujqësore dhe blegtorale”, për të cilën është marrë Vendimi nr. 1, datë 03.02.2020, me zhvillues “D” Shpk, me adresë Verbas, NJA Zharrëz, Patos; 2. “Objekt për grumbullimin dhe ruajtjen e produkteve bujqësore e blegtorale, përfshirë edhe ato frigoriferike”, për të cilën është marrë Vendimi nr. 6, datë 23.08.2021, me zhvillues “S” Shpk, Patos, Rrethi Patos; 3. “Shtesë anësore në objekt ekzistues”, për të cilën është marrë Vendimi nr. 9, datë 23.10.2020, me zhvillues F.S , NJA

Zharrëz, Patos; 4. “Magazinë për grumbullimin e produkteve bujqësore”, për të cilën është marrë Vendimi nr. 10, datë 12.07.2022, me zhvillues E.Ç, Verbas, Patos. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin 107, neni 50, me Ligjin 107, neni 52, pika “g”, me VKM-në nr. 408, neni 27. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 131-143 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

23.1. Rekomandimi: Pas miratimit të lejes së ndërtimit DPZHT Patos të marrë masa për të zhvilluar mbikëqyrjen e punimeve dhe verifikime në terren të ndërtimit të objektit, për të verifikuar mbajtjen e akteve të kontrollit dhe të mos lejojë përdorimin e objektit pa u pajisur me certifikatë përdorimi.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi se: Lidhur me këtë rekomandim, është trajtuar hollësisht në pikën 5 të programit të auditimit. Pra **Rekomandimi 23.1** është pranuar nga subjekti dhe është në proces zbatimi.

24. Gjetje nga auditimi: Gjatë auditimit të procedurave së miratimit të “Certifikatave të përdorimit” u konstatuan dy praktika në të cilat pasqyrohej e njëjta situatë, në të cilat zbatimi i punimeve në terren nuk përputhej me lejet e ndërtimit të miratuara, përkatësisht për lejet e ndërtimit me objekt: 1. “Ndërtim kantine vere 1 kat+bodrum beton arme”, për të cilën është marrë Vendimi nr. 21, datë 13.01.2020, me zhvillues B.G , Dukas, Patos; 2. “Banesë 1 kat beton arme”, për të cilën është marrë Vendimi nr.17, datë 17.06.2022, me zhvillues N.K e I.K , Sheqishtë, NJA Zharrëz, Bashkia Patos. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin 107/2014, neni 42, “Certifikata e përdorimit”, me Ligjin 107/2014, neni 29, pika c, me VKM-në nr. 408, neni 27. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 131-143 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

24.1. Rekomandimi: Përpara miratimit të certifikatës së përdorimit, DPZHT Patos të marrë masa për të verifikuar aktet e kontroleve të mbajtura dhe realizimin e zbatimit të punimeve në terren, në mënyrë që të jenë në përputhshmëri me lejen e ndërtimit të miratuar.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi se: Lidhur me këtë rekomandim, është trajtuar hollësisht në pikën 4 të programit të auditimit. Pra **Rekomandimi 24.1** është pranuar nga subjekti dhe është në proces zbatimi.

25. Gjetje nga auditimi: Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatuan tetë praktika tek të cilat pasqyrohej e njëjta situatë, në lidhje me mosparaqitja e mënyrës së llogaritjes së taksës së ndikimit në infrastrukturë në njoftimin për pagesën e taksës, përkatësisht në lejet e ndërtimit me objekt: 1. “Ndërtim kantineve 1 kat+bodrum beton arme”, për të cilën është marrë Vendimi nr. 21, datë 13.01.2020, me zhvillues B.G , Patos; 2. “Stallë për rritje derrash 1 kat b/a+metalike”, për të cilën është marrë Vendimi nr. 2, datë 27.02.2020, me zhvillues K.S, në Sheqishtë, NJA Zharrëz, Patos; 3. “Dy kapanone 1 kat për grumbullimin dhe ruajtjen e produkteve bujqësore dhe blegtorale”, për të cilën është marrë Vendimi nr.1, datë 03.02.2020, me zhvillues “D” Shpk, Verbas, NJA Zharrëz, Patos; 4. “Objekt për grumbullimin dhe ruajtjen e produkteve bujqësore e blegtorale, përfshirë edhe ato frigoriferike”, për të cilën është marrë Vendimi nr. 6, datë 23.08.2021, me zhvillues “S” Shpk, me adresë Patos, Rrethi Patos; 5. “Shtesë anësore në objekt ekzistues”, për të cilën është marrë Vendimi nr. 9, datë 23.10.2020, me zhvillues F.S , NJA Zharrëz, Patos; 6. “Banesë 1 kat beton arme”, për të cilën është marrë Vendimi nr. 17, datë 17.06.2022, me zhvillues N.K e I.K, Sheqishtë, NJA Zharrëz, Bashkia Patos; 7. “Objekt 1 kat për grumbullimin e produkteve bujqësore”, për të cilën është marrë Vendimi nr. 6, datë 13.08.2020, me zhvillues M.S, Sheqishtë, NJA Zharrëz, Bashkia Patos; 8. “Magazinë për grumbullimin e produkteve bujqësore”, për të cilën është marrë Vendimi nr. 10, datë 12.07.2022, me zhvillues E.Ç, Verbas, Patos. Në shkresa për njoftimin e pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë,

nevojitet të paraqitet edhe mënyra e llogaritjes së saj. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” të ndryshuar, neni 27, taksa e ndikimit në infrastrukturë, me Ligjin nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, neni 46, Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 131-143 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

25.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Patos të merren masa që në njoftimin për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë të pasqyrohet mënyra e llogaritjes së saj dhe jo vetëm tarifa që nevojitet të likuidohet.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi se: Nga Drejtoria e Planifikimit Urban, Projekteve, Shërbimeve dhe Emergjencave civile/Bashkia Patos, ka nxjerrë “fletë njoftimet” të 16 debitorëve për TNI nga ndërtimet e reja, me shkresat nr. 3240 prot., deri në 3255 datë 07.12.2023. Pra **Rekomandimi 25.1** është pranuar nga subjekti dhe është zbatuar.

26. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi në terren i realizimit të punimeve të zbatimit të lejeve të ndërtimit të miratuara, u konstatuan pesë praktika tek të cilat pasqyrohej e njëjta situatë, në lidhje me mospërputhjen ndërmjet projektit të miratuar për leje ndërtimi dhe zbatimit në terren sipas rregullores dhe legjislacionit në fuqi. Zbatimi i realizimit jo në përputhje me lejen e ndërtimit të miratuar ndikon në zhvillimin informal të ndërtimeve, pa u bazuar në Planin e Përgjithshëm Vendor të miratuar dhe në legjislacionin në fuqi. Ndryshimi/shtimi i volumeve të ndërtimit të cilat nuk janë parashikuar në projektin e ndërtimit të miratuar, ndikojnë në qëndrueshmërinë dhe sigurinë e objektit, në aspektin arkitektonik dhe në ndryshimin e parametrave të zhvillimit në zonën e caktuar, si edhe në respektimin e distancave. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, neni 51 dhe Ligjin nr. 9780, datë 16.07.2007, neni 5. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 143-151 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

26.1. Rekomandimi: Nga IVMT Patos të merren masa për të zhvilluar kontrolle të vazhdueshme në terren dhe të evidentojë në mënyrë konstante çdo problematikë që konstatohet nga kontrolli i kryer dhe duke ekzekutuar vendimet e marra.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi se: Lidhur me këtë rekomandim, është trajtuar hollësisht në pikën 6 të programit të auditimit. Pra **Rekomandimi 26.1** është pranuar nga subjekti dhe është në proces zbatimi.

27. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi në terren i realizimit të ndërtimit, u konstatuan një praktikë tek e cila pasqyrohej realizimi i ndërtimit pa u pajisur me leje ndërtimi dhe pa deklaratë paraprake punimesh. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, neni 51 dhe me Ligjin nr. 9780, datë 16.07.2007, neni 5. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 143-151 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

27.1. Rekomandimi: Nga IVMT Patos të merren masa për të zhvilluar kontrolle të vazhdueshme në terren dhe të evidentojë zhvillimin e ndërtimeve pa leje ndërtimi, duke marrë masat e nevojshme për ndërprerjen e punimeve pa u pajisur me leje ndërtimi.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi se: Lidhur me këtë rekomandim, është trajtuar hollësisht në pikën 6 të programit të auditimit. Pra **Rekomandimi 27.1** është pranuar nga subjekti dhe është në proces zbatimi.

28. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi në terren i realizimit të ndërtimit, u konstatuan një praktikë tek e cila pasqyrohej realizimi i ndërtimit pa u pajisur me leje ndërtimi dhe pa deklarata paraprake punimesh. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, neni 51 dhe me Ligjin nr. 9780, datë 16.07.2007, neni 5. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 143-151 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

28.1. Rekomandimi: Nga IVMT Patos të merren masa për të zhvilluar kontrolle të vazhdueshme në terren dhe të evidentojë zhvillimin e ndërtimeve pa leje ndërtimi, duke marrë masat e nevojshme për ndërprerjen e punimeve pa u pajisur me leje ndërtimi.

Menjëherë dhe në vijimësi

Është përsëritur Rekomandimi 27.1

29. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i të dhënave të paraqitura nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore të Bashkisë Patos, tre inspektorë nuk kanë kualifikimin e duhur për pozicionin e punës dhe nuk plotësojnë kriterin e arsimit të nevojshëm për pozicionin e punës si kryeinspektorë/inspektorë. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 183/2014, datë 24.12.2014, nenin 11, të arsimit të kryeinspektorëve dhe inspektorëve të inspektoratit të mbrojtjes së territorit. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 143-151 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

29.1. Rekomandimi: Nga Bashkisë Patos të merren masa për të punësuar punonjës të kualifikuar për pozicionin e punës dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi se: Struktura e IMTV/Bashkia Patos për vitin 2023 është përbërë si në tabelë:

Nr.	Struktura e IVMT	Profili arsimor	Pozicioni	Emërimi
1	A.G	Juridik	k/inspektor	01.07.2021
2	XH.Ç	Administrim Biznesi	Inspektor	16.09.2016
3	D.L	Shkolla Ushtarake	inspektor	10.12.2013-21.12.2023

Nga Drejtoria e Burimeve njerëzore/Bashkia Patos janë marrë masat që për periudhat në vijim të rekrutojë inspektorë të IVMT sipas kriterëve të ligjit nr. 183/2014, datë 24.12.2014, nenin 11. Pra **Rekomandimi 29.1** është pranuar nga subjekti dhe në proces zbatimi.

30. Gjetje nga auditimi: Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit të Bashkisë Patos, gjatë periudhës 01.07.2019-31.12.2022, ka marrë shtatë vendime për “Dënim me gjobë”, të cilat janë të pa mbledhura e të pa ekzekutuara, me një vlerë të debisë për 4 vjet, në vlerën 200,000 lekë. Veprime këto në kundërshtim me Ligji nr. 9780, datë 06.07.2007, “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme” i ndryshuar, dhe Ligjin nr.10279, datë 20.05.2010, “Për kundërvajtjet administrative”, neni 9 dhe neni 22. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 143-151 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

30.1. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të ndjekin me përpikmëri procedurat gjyqësore që kanë ndërmarrë kundër kundërvajtësve që nuk kanë paguar në mënyrë vullnetare gjobat e vendosura nga IMTV për vlerën totale 200,000 lekë. Gjithashtu, IVMT të ndjekë me vëmendje të gjitha rastet që nuk e paguajnë gjobën brenda afatit duke i dërguar menjëherë në gjykatë për të nxjerrë titullin ekzekutiv si dhe të llogarisë kamatëvonesën përkatëse referuar kuadrin ligjor në fuqi.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi se: Nga Bashkia Patos informacioni që iu vu në dispozicion grupit të auditimit është si në tabelën më poshtë:

Nr.i proceseve gjyqesore per gjobat e IMTV deri ne 31.12.2022	Arketimet nga vendimet gjyqesore deri me 31.12.2022	Nr.i proceseve gjyqesore per gjobat e IMTV deri ne 31.12.2023	Arketimet nga vendimet gjyqesore deri me 31.12.2023
0	0	0	0

Ndërsa lidhur me gjobat e vendosura për kundërvajtësit, është trajtuar hollësisht në pikën 6 të programit të auditimit. Pra **Rekomandimi 30.1** është pranuar nga subjekti dhe është në proces zbatimi.

32. Gjetje nga auditimi: 1. Bashkia Patos, së fundmi është audituar nga KLSH në vitin 2022 dhe Raporti Përfundimtar me objekt: “Auditim financiar në Bashkinë Patos për periudhën nga data 01.01.2019, deri më 31.12.2021”, si dhe rekomandimet janë dërguar me shkresën nr. 51/8 prot., datë 16.05.2022, protokolluar në Bashkinë Patos me nr. 120/2 prot., datë 18.05.2022, ku janë lënë për zbatim 9 masa organizative, 8 masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitet të fondeve publike (të ardhura të munguara) në vlerën 99,398,839 lekë dhe 5 masa disiplinore.

a. Masa organizative janë rekomanduar 9 masa të cilat janë pranuar plotësisht, nga masat e pranuar 4 masa janë zbatuar, 3 masa janë zbatuar pjesërisht, 2 masa janë në proces zbatimi.

b. Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitet të fondeve publike (të ardhura të munguara) janë rekomanduar 8 masa në vlerën 99,398,839 lekë të cilat janë pranuar plotësisht, nga masat e pranuar 8 masa nuk janë zbatuar.

c. Masa disiplinore janë rekomanduar 5 masa të cilat janë pranuar plotësisht, nga masat e pranuar 5 masa janë zbatuar pjesërisht.

32.1. Rekomandimi: Strukturat drejtuese të Bashkisë Patos të analizojnë dhe të nxjerrë përgjegjësinë për moszbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditimin “Financiar për periudhën nga data 01.01.2019, deri më 31.12.2021”. Të marrë masa të menjëhershme për zbatimin e rekomandimeve që janë ende të zbatuara pjesërisht, në proces zbatimi dhe të pa zbatuara si vijon:

-Për 3 masa organizative të cilat janë zbatuar pjesërisht, dhe 2 masa në proces zbatimi.

2.1. Kryetari i Bashkisë Patos, të marrë masa për plotësimin e strukturës së NJAB me personel konform akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi duke përcaktuar kriteret specifike profesionale për çdo pozicioni të strukturës së NJAB si dhe ndjekë në kohë procedurën për certifikimin e audituesve.

Nga verifikimi rezultoi se: Bashkia Patos nëpërmjet Urdhrave të Titullarit nr. 252 datë 04.08.2023, nr. 250 datë 02.08.2023 dhe nr. 350 datë 01.11.2023 ka plotësuar NJAB me 2 specialistë auditues, duke mundësuar funksionimin me kapacitete të plotë të tij në arritjen e objektivave, konform Ligjit nr. 115/2014 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” i ndryshuar dhe manualit për Auditimin e brendshëm. Pra **Rekomandimi 32.1/2.1** është pranuar nga subjekti dhe është zbatuar.

3.1. Në mënyrë që të mos krijohen diferenca të dukshme midis parashikimit dhe realizimit të buxhetit, Bashkia Patos, të marrë masa për hartimin e një buxheti real, mbështetur në realizimin e mundshëm dhe objektiv të të ardhurave dhe shpenzimeve. Të bëhen periodikisht analizat e punës për realizimin/mosrealizimin e buxheteve paraardhës, duke nxjerrë konkluzione të sakta për realizimet dhe mosrealizimet e buxheteve përkatëse. Të kryhet në mënyrë të saktë kontabilizimi i të ardhurave në llogaritë kontabël dhe të sigurohet rregullsi dhe saktësi në raportimin dhe rakordimin e treguesve të realizimit të të ardhurave, në përputhje me raportimet e Degës së Thesarit sipas akt-rakordimeve të Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit.

Nga verifikimi rezultoi se: Nga Bashkia Patos, Drejtoria e Financës ka marrë parasysh rekomandimin dhe i ka kushtuar vëmendje zbatimit të tij, konfirmuar kjo nga akt rakordimet me thesarin, takimet e GMS, raportet e monitorimit etj. Pra ***Rekomandimi 32.1/3.1*** është pranuar nga subjekti dhe është në proces zbatimi.

4.1. Nga Bashkia Patos, të merren masa që planifikimi i procedurave për investime, shërbime dhe blerje mallrash të bëhet mbi bazën e të ardhurave reale, të disponueshme dhe jo të planifikimit, duke planifikuar shpenzimet më të domosdoshme për nevojat e bashkisë Patos.

Nga verifikimi rezultoi se: Bashkia Patos, GMS, Drejtoria e Financës kanë marrë parasysh rekomandimin e lënë dhe para hartimit të PBA-së dhe planeve vjetore analizojnë (mos)realizimin e të ardhurave të veta. Pra ***Rekomandimi 32.1/4.1*** është pranuar nga subjekti dhe në proces zbatimi.

5.1. Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Drejtorin e të Ardhurave të marrin masat për kontabilizimin dhe arkëtimin e detyrimeve të pa shlyera nga të ardhurat vendore për vitet 2020 - 2021 në vlerën 136,906,723 lekë sipas evidencave të Drejtorisë të Ardhurave Vendore.

Nga verifikimi rezultoi se: Bashkia Patos, Drejtoria e të Ardhurave dhe Drejtoria e Financës kanë marrë masa për vjeljen e detyrimeve të prapambetura nga taksat e tarifave vendore nëpërmjet lëshimit të Urdhër bllokimit nr. 3412 prot., datë 20.12.2023 të llogarive bankare të debitorëve në të gjitha bankat e nivelit të dytë Fier, si dhe kontabilizimin e vlerës reale të tyre. Pra ***Rekomandimi 32.1/5.1*** (i njëjtë me ***Rekomandimin 32.1/3.1*** dhe ***Rekomandimin 4.1***) është pranuar nga subjekti, pjesërisht zbatuar dhe në proces zbatimi.

7.1. Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Drejtorinë e Urbanistikës të njoftojë subjektet të cilave ju është ngurtësuar vlera 5% e garancisë së punimeve, për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për të likuiduar garancitë të cilat tashmë u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratën e investimit.

Nga verifikimi rezultoi se: Drejtoria e Financës/Bashkia Patos me shkresën nr. 2781 prot., datë 20.10.2023 i ka dërguar Drejtorisë së Urbanistikës listën e 52 subjekteve në cilësinë e OE fitues në investimet e kryera nga Bashkia Patos, të cilëve iu është ngurtësuar 5% i garancisë së punimeve. Drejtoria e Planifikimit Urban, Projekteve, Shërbimeve dhe Emergjencave civile nuk e ka praktikë të punës së saj njoftimin e këtyre subjekteve, por trajton vetëm rastet kur subjektet paraqesin kërkesën për të kaluar në llogaritë e tyre bankare vlerën e 5% të ngurtësuar nga bashkia. Kështu nga Shoqëria “C” ShPk kanë mbërritur në Bashkinë Patos 3 kërkesa: nr. 3346 prot., datë 13.12.2023 për vlerën 201,055 lekë; nr. 3347 prot., datë 13.12.2023 për vlerën 135,435 lekë; nr.3348 prot., datë 13.12.2023 për vlerën 149,260 lekë; nga Shoqëria “K” ShPk kanë mbërritur 2 kërkesa: nr. 3155 prot., datë 04.12.2023 për vlerën 1,148,659 lekë; nr. 3156 prot., datë 04.12.2023 për vlerën 402,002 lekë. Nga ana e vet DPUPSHEC ka nisur në terren inxhinirët për të verifikuar punimet referuar situacioneve. Deri tani nuk është likuiduar asnjë OE. Pra ***Rekomandimi 32.1/7.1*** është pranuar nga subjekti dhe është pjesërisht zbatuar.

-Për 8 masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet të fondeve publike (të ardhura të munguara) në vlerën 99,398,839 lekë të cilat nuk janë zbatuar.

1.1. Bashkia Patos, të marrë masa për të krijuar bazat e të dhënave për subjektet, tarifave apo taksat e të cilave mblidhen nëpërmjet agjentëve tatimorë etj., të kryqëzohet informacioni me institucionet e tjera përkatëse dhe rakordimet të bëhen në fund të çdo muaji sipas formularit përkatës të miratuar nga Ministri i Financave. Bashkia Patos, të bashkërendojë veprimtarinë e saj me institucionet e tjera të linjës, të nisë menjëherë procedurat për të krijuar të plotë regjistrin e subjekteve që zhvillojnë aktivitete në territorin e saj, si dhe të zhvillojë korrespondencë të rregullt periodike me këto institucione (QKB-në, QKL-në, DRT-në, ASHK-në, etj.), për të evidentuar bizneset që ushtrojnë aktivitete në territorin e saj dhe për të përditësuar bazën ekzistuese të të dhënave.

Nga verifikimi rezultoi se: Bashkia Patos, Drejtoria e të Ardhurave Vendore ka krijuar bazën e të dhënave për ato subjekte taksat dhe tarifave e të cilëve mblidhen me agjentë tatimorë; DAV dhe Drejtoria e Financës kanë marrë masat për marrëveshje bashkëpunimi me agjentët tatimorë. Deri tani është realizuar me

Drejtorinë Rajonale të Tatimeve, Drejtorinë Rajonale të Shërbimeve të Transportit Rrugor. Me ASHK Rajonale nuk është arritur ende marrëveshje bashkëpunimi. Pra **Rekomandimi 32.1/1.1** është pranuar nga subjekti, pjesërisht zbatuar dhe në proces zbatimi.

2.1. Bashkia Patos të ngrejë grup pune me specialistë të fushës, për të përditësuar regjistrin e familjeve që disponojnë tokë bujqësore, sipas të dhënave të marra nga institucionet përgjegjëse (ASHK Patos dhe Qarku Fier). Të marrë të gjitha masat duke ndjekur procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës 40,491,275 lekë.

Nga verifikimi rezultoi se: Nga Bashkia Patos nuk është ngritur grup pune për përditësimin e regjistrit të familjeve që disponojnë tokë bujqësore, por nga ana e vet DAV ka krijuar një regjister elektronik mbështetur në informacionin dokumentar të mëparshëm. Për vënien në dijeni të debitorëve janë angazhuar Njesitë administrative, kryepleqtë dhe punonjësi i taksave nëpërmjet fletë njoftimeve. Kjo nuk ka rezultuar efektive, pasi nga të dhënat e vëna në dispozicion rezultoi se numri i debitorëve ka pësuar rritje nga viti 2022 në vitin 2023 me 26 familje dhe shprehur në vlerë nga viti 2022 në vitin 2023 debia është rritur me 12,337,837 lekë. Pra **Rekomandimi 32.1/2.1** është pranuar nga subjekti dhe nuk është zbatuar.

2.2. Bashkia Patos, të marrë masa për të propozuar dhe miratuar në Këshillin Bashkiak kontraktimin e shoqërisë “U” Sha, për kryerjen nga ana e këtij të fundit të agjentit tatimor për arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore së bashku me faturat ujit të pijshëm, me synim përmirësimin e vjeljes së detyrimeve nga familjarët.

Nga verifikimi rezultoi se: Bashkia Patos nëpërmjet VKB nr. 41 datë 20.06.2022 dhe nr. 1495/2 prot., datë 27.06.2022, kanë caktuar UK -Sha Patos si agjent tatimor për vjeljen e taksave e tarifave familjare. Nga ana e vet UK -Sha Patos ka konfirmuar dakortësinë, por lidhja e marrëveshjes do të realizohet me përfundimin e lotit 3 që korrespondon me regjistrimin e të gjitha familjeve si abonentë. Pra **Rekomandimi 32.1/2.2** është pranuar nga subjekti, pjesërisht zbatuar dhe në proces zbatimi.

2.3. Bashkia Patos, të marrë masa për ngritjen e grupit të punës për evidentimin e familjeve ndaj të cilave nuk janë aplikuar detyrimet për taksat e tarifave vendore. Të hartohet regjistri përkatës me të dhënat e evidentuara në terren, si dhe të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme administrative në të gjitha shkallët për arkëtimin e vlerës debitorë prej 44,507,884 lekë.

Nga verifikimi rezultoi se: Nga Drejtoria e të Ardhurave Vendore lidhur me rekomandimin është vepruar duke bërë shënimet përkatëse tek secili përfitues, por nuk është krijuar një regjister elektronik për këtë kategori. Mungesa e këtij regjistri ka sjellë pasojë jo vetëm mos vjeljen e detyrimit, por as shkarkimin e tij nga totali i vlerës progresive. Pra **Rekomandimi 32.1/2.3** është pranuar nga subjekti dhe është pazbatuar.

3.1. Bashkia Patos të marrë masa për të llogaritur dhe kontabilizuar detyrimin total të papaguar (përfshirë vlerën e kamatëvonesave) dhe të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës prej 1,612,831 lekë, duke llogaritur dhe shtuar vlerën e kamatëvonesave për të gjitha rastet e detyrimeve të pa arkëtuara në afat, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit ndaj debitorëve.

Nga verifikimi rezultoi se: Drejtoria e të Ardhurave Vendore/Bashkia Patos ka marrë masat dhe nëpërmjet shkresave: nr. 3412 prot., datë 20.12.2023 dërguar të gjitha bankave të nivelit të dytë Fier; nr. 3410 prot., datë 20.12.2023 drejtuar ASHKDV Fier; nr. 3411 prot., datë 20.12.2023 drejtuar DRSHTRR Fier, për vendosje sekuestro konservative llogarive bankare të debitorëve, pronave të luajtshme dhe të paluajtshme në pronësi të debitorëve sipas listës bashkëngjitur. Pra **Rekomandimi 32.1/3.1** është pranuar nga subjekti, pjesërisht zbatuar dhe në proces zbatimi.

4.1. Bashkia Patos nëpërmjet bashkëpunimit institucional t'i kërkojë ASHK-së, Drejtoria Fier, që të mos lëshojë dhe të pajisë me certifikata legalizimi subjektet apo individët përfitues nga procesi i legalizimit pa kryer pagesat e taksës së ndikimit në infrastrukturë në masën 0.5% të vlerës së investimit për objektet që përfitojnë nga legalizimi pranë Bashkisë Patos. Drejtoria e planifikimit urban, kontrollit të zhvillimit dhe projekteve, të ndjekë procedurat e njoftimit të personave për detyrimet, si dhe të vijojë me masa shtrënguese

deri në arkëtimin e vlerës 33,398,133 lekë nga të gjithë individët e listuar si debitorë, sipas listës në aneksin pasqyrë nr. 15 bashkangjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Nga verifikimi rezultoi se: Bashkia Patos nëpërmjet shkresës nr. 3165 prot., datë 22.12.2022 i ka kërkuar ASHKDV Fier bashkëpunim për të mos shpërndarë lejen e legalizimit qytetarëve pa paraqitur më parë nga ana e tyre vërtetimin e lëshuar nga Bashkia Patos për shlyerjen e TNI për objektin përkatës. Pra ***Rekomandimi 32.1/4.1*** është pranuar nga subjekti, pjesërisht zbatuar dhe në proces zbatimi.

5.1. Bashkia Patos, të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e detyrimeve të pa vjela nga subjektet fizikë/juridikë, për të gjitha detyrimet tatimore të pa mbledhura ndaj subjekteve debitorë në vlerën prej 11,346,600 lekë (9,308,122 lekë detyrimi dhe 2,038,849 lekë gjoba, sipas, sipas listës në aneksin nr. A-16, A-17 dhe A-18 bashkangjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit, duke ndjekur rrugët e mëposhtme:

- a. T'u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimet e llogarive bankare.
- b. Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme).
- c. Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, Sektori i zhvillimit ekonomik të angazhohet për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatimpaguesve, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50% të qarkullimit të realizuar.
- d. Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare bizneset, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet në vite, nga ana e Drejtorisë së Financës dhe sektorit juridik të Bashkisë Patos, të merren masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal.

Nga verifikimi rezultoi se: Drejtoria e të Ardhurave Vendore/Bashkia Patos ka marrë masat dhe nëpërmjet shkresave: nr. 3412 prot., datë 20.12.2023 drejtuar të gjitha bankave të nivelit të dytë Fier; nr. 3410 prot., datë 20.12.2023 drejtuar ASHKDV Fier; nr. 3411 prot., datë 20.12.2023 drejtuar DRSHTRR Fier për vendosje sekuestro konservative llogarive bankare të debitorëve, pronave të luajtshme dhe të paluajtshme në pronësi të debitorëve sipas listës bashkëngjitur. Gjithashtu janë realizuar akt rakordimet mujore mes Bashkisë Patos dhe Institucioneve në rolin e agjentit tatimor: DRSHTRR Fier, DRT/DRD Doganore. Pra ***Rekomandimi 32.1/5.1*** (i njëjtë me ***Rekomandimin 32.1/3.1***) është pranuar nga subjekti, pjesërisht zbatuar dhe në proces zbatimi.

6.1. Nga Bashkia Patos të merren masa për të pajisur subjektet me licenca për tregtimin me pakicë të karburanteve për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë dhe të arkëtojnë tarifën e plotë për subjektet që kanë bërë pagesa pjesore për pajisje me autorizime, për shumën debitorë prej 5,550,000 lekë, sipas listës/pasqyrës aneks nr. A22 bashkangjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit. Në rastet kur këto subjekte nuk paraqiten për licencim apo për arkëtimin e plotë të tarifës së licencë/autorizimit në bashkëpunim me Inspektoriatin Shtetëror Teknik të ndërmerren veprime administrative e ligjore deri në mbylljen e aktivitetit të këtyre subjekteve.

Nga verifikimi rezultoi se: Drejtoria e të Ardhurave Vendore ka marrë masat duke verifikuar në terren statusin e subjekteve që tregëtojnë me pakicë karburante për automjetet, vajra lubrifikante dhe lëndë djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë referuar licencave të lëshuara nga Bashkia Patos dhe ka mundur të arkëtojë detyrimin e papaguar. Pra ***Rekomandimi 32.1/6.1*** (i njëjtë me ***Rekomandimin 4.1***) është pranuar nga subjekti, pjesërisht zbatuar dhe në proces zbatimi.

-Për 5 masa disiplinore të cilat janë zbatuara pjesërisht.

1. Znj. M.SH, me detyrë Drejtore e Financës.
2. Znj. XH.GJ, me detyrë Përgjegjëse e Kontabilitetit.
3. Z. A.M, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore.
4. Znj.S.M, me detyrë specialiste në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore.
5. Z.E.A, me detyrë inspektor në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore.

Nga verifikimi rezultoi se: Referuar Rubrikës E-“Masa Disiplinore”, ky rekomandim është i përfshirë në të. Nga Bashkia Patos/DBNJL janë marrë masa, ku nëpërmjet Urdhrave të titullarit janë ngritur komisionet dhe trajtuar punonjësit e atakuar në RPA. Pra **Rekomandimi** është pranuar dhe zbatuar.

2. Raporti Përfundimtar për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme të evaduara për periudhën 23.09.2019, deri më 31.12.2019, në Bashkinë Patos e cila përfshin: “Auditim financiar dhe përputhshmërie për periudhën nga data 01.01.2017, deri më 30.06.2019”, janë dërguar me shkresën nr. 610/64 prot., datë 04.12.2020, protokolluar në Bashkinë Patos me nr. 1468/5 prot., datë 07.12.2020, ku janë rikërkuar për zbatim **6** masa organizative, **5** masa për shpërblim dëmi në vlerën 2,668,052 lekë dhe **1** masë për uljen e borxhit tatimor duke rritur performancën në arkëtimin e detyrimeve për tatim taksat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia e tokave bujqësore, taksa e ndikimit në infrastrukturë (Të ardhura të munguara) në vlerën 42,732,889 lekë.

a. Masa organizative janë rikërkuar për zbatim 6 masa nga të cilat 2 masa janë në proces zbatimi dhe 4 masa nuk janë zbatuar.

b. Masa për shpërblim dëmi janë rikërkuar 5 masa në vlerën 2,668,052 lekë të cilat janë në proces zbatimi.

c. Masa për uljen e borxhit tatimor duke rritur performancën në arkëtimin e detyrimeve për tatim taksat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia e tokave bujqësore, taksa e ndikimit në infrastrukturë (Të ardhura të munguara) është rikërkuar 1 masë në vlerën 42,732,889 lekë e cila nuk është zbatuar. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15, gërma “c”, neni 30, pika 2. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7, faqe 151-165 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

32.2. Rekomandimi: Strukturat drejtuese të Bashkisë Patos të analizojnë dhe të nxjerrë përgjegjësinë për moszbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditimin për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve për “Auditimin financiar dhe të përputhshmërisë periudhën nga data 01.01.2017, deri më 30.06.2019”. Të marrë masa të menjëhershme për zbatimin e rekomandimeve që janë ende të zbatuara pjesërisht, në proces zbatimi dhe të pa zbatuara si vijon:

-Për 2 masa organizative të cilat janë në proces zbatimi dhe 4 masa të cilat nuk janë zbatuar

5.1. Bashkia Patos, të marrë masat që me specialist të fushës, të saktësojë pronat të cilat padrejtësisht zotërohen nga persona të ndryshëm dhe të procedojë sipas kërkesave ligjore për lirimin dhe administrimin e tyre në interes publik. Drejtoria e Aseteve në bashkëpunim me Drejtorinë e Urbanistikës, Drejtorinë e Planifikimit Territorit, të marrin masat për krijimin e regjistrit të asetëve dhe vazhdimin e procedurave për regjistrimin e tyre në pronësi të Bashkisë Patos në zbatim të kërkesave të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar dhe ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

Nga verifikimi rezultoi se: Nga Drejtoria e Zhvillimit Bujqësor, Blegtoral, Pyjeve, Mjedisit dhe Kontrollit Ushqimor/Bashkia Patos nëpërmjet shkresës nr. 1823/2 prot., datë 16.08.2023 drejtuar AKBN/MIE, i është kërkuar informacion i detajuar mbi subjektet që janë pajisur me “leje shfrytëzimi” dhe “leje mjedisi” për kategorinë minerare dhe hidrokarbure, që operojnë në territorin administrativ të Bashkisë Patos. Përgjigjja nga ana e saj ka ardhur me atë nr. 3800/1 datë 07.09.2023, konform kërkesave të paraqitura nga Bashkia Patos.

I

Nr	Nr Lejes	Data Akt Miratimit	Subjekti	Nipti	Vend burimi	Minerali	Sip. km ²	Statusi
1	1356	04.06.2009	C	K...D	Kasnicë	Rërë bituminoze	0.39	Aktiv
2	1643	01.07.2013	B	L...A	Visokë	Rërë bituminoze	0.424	Pezullim përkohshëm dt.19.08.2022
3	1736	23.12.2014	A	L...E	Zharrëz	Konglomerat	0.236	Aktiv

II

Nr	Viti Akt Miratimit	Subjekti	Vendburimi	Hidrokarbure	Statusi
1	2004	B	Patos-Marinzë	√	Aktiv
2	2009	T	Visokë	√	Aktiv
3	2009	SH	Blloku i Kërkimit 2-3	√	Aktiv

Gjithashtu informacion i është kërkuar edhe MIE nëpërmjet shkresës nr. 2750 prot., datë 17.10.2023 në zbatim të VKM nr. 888 datë 27.12.2022 “Për rastet e dhënies në përdorim dhe ndryshimet e kategorisë së përdorimit, procedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve dhe pakësimeve në volum nga fondi pyjor kombëtar apo zgjerimin e tyre”. Deri tani nga ana e MIE ende nuk ka një përgjigje zyrtare. Pra **Rekomandimi 32.2/5.1** është pranuar nga subjekti, pjesërisht zbatuar dhe në proces zbatimi.

7.1. Bashkia Patos, të analizojë gjendjen e debitorëve sipas viteve të krijimit të dhe të procedojë sipas kërkesave ligjore për arkëtimin e vlerës së tyre duke bërë kërkesë padi në gjykatë. Të vlerësojë rastet e debitorëve pa shpresë arkëtimi dhe të procedojë sipas kërkesave ligjore për sistemimin e vlerave debitorë. **Nga verifikimi rezultoi se:** Nga Drejtoria e të Ardhurave dhe Tarifave Vendore po punohet për zbatimin e rekomandimit të lënë. Është krijuar lista e debitorëve, por deri tani nuk është seleksionuar ajo kategori debitorësh që nuk ka shpresë për arkëtim. Pra **Rekomandimi 32.2/7.1** është pranuar nga subjekti dhe pjesësisht zbatuar.

8.1. Drejtoria e Financës, në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe Drejtorinë e Shërbimeve, të saktësojnë subjektet dhe fondet për të cilat janë ngurtësuar si garanci për punimet e kryera për të cilat kanë humbur të drejtën e përfitimit të tyre ose që janë në kushtet e parashkrimit të së drejtës, në zbatim të kërkesave të pikës 10, Kap. II të UKM nr. 3, datë 15.02.2011 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar. Drejtoria e Financës, për këto raste, të procedojë sipas kërkesave ligjore pranë Degës së Thesarit Fier për rimarrjen e fondeve të ngurtësuar dhe përdorimin e tyre në interes publik. **Nga verifikimi rezultoi se:** Nga Drejtoria e Financës/Bashkia Patos u marrën masat dhe me shkresën nr. 2781 prot., datë 20.10.2023 i është dërguar Drejtorisë së Planifikimit Urban, Projekteve, Shërbimeve dhe Emergjencave civile lista e subjekteve si OE fitues në investimet e kryera nga Bashkia Patos, për të cilën iu është ngurtësuar 5% i garancisë. Pra **Rekomandimi 32.2/8.1** (i njëjtë me **Rekomandimin 32.1/7.1**) është pranuar nga subjekti dhe pjesërisht zbatuar.

11.1. Drejtoria e Shërbimit të marri masa të menjëhershme deri në vjeljen përfundimtare të kësaj tarife, për të gjitha subjektet që ushtrojnë aktivitet në tregtimin e karburanteve për konsumatorët fundorë në këtë bashki.

Nga verifikimi rezultoi se: Drejtoria e të Ardhurave Vendore/Bashkia Patos ka marrë masat duke verifikuar në terren statusin e subjekteve që tregëtojnë me pakicë karburante për automjetet, vajra lubrifikante dhe lëndë djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë referuar licencave të lëshuara nga Bashkia Patos. Pra **Rekomandimi 32.2/11.1** (i njëjtë me **Rekomandimin 32.1/6.1**) është pranuar nga subjekti, pjesërisht zbatuar dhe në proces zbatimi.

12.1. Bashkia Patos të marrë masa të menjëhershme deri në vjeljen përfundimtare të taksës së ndikimit në infrastrukturë në vlerën 13,309,757 lekë, për të gjitha subjektet dhe familjarët që janë pajisur me leje legalizimi nga zyra e ALUIZN-it.

Nga verifikimi rezultoi se: Nëpërmjet shkresës nr. 3165 prot. datë 22.12.2022 drejtuar ASHKDV Fier bashkëpunim për të siguruar vjeljen e TNI nga ana e Bashkisë Patos. Pra **Rekomandimi 32.2/12.1** (i njëjtë me **Rekomandimin 32.2/1.1**) është pranuar nga subjekti, pjesërisht zbatuar dhe në proces zbatimi.

13.1. Nga Bashkia Patos të marri masa të menjëhershme për arkëtimin e vlerës 29,803,435 lekë për taksat e tarifave vendore për familjarët, për lidhjen e kontratave të qirasë përpara noterit e taksave vendore nga

bizneset. Bashkia Patos të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme ligjore për vjeljen e detyrimeve të subjekteve debitorë, siç parashikohet në Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 i ndryshuar, neni 93 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë".

Nga verifikimi rezultoi se: Drejtoria e të Ardhurave e Tarifave Vendore/Bashkia Patos ka ndjekur hapat administrativë por jo ato ligjore për arkëtimin e detyrimeve të prapambetura dhe vjeljen brenda vitit të taksave e tarifave vendore. Pra **Rekomandimi 32.2/13.1** (i njëjtë me **Rekomandimin 32.1/5.1**) është pranuar nga subjekti, pjesërisht zbatuar dhe në proces zbatimi.

-Për 5 masa për shpërblim dëmi në vlerën 2.668,052 lekë të cilat nuk janë zbatuar.

1.1. Nga Bashkia Patos të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 161,000 lekë pa Tvsh nga BOE "E" Shpk & "F" Shpk & "A" Shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 683/14 prot., datë 03.11.2016, me objekt: "Rikualifikimi urban i shëtitorës Republika", Bashkia Patos, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Nga verifikimi rezultoi se: Nga Bashkia Patos lidhur me rekomandimin e lënë për arkëtimin e shumës 161,000 lekë nga BOE "E" Shpk & "F" Shpk & "A" Shpk, rezulton se është bërë arkëtimi në masë të plotë i vlerës në Bankën Kombëtare Tregtare nr. 153 datë 02.09.2022. Pra **Rekomandimi 32.2/1.1** është pranuar nga subjekti dhe është zbatuar.

3.1. Nga Bashkia Patos, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 1,321,591 lekë pa Tvsh nga OE "G" Shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1718/10 prot., datë 20.04.2018, me objekt: "Rikonstruksion i rrugës Unaza", Bashkia Patos, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e likuidimit dy herë për trajtimin e dubluar "Spërkatje me emulsion bituminoz 0.5 l/m²".

Nga verifikimi rezultoi se: Lidhur me Rekomandimin e lënë, për mosnjohje të detyrimit nga ana e OE "G" Shpk, OE dorëzoi në gjykatë kërkesë padi, e cila u trajtua dhe Vendimi nr. 174 datë 09.03.2020 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë është shprehur në favor të OE "G" Shpk. Bashkia Patos ka ankimuar këtë vendim në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë me nr. 3395/5 prot., datë 29.06.2020. Deri tani për këtë çështje nuk ka dalë vendim. Pra **Rekomandimi 32.2/3.1** është pranuar nga subjekti dhe pjesërisht zbatuar.

4.1. Nga Bashkia Patos, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 664,600 lekë pa Tvsh nga BOE "S" Shpk & "J" Shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 829/16 prot., datë 31.08.2017, me objekt: "Rikonstruksioni i rrugës Unazë-Grizë Velaj", vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Nga verifikimi rezultoi se: Ky pretendim i është nënshtruar procesit gjyqësor, pasi BOE "S" Shpk dhe "J" Shpk nuk e kanë njohur detyrimin prej 664,600 lekë; Vendimi nr. 78 datë 08.02.2023 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, është shprehur në favor të Bashkisë Patos. Pra **Rekomandimi 32.2/4.1** është pranuar nga subjekti dhe është pjesërisht zbatuar.

6.1. Nga Bashkia Patos, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 176,862 lekë pa Tvsh nga OE "SH" Shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1636/12 prot., datë 12.09.2018, me objekt: "Ndërtim trotuari përgjatë rrugës Nacionale Fier-Berat (në fshatin Zharrës) si dhe ndërtimi i dy urave për këmbësorë në krah të urës së automjeteve", Bashkia Patos, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Nga verifikimi rezultoi se: Lidhur me këtë rekomandim, OE "SH" Shpk e ka njohur detyrimin dhe e ka bërë pagesën në masë të plotë të detyrimit prej 176,862 lekë në datën 03.09.2020. Pra **Rekomandimi 32.2/6.1** është pranuar nga subjekti dhe është zbatuar.

7.1. Bashkia Patos, Drejtoria e financës, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e shumës 343,999 lekë si sigurim kontrate OE "S" Shpk të shpallur fitues për procedurën e prokurimit me objekt: "Blerje mjet makine vetëshkarkuese", bazuar kjo në LPP dhe të Udhëzimit nr. 914, datë 29.12.2014, neni 24.

Nga verifikimi rezultoi se: Nga Bashkia Patos për shkak të mosnjohjes së detyrimit nga OE “S” Shpk, u dorëzua në Gjykatë Kërkesë padia e cila në përfundim të gjykimit të çështjes, zbardh Vendimin nr. 78 datë 08.02.2023 në favor të Bashkisë Patos. Nga ana e tij OE “S” Shpk ka apeluar Vendimin. Me daljen e vendimit të Gjykatës së Apelit, do arkëtohet dhe shuma e pretenduar. Pra ***Rekomandimi 32.2/7.1*** është pranuar nga subjekti dhe është pjesërisht zbatuar.

-Për 1 masë për uljen e borxhit tatimor duke rritur performancën në arkëtimin e detyrimeve për tatim taksat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia e tokave bujqësore, taksa e ndikimit në infrastrukturë (Të ardhura të munguara) në vlerën 42,732,889 lekë e cila nuk është zbatuar.

1.1. Bazuar në nenin 91-93 pika 1 “Masa e sigurimit të detyrimit tatimor”, “Sekuestrimi dhe konfiskimi i pasurisë” të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nga Drejtoria e Tatim Taksave Bashkia Patos të merren masa për të zbatuar të gjitha etapat për arkëtimin e detyrimeve për vlerën 42.732,889 lekë, si më poshtë:

-Të arkëtohet vlera prej 13,309,757 lekë sipas VKM. nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim”, pika 5, si dhe ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, pika 3 e nenit 27- Taksa e ndikimit në infrastrukturë, për objektet që legalizohen.

Të ndiqen rrugët e mëposhtme:

a-Të ndiqen të gjitha etapat sipas kërkesave të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, nenet 91-93 (Sektori i Taksave dhe Drejtoria Juridike).

b- Bashkia Patos, nëpërmjet Drejtorisë së Planifikimit, Zhvillimit dhe Mbrojtjes së Territorit të marrë masa si dhe të ndjek të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet pa leje në vlerën prej 13,309,757 lekë.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi se: Nga Drejtoria e Planifikimit Urban, Projekttimeve, Shërbimeve janë marrë masat për arkëtimin e TNI nëpërmjet rrugëve administrative, por nuk ka ndërmarë hapa ligjorë. Pra ***Rekomandimi 32.2/1.1*** (i njëjtë m e ***Rekomandimin 32.1/12.1***) është pranuar nga subjekti, pjesërisht zbatuar dhe në proces zbatimi.

C. Masa për shpërblim dëmi

KLSH i ka rekomanduar Nëpunësi zbatues të ndjekë procesin dhe të kryej regjistrimet e nevojshme kontabël përfundimtare, me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën 2,081,633 lekë, si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt: “Sistemimi i hapësirave, Lagjja “29 Marsi”, Blloku Zjarrëfiksja”, Bashkia Patos, me vlerë të kontratës 48,994,499 lekë me Tvsh, realizuar nga BOE “M” Shpk & “L” Shpk, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 96,532 lekë pa Tvsh. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 851/15 prot., datë 03.08.2021, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Patos dhe BOE “M” Shpk & “L” Shpk. (Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.4.1, faqe 121-131 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Patos të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 96,532 lekë pa Tvsh nga BOE “M” Shpk & “L” Shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 851/15 prot datë 03.08.2021, me objekt “Sistemimi i hapësirave, Lagjja “29 Marsi”, Blloku Zjarrëfiksja”, Bashkia Patos, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

Nga verifikimi rezultoi se: Drejtoria e Financës/Bashkia Patos ka dërguar njoftimin për shlyerje detyrimi me nr. 2312 prot., datë 06.09.2023 BOE “M” Shpk & “L” Shpk, me nr. 2312/1 prot., datë 14.09.2023 dhe me nr. 2312/2 prot., datë 09.10.2023, për njohjen dhe pagesën e detyrimit prej

96,532 lekë. Deri tani nga BOE “M” Shpk & “L” Shpk nuk është bërë asnjë arkëtim për llogari të Bashkisë Patos. Pra **Rekomandimi 1.1** është pranuar nga subjekti dhe është pjesërisht zbatuar.

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt: “Rikonstruksion dhe shtrim me asfaltobeton i rrugës Fshati i Ri - Sheqishtë”, me vlerë të kontratës (me tvsh) 17,564,628 lekë, realizuar nga OE “A” Shpk, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 754,952 lekë pa Tvsh. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 1673/19 prot., datë 05.10.2022, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Patos dhe OE “A” Shpk. (Më hollësisht trajtuar në nën pikën 2.4.1, faqe 121-131 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Patos të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 754,952 lekë pa Tvsh nga OE “A” Shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1673/19 prot., datë 05.10.2022, me objekt: “Rikonstruksion dhe shtrim me asfaltobeton i rrugës Fshati i Ri - Sheqishtë”, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

Nga verifikimi rezultoi se: Drejtoria e Financës/Bashkia Patos ka dërguar njoftimin për shlyerje detyrimi me nr.2311 prot., datë 06.09.2023 dhe me nr. 2311/1 prot., datë 10.10.2023 OE “A” Shpk, për njohjen dhe arkëtimin e detyrimit në vlerën prej 754,952 lekë për llogari të Bashkisë Patos. Nga OE nuk u njoh ky detyrim, i cili nga ana e vet ka dorëzuar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Lushnje kërkesë padinë nr.1818 datë 22.01.2024 mbërritur në Bashkinë Patos me nr. 271 pot., datë 29.01.2024. Bashkia Patos ka reaguar me shkresën nr. 271/3 prot., datë 05.02.2024 me objekt “Prapsimet dhe aktet shkresore për kërkesë padinë me nr. 1818 datë 19.01.2024. Pra **Rekomandimi 2.1** është pranuar nga subjekti dhe në proces zbatimi.

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt: “Rikonstruksion i segmentit Hekuran Melova, degëzimi i rrugës “Late Bregu” tek pallatet dykatëshe”, me vlerë të kontratës 30,588,573.6 lekë me Tvsh, realizuar nga OE “C” Shpk, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 481,563 lekë pa Tvsh. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 2324/57 prot., datë 19.09.2022, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Patos dhe OE “C” Shpk. (Më hollësisht trajtuar në nën pikën 2.4.1, faqe 121-131 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Patos të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 481,563 lekë pa Tvsh nga OE “C” Shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 2324/57 prot., datë 19.09.2022, me objekt “Rikonstruksion i segmentit Hekuran Melova, degëzimi i rrugës “Late Bregu” tek pallatet dykatëshe”, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

Nga verifikimi rezultoi se: Drejtoria e Financës/Bashkia Patos ka dërguar njoftimin për shlyerje detyrimi me nr.2310 prot., datë 06.09.2023 dhe nr. 2649 prot., datë 09.10.2023 OE “C” Shpk për njohjen dhe pagesën e detyrimit prej 481,563 lekë. Deri tani nga OE nuk është kryer asnjë arkëtim për llogari të Bashkisë Patos. Pra **Rekomandimi 3.1** është pranuar nga subjekti dhe pjesërisht zbatuar.

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt: “Rikonstruksion i shkollës “Mustafa Matohiti””, Bashkia Patos, me vlerë të kontratës 85,964,816 lekë pa Tvsh, realizuar nga BOE “G” Shpk & “A” Shpk & “SH” Shpk, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 748,586 lekë pa Tvsh. Veprimet e mësipërme janë në

kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 1067/19 prot., datë 24.09.2019, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Patos dhe BOE “G” Shpk & “A” Shpk & “SH” Shpk. (Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.4.1, faqe 121-131 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Patos të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 748,586 lekë pa tvsh nga BOE “G” ShPK & “A” ShPK & “SH” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1067/19 prot., datë 24.09.2019, me objekt “Rikonstruksion i shkollës “Mustafa Matohiti”, Bashkia Patos, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

Nga verifikimi rezultoi se: Nga Bashkia Patos për të zbatuar rekomandimin e lënë, janë marrë masat për njoftimin e BOE “G” ShPK & “A” ShPK & “SH” ShPK me nr. 2309 prot., datë 06.09.2023 dhe me nr. 2309/1 prot., datë 10.10.2023 për njohjen dhe arkëtimin e detyrimit prej 748,586 lekë për llogari të Bashkisë Patos; pas mosnjohjes së detyrimit nga BOE “G” ShPK & “A” ShPK & “SH” SHPK Bashkia Patos i është drejtuar Gjykatës Administrative së Shkallës së Parë Lushnje me kërkesë- padinë nr. 2309/2 prot., datë 23.10.2023 me objekt padie “shpërblim dëmi”. Pritet dalja e Vendimit të Gjykatës Administrative së Shkallës së Parë Lushnje. Pra Rekomandimi 4.1 është pranuar nga subjekti dhe në proces zbatimi.

D. Masa për uljen e borxhit tatimor për rritur performancën në arkëtimin e detyrimeve për tatim taksat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia (të ardhura të munguara).

Për shpenzime në kundërshtim me principet e 3 E-të dhe të ardhura të munguara janë rekomanduar dhe pranuar 7 masa në vlerën totale 167,477,530 lekë deri në 31.12.2022, nga të cilat 6 masa në vlerën totale 165,479,282 lekë janë pjesërisht dhe në proces zbatimi, 1 masë në vlerën 1,963,641 lekë është pa zbatuar.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i të dhënave në lidhje me detyrimet e tatimpaguesit që kanë ndaj Bashkisë Patos konstatohet se deri më datën 31.12.2021, borxhi tatimor është në vlerën 91,459,528 lekë. Përgjatë periudhës nga data 01.01.2022 deri më 31.12.2022, është krijuar borxhi tatimor në vlerën 33,236,601 lekë. Në total detyrimet për taksat dhe tarifatat vendore në mënyrë progresive më datën 31.12.2022, në Bashkinë Patos janë në vlerën 124,696,129 lekë, e cila konsiderohet detyrim i pa arkëtuar nga debitorët (e ardhur e planifikuar por e pa arkëtuar) për buxhetin e Bashkisë Patos e përbëra nga:

- Detyrimet për taksën e tokës bujqësore në vlerën 53,023,566 lekë për 2,618 familje;
- Detyrimet për taksën e ndërtesës në vlerën 22,921,574lekë për 5,357 familje;
- Detyrimet për taksën e pastrimit në vlerën 34,064,516 lekë për 5,357 familje;
- Detyrimet për tarifën e shërbimit komunitar në vlerën 3,195,792 lekë për 5,357 familje;
- Detyrimet për tarifën e vaditjes dhe kullimit në vlerën 2,557,411 lekë për 657 familje;
- Detyrime nga biznesi i vogël në vlerën 7,383,601 lekë;
- Detyrime nga biznesi i madh në vlerën 1,549,669 lekë.

Lidhur me hapat që janë ndjekur për të mbledhur detyrimet për taksat dhe tarifatat vendore në Bashkinë Patos konstatohet se, të gjitha bizneset debitorë janë njoftuar për kalimin e afatit për pagesat vendore. Pas dërgimit të njoftimeve, për subjektet që kanë vazhduar të rezultojnë debitorë për detyrimet vendore nuk janë marrë masa të tjera ligjore. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Kreu XI “Mbledhja me force e detyrimeve tatimore të papaguara”, nenet 88-104, neni 114, Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, neni 9, pika 1.3, Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, “Për financat e qeverisjes vendore”, neni 35, dhe Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, neni 3, pikat 9-10. Ligjin nr. 68/2017, “Për financat

e qeverisjes vendore”, neni 35 “Të ardhurat që rrjedhin nga burimet e veta vendore”. (Më hollësisht trajtuar në nën pikën 2.2, faqe 28-50 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1. Rekomandimi: Bashkia Patos, Drejtoria e të Ardhurave Vendore të marrë masa për nxjerrjen e njoftimit të vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore deri më datën 31.12.2022, në vlerën totale 124,696,129 lekë, e cila përbëhet nga:

-53,023,566 lekë detyrime për taksën e tokës bujqësore për 2,618 familje;

-22,921,574 lekë detyrime për taksën e ndërtesës për 5,357 familje;

-34,064,516 lekë detyrime për taksën e pastrimit për 5,357 familje;

-3,195,792 lekë detyrime për tarifën e shërbimit komunitar për 5,357 familje;

-2,557,411 lekë detyrime për tarifën vaditje dhe kullimi për 657 familje;

-7,383,601 lekë detyrime nga biznesi i vogël;

-1,549,669 lekë detyrime nga biznesi i madh;

a. T’u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimet e llogarive bankare.

b. Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme).

c. Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, Drejtoria e të Ardhurave Vendore, të angazhohet për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar.

d. Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, nga ana e Drejtorisë së të Ardhurave Vendore të merren masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal.

e. Drejtoria e të Ardhurave Vendore të bashkërendojë punën me QKB Bashkia Patos, për mos kalimin e subjekteve debitorë me status pasiv ose mbyllje dhe lejimin e tyre në debitorë të keq.

f. Në regjistrat e debitorëve, të evidentohen vlera e detyrimit të pa arkëtuar, statusi i tyre dhe hapat e ndërmarra për çdo subjekt në zbatim të ligjit për arkëtimin e debitorëve.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi se: Drejtoria e të Ardhurave Vendore/Bashkia Patos ka marrë masat dhe nëpërmjet shkresave: nr. 3412 prot., datë 20.12.2023 dërguar të gjitha bankave të nivelit të dytë Fier; nr. 3410 prot., datë 20.12.2023 drejtuar ASHKDV Fier; nr. 3411 prot., datë 20.12.2023 drejtuar DRSHTRR Fier për vendosje sekuestro konservative llogarive bankare të debitorëve, pronave të luajtshme dhe të paluajtshme në pronësi të debitorëve sipas listës bashkëngjitur shkresave. Nga informacioni i pasqyruar në tabelë, rezulton se edhe me masat e marra pavarësisht arkëtimeve të debitorëve, janë krijuar debitorë të rinj duke e çuar numrin total të tyre në fund të vitit 2023 me 19,688 ose 274 më shumë; vlera e debisë nga 122,172,729 lekë në mbyllje të vitit 2022 në 160,266,603 lekë në mbyllje të vitit 2023 ose 38,093,874 lekë më shumë. Pra ***Rekomandimi 1.1*** (i njëjtë me ***Rekomandimin 32.1/3.1*** dhe ***Rekomandimin 32.1/5.1***) është pranuar nga subjekti, pjesërisht zbatuar dhe në proces zbatimi.

Lloji i taksës/tarifës	Numri i familjeve debitore deri në 31.12.2022	Arkëtimet nga debitorët gjatë 2022	Vlera e debisë deri në 31.12.2022	Numri i familjeve debitore deri në 31.12.2023	Arkëtimet gjatë 2023	Vlera e debisë deri në 31.12.2023
Taksa toka bujqësore	2618	4,299,877	53,023,566	2,644	9,082,163	65,361,403
Taksa e ndërtesës	5357	2,017,346	22,921,574	5,414	5,248,254	28,831,319
Taksa e pastrimit	5357	2,907,700	34,064,516	5,414	10,175,269	47,726,247
Tarifa e shërbimit komunitar	5357	824,870	3,195,792	5,414	1,142,525	7,079,267
Tarifa vaditje /kullim	657	145,252	2,557,411	722	648,460	2,788,951
Biznesi i vogël	63	537,003	5,301,120	75	1,231,816	6,999,779
Biznesi i madh	5	40,120	1,108,750	5	0	1,479,637
Totali	19,414	10,772,168	122,172,729	19,688	27,528,487	160,266,603

2. Gjetje nga auditimi: Bashkia Patos ka të mbartura nga ish-komuna Ruzhdie 65 kontrata me persona fizikë për qiradhënie të tokave bujqësore, të cilat janë lidhur përgjatë viteve 2009-2012. Detyrimi për pagesën e qirasë së tokave bujqësore i komunikohet qiramarrësve nëpërmjet njoftimeve përkatëse të taksave dhe tarifave vendore, të cilat shpërndahen nga specialisti i taksave në NJA Ruzhdie. Megjithëse njoftimet bëhen çdo fillim viti dhe përsëri gjatë vitit, pagesat e tokës me qira nuk janë bërë në mënyrë të rregullt ku konstatohet se detyrimet deri më datën 31.12.2022, janë në vlerën 1,963,641 lekë e cila konsiderohet detyrim i pa arkëtuar nga debitorët për buxhetin e Bashkisë Patos. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 7850, datë 29.07.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, Ligjin nr. 48/2014, datë 24.04.2014, “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”, Ligjin nr. 7501, datë 19.07.1991, “Për tokën” i ndryshuar, Ligjin nr. 8312, datë 26.03.1998, “Për tokat bujqësore të pandara”, VKM nr. 531, datë 21.08.1998, “Për tokat bujqësore të pandara” i ndryshuar me VKM nr. 176, datë 30.03.2001, VKM nr. 373, datë 20.06.2018, “Për përcaktimin e kritereve, të rregullave, procedurave dhe kontratës tip për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit”, ku përcaktohet edhe Kontrata tip për t’u lidhur me qiramarrësit, përfshirë sanksionet, VKM nr. 54, datë 05.02.2014, “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, UKM nr. 1, datë 18.07.2012, “Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara”. (Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.2, faqe 28-50 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.2. Rekomandimi: Bashkia Patos, Drejtoria e të Ardhura Vendore të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e detyrimeve të papaguara nga dhënia me qira e tokave bujqësore në total në vlerën 1,963,641 lekë duke llogaritur dhe shtuar vlerën e kamatëvonesave për të gjitha rastet e detyrimeve të pa arkëtuara në afat.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi se: Nga Drejtoria e të Ardhurave Vendore/Bashkia Patos janë marrë masat duke përditësuar listën e debitorëve të krijuar nga mospagesa e taksës së tokës bujqësore individëve me të cilët është lidhur kontratë qiradhënieje. Lista përmban 67 debitorë me informacionin si në tabelën mëposhtë:

Nr.i familjeve që kane marre tokë bujqësore me qira deri në 31.12.2022	Numri i debitorëve t tokës bujqësore me qira deri në 31.12.2022	Debia vetem për vitin 2022	Nr.i familjeve që kanë marrë tokë bujqësore me qira deri në 31.12.2023	Numri i debitorëve te tokës bujqësore me qira deri ne 31.12.2023	Debia vetëm për vitin 2023	Debia progresive deri në 31.12.2023
67	37	278,823	67	52	381,099	1,998,248

Rezulton se nuk janë dërguar njoftime qiramarrësve të tokës bujqësore, ku të njihen me vlerën e debisë që duhet paguar nga ana e tyre. Kështu deri në 31.12.2023 numri i debitorëve është rritur nga 37 në 52 debitorë, duke e çuar vlerën progresive të debisë në 1,998,248 lekë. Gjithashtu rezulton se nuk janë dërguar njoftimet në adresat e debitorëve, me arsyetimin se kanë emigruar. Pra **Rekomandimi 2.2** është pranuar nga subjekti dhe nuk është zbatuar.

3. Gjetje nga auditimi: Duke u bazuar në të dhënat që disponon Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore dhe Drejtoria e Planifikimit, Kadastrës dhe Kontrollit të Zhvillimit Urban në lidhje me pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë për legalizimin e ndërtimeve pa leje sipas listave të sjella nga Drejtoria Rajonale e Aluiznit Fier (ASHK), me shkresë të destinuar për regjistrim në ASHK Fier, deri më datën 31.12.2021, sipas listave për leje legalizimi dhe kryqëzimi i tyre me personat që kanë bërë të mundur likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturës konstatohet se nuk kanë kryer pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë për 1,524 persona në vlerën 33,340,042 lekë e cila konsiderohet detyrim i pa arkëtuar nga debitorët për Buxhetin e Bashkisë Patos. Për vitin 2022, nga Drejtoria e të Ardhurave Vendore dhe Drejtoria e Planifikimi, Kadastrës

dhe Kontrollit të Zhvillimit Urban nuk ka asnjë korrespondencë në formë shkresore me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës Drejtoria Vendore Fier në lidhje me taksën e ndikimit në infrastrukturë. Referuar aktrakordimeve me Degën e Thesarit Fier të ardhurat e realizuara për taksën e kalimit të së drejtës së pronësisë së paluajtshme për periudhën janar-dhjetor 2022 janë në vlerën 0 lekë. Gjithashtu nuk disponohet lista emërore sipas banesave të legalizuara në territorin e bashkisë për vitin 2022 për kalimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë. Grupi i auditimit më datë 28.02.2023, bërë kërkesë për informacion drejtuar Drejtorisë së të Ardhurave Vendore dhe Drejtorisë së Planifikimit, Kadastrës dhe Kontrollit të Zhvillimit Urban për arkëtimet dhe detyrimet ndaj Bashkisë për taksën e ndikimit në infrastrukturë. Në lidhje me këtë situatë Bashkia Patos me shkresën nr. 636 prot., datë 28.02.2023, është drejtuar ASHK Fier. Deri më datën 24.03.2023, nga ASHK Fier nuk ka asnjë përgjigje zyrtare. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, neni 27, pika “d”, Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 27, pika 2.1, dhe VKM nr. 860, datë 10.12.2014, “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim” i ndryshuar, pika 5. (Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.2, faqe 28-50 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1. Rekomandimi: Bashkia Patos, Drejtoria e të Ardhurave Vendore dhe Drejtoria e Planifikimi, Kadastrës dhe Kontrollit të Zhvillimit Urban duke ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet pa leje në vlerën 33,340,042 lekë ndaj 1,524 persona.

3.2. Rekomandimi: Bashkia Patos, Drejtoria e të Ardhurave Vendore dhe Drejtoria e Planifikimi, Kadastrës dhe Kontrollit të Zhvillimit Urban të vazhdojë korrespondencën zyrtare me ASHK Fier në lidhje me situatën debitore nga taksa e ndikimit në infrastrukturë për vitin 2022.

Brenda datës 31.12.2023

Nga verifikimi rezultoi se: Drejtoria e të Ardhurave Vendore në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikimit, Kadastrës Kontrollit të Zhvillimit Urban, kanë patur korrespondencë të vazhdueshme me ASHKDV Fier për informacion të detajuar mbi listën e përfituesve nga leje legalizimet, për të llogaritur sakt vlerën e TNI si dhe marrjen e masave shtrënguese për arkëtimin e detyrimeve të prapambetura. Kështu nëpërmjet lëshimit të Urdhër bllokimit nr. 3412 prot., datë 20.12.2023 të llogarive bankare të debitorëve në të gjitha bankat e nivelit të dytë Fier; kontabilizimin e vlerës reale të tyre; shkresat dërguar ASHKDV Fier janë: nr. 3165 prot., datë 22.12.2022 dhe nr. 3410 prot., datë 20.12.2023. Rezulton se nga Bashkia Patos nuk janë njoftuar debitorët sipas listës së ASHKDV Fier dhe se informacioni përmbledhës deri në 31.12.2023 është si në tabelën më poshtë:

Lloji i taksës/tarifës	Numri i familjeve debitore deri në 31.12.2022	Vlera e debisë deri në 31.12.2022	Arkëtimet nga debitorët e 2022 gjatë 2023	Arkëtimet total gjatë 2023	Numri i familjeve debitore deri në 31.12.2023	Vlera e debisë deri në 31.12.2023
TNI	1112	33,340,042	0	0	1158	39,904,291

Pra ***Rekomandimi 3.1*** (i njëjtë me ***Rekomandimin 32.2/1.1***, ***Rekomandimin 32.1/12.1***, ***Rekomandimin 32.1/5.1*** dhe ***Rekomandimin 32.1/3.1***) është pranuar nga subjekti, pjesërisht zbatuar dhe në proces zbatimi.

Nga verifikimi rezultoi se: Nga Drejtoria e të Ardhurave Vendore në vijim të shkresës nr. 3165 prot., datë 22.12.2022, ka patur një korrespondencë të vazhdueshme me ASHKDV Fier lidhur me listën emërore të personave të pajisur me leje legalizimi dhe për taksën e kalimit të së drejtës së pronësisë, në rolin e agjentit tatimor. Bashkia Patos ka nisur shkresat: nr. 636 prot., datë 28.02.2023

dhe atë nr. 636/1 prot., datë 11.04.2023. Nga ana e saj ASHKDV Fier nuk ka reaguar me korrektësi ndaj shkresave të dërguara nga Bashkia Patos. Kështu ASHKDV Fier ka kthyer përgjigje nëpërmjet shkresave: nr. 1665/1 prot., datë 23.03.2023 (përgjigje e pjesshme, vetëm për listën e legalizimeve gjatë vitit 2022); nr. 3911 prot., datë 20.06.2023 “lista e legalizimeve për periudhën 01.01.2023-26.05.2023”; nr. 3922 prot., datë 20.06.2023 “lista e legalizimeve për periudhën 01.01.2022-31.12.2022. Lidhur me taksën e kalimit të së drejtës së pronësisë nuk ka asnjë informacion, asnjë arkëtim , asnjë sqarim nga ana e ASHKDV Fier. Pra **Rekomandimi 3.2** është pranuar nga subjekti dhe është pjesërisht zbatuar.

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i tarifave vendore për subjektet që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre u konstatua se ka mangësi në plotësimin e të dhënave të këtyre subjekteve në përgjithësi dhe debitorëve në veçanti, si në krijimin e një regjistri të posaçëm për këto lloj subjektësh, në evidentimin e subjekteve që vërtet e ushtrojnë këtë lloj aktiviteti dhe në mbledhjen e detyrimeve specifike për këto kategori biznesi.

Nga të dhënat e paraqitura nga Drejtoria e të Ardhurave Vendore si dhe nga verifikimi në faqen e internetit të Qendrës Kombëtare të Biznesit u konstatua se në Bashkisë Patos figurojnë rreth 13 subjekte me aktivitet në territorin e Bashkisë Patos dhe në NJA Zharrëz të cilat tregtojnë me pakicë hidrokarbure dhe nënproduktet e tyre.

Nga auditimi i kësaj kategorie të bizneseve në lidhje me pajisjen me lejet përkatëse të tregtimit dhe pagesat e tyre u konstatua se 13 subjekte janë pajisur me autorizim të cilat janë përpara objekt auditimi konkretisht: 12 subjekt për tregtim karburanti dhe 1 subjekt tregtim me shumicë të hidrokarbureve dhe nënprodukteve të tyre.

Në total nga 13 subjekte të cilat kanë ushtruar aktivitetin deri më datë 31.12.2022, pesë prej tyre kanë ende pa likuiduar detyrimin në vlerën 5,350,000 lekë e cila konsiderohet e detyrim i pa arkëtuar nga debitorët për buxhetin e Bashkisë Patos. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 35, VKM nr. 170, datë 25.04.2002, “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, Kapitulli II dhe III, pika 4, dhe VKM nr. 970, datë 02.12.2015, “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar, Kapitulli II, pika 1, gërma “b”, dhe pika 9, ndryshuar me VKM nr. 344, datë 19.04.2017, Kapitulli II, pika 1, gërma “b” dhe pika 9 dhe 15. (Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.2, faqe 28-50 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Patos, Drejtoria e Hartimit të Projekteve, Monitorimit të Investimeve dhe Shërbimeve të merren masa për të pajisur subjektet me licenca për tregtimin me pakicë të karburanteve për automjetet, vajrave lubrifikanëte dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë dhe të arkëtojnë tarifën e plotë për subjektet që kanë bërë pagesa pjesore për pajisje me autorizime, për shumën debitorë prej 5,350,000 lekë. Në rastet kur këto subjekte nuk paraqiten për licencim apo për arkëtimin e plotë të tarifës së licencë/autorizimit në bashkëpunim me Inspektoratin Shtetëror Teknik të ndërmerren veprime administrative e ligjore deri në mbylljen e aktivitetit të këtyre subjekteve.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi se: Nga Drejtoria e Hartimit të Projekteve, Monitorimit të Investimeve dhe Shërbimeve dhe Drejtoria e të Ardhurave Vendore janë marrë masat duke verifikuar në terren statusin e subjekteve që tregëtojnë me pakicë karburante për automjetet, vajra lubrifikante dhe lëndë djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë referuar licencave të lëshuara nga Bashkia Patos dhe ka mundur të arkëtojnë detyrimin e papaguar. Pra **Rekomandimi 4.1** (i njëjtë me

Rekomandimin 32.1/6.1 dhe Rekomandimin 32.2/11.1) është pranuar nga subjekti, pjesërisht zbatuar dhe në proces zbatimi. Gjendja në fund të vitit 2023 është si mëposhtë:

Numri i subjekteve total	Të pajisur me licencë	Të papajisur me licencë	Pagesa të kryera	Detyrimi i mbetur
12	11	1	7,650,000	5,350,000

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i të dhënave të pasqyruara në AKBN konkretisht Regjistrin e Lejeve Minerare, Drejtorinë Rajonale të Fier, Qendrës Kombëtare të Biznesit konstatohet se për vitin 2022, në territorin e Bashkisë Patos ushtrojnë aktivitet subjektet si më poshtë:

1. Subjekti “A” Shpk (me Nipt L...E) i regjistruar në AKBN i pajisur me lejen nr. 1736, datë 23.12.2014, për shfrytëzimin e vendburimit Zharrëz për llojin e mineralit kongomeratë me sipërfaqe 0.428 km².

2. Subjekti “C” Shpk (me Nipt K...D) i regjistruar në AKBN i pajisur me lejen nr. 1356, datë 04.06.2009, për shfrytëzimin e vendburimit Kasnicë, Fier për llojin e mineralit rërë bituminoze me sipërfaqe 0.39 km². Deri më datën 31.12.2022, Subjekti “C” Shpk, ka detyrime të pa paguar të cilat lindin nga kontrata e qirasë me nr. 3113/1 prot., datë 28.12.2018, në vlerën 2,327,718 lekë e cila konsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Patos.

-Gjithashtu në Bashkinë Patos dy subjektet që ushtrojnë aktivitet shfrytëzimi konkretisht për rërë bituminoze dhe konglomeratë nuk ka të miratuar me VKM apo ligj të veçantë heqjen nga fondi pyjor/ndryshimi i zërit kadastral i sipërfaqeve të miratuara referuar lejeve të AKBN-së. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 10 304, datë 15.07.2010, “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, neni 15, pika 5, neni 24, pika 10, Ligji nr. 9385, datë 04.05.2005, “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar, pika 6 e nenit 17, të Ligjin nr. 9693, datë 19.03.2007, “Për fondin kullor”, pikat 3, 7, 7, 9, 10, 11 dhe 12, VKM nr. 1353, datë 10.10. 2008, “Për rregullat për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor” i ndryshuar me VKM nr. 434, datë 08.06.2016, VKM nr. 1374, datë 10.10.2008, “Për rregullat dhe procedurat qe ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullor” i ndryshuar me VKM nr. 435, datë 08.06.2016, dhe VKM nr. 391, datë 21.06.2006, i ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010, “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”, lidhja nr. 2, pikat 6.1 dhe pika 9.2.3.4. (Më hollësisht trajtuar në nënpikën 2.2, faqe 28-50 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1. Rekomandimi: Bashkia Patos, Drejtoria e Zhvillimit, Bujqësor, Blegtorial, Pyjor Mjedisit dhe Kontrollit të Ushqimit të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e detyrimeve në vlerën 2,327,718 lekë të papaguara ndaj Subjektit “C” Shpk sipas kontratës së qirasë me nr. 3133/1 prot., datë 28.12.2018, për shfrytëzimin e vendburimit Kasnicë, Fier për llojin e mineralit rërë bituminoze me sipërfaqe 0.39 km².

5.2. Rekomandimi: Bashkia Patos, Drejtoria e Zhvillimit, Bujqësor, Blegtorial, Pyjor. Mjedisit dhe Kontrollit të Ushqimit të marrë masa të menjëhershme ku t’i kërkojë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, që të marrë masa për evidentimin e sipërfaqeve të shfrytëzueshme nga subjektet private, duke zbritur nga fondi pyjor dhe kullor këto sipërfaqe, si dhe të hartojë bilancin e përgjithshëm të sipërfaqeve pyjore dhe kullorë të mbetura.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi rezultoi se: Shoqëria “C” Shpk ka lidhur kontratë qiraje me ish Komunën Ruzhdie, e cila për shkak të Reformës Administrative i ka kaluar nën juridiksion Bashkisë Patos. Për këtë arsye mes Bashkisë Patos dhe Shoqërisë “C” është lidhur kontrata e qirasë me nr. 3133/1 prot., datë 28.12.2018 dhe për shlyerjen e detyrimeve është nënshkruar një Akt marrëveshje nr. 3133/2 prot., datë 18.06.2019 e miratuar edhe me VKB, për shlyerjen me këste prej 200,000 lekë të detyrimit të akumuluar. Pas pagesës së këstit të parë, është pezulluar kontrata deri në regjistrimin e saj në pronësi të Bashkisë Patos. Nga Drejtoria e Planifikimit Urban, Projekteve, Shërbimeve

dhe Emergjencave Civile është aplikuar pranë ASHKDV Fier. Me regjistrimin e pronave të ish komunave në pronësi të Bashkisë Patos, do vijohet me arkëtimin e detyrimeve. Pra **Rekomandimi 5.1** është pranuar nga subjekti, pjesërisht zbatuar dhe në proces zbatimi.

Nga verifikimi rezultoi se: Drejtoria e Zhvillimit, Bujqësor, Blegtorial, Pyjor. Mjedisit dhe Kontrollit të Ushqimit/Bashkia Patos ka marrë masat duke i kërkuar informacion MIE nëpërmjet shkresës nr. 2750 prot., datë 17.10.2023 në zbatim të VKM nr. 888 datë 27.12.2022 “Për rastet e dhënies në përdorim dhe ndryshimet e kategorisë së përdorimit, procedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve dhe pakësimeve në volum nga fondi pyjor kombëtar apo zgjerimin e tyre”. Deri tani nga ana e MIE nuk është kthyer përgjigje, pasi edhe informacioni dokumentar i kërkuar është voluminoz. Pra **Rekomandimi 5.2** është pranuar nga subjekti, pjesërisht zbatuar dhe në proces zbatimi.

E. Masa disiplinore.

Bazuar në nenin 15, Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 57, 58 dhe 59, të Ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar me VKM nr. 115, datë 05.03.2014, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisioni disiplinor në shërbimin civil, i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Patos t’i kërkojë Komisionit Disiplinor pranë Institucionit, që bazuar në shkeljet e konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për çdo nëpunës të atakuar dhe të kryej marrjen e masave disiplinore përkatëse në proporcion me shkallën e shkeljes.

Bazuar në nenin 37 të Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996, “Kodi i punës në Republikën e Shqipërisë” dhe kontratën individuale të punës, pasi të jenë shqyrtuar dhe vlerësuar shkeljet e evidentuara, i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Patos, fillimin e dhënies së masave disiplinore për të gjithë punonjësit e konstatuar me përgjegjësi sipas çështjeve të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, në proporcion me shkallën e shkeljes.

Nga verifikimi rezultoi se: Bashkia Patos ka marrë masat për zbatimin e rekomandimit. Një informacion i detajuar mbi ecurinë e disiplinore pasqyrohet në tabelën më poshtë:

Emri Mbiemri	Urdhër i Titullarit	Noftimi për fillimin e ED	Procesverbali	Vendimi
Daniela Kukaj	Nr. 3051 Prot., dt. 17.11.2023	Nr. 3051/1 Prot., dt. 17.11.2023	Nr. 3051/2 Prot., dt. 24.11.2023	Nr. 3051/3 Prot., dt. 30.11.2023
Andon Kristo	Nr. 3052 Prot., dt. 17.11.2023	Nr. 3052/1 Prot., dt. 17.11.2023	Nr. 3052/2 Prot., dt. 24.11.2023	Nr. 3052/3 Prot., dt. 30.11.2023
Enrijada Rizaj	Nr. 3053 Prot., dt. 17.11.2023	Nr. 3053/1 Prot., dt. 17.11.2023	Nr. 3053/2 Prot., dt. 24.11.2023	Nr. 3053/3 Prot., dt. 30.11.2023
Ilva Shehu	Nr. 3054 Prot., dt. 17.11.2023	Nr. 3054/1 Prot., dt. 17.11.2023	Nr. 3054/2 Prot., dt. 24.11.2023	Nr. 3054/3 Prot., dt. 30.11.2023
Blerina Ferko	Nr. 3055 Prot., dt. 17.11.2023	Nr. 3055/1 Prot., dt. 17.11.2023	Nr. 3055/2 Prot., dt. 24.11.2023	Nr. 3055/3 Prot., dt. 30.11.2023
Arben Manoku	Nr. 3056 Prot., dt. 17.11.2023	Nr. 3056/1 Prot., dt. 17.11.2023	Nr. 3056/2 Prot., dt. 24.11.2023	Nr. 3056/3 Prot., dt. 30.11.2023
Migena Mërtiri	Nr. 3057 Prot., dt. 17.11.2023	Nr. 3057/1 Prot., dt. 17.11.2023	Nr. 3057/2 Prot., dt. 24.11.2023	Nr. 3057/3 Prot., dt. 30.11.2023
Ledio Çapo	Nr. 3058 Prot., dt. 17.11.2023	Nr. 3058/1 Prot., dt. 17.11.2023	Nr. 3058/2 Prot., dt. 30.11.2023	Nr. 3058/3 Prot., dt. 01.12.2023
Antonela Kola	Nr. 3059 Prot., dt. 17.11.2023	Nr. 3059/1 Prot., dt. 17.11.2023	Nr. 3059/2 Prot., dt. 30.11.2023	Nr. 3059/3 Prot., dt. 01.12.2023
Rushan Behari	Nr. 3060 Prot., dt. 17.11.2023	Nr. 3060/1 Prot., dt. 17.11.2023	Nr. 3060/2 Prot., dt. 30.11.2023	Nr. 3060/3 Prot., dt. 01.12.2023
Agim Lisi	-	Nr. 3061 Prot., dt. 17.11.2023	Nr. 3061/1 Prot., dt. 01.12.2023	Nr. 3061/2 Prot., dt. 04.12.2023
Anisa Petani	-	Nr. 3062 Prot., dt. 17.11.2023	Nr. 3062/1 Prot., dt. 01.12.2023	Nr. 3062/2 Prot., dt. 04.12.2023
Klaudio Alisiananaj	-	Nr. 3063 Prot., dt. 17.11.2023	Nr. 3063/1 Prot., dt. 01.12.2023	Nr. 3063/2 Prot., dt. 04.12.2023
Vnagjel Nushi	-	Nr. 3064 Prot., dt. 17.11.2023	Nr. 3064/1 Prot., dt. 01.12.2023	Nr. 3064/2 Prot., dt. 04.12.2023
Astrit Murati	Nr. 3169 Prot., dt. 05.12.2023	Nr. 3169/1 Prot., dt. 07.12.2023	Nr. 3169/2 Prot., dt. 14.12.2023	Nr. 3169/3 Prot., dt. 15.12.2023
Mitjon Nikolla	Nr. 3170 Prot., dt. 05.12.2023	Nr. 3170/1 Prot., dt. 07.12.2023	Nr. 3170/2 Prot., dt. 14.12.2023	Nr. 3170/3 Prot., dt. 15.12.2023
Florian Kita	Nr. 3171 Prot., dt. 05.12.2023	Nr. 3171/1 Prot., dt. 07.12.2023	Nr. 3171/2 Prot., dt. 14.12.2023	Nr. 3171/3 Prot., dt. 15.12.2023
Edona Beqaj	Nr. 3172 Prot., dt. 05.12.2023	Nr. 3172/1 Prot., dt. 07.12.2023	Nr. 3172/2 Prot., dt. 14.12.2023	Nr. 3172/3 Prot., dt. 15.12.2023
Nurkë Hazizaj	Nr. 3211 Prot., dt. 06.12.2023	Nr. 3211/1 Prot., dt. 06.12.2023	Nr. 3211/2 Prot., dt. 14.12.2023	Nr. 3211/3 Prot., dt. 15.12.2023
Juela Shpata	Nr. 3212 Prot., dt. 06.12.2023	Nr. 3212/1 Prot., dt. 06.12.2023	Nr. 3212/2 Prot., dt. 15.12.2023	Nr. 3212/3 Prot., dt. 18.12.2023
Mimoza Shtëmbari	Nr. 3213 Prot., dt. 06.12.2023	Nr. 3213/1 Prot., dt. 06.12.2023	Nr. 3213/2 Prot., dt. 15.12.2023	Nr. 3213/3 Prot., dt. 15.12.2023
Silvana Mici	Nr. 3214 Prot., dt. 06.12.2023	Nr. 3214/1 Prot., dt. 07.12.2023	Nr. 3214/2 Prot., dt. 15.12.2023	Nr. 3214/3 Prot., dt. 18.12.2023
Boreta Murati	Nr. 3215 Prot., dt. 06.12.2023	Nr. 3215/1 Prot., dt. 07.12.2023	Nr. 3215/2 Prot., dt. 14.12.2023	Nr. 3215/3 Prot., dt. 15.12.2023
Agim Muskaj	-	Nr. 3216 Prot., dt. 07.12.2023	Nr. 3216/1 Prot., dt. 18.12.2023	Nr. 3216/2 Prot., dt. 18.12.2023
Orges Golloshi	Nr. 3217 Prot., dt. 06.12.2023	Nr. 3217/1 Prot., dt. 13.12.2023	Nr. 3217/2 Prot., dt. 18.12.2023	Nr. 3217/3 Prot., dt. 19.12.2023
Xhevahire Gjoka	Nr. 3218 Prot., dt. 06.12.2023	Nr. 3218/1 Prot., dt. 07.12.2023	Nr. 3218/2 Prot., dt. 19.12.2023	Nr. 3218/3 Prot., dt. 20.12.2023
Erjon Qalliaj	Nr. 3219 Prot., dt. 06.12.2023	Nr. 3219/1 Prot., dt. 06.12.2023	Nr. 3219/2 Prot., dt. 18.12.2023	Nr. 3219/3 Prot., dt. 19.12.2023
Endrit Adushaj	Nr. 3220 Prot., dt. 06.12.2023	Nr. 3220/1 Prot., dt. 13.12.2023	Nr. 3220/2 Prot., dt. 18.12.2023	Nr. 3220/3 Prot., dt. 19.12.2023
Silvana Mustafa	Nr. 3221 Prot., dt. 06.12.2023	Nr. 3221/1 Prot., dt. 13.12.2023	Nr. 3221/2 Prot., dt. 18.12.2023	Nr. 3221/3 Prot., dt. 19.12.2023
Shkëlqim Beqiraj	Nr. 3222 Prot., dt. 06.12.2023	Nr. 3222/1 Prot., dt. 06.12.2023	Nr. 3222/2 Prot., dt. 15.12.2023	Nr. 3222/3 Prot., dt. 18.12.2023
Xhuljano Çollari	-	Nr. 3223 Prot., dt. 06.12.2023	Nr. 3223/2 Prot., dt. 21.12.2023	Nr. 3223/3 Prot., dt. 22.12.2023
Armado Gushi	-	Nr. 3224 Prot., dt. 06.12.2023	Nr. 3224/2 Prot., dt. 21.12.2023	Nr. 3224/3 Prot., dt. 22.12.2023

Rekomandimi për masë disiplinore është pranuar nga subjekti dhe është zbatuar.

IV GJETJE DHE REKOMANDIME

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Bashkia Patos, nuk ka ngritur një sistem efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke mos hartuar një kuadër të plotë rregullash të shkruara për këtë qëllim. Për periudhën objekt auditimi për komponentët e MFK rezultoi se: Nuk ka krijuar struktura organizative mbi bazën e një analize të mirëfilltë të veprimtarisë së deritanishme në raport me kompetencat ligjore ndaj komunitetit, nuk janë hartuar dhe miratuar gjurmët standarde të auditimit, nuk ka përditësuar Rregulloren e brendshme sipas strukturave organizative të miratuara, nuk ka hartuar Listën (hartën)/manualin e proceseve të punës, nuk ka politika dhe praktika që të garantojnë ruajtjen dhe zhvillimin e kompetencave profesionale të stafit, duke mos hartuar dhe zhvilluar edhe programe trajnimesh në njësinë vendore për ngritjen dhe zhvillimin profesional të stafit; Grupi i Menaxhimit Strategjik, nuk ka miratuar plane zhvillimi strategjike me afat jo më pak se 5 vjet, plane dhe raporte vjetore mbi problematikat e hasura dhe zgjidhjen që iu është dhënë gjatë veprimtarisë së njësisë publike; menaxhimi dhe mirëmbajtja e sistemeve dhe programeve IT, nuk bëhet sipas kërkesave dhe standardeve ligjore në fuqi dhe paraqet risk në komprometimin e të dhënave që këto sisteme ruajnë dhe administrojnë. Mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 16, 20, 21, 22, nenin 32 të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Manuali MFK”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3.1 faqe 14-27 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Patos të marrë masa për (i) hartimin dhe miratimin e strategjisë së menaxhimit të riskut ku të identifikohen, analizohen, vlerësohen risqet që mund të ndikojnë në aktivitetin dhe përmbushjen e objektivave të institucionit, (ii) rishikimin periodik dy herë në vit të Regjistrimit të Riskut (iii) si dhe të marrë masa për përditësimin e Rregullores së Brendshme, në përputhje me strukturën organizative, duke paraqitur në mënyrë të plotë e të saktë detyrat specifike të punonjësve, duke bërë edhe përditësime të vijueshme në rastet e ndryshimit të strukturës, (iv) të marrë masa për të hartuar plane dhe programe trajnimit vjetore për ngritjen profesionale të stafit bazuar në nevojat e njësisë; për vendosjen e një sistemi komunikimi sa më efektiv që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi Nga auditimi, mbi vlerësimin e aktivitetit të Njësisë së auditimit të brendshëm në Bashkinë Patos u konstatua se:

- Drejtuesi i NJAB është emëruar në detyrën e përgjegjës të AB pa mbushur afatin minimal prej 3 vitesh në detyrën si auditues i brendshëm. Gjithashtu dhe dy specialistët pjesë e NJAB janë pa certifikatë të AK, në kundërshtim me ligjin nr. 114/2015 datë 22.10.2015 “Për Auditimin e Brendshëm në sektorin publik“ i ndryshuar neni 11, pika 2/b dhe VKM nr. 83/2016 datë 03.02.2016 “Mbi Miratimin e Kritereve të Krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik” pika 3.

- Nga NJAB nuk është realizuar plani i auditimeve i parashikuar në fillim të vitit, ku nga 3 auditime janë realizuar 2 misione auditimi, në kundërshtim me ligjin nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” neni 14/ç,i; Manuali i Auditimit të Brendshëm Kap.III, Rubrika 3.5;

- Nga analiza e planit të auditimeve për 2 vitet e fundit dhe pasqyruar edhe në tabelë, rezultoi se ndonëse njësitë (drejtoritë) që i janë nënshtruar misioneve audituese me nivel risku “i lartë” e kanë

të përvitshëm frekuencën e auditimit, numri i rekomandimeve të lëna në total ka ardhur në rritje (auditime plan e fakt të njëjta në numër-14); “të zbatuara” ka ardhur në rënie nga viti 2022 në vitin 2023, “në proces” ka ardhur në rritje dhe “pa zbatuar” gjithashtu ka ardhur në rritje.

- Nga auditimi i planeve strategjike [2021-2023], [2022-2024] dhe [2023-2025] dhe atij vjetor [2023], rezultoi se nga NJAB Bashkia Patos nuk janë bërë pjesë e tyre misioni auditues mbi “Zbatimin e Rekomandimeve”, në moszbatim të Udhëzimit nr. 42 datë 27.10.2020 me nr. 20255 prot., datë 27.10.2020 e Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë me objekt “Ndjekjen e zbatimit të Rekomandimeve të lëna nga auditimi i brendshëm në sektorin publik”.

- Nga ana e subjekteve të audituara nuk janë hartuar Planet e veprimit të cilat i dërgohen NJAB jo më vonë se 30 ditë pune pas dërgimit nga ana e saj të Raportit Përfundimtar, duke mos përmbushur detyrimin nr. 5 e skemës finale të auditimit, në moszbatim të kreut 4.1.12 hapi 11” i “Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3.1.2 faqe 27-34 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1.Rekomandimi: Drejtuesi i Njësies së auditimit të brendshëm dhe audituesit, të ndjekin me korrektësi çdo fazë të misionit auditues, duke e plotësuar me praktikën dokumentare përkatëse; pas dërgimit të raportit përfundimtar në subjektin e audituar, t’i kërkojë menaxherit të tij të reagojë në lidhje me rekomandimet e lëna dhe të raportojë periodikisht në Njësinë e auditimit të brendshëm sipas afateve të përcaktuara në planin e veprimit;

- Të krijojë dhe mirëmbajë një sistem për monitorimin e trajtimit të rezultateve të rekomanduara për t’ia përcjellë menaxhimit, nëpërmjet raporteve informuese të dhëna mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve, sipas Manualit të auditimit të brendshëm.

Menjëherë dhe në vijimësi

3.Gjetje nga auditimi Nga auditimi i shpenzimeve të kryera në llogarinë 602, konstatohet se:

- Në këtë llogari është kaluar kontributi për shoqëritë tregtare për Shoqatën sportive “A ” në vlerën 7,105,900 mijë lekë për gjithë vitin 2023.

- Bashkia Patos nuk ka vijuar me procedurat për shitjen e aksioneve ndaj Shoqatën sportive “A ” në përputhje me ligjin nr. 105/2020 , datë 29.07.2020 “Për Sportin”, neni 8, ku nga mos zbatimi i këtij ligji Bashkia Patos është vijuar me planifikimin dhe kryerjen e pagesave si kontribut në vlerë totale 7,105 mijë lekë ndaj “A ”, që përbën shpenzim pa ekonomikitet i fondeve të buxhetit të shtetit. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3.2 faqe 34-40 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1.Rekomandimi: Bashkia Patos të marrë masa të nxjerrë në shitje aksionet që zotëron në shoqërinë “A ”, sha me qëllim menaxhimin me ekonomikitet të fondeve të buxhetit të shtetit, duke i përdorur ato në investime me qëllim përmirësimin e jetës së qytetarëve të Bashkisë Patos.

Menjëherë dhe në vijimësi

4.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i evidencave të rakorduara me degën e thesarit në Bashkinë Patos, mbi realizimin e të ardhurave nga taksat/tarifat vendore, rezulton se:

Në total të ardhurat janë realizuar në masën 84 %, ku nga vlera e planifikuar prej 287,999 mijë lekë është arkëtuar vlera 240,198 mijë lekë, me mosrealizim në vlerën 47,801 mijë lekë, ku disa nga zërat paraqesin këtë realizim:

- Taksa e tokës është planifikuar për vlerën **21,420** mijë lekë dhe është realizuar **42 %**, me mosrealizim në vlerën **12,338** mijë lekë.

- Taksa ndërtese dhe Tarifa pastrimi gjelbërimi e ndriçimi, tarifa për shërbimin komunitare, janë planifikuar gjithsej në vlerën **93,119** mijë lekë ose **32%** e planit vjetor. Janë realizuar **74,852** mijë lekë ose **53 %** të planit.

- Tarifa vendore (pastrimi, ndriçimi, gjelbërimi dhe shërbimi komunitar), rezulton se në vitin 2023, nga **50,275** mijë lekë e planifikuar janë realizuar **29,289** mijë lekë ose **58 %**, me një mosrealizim në vlerën **20,986** mijë lekë.

Nga mosrealizimi i planit të të ardhurave si më sipër ka sjellë mungesë të ardhurash në buxhetin e bashkisë vetëm për taksat dhe tarifave vendore familjare në vitin 2023 në vlerën gjithsej **31,192 mijë lekë**, veprime në kundërshtim m, Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, Ligjin nr. 9975, datë 28.07.2008, “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar, Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 22 dhe neni 23. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3.2 faqe 34-40 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1. Rekomandim: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave në Bashkinë Patos, të marrin masa për realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore, duke bërë një analizë e hollësishme për planifikimin sa më real të të ardhurave për të mos krijuar diferenca të dukshme në realizimin e shpenzimeve buxhetore, kjo duke u mbështetur në burimet e krijimit të të ardhurave dhe arkëtimin e borxhit të akumuluar nga mospagimi i taksave dhe tarifave vendore nga familjet.

Menjëherë dhe në vijimësi

5. Getje nga auditimi Nga auditimi rezulton se llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm” për vitin 2023 paraqitet në vlerën **14,039,680 lekë**, e cila përfaqëson detyrimet e të tretëve ndaj Bashkisë. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se gjendje debitorë e subjekteve taksapagues privat dhe familjar e konstatuar gjendje 31.12.2023 është në vlera **207,517 mijë lekë** e cila nuk është pasqyruar në gjendjen kontabël sipas llojit të taksapaguesve. (Trajtuar më hollësisht në pikën 2.6 të RPA).

Gjithashtu rezulton se DAV Bashkia patos nuk ka komunikuar zyrtarisht me Drejtorin e Financës për pasqyrimin në kontabilitet të debitorëve gjendje 31.12.2023, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Urdhri nr.64 datë 22.07.2014 “Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuar” dhe Standardit Kombëtar të Kontabilitetit nr.8 “Të ardhurat”, pika 8 e Standardit ku përcaktohet njohja fillestare e të ardhurës UMF nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësisë të Qeverisjes së Përgjithshme”, kapitulli II, pika 6. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3.3 faqe 49-59 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1.Rekomandimi: Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Drejtorin e të Ardhurave të merren masat për kontabilizimin dhe arkëtimin e detyrimeve të pa shlyera nga të ardhurat vendore gjendje 31.12.2023, në vlerën **207,517 mijë lekë** sipas evidencave të Drejtorisë të Ardhurave Vendore. Drejtoria e Financës, në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të vlerësojë rastet e debitorëve pa shpresë arkëtimi dhe të procedojë sipas kërkesave ligjore për sistemimin e vlerave debitorë.

Në mbyllje të pasqyrave financiare 2024

6. Gjetje nga auditimi Nga auditimi rezulton se llogaria 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”, më 31.12.2023 paraqitet në vlerën 53,133,380 lekë, të cilat përfaqësojnë garanci të 27 subjekteve për 48 objektet e përfunduara dhe garanci për taksa pulle, kopshte çerdhe dhe qira banesat sociale për vlerën 638,743 lekë.

Gjatë vitit 2023 shesta janë në vlerën 19,424,682 lekë dhe likuidimet e kryera në vlerën 2,014,236 lekë për 4 subjekte. Për 48 objekte të përfunduara dhe në proces, në vlerën 53,133,380 lekë (sipas aneksit nr.11, pika 3), nuk është bërë zhbllokimi i tyre, dhe fondet gjenden të ngurtësuar në degën e Thesarit. Për 8 objekte janë në proces dhe të pa marra në dorëzim nga Bashkia për vlerën e ngurtësuar 13,214,965 lekë dhe për 40 objekte të marra në dorëzim të përkohshëm për të cilat është plotësuar afati i garancisë.

Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me UMF nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, ndryshuar me udhëzimin nr. 5 datë 21.02.2022, Kap. III, pikat 30, 50. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3.3 faqe 49-59 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.1.Rekomandimi: Drejtorisë së Shërbimeve dhe Hartimit të Projekteve në bashkëpunim me

Drejtorinë e Financave Bashkia Patos, të marrë masa për njoftimin e subjekteve për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për të ç'ngurtësuar garancitë të cilat tashmë u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratën e investimit përkatës.

Për rastet e refuzimit ose mos kërkesës së subjekteve të kërkohet bashkëpunim me Drejtorinë e Thesarit për riaktivizimin e këtyre fondeve në interes të bashkisë.

Në mbyllje të pasqyrave financiare 2024

7.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të prokurimit të zhvilluara përgjatë periudhës 01.01.2023-31.12.2023, u konstatua se nga AK Bashkia Patos në procedurën me objekt “*Rikonstruksion i Çerdhes Patos me hapësirat përreth*”, për pajisjet dhe grup pajisjet nuk janë vendosur specifikimet teknike, “*Treguesit kryesor teknik sipas pasaportës teknike*”, duke krijuar mundësin e spekulimit të OE pjesëmarrës në garë për të vendosur instaluar pajisje me tregues teknik me të ulët, duke mos garantuar funksionimin me efektivitet dhe eficensë të sistemit të ngrohjes dhe jo vetëm.

Veprimet më sipër bien në kundërshtim kërkesat e nenit 7 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “*Për prokurimin publik*” i ndryshuar, dhe pikës 4 të nenit 39 të VKM me nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3.4 faqe 59-100 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7.1.Rekomandimi: Bashkia Patos (AK dhe Njësia e Prokurimit), të marrë masa që në zhvillimin e procedurave të prokurimit të vendosur specifikimet teknike, “*Treguesit kryesor teknik sipas pasaportës teknike*”, duke përcaktuar nevojat reale për punë, shërbime dhe mallra.

Menjëherë dhe në vijimësi

8.Gjetje nga auditimi: Nga të dhënat konstatohet se për periudhën objekt auditimi (01.01.2021 – 31.12.2023), janë realizuar gjithsej **26** procedura me vlerë të lartë me fond limit 230,566 mijë lekë dhe vlerë kontrate të lidhur prej 169,557 mijë lekë, me një diferencë prej 61,009 mijë lekë ose 26.4%.

Nga grupi mbi bazën e materialitetit janë vlerësuar për auditim **7** procedura nga 26 të realizuara me vlerë të fondit limit 118,224 mijë lekë ose 52 % e fondit të prokuruar.

Nga auditimi i **7** procedurave janë konstatuar në shkelje të dispozitave të LPP, **6** procedura me fond limit prej **89,904** mijë lekë, konkretisht parregullsi në hartimin e kriterëve jo në përputhje me tipologjinë e objektit që prokurohet dhe se OE të shpallur fitues nuk plotësojnë kriteret e DT, të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, si më poshtë:

- Në **6** procedura nga 7 të audituara, u konstatua se janë aplikuar kriteret e paargumentuara dhe specifikime teknike të pa argumentuara, jo në lidhje të ngushtë me tipologjinë e procedurës që zhvillohet, e cila ndikon drejtpërdrejt në pjesëmarrjen e OE në procedurë për rritjen e konkurrencës, frenojnë pjesëmarrjen e biznesit të mesëm, si dhe ndikojnë indirekt në eliminimin e OE me oferta më të leverdishme dhe pengojnë në zbatimin e kontratës.

- Në **3** procedura nga **7** të audituara, u konstatua se, OE i shpallur fitues nuk është në kushtet e plotësisimit të kriterëve të DST të miratuara nga AK Bashkia Patos, pasi në dokumentacionin e paraqitur prej tyre u konstatuan mangësi dhe mosplotësim i kriterëve të vendosura në DT.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit nr.162/2020 “*Për prokurimin publik*”; neni 2, neni 3, pika 2, neni 35, neni 39, pika 2, neni 77 dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2020 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar neni 2, pika 2, shkronja “c”, neni 15, pika 3, shkronja “b”, neni 39, pika 4, neni 40, pika 1, neni 43, pika 2, shkronja “c”, neni 44, pika 1, neni 55, pika 4, neni 78, pika 2. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3.4 faqe 59-100 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

8.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Patos të marrë të gjithë masat e nevojshme për përzgjedhjen e zyrtarëve të përfshirë në procesin prokurues që të jenë specialistë të fushës, si dhe të bëjë trajnimin e vazhdueshëm të tyre, me qëllim argumentimin e kriterëve të vendosura për çdo

procedurë të jetë në përputhje me tipologjinë e procedurës dhe që gjatë vlerësimit të ofertave të mbajnë në konsideratë garantimin e Autoritetit kontraktor në realizimin në afat dhe me cilësi të kontratës.

Në vijimësi

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi regjistrin e parashikimeve u konstatua se ka një numër të lartë të ndryshimeve në procedurat BVV për vitin 2023, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” neni 2/b; VKM nr. 285/2021 “Procedurat e prokurimit publik” i ndryshuar neni 1/b, neni 8/7. Kjo ka ardhur si rezultat i mungesës së analizave dhe të studimit të mirëfilltë të nevojave për mallra, shërbime e punë;

- Nuk jepet përshtetja e qartë mbi procedurën nëse përfshin përveç mallit dhe shërbimit nga OE edhe magazinimin apo jo në ambientet e tij apo në ato të bashkisë, si në rastin e “Blerje medikamente mjekësore” dhe “Blerje produkte pastrimi - detergjente”.

- Për mallra/grupmallra dhe shërbime/grupshërbime të njëjta, janë parashikuar me copëzim të fondit në 12 raste, prej të cilave në 3 raste me vlera në tejkalim të vlerës limit prej 1,000,000 lekë, në kundërshtim me nenin 11 dhe nenin 56 pika 2 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Udhëzimi nr. 4 datë 18.06.2021 “Për hartimin e regjistrit të parashikimeve të procedurave të prokurimit publik dhe regjistrit të realizimeve të procedurave të prokurimit dhe krijimi i tyre në sistemin e prokurimit elektronik”, Udhëzimi nr.5 datë 25.06.2021 “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, Udhëzimi nr. 05, datë 29.07.2022 “Për disa ndryshime në manualin teknik që shoqëron Udhëzimin nr. 05, datë 25.06.2021 “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”.

Gjithashtu u konstatua se: për mallra/grupmallra apo shërbime/grupshërbime ka copëtim të fondit në vlera nën 100,000 lekë në 10 raste.

- Në 3 procedura nuk është përcaktuar saktë lloji i procedurës, respektivisht “Blerje materiale pastrimi-detergjente”/mallra, “Shërbime e mirëmbajtje mjetesh” /shërbime dhe “Blerje baze materiale për rikonstruksionin e banesave sociale” /mallra, u konstatua se edhe pse në të njëjtën vlerë të fondit limit, dy procedurat e para i janë nënshtruar prokurimit BVV ndërsa procedura e tretë i është nënshtruar procedurës së hapur, referuar nenit 41, pika 3 e Ligjit nr. 162 dt. 23.12.2020 “Mbi prokurimin publik” i ndryshuar.

Nga ana e NJP nuk janë dhënë detaje në përshtetjen e procedurës, për të saktësuar arsyet e përzgjedhjes së procedurës së prokurimit në secilin rast, në moszbatim të VKM nr. 285/2021 datë 21.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar neni 2 pika 2/a,b,ç, neni 11 pika 1/c, pika 2, pika 3 dhe neni 12.

- Në vitin 2023 është parashikuar në regjistrin prokurimeve me BVV me objekt “Siguracion, kolaudim dhe taksa vjetore e qarkullimit” në vlerën e fondit limit prej 437,500 lekë, ku vetëm “siguracioni i mjeteve” duhet përfshirë në procedurën e prokurimit BVV, pasi është shërbim që ofrohet nga OE veprimtaria e të cilëve i nënshtrohet konkurrencës së lirë; ndërsa taksat vjetore të qarkullimit dhe kolaudimi i mjeteve ofrohet vetëm nga një njësi publike – DPSHTRR, njësi varësie e MIE.

- Janë parashikuar procedura të cilat janë pjesë e procedurave të nisura më parë dhe duke u copëtuar apo shkëputur prej tyre, janë klasifikuar të blerjet me vlerë të vogël për vitin pasardhës 2023, konkretisht: procedura me nr. 13 “Blerje benzine për Klubin Sportiv, Sektori Ujitje Kullim dhe Pyje” me fondin limit prej 262,083 lekë; nr. 17 “Blerje dru zjarri dhe paletë druri për ngrohje shkolla M.Matohiti + K.Sheqisht” me fondin limit prej 672,333 lekë, për të cilat duhet të ishin zbatuar pikat 8,9/a,b dhe 10 (sipas rastit) të nenit 12 të VKM nr. 285 datë 21.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

- Mbi bazën e materialitetit janë vlerësuar për auditim 25 procedura me BVV dhe u kërkuan dosjet përkatëse të tyre. Nga auditimi rezultoi se praktikat e procedurave nuk ishin të sistemuara në dosje, gjë që ka sjellë edhe mungesën e inventarizimit të dokumentacionit që përmban procedura e ndjekur, si dhe kishin mangësi të theksuar të dokumentacionit, ku “*testimi i tregut*” ishte procedurë që në të shumtën e rasteve nuk zhvillohej, në kundërshtim me nenin 2, 13 dhe 15 të VKM nr. 285/2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar; Urdhri i titullarit për ngritjen e komisioni të marrjes në dorëzim të mallit apo shërbimit, nuk është bërë pjesë e praktikës së procedurës së BVV në moszbatim të nenit 74 pika 3/ ç të VKM nr. 285/2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar;

- Nga auditimi i procedurave “*emergjente*”, rezultoi se përveçse dokumentacionit standard, procesverbali i konstatimit të avarisë apo dëmtimit të përpiluar nga personat përgjegjës dhe dokumenti faktik (foto) shoqërues i tij, ose nuk është përpiluar korrekt ose nuk i është bashkëngjitur formularit nr. 4 “*Formulari i rasteve të emergjencës*”; gjithashtu nuk është bërë pjesë e praktikës as Urdhri i brendshëm me anë të të cilit miratohet çmimi i mallit apo shërbimit (sipas rastit). (Më hollësisht trajtuar në pikën 3.4 faqe 59-100 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

9.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Patos dhe Strukturat Përgjegjëse të marrin masa për mbikëqyrjen e procedurave të prokurimit me vlerë të vogël, duke mos lejuar copëzim të fondeve si dhe dokumentimin e të gjithë hapave të procedurës.

Menjëherë dhe në vijimësi

10. Gjetje nga auditimi: Në **3 (tre) raste**, nga auditimi i zbatimit të kontratave për punë publike, u konstatuan se dosjet e zbatimit të kontratave janë të pa inventarizuara dhe të pa arkivuara nga Autoriteti Kontraktor Bashkia Patos, veprime në kundërshtim me Ligjin Nr. 9154, datë 6.11.2003 “*Për arkivat*”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3.4.4. faqe 100-140 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

10.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Patos të ngarkojë Zyrën e Protokoll-Arkivës, për inventarizim dhe arkivim e dosjeve të investimet për të cilat janë përfunduar procedurat përkatëse, por edhe për të gjitha rastet në vijim, me qëllim shmangien e risqeve të tjetërsimit dhe/ose humbjes së dokumentacionit si dhe në mënyrë që çdo dokument i administruar nga ky institucion të ketë të gjithë elementët e dokumenteve sipas normave tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor.

Menjëherë

11.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të prokurimit publik dhe zbatimit të kontratave për punë publike, u konstatua se në **4 (katër) raste**, nga AK Bashkia Patos, **nuk është kryer oponenca teknike**, respektivisht për objektet:

-“*Rikonstruksioni i shkollës “Muhamet Shehu” dhe ndërtimi i palestrës*”;

-“*Rikonstruksion dhe shtrim me asfaltobeton të rrugës Banaj*”;

-“*Rikonstruksion i çerdhes Patos me hapësirat përreth*”;

-“*Përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra të pa favorizuara*”.

Mos kryerja e oponencës teknike nga AK Bashkia Patos, vjen në kundërshtim me pikën 1 të VKM Nr.1055, datë 22.12.2010 “*Për vendosjen e oponencës teknike për projektet e veprave të ndërtimit*”, sipas të cilës: “*Për të gjitha projektet e veprave të ndërtimit, që realizohen në territorin e Republikës së Shqipërisë nga subjekte fizike dhe juridike, vendas ose të huaj, për të cilat vlera e preventivuar e punimeve të ndërtimit është jo më pak se 100,000,000 lekë, të bëhet oponencë teknike*”, si dhe me pikën 3 të VKM Nr.1055, datë 22.12.2010 “*Për vendosjen e oponencës teknike për projektet e veprave të ndërtimit*”, sipas të cilës: “*Të gjitha projektet e veprave të ndërtimit, të përmendura në pikën 1 të këtij vendimi, nuk mund të miratohen nga organet kompetente pa kryerjen e oponencës teknike...*” (Më hollësisht trajtuar në pikën 3.4.4. faqe 100-140 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

11.1.Rekomandimi: Bashkia Patos të marrë masa që të pajisë me **Oponencë Teknike** çdo projekt zbatimi, për të siguruar hartimin e projekteve të zbatimit me cilësi, në përputhje me kërkesat urbanistike, kushtet teknike të projektimit, kushtet teknike të zbatimit, si dhe me destinacionin e tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit, u konstatua se në kontratën me objekt: “*Rikonstruksion dhe shtrim me asfaltobeton të rrugës Banaj*”, kolaudimi i punimeve është bërë me 4 muaj vonesë, ku nga data 26.6.2023 që subjekti ka deklaruar mbylljen e punimeve, kolaudimi është bërë me datë 23.10.2023, veprim në kundërshtim e Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “*Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit*” i ndryshuar, neni 12. Proces verbali mbi kolaudimin është nënshkruar nga: Kontraktori i punimeve “N” SHPK; nga Mbikëqyrësi i punimeve shoqëria “R” SHPK dhe nga Kolaudatori i punimeve shoqëria “A” SHPK. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3.4.4. faqe 100-140 të Raportit përfundimtar të Auditimit).

12.1.Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Patos për zbatimin e kontratave për punë publike, të bëjë emërimin e kolaudatorit apo grupit të kolaudimit, **brenda 30 ditëve** nga përfundimit i punimeve të ndërtimit për të hapur rrugën e periudhës së garancisë së defekteve të punimeve.

Në vijimësi

13.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit u konstatua se në **1 (një)** rast nuk janë respektuar kondicionet urbane të parashikuara në ligj, siç janë distancat që objekti me funksion stallë duhet të ruajë nga banesa më e afërt, e veçuar nga qendra urbane, konkretisht në leje ndërtimi për objekt 1 kat për rritjen e dhive, me zhvillues z. F.H, për të cilën është marrë Vendimi Nr. 1337/3 Prot; datë 12.06.2023, me problematika si më poshtë vijon:

- Objekti i miratuar nuk respekton kondicionet urbane sipas përcaktimeve të pikës II.b. të VKM-së nr. 283, datë 01.04.2015, nën-pika 3.a), pasi nuk respekton distancat urbane nga banesa më e afërt, e veçuar nga qendra urbane. Distanca që objekti me funksion stallë do të duhej të ruante është 100 metra. Distanca faktike është 85 metra. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3.5 faqe 140-143 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

13.1.Rekomandimi: Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit të Zhvillimit Territorit Bashkia Patos, të marrë masa për verifikuar në çdo rast respektimin e distancave urbane nga objektet e tjera, sipas përcaktimeve ligjore, të kërkojnë përmasimin e parcelave në zhvillim dhe evidentimin e distancave urbane nga rrugët, parcelat kufitare dhe objektet e tjera, që në dokumentin e rievimit topografik, me qëllim marrjen e sigurisë së lartë se objekti në zhvillim i respekton të gjithë kondicionet urbane.

Menjëherë dhe në vijimësi

14.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit dhe përdorimit u konstatua se në **3 (tre) raste**, projekti ndërtimor nuk është i plotë ose i saktë, sipas përcaktimeve në ligj dhe rregullore. Më konkretisht, këto anomali janë konstatuar në rastet e mëposhtme:

a. Leje ndërtimi për objekt 1 kat për rritjen e dhive, me zhvillues z. F.H, për të cilën është marrë Vendimi Nr. 1337/3 Prot; datë 12.06.2023, me problematika si më poshtë vijon:

- Projekti konstruktiv është nënshkruar elektronikisht nga ing. A.M, në cilësinë e drejtorit të Drejtorisë së Hartimit të Projekteve, Shërbimeve dhe Emergjencave Civile. Gjithashtu, z. M. ka kryer dhe aplikimin online për lejen e ndërtimit gjatë orarit të punës, veprime këto në kundërshtim me neni 3 të Ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar, pika 1, si dhe në kundërshtim nenet 45, 46, 47 të Ligjit nr. 152, datë 30.05.2013.

- Kartelat e pasurisë nuk janë rifreskuar gjatë tre muajve të fundit, veprime këto në kundërshtim me nenin 17 të Ligjit Nr.111/2018, pika 4 dhe 6 dhe VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, neni 18, 21 dhe 45, pika c). Nga auditimi i kësaj procedure, është konstatuar se kartelat janë rifreskuar në datën 16/12/2022, ndërsa aplikimi për pajisje me leje ndërtimi është bërë në datë 30.05.2023.

b. Leje ndërtimi për magazinë për grumbullimin dhe ruajtje produktesh, me subjekt zhvillues z. F.K , për të cilën është marrë Vendimi Nr. 492/3 Prot; datë 24.03.2023, me problematika si më poshtë vijon:

- Projekti konstruktiv është nënshkruar elektronikisht nga ing. A.M, në cilësinë e drejtorit të Drejtorisë së Hartimit të Projekteve, Shërbimeve dhe Emergjencave Civile. Gjithashtu, z. M. ka kryer dhe aplikimin online për lejen e ndërtimit gjatë orarit të punës, veprime këto në kundërshtim me neni 3 të Ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar, pika 1, si dhe në kundërshtim nenet 45, 46, 47 të Ligjit nr. 152, datë 30.05.2013.

- Kartelat e pasurisë nuk janë rifreskuar gjatë tre muajve të fundit, veprime këto në kundërshtim me nenin 17 të Ligjit Nr.111/2018, pika 4 dhe 6 dhe VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, neni 18, 21 dhe 45, pika c). Nga auditimi i kësaj procedure, është konstatuar se kartelat janë rifreskuar në datën 11/02/2021, ndërsa aplikimi për pajisje me leje ndërtimi është bërë në datë 16.02.2023.

c. Çertifikatë përdorimit për dy kabanone 1 kat për grumbullimin dhe ruajtjen e produkteve bujqësore dhe blegtorale, zhvilluesi “D” ShPK, për të cilën është marrë vendimi nr. 377/3 prot; datë 18.04.2023, me problematika si më poshtë vijon:

- Aktet e kontrollit sipas fazave të ndërtimit nuk janë përpiluar dhe dorëzuar elektronikisht sipas përcaktimeve të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, i ndryshuar, neni 27/1, pika 1, pasi nuk kanë të përcaktuar datën e përpilimit dhe numrin e protokollit.

- Mungon akti përkatës i lëshuar nga institucionet kompetente për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin, kjo në kundërshtim me VKM-në nr. 408, datë 13.05.2015, i ndryshuar, neni 27/2, pika 1, nënpika ë).

- Mungon projekti as-built, kjo në kundërshtim me VKM-në nr. 408, datë 13.05.2015, i ndryshuar, neni 27/2, pika 1, nënpika g).

- Mungojnë fotografitë e objektit në të gjitha drejtimet, kjo në kundërshtim me VKM-së nr. 408, datë 13.5.2015, i ndryshuar, në nenin 27/2, në pikën 1, nënpika j). *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3.5 faqe 140-143 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

14.1.Rekomandimi: Drejtoria Planifikimit, Kontrollit të Zhvillimit Territorit, Bashkia Patos të marrë të gjitha masat për të kërkuar, në çdo rast që aplikohet për pajisje me leje ndërtimi ose çertifikatë përdorimi, të gjithë dokumentacion e nevojshëm dhe të detyrueshëm, të projektit ndërtimor dhe dokumentacionit shoqërues të tij.

Menjëherë dhe në vijimësi

15.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit u konstatua se në **2 (dy) raste** Bashkia Patos dhe Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit të Zhvillimit Territorit nuk kanë kërkuar ose respektuar mendimin e autoriteteve publike që duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit. Referuar VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 “*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit*”, i ndryshuar, Neni 21, pika 6, DPKZHT ka detyrimin të kërkojë dhe respektojë mendimin e autoriteteve që duhet të shprehen përpara miratimit të lejeve të ndërtimit. Më konkretisht, këto anomali janë konstatuar në rastet e mëposhtme:

a. Leje ndërtimi për objekt 1 kat për rritjen e dhive, me zhvillues z. F.H, për të cilën është marrë Vendimi Nr. 1337/3 Prot; datë 12.06.2023.

b. Leje ndërtimi për magazinë për grumbullimin dhe ruajtje produktesh, me subjekt zhvillues z. F.K , për të cilën është marrë Vendimi Nr. 492/3 Prot; datë 24.03.2023. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3.5 faqe 140-143 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

15.1.Rekomandimi: Drejtoria Planifikimit, Kontrollit të Zhvillimit Territorit, Bashkia Patos të marrë të gjitha masat për të kërkuar dhe respektuar, në çdo rast që aplikohet për leje ndërtimi, mendimin e autoriteteve të cilat duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit, me qëllim marrjen e sigurisë së plotë mbi konformitetin e objektit në zhvillim me kriteret, dispozitat, infrastrukturën si dhe projektet e planifikuara të këtyre autoriteteve.

Menjëherë dhe në vijimësi

16.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit u konstatua se në **1 (një) rast** Drejtoria Planifikimit, Kontrollit të Zhvillimit Territorit dhe Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV) nuk kanë kryer detyrat e tyre funksionale në lidhje me evidentimin e shmangies nga projekti i miratuar, respektivisht:

c. Çertifikatë përdorimit për dy kabanone 1 kat për grumbullimin dhe ruajtjen e produkteve bujqësore dhe blegtorale, zhvilluesi “D” ShPK, për të cilën është marrë vendimi nr. 377/3 prot; datë 18.04.2023, ku referuar përcaktimeve të nenit 42 të Ligjit 107/2014, datë 31.7.2014, i ndryshuar, pika 3, marrim informacionin se çertifikata e përdorimit lëshohet vetëm kur aktet e kontrollit vërtetojnë realizimin e punimeve, në përputhje me kushtet e lejes ose deklaratës paraprake për kryerje punimesh.

Në pikën 4 të këtij vendimi përcaktohet se në rast se konstatohet mospërputhje e punimeve të kryera me kërkesat, autoriteti i planifikimit lëshon aktin e konstatimit të mospërputhshmërisë. Autoriteti vendor nuk ka kryer verifikimet në terren përpara miratimit të çertifikatës së përdorimit. Nga inspektimi në terren konstatohet se aksesimi për në objekt nuk është ndërtuar sipas projektit të miratuar. Hyrjet e objekteve në projektin e miratuar ndodhen në fasadat lindore ndërsa ato faktike janë njëra në fasadën jugore dhe tjetra në fasadën veriore. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3.5 faqe 140-143 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

16.1.Rekomandimi: Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor dhe Drejtoria Planifikimit, Kontrollit të Zhvillimit Territorit, Bashkia Patos të marrë të gjitha masat për të rritur dhe përmirësuar bashkëpunimin ndër-strukturor, me qëllim rritjen e cilësisë dhe shpeshësisë së kontrolleve dhe inspektimeve në territorin e Bashkisë Patos, me qëllim evidentimin e kundërvajtjeve dhe reduktimin e shmangieve nga projektet e miratuara.

Menjëherë dhe në vijimësi

17.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit mbi strukturën e IMT Bashkia Patos, konstatohet se dy inspektorë nuk kanë kualifikimin e duhur për pozicionin e punës dhe nuk plotësojnë kriterin e arsimit të nevojshëm për pozicionin e punës si kryeinspektorë/ inspektorë, veprimet dhe mosveprimet në kundërshtim me ligjin nr.183/2014, datë 24.12.2014, neni 11. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3.6, faqe 143-144 të Raportit përfundimtar të Auditimit)*

17.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Patos në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, të marrin për plotësimin e strukturës së IMT me specialist të fushës në zbatim të kuadrit ligjor.

Menjëherë dhe në vijimësi

18. Gjetje nga auditimi: Për periudhën objekt auditimi 01.01.2023 deri më 31.12.2023 gjatë ushtrimit të veprimtarisë dhe në përmbushje të detyrës funksionale të parashikuar në ligjin nr. 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, IMT Bashkia Patos, ka marrë **13** vendime për prishje objektesh pa leje të cilat rezultojnë të pa ekzekutuara nga ana e IMT Bashkia Patos për prishjen e ndërtimeve dhe kthimin e gjendjes në situatën e mëparshme, për të cilat nga IMT duhej vepruar në përputhje me përcaktimet e ligjit 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3.6, faqe 143-144 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

18.1.Rekomandimi: Inspektorati i Mbrojtjes Territorit të marrë masa që për rastet e ndërtimeve të paligjshme (pa leje ndërtimi), ndaj të cilave janë mbajtur procesverbale prishje objekti dhe kthimin në gjendjen fillestare të truallit, të zbatojë vendimet e prishjes së objekteve duke ndjekur më tej edhe procedurat ligjore.

Menjëherë dhe në vijimësi

A.1. Zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

19.Gjetje nga auditimi Në përfundim të procesit të auditimit, duke vlerësuar punën e bërë nga Bashkia Patos për zbatimin e rekomandimeve të KLSH paraqitur me shkresën e saj nr. 119/19 prot., datë 21.06.2023, konstatohet se pjesa më me peshë e tyre nuk është zbatuar për të cilat rikerkohet zbatimin e tyre.

a. Për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar 46 masa organizative në total nga të cilat janë pranuar plotësisht 46 masa organizative, nga të pranuarat janë zbatuar 13 masa, janë në proces zbatimi 31 masa, **2 masa pjesërisht zbatuar, si dhe nuk janë zbatuar 2 masa;**

b. Për masat shpërblim dëmi janë rekomanduar 9 masa në vlerën 4,749,685 lekë të cilat janë pranuar plotësisht, nga të cilat janë zbatuar **pjesërisht 2 masa** në vlerën 578,095 lekë, si dhe janë në proces gjyqësor 7 masa në vlerën 4,171,890 lekë të cilat janë konsideruar të zbatuara.

c. Për shpenzime në kundërshtim me principet e 3 E-të dhe të ardhura të munguara janë rekomanduar 7 masa në vlerën totale 165,992,712 lekë nga të cilat **nuk është ndërmarr asnjë procedurë për 3 masa:** 1 masë në vlerën 1,963,641 lekë, si dhe janë në proces zbatimi 4 masa në vlerën 164,029,071 lekë (përfshihet dhe vlera e 2 masave prej 84,999,159 lekë të pazbatuara).

d. KLSH i ka rekomanduar Kryetarit të Bashkisë Patos, fillimin e dhënies së masave disiplinore për të gjithë punonjësit e konstatuar me përgjegjësi sipas çështjeve të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, në proporcion me shkallën e shkeljes. Nga verifikimi rezultoi se referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion janë vendosur 37 masa disiplinore.

Sa më sipër veprimet apo mosveprimet janë në kundërshtim me ligji Nr. 154, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15, “Të drejtat e KLSH”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3.7 faqe 144-182 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

21.1.Rekomandimi: Bazuar në nenet 15 dhe 16, të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për përmirësimin e gjendjes, Ju rikërkojmë marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve që rezultuan të pazbatuara si dhe të zbatuara pjesërisht si dhe përshejtimin e atyre në proces si më poshtë:

A. Masa Organizative.

10.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Patos, Drejtoria e Financës dhe Drejtoria e Hartimit të Projekteve, Shërbimeve dhe Emergjencave Civile të marrë masa për kalimin e fondeve te secili kontraktor për të cilin ka mbaruar periudha e garancisë dhe Autoriteti Kontraktor nuk ka pretendime për cilësinë e investimin të kryer për periudhën e garancisë.

11.1. Rekomandimi: Nga Kryetari i Bashkisë dhe Drejtoria e Financës të evidentohen të gjitha rastet të cilat janë objekt i Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, për të cilat nuk është zhvilluar procedurë prokurimi si dhe për rastet që nuk janë nënshtruar procedurës së prokurimit, të merren masat e nevojshme për ndërprerjen e tyre referuar akteve ligjore në fuqi.

32.1/7.1. Rekomandim (rikërkuar): Bashkia Patos, të analizojë gjendjen e debitorëve sipas viteve të krijimit të dhe të procedojë sipas kërkesave ligjore për arkëtimin e vlerës së tyre duke bërë kërkesë padi në gjykatë. Të vlerësojë rastet e debitorëve pa shpresë arkëtimi dhe të procedojë sipas kërkesave ligjore për sistemimin e vlerave debitorë.

32.2/8.1. Rekomandim (rikërkuar): Drejtoria e Financës, në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe Drejtorinë e Shërbimeve, të saktësojnë subjektet dhe fondet për të cilat janë ngurtësuar si garanci për punimet e kryera për të cilat kanë humbur të drejtën e përfitimit të tyre ose që janë në kushtet e parashkrimit të së drejtës, në zbatim të kërkesave të pikës 10, Kap. II të UKM nr. 3, datë 15.02.2011 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar. Drejtoria e Financës, për këto raste, të procedojë sipas kërkesave ligjore pranë Degës së Thesarit Fier për rimarrjen e fondeve të ngurtësuar dhe përdorimin e tyre në interes publik.

Menjëherë

B. Masa Shpërblim Dëmi.

1.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Patos të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 96,532 lekë pa TVSh nga BOE "M" Shpk & "L" ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 851/15 prot datë 03.08.2021, me objekt "Sistemimi i hapësirave, Lagjja "29 Marsi", Blloku Zjarrfikësja", Bashkia Patos, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

3.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Patos të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 481,563 lekë pa TVSh nga OE "C" ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 2324/57 prot., datë 19.09.2022, me objekt "Rikonstruksion i segmentit Hekuran Melova, degëzimi i rrugës "Late Bregu" tek pallatet dykatëshe", vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

C. Masa për uljen e borxhit tatimor .

32.1/2.1 Rekomandim (rikërkuar) Bashkia Patos të ngrëjë grup pune me specialistë të fushës, për të përditësuar regjistrin e familjeve që disponojnë tokë bujqësore, sipas të dhënave të marra nga institucionet përgjegjëse (ASHK Patos dhe Qarku Fier). Të marrë të gjitha masat duke ndjekur procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës 40,491,275 lekë.

32.1/2.3 Rekomandim (rikërkuar) Bashkia Patos, të marrë masa për ngritjen e grupit të punës për evidentimin e familjeve ndaj të cilave nuk janë aplikuar detyrimet për taksat e tarifave vendore. Të hartohet regjistri përkatës me të dhënat e evidentuara në terren, si dhe të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme administrative në të gjitha shkallët për arkëtimin e vlerës debitorë prej 44,507,884 lekë.

3.2. Rekomandimi: Bashkia Patos, Drejtoria e të Ardhurave Vendore dhe Drejtoria e Planifikimi, Kadastrës dhe Kontrollit të Zhvillimit Urban të vazhdojë korrespondencën zyrtare me ASHK Fier në lidhje me situatën debitorë nga taksa e ndikimit në infrastrukturë për vitin 2022.

2.2. Rekomandimi: Bashkia Patos, Drejtoria e të Ardhura Vendore të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e detyrimeve të papaguara nga dhënia me qira e tokave bujqësore në total në vlerën 1,963,641 lekë duke llogaritur dhe shtuar vlerën e kamatëvonesave për të gjitha rastet e detyrimeve të pa arkëtuara në afat.

Menjëherë

C. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me objekt: "Rikonstruksioni i magjstralit kryesor dhe rrjetit të brendshëm të ujësjellësit qytetit Patos Loti I (Rrjeti shpërndarës)" Bashkia Patos, me vlerë 532,867,612.80 lekë me TVSH, fituar nga shoqëria "T" SHPK, rezultuan punime ndërtimi të pakryera në volumet e situacionuara, për zërat e punimeve: [Gërmim kanalesh në tokë të zakonshme, me krah, me seksion deri 0.75 m²; Gërmim dheu me ekskavator goma 0.25 m³, në kanale gjerësi deri 2 m, tok zak, kategoria III, me shkarkim në mjet; Prerje asfalti me makineri (Linjat e ujësjellësit rrjeti shpërndarës Qendër Patos); Shtresë rëre; Nënshtrësë zhavorri (për rrugët pa asfaltim); Mbushje me material të gërmuar; Shtresë çakelli mbeturinë kave t=20 cm, përhapur e ngjeshur makineri; Shtresë stabilizanti t=10 cm; FV. Tuba e rakorderi ujësjellësi PE d=90 mm, PN 16; FV. Tuba e rakorderi ujësjellësi PE d=110 mm, PN 16; FV. Tuba e rakorderi ujësjellësi PE d=125 mm, PN 16; FV. Tuba e rakorderi ujësjellësi PE d=140 mm, PN 16; FV. Tuba e rakorderi ujësjellësi PE d=160 mm, PN 16; FV. Tuba e rakorderi ujësjellësi PE d=200 mm, PN 16; FV. Tuba e rakorderi ujësjellësi PE d=250 mm, PN 16; Pusetat vertikale të shpërndarjes (Ana ndërtimore); Lidhjet e banesave individuale (me kaseta metalike) ujësjellësit; etj.] me pasojë dëm ekonomik në buxhetin e Bashkisë Patos në vlerën **7,574,268 lekë**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 2214/21 prot., datë 31.03.2020 të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë

Patos dhe sipërmarrësit të punimeve OE “T” SHPK. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3.4.4. faqe 100-140 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës & Kontabilitetit Bashkia Patos në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të marrin të gjitha masat duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e dëmit në vlerën **7,574,268 pa TVSh** nga OE “T” SHPK, për punime të pakryera në volumet e situacionuara, parashikuar në kontratën me nr. 2214/21 prot., datë 31.03.2020, me objekt “Rikonstruksioni i magjstralit kryesor dhe rrjetit të brendshëm të ujësjellësit qytetit Patos Loti I (Rrjeti shpërndarës)” Bashkia Patos.

Deri më 30.09.2024

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me objekt: “Rikonstruksioni i shkollës “Muhamet Shehu” dhe ndërtimi i palestrës” Bashkia Patos, me vlerë 85,682,886 lekë me TVSH, fituar nga OE “SH” SHPK, rezultuan punime ndërtimi të pakryera në volumet e situacionuara, për zërat e punimeve: [Kasetë shkarkimi me llamarinë xingat; Hidroizolim me emulsion bitumi dhe 1 shtresë katrama; Kolona b/a monolite C 20/25 h-4 m (koloncinat e kangjellave); Dritare duralumini dyfish xham], me pasojë dëm ekonomik në buxhetin e Bashkisë Patos, në vlerën **1,161,868 lekë pa TVSH** nga ku:

-Vlera prej **332,430 lekë pa TVSH**, përfaqëson volume pune të likuiduara më tepër në situacionin nr. 1, për zërat e punimeve (Zëri 7(An). Prishje suvatim i jashtëm t=2-3 cm dhe Zëri 8(An). Prishje suvatim i brendshëm t=2-3 cm). Kjo shumë duhet t’i mbahet sipërmarrësit të punimeve nga Autoriteti Kontraktor Bashkia Patos në situacionin përfundimtar.

-Vlera prej **616,840 lekë pa TVSH**, përfaqëson volume pune të pa realizuara, për zërat e punimeve Zëri 5 (2.206). Kasetë shkarkimi me llamarinë xingat; Zëri 2 (2.196). Hidroizolim me emulsion bitumi dhe 1 shtresë katrama; Zëri 24(2.117/1) Kolona b/a monolite C 20/25 h-4 m (koloncinat e kangjellave); Zëri 27 (2.a-121) Kanalinë metalike 150x50. Kjo shumë duhet të dëmshpërblehet nga mbahet sipërmarrësit të punimeve.

-Vlera **212,598 lekë pa TVSH**, përfaqëson realizimin e zërit “Zëri 25 (2.375/a) Dritare duralumini dyfish xham” jo në përputhje me specifikimet teknike dhe kushtet e kontratës. Kjo shumë duhet të dëmshpërblehet nga mbahet sipërmarrësit të punimeve.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 1784/18 prot., datë 05.12.2022 të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Patos dhe sipërmarrësit të punimeve OE “SH” SHPK. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3.4.4. faqe 100-140 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës & Kontabilitetit Bashkia Patos në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të marrin të gjitha masat duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e dëmit në vlerën **829,438 pa TVSh** nga OE “SH” SHPK, për punime të pakryera në volumet e situacionuara, parashikuar në kontratën me nr. 1784/18 prot., datë 05.12.2022, me objekt “Rikonstruksioni i shkollës “Muhamet Shehu” dhe ndërtimi i palestrës” Bashkia Patos.

Vlera prej **332,430 lekë pa TVSH**, duhet t’i mbahet sipërmarrësit të punimeve nga Autoriteti Kontraktor Bashkia Patos në situacionin përfundimtar për volume pune të likuiduara më tepër në situacionin nr. 1, datë 22.12.2022 për zërat e punimeve (Zëri 7(An). Prishje suvatim i jashtëm t=2-3 cm dhe Zëri 8(An). Prishje suvatim i brendshëm t=2-3 cm).

Deri më 30.09.2024

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me objekt “Rikonstruksion dhe shtrim me asfaltobeton të rrugës Banaj” Bashkia Patos, me vlerë 30,430,183 lekë me TVSH, fituar nga OE “N” SHPK, rezultuan punime ndërtimi të pakryera në volumet e situacionuara, për zërat e punimeve: [Bankinë, shtresë stabilizanti t=10cm; Struktura monolite betoni C 16/20], me pasojë dëm ekonomik në buxhetin e Bashkisë Patos, në

vlerën **877,040 lekë pa TVSH**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 2214/21 prot., datë 31.03.2020 të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Patos dhe sipërmarrësit të punimeve OE “N” SHPK. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3.4.4. faqe 100-140 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës & Kontabilitetit Bashkia Patos në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të marrin të gjitha masat duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e dëmit në vlerën **877,040 pa TVSh** nga OE “N” SHPK, për punime të pakryera në volumet e situacionuara, parashikuar në kontratën me nr. 2085/22 prot., datë 20.12.2022, me objekt “*Rikonstruksion dhe shtrim me asfaltobeton të rrugës Banaj*” Bashkia Patos.

Deri më 30.09.2024

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike, me objekt “*Rikonstruksion i çerdhes Patos me hapësirat përreth*” Bashkia Patos, me vlerë 30,430,183 lekë me TVSH, fituar nga OE “S” SHPK, specifikisht për volumet e punimeve të ndërtimit të pasqyruara në situacionin nr. 1 dhe në situacionin nr. 2, rezultuan punime të pasqyruara në volume më tepër, krahasuar me volumet faktike sipas preventivit të ripunuar dhe tabelës së rakordimeve të punimeve që shtohen dhe punimeve që pakësohen, në vlerën **1,921,946 lekë pa TVSH**, për 26 zëra pune ndërtimi. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 2104/20 prot., datë 19.01.2023 të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Patos dhe sipërmarrësit të punimeve OE “S” SHPK. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3.4.4. faqe 100-140 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

4.1. Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Patos t’i kërkojnë menjëherë sipërmarrësit të punimeve “S” SHPK të hartojnë situacionin përfundimtar të punimeve (pasi situacioni përfundimtar i paraqitur nga sipërmarrësi në bashki, nuk pasqyron volumet faktike sipas preventivit të ripunuar dhe tabelës së rakordimit të punimeve që shtohen dhe punimeve që pakësohen) duke rakorduar volumet për zërat e punimeve që janë likuiduar tepër në situacionin nr. 1, datë 07.04.2023 dhe në situacionin nr. 2, datë 19.01.2023 dhe, duke zbritur vlerën **1,921,946 lekë pa TVSH**, vlerë e cila është likuiduar për volume tepër, si pasojë e mos rakordimeve të volumeve të projekt preventivit me volumet sipas faktit nga matjet në objekt.

Në vijim, Titullari i Bashkisë Patos të ngrejë grupin e punës për marrjen në dorëzim të investimit dhe, të fillojë procedura e marrjes së përkohshme në dorëzim të objektit.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me objekt “*Përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra të pa favorizuara*” Bashkia Patos, me vlerë 16,528,523 lekë me TVSH, fituar nga OE “I” SHPK, rezultuan punime ndërtimi të pakryera në volumet e situacionuara, për zërat e punimeve: Transport materiale ndërtimi, dheu me auto deri 5.0 km; Suva e zakonshme fasade mur tulle lartësi mbi 8 m; Hidroizolim me emulsion bitumi dhe 2 shtrese k katrama; F.V Dritare duralumini dyfish xham;] si dhe, penalitet për kryerje punime ndërtimi jashtë afatit të përfundimit të kontratës, me pasojë dëm ekonomik në buxhetin e Bashkisë Patos, në vlerën **237,762 lekë pa TVSH**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 1861/16 prot., datë 28.09.2022 të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Patos dhe sipërmarrësit të punimeve OE “I” SHPK. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3.4.4. faqe 100-140 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

5.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës & Kontabilitetit Bashkia Patos në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të marrin të gjitha masat duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e dëmit në vlerën **237,762 pa TVSh** nga OE “I” SHPK, për punime të pakryera në volumet e situacionuara dhe jo në përputhje me specifikimet teknike, parashikuar në

kontratën me nr. 1861/16 prot., datë 28.09.2022, me objekt “Përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra te pa favorizuara” Bashkia Patos.

Kryetari i Bashkisë Patos në bashkëpunim me mbikëqyrësin e punimeve shoqërinë “D ” SHPK, t’i kërkojnë sipërmarrësit të punimeve shoqërisë “I” SHPK, të marrë masa të menjëhershme për eliminimin e lagështirës në banesën e z. K.G , Zharrëz.

Deri më 30.09.2024

D. MASA PËR ELIMINIM E EFEKTEVE NEGATIVE NË MENAXHIMIN E TË ARDHURAVE NGA TAKSAT E TARIFAT VENDORE, ME EFEKT MUNGESË TË ARDHURASH.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i të dhënave rezulton se stoku i borxhit progresive deri me datë 31.12.2023, paraqitet në vlerën **160,265 mijë lekë**. Për vitin 2023 ky borxh është shtuar në vlerën **38,092 mijë lekë** ose **18.3%** e totalit, ku zërin kryesor në rritje e kanë debitorët familjarë për mos pagesën e taksave dhe tarifave vendore, në vlerën **36,032 mijë lekë** ose **22.4%** e totalit të stokut të borxhit të akumuluar, ndërsa për mos pagesën e detyrimeve tatimore të subjekteve nga biznesi i vogël dhe biznesi i madh është në vlerën **2,069 mijë lekë** ose **1.2%**. Në mënyrë analitike paraqiten në **aneksin nr. 2.6.3** bashkëlidhur RPA. Sipas dokumentacionit të venë në dispozicion rezulton se nga drejtoria e të ardhurave janë marrë masa shtrënguese por jo në mënyrë shteruese. Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Kreut XI-“Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara”, të neneve 88 deri 104, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore”, të ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3.2.6. faqe 40-49 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1. Rekomandimi: Bashkia Patos, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave, të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimit tatimore për debitorët duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifave vendore në fund të periudhës në vlerën **160,265 mijë lekë** si më poshtë vijon:

a-T’u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimit e llogarive bankare.

b-Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme).

c-Në funksion të mbledhjes së detyrimit të paguar, Sektori i Taksave dhe Tarifave, të angazhojë strukturat e saj për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar.

d- Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, në vite nga ana e Sektori i Taksave dhe Tarifave dhe Sektori Juridik, të marrin masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal bazuar në Kodin Penal të R.SH, miratuar me ligjin nr.7895, datë 27.1.1995 i ndryshuar neni 181 “Mospagimi taksave dhe tatimeve”.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit që disponon Drejtoria e të Ardhurave, Bashkia Patos në lidhje me legalizimet e ndërtimeve pa leje dhe listave që disponon për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, konstatohet se nga Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Fier janë dërguar zyrtarisht me shkresë lista e qytetarëve shoqëruar me leje legalizimi dhe destinuar për regjistrim në ZVRPP (ASHK) Fier. Konkretisht për periudhën nga 01.01.2016 deri më 31.12.2023, sipas listave të vëna në dispozicion me leje legalizimi dhe kryqëzimi i tyre me personat që kanë bërë të mundur likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturës, rezulton se detyrimi për këtë taksë është në vlerën **39,904,291 lekë** për 1,158 persona, ku vetëm për vitin 2023 janë debitorë 46 persona në vlerën 1,715,276. Vlera progresive **39,904,291 lekë** është e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Patos. (sipas listës të administruar) dhe të paraqitur **në aneks**

nr.26.2 bashkëlidhur PRA. Nga auditimi i ushtruar dhe dokumentacioni i paraqitur, konstatohet se: Bashkia Patos për periudhën ushtrimore nuk janë njoftuar subjektet debitorë. Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me nenin 27 pika (d), të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”; VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim” i ndryshuar, pika 5 dhe ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave vendore”, i ndryshuar, neni 27- Taksa e ndikimit në infrastrukturë, pika 2/1 dhe ngarkohen me përgjegjësi Drejtorinë e PZHT dhe DTT Bashkia Patos. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3.2.6. faqe 40-49 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1.Rekomandimi: Bashkia Patos, Drejtoria të Ardhurave, të marrë masa duke bashkëpunuar me ASHK me qëllim arkëtimin taksës së ndikimit në infrastrukturë për **1158 persona** me vlerë **39,904,291 lekë**, e cila konsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Patos.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit mbi pasjen me Liçensë tregtimi për subjektet që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre, u konstatua se ka mangësi në plotësimin e të dhënave të këtyre subjekteve në përgjithësi dhe debitorëve në veçanti, si mos aplikimin e tarifës së licencës dhe lejimin e subjekteve të ushtrorë aktivitet pa paguar këtë taksë dhe mos ndjekjen e detyrimeve për subjektet të cilat janë pajisur dhe nuk e kanë paguar tarifën.

Sipas dokumentacionit të venë në dispozicion nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave, rezulton se në territorin e Bashkisë Patos dhe në Njësitë Administrative në vartësi, ushtrorë aktivitetin 12 subjekte të cilat tregtojnë me pakicë hidrokarbure dhe nënprodukte të tyre.

Nga 12 subjekte janë pajisur me autorizim 11 subjekte, të cilat janë përpara periudhës objekt auditimi dhe janë liçensuar me leje tregtim karburanti, gjithsej janë evidentuar **5 subjekte** të cilët ushtrorë aktivitet dhe papaguar detyrimin në vlerën totale **5,350,000 lekë**, e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Patos.

Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar, neni 35, VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar kapitulli II, pika 1; germa “b”, dhe pika 9, i ndryshuar me VKM nr. 344, datë 19.04.2017, kapitulli II, pika 1; germa “b” dhe pika 9, si dhe pika 15.1, 15.2 të këtij akti normativ. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3.2.6. faqe 40-49 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1.Rekomandimi: Bashkia Patos, Drejtoria e Tatim Taksave Vendore, të marrë masa për ndjekjen e të gjitha procedurave administrative dhe ligjore për arkëtimin nga subjektet:

- “A” ShPK, për shumën e mbetur **600,000 lekë**.
- “H” ShPK, për shumën e mbetur **850,000 lekë**.
- “E” ShPK, për shumën **1,000,000 lekë**.
- “E” ShPK, për shumën **1,000,000 lekë**.
- “G” ShPK, për shumën **1,900,000 lekë**.

Brenda datës 30.9.2024

E. MASA DISIPLINORE.

KLSH mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15 germa b, c dhe ç, ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, neni 59 “Kompetenca dhe procedura për masat disiplinore”, pika 1 dhe pika 4 germa b, VKM-në nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil, i

rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Patos t'i kërkojë Komisionit Disiplinor pranë institucionit, që bazuar në performancën e secilit punonjës dhe shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për çdo nëpunës të adresuar dhe të sigurojë marrjen e masave disiplinore përkatëse, si më poshtë:

a- Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet, sipas germës “c” e nenit 58, për 3 (tre) punonjësit e mëposhtëm:

1. Znj. J.SH. me detyrë Drejtoresha e Burimeve Njerëzore, në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave për shkeljet e konstatuara në procedurën e prokurimit me objekt:

-Procedura me objekt “Rikonstruksion i rrugës Unazë Varreza pikë takimi rruga “Dhori Tanaka” me fond limit 13,462 mijë lekë.

2. Z. M.N. me detyrë specialist në Njësinë e Prokurimit, në cilësinë e anëtares së njësisë së prokurimit dhe hartuese e kriterëve të veçanta të DST, për shkeljet e konstatuara në procedurën e prokurimit me objekt:

-Procedura me objekt “Rikonstruksion i rrugës Unazë Varreza pikë takimi rruga Dhori Tanaka” me fond limit 13,462 mijë lekë.

3. Znj. B.M. me detyrë ing. në Drejtorinë e Hartimit të projekteve, Monitorimit të Investimeve dhe të Shërbimeve, në cilësinë e anëtarit KVO-së, për shkeljet e konstatuara në

-Procedura me objekt “Rikonstruksion i rrugës Unazë Varreza pikë takimi rruga Dhori Tanaka” me fond limit 13,462 mijë lekë.

b- “Vërejtje”, sipas germës “a” të nenit 58 për 5 (pesë) punonjës

1. Z. L.Ç, në cilësinë e drejtorit të DPKKZHU.

2. Z. D.XH, në cilësinë spec. i aseteve publike të DPKKZHU.

3. Znj. E.B, në cilësinë e specialist-jurist, Sektori Juridik.

4. Znj. N.H, në cilësinë e përgjegjës Sektori Juridik.

5. Znj. A.K, në cilësinë e spec. pranë DPKKZHU.

Për shkeljet e konstatuara në miratimin e lejeve të ndërtimit dhe përdorimit të tyre respektivisht:

a. Leje ndërtimi për objekt 1 kat për rritjen e dhive, me adresë në Verbas, Bashkia Patos, me zhvillues z. F.H, për të cilën është marrë Vendimi Nr. 1337/3 Prot; datë 12.06.2023.

b. Leje ndërtimi për magazinë për grumbullimin dhe ruajtje produktesh, me adresë në Zharrëz, Bashkia Patos, me subjekt zhvillues z. F.K, për të cilën është marrë Vendimi Nr. 492/3 Prot; datë 24.03.2023.

c. Certifikatë përdorimit për dy kapanone 1 kat për grumbullimin dhe ruajtjen e produkteve bujqësore dhe blegtorale, me adresë në Verbas, Bashkia Patos, zhvilluesi “D” ShPK, për të cilën është marrë vendimi nr. 377/3 prot; datë 18.04.2023.

F. NJOFTIMI I DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË MBIKËQYRJES TË SHËRBIMIT CIVIL

Për punonjësit të cilët janë rekomanduar masat disiplinore sa më sipër, Bashkia Patos pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, të ndërmarrë veprimet si më poshtë:

a. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar.

b. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të ligjit nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil", i ndryshuar.

G. PËR MASA ADMINISTRATIVE.

G/1. Për Agjencinë e Prokurimit Publik.

Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e prokurimeve publike, në kundërshtim me nenet 3- "Parimet e përzgjedhjeje", 98- "Anulimi i një procedure", 76- "Kriteret detyruese për skualifikim" dhe 92- "Shqyrtimi i ofertave" të Ligjit nr. 162/2020, datë 23/12/2020 "Për Prokurimin Publik", si dhe nenet 67- "Klasifikimi i ofertave", 82- "Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave" dhe 83- "Njoftimi i fituesit" të VKM nr. 285, datë 19.5.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, personat përgjegjës të evidentuar dhe pasqyruar Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Mbështetur në nenin 15, të Ligjit nr. 154/2012, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"; nenin 132 të ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", si dhe shkronjat (b, c, ç) e nenin 58- "Llojet e masave disiplinore", të Ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 "Për kundërvajtjet administrative", i rekomandojmë **Kryetarit të Bashkisë Patos, ti kërkojë Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Prokurimit Publik**, të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e masave administrative (dënim me gjobë) në raport me shkeljet e konstatuara, apo rekomandimin autoritetit kontraktor (për marrjen e masave disiplinore), për:

a- anëtarët e Njesisë së Prokurimit, në mos argumentim dhe vendosje të kërkesave të specifikime teknike dhe kërkesat për kualifikim të pa argumentuara, veprime të cilat direkt ose indirekt çojnë në mospjesëmarrjen e OE në procedura duke ulur konkurrencën ose skualifikimin e OE me oferta më të leverdishme por me kapacitet për zbatimin e procedurës, të cilat nuk nxisin pjesëmarrjen e gjerë të OE në procedurat e prokurimit dhe konkurrencën ndërmjet OE, veprim në mospërputhje me kuadrin rregullator në fuqi në prokurimin publik, konkretisht; me nenet 1, 2 dhe pika 1 e nenit 21 të Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", si dhe nenet 41 -Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve dhe 78 "Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit" dhe me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 " Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

b- anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, në vlerësimin dhe shpallje fituese të OE jo në kushtet e plotësisht të të gjitha kriterëve kualifikuese, procedura të cilat duhej të ishin anuluar dhe njoftuar titullarit e AK për zhvillimin e procedurë tjetër me kushte më të favorshme ose midis OE të skualifikuar KVO të vlerësonte kriterin kryesorë "Çmimi më i leverdishëm", veprim në mospërputhje me kuadrin rregullator në fuqi në prokurimin publik, konkretisht ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2020, "Për prokurimin publik", i ndryshuar me ligjin neni 3, "Parimet e përzgjedhjeje", neni 98, "Anulimi i një procedure", neni 76 "Kriteret detyruese për skualifikim", neni 92, "Shqyrtimi i ofertave", , si dhe VKM nr. 285, datë 19.5.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 82, "Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave", neni 67, "Klasifikimi i ofertave", neni 83, "Njoftimi i fituesit". (Trajtuar në pikën 3.4 faqe 59-100 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Auditimi.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT